



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 6 DHE 7 DHJETOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 6. I 7. DECEMBRA 2018. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet biocide,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
9. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
10. Emërimi i një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe
11. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje N/zakona o budžetskoj podeli budžeta Republike Kosovo za 2019. godinu,
4. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o Ekonomsko- socijalnom savetu,
5. Prvo razmatranje N/zakona o biocidnim proizvodima,
6. Prvo razmatranje N/zakona Komori arhitekta i Komori inženjera u oblasti građevinarstva,
7. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni zakona br.20014/32 o porodici Kosova,
8. Razmatranje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
9. Razmatranje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine
10. Imenovanje jednog (1) člana Borda RTK-a, i
11. Izbor jednog (1) člana Nezavisne komisije za medije.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar zotërinj deputetë, zonja deputete,  
Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 3 dhjetor 2018.

Para se të hyjmë në pikat e rendit të ditës, zonja Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Grupit të Grave Deputete, e ka fjalën për ta bërë një deklaratë, e keni fjalën zonja Mexhide.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë, ministra,

Të nderuar të pranishëm,

Shumë të respektuar qytetarë,

Fushata 16 ditë e aktivizimit është fushatë botërore që organizohet çdo vit.

Fushata fillon më 25 nëntor, e njohur si Dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe përfundon më 10 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut.

Çdo vit përmes fushatës bëhen thirrej për veprime globale për të rritur ndërgjegjësimin në mbarë botën për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Të nderuar kolegë,

Sot po flas në cilësinë e kryesueses së Grupit të Grave Deputete për një çështje shumë të ndjeshme, siç është fenomeni dhunë. Në vendin tonë dhuna ndaj gruas vazhdon të jetë shumë shqetësuese, ku çdo vit raportohen rreth 1 000 raste të tilla, por që shpesh rezulton edhe me humbjen e jetës së tyre.

Humbja e jetës së nënave, bashkëshorteve, vajzave, motrave duhet të jetë një alarm për të gjitha institucionet përgjegjëse në vend.

Pavarësisht ndryshimeve pozitive dhe përparimit të arritur, veprimet e dhunshme nuk po mungojnë në përditshmërinë tonë. Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave po renditen një ndër shkaqet kryesore të dëmtimit të jetës njerëzore si dhe klasifikohen si shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Me këtë rast dua të tërheq vëmendjen e domosdoshmërisë së reagimit me kohë dhe sipas përgjegjësiwe institucionale të gjithë institucioneve shtetërore dhe mbarë shoqërisë, veçanërisht në rastet kur dhuna në familje lajmërohet dhe se është i pajustificueshëm mosveprimi apo dështimi i institucioneve përgjegjëse për të mbrojtur viktimën.

Ne të gjithë e dimë se Kosova ka një infrastrukturë mjaft të mirë ligjore. Institucionet e vendit kanë punuar shumë për të zhvilluar dhe nxjerrë ligjet dhe politika kombëtare, duke u mbështetur në instrumente ndërkombëtare për të trajtuar pabarazi gjinore dhe kushtet që diskriminojnë gratë, femrat dhe i vendosin në pozita nënshtuese në sfera publike dhe ato private dhe kjo tregon për angazhimin serioz dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të fenomenit dhunë në familje.

Në këtë sfond të përgjithshëm të situatës në lidhje me dhunën në familje, në mbarë botën janë përgatitur dhe kanë hyrë në fuqi një sërë konventash dhe traktatesh ndërkombëtare, një pjesë e të cilave janë të zbatueshme edhe në Kosovë.

Për të parë për së afërmi zbatimin apo moszbatimin e ligjeve si dhe problemet dhe nevojat e institucioneve, ne si Grup i Grave Deputete, bashkë me koordinatorin nacional kundër dhunës në familje si dhe Agjencia për Barazi Gjinore, për dy muaj rresht kemi realizuar vizita në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë themelore. Këto takime kanë qenë shumë përmbajtjesore dhe me interes, sepse nga këto takime ka rezultuar edhe gjendja siç është në vijim.

Për të mos ju marrë shumë kohë, janë radhitur shumë të gjetura, kështu që koordinatori nacional kundër dhunës në familje ka adresuar të gjitha këto të gjetura te ministrinë e linjës, po njëra prej tyre që ka dalë edhe si rezultat i debatit që ka qenë i realizuar më 8 mars, ka qenë kërkesë edhe plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit kundër dhunës në familje.

Të nderuar kolegë,

Është për t'u përhëndetur ky Kuvend me rastin e mbështetjes me votë të amendamentit të Grupit të Grave Deputete në Kodin Penal si dhe angazhimin e të gjitha institucioneve për të luftuar fenomenin dhunë, e vlerësoj lart këtë bashkëpunim ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës, organizatave ndërkombëtare dhe vendore, shoqërisë civile, mediave dhe të gjithë shoqërisë, sepse vetëm me përpjekje të përbashkët mund t'i japim fund dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe do të formësojmë një ambient të përgjithshëm ku dhuna ndaj grave është e papranueshme dhe e patolerueshme.

Në përmbyllje të fjalës sime më duhet të them se vizioni i përbashkët yni është që ne bashkë vendin tonë ta orientojmë drejt një shoqërie dhe një gjenerate të re që të mbajë qëndrim për tolerancë zero kundër dhunës në familje dhe që për synim të ketë barazi, paqe dhe harmoni.

Në fund dua të falënderoj Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Organizatën Woman që sot i kemi këtu për mbështetje, sot i kemi edhe fjongot këtu të vendosura në duart tona. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kemi sipas premtimit të dhënë votimin e propozim-rezolutës që e kemi diskutuar pardje, nuk e di a e keni harmonizua apo jo, dikush ta marrë fjalën e të na e sqarojë. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Në përputhje me qëndrimin këtu në seancë, dje e kemi ftuar në takim kryetarët e grupeve parlamentare nëpërmjet Sekretarisë në orën 15:00, nuk jemi harmonizuar për rezolutën të cilën e ka propozuar grupi ynë parlamentar dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, ju ftoj që këtë rezolutë ta hidhni në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë, edhe pse s'jeni harmonizuar, po kërkon të hedhet në votim.

Atëherë unë e hedh në votim rezolutën e propozuar nga dy grupet parlamentare që ka të bëjë me liberalizimin e vizave.

Ju njoftoj që në sallë janë 70 deputetë.

Ju lus që të përgatiteni ata që votojnë. Votojmë tani!

Është situata e mosmarrëveshjes.

Kanë votuar 42, 40 janë për, 1 kundër dhe 1 abstenim. Mbetet për një herë tjetër.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Rregullat i dimë të gjithë, fillojmë me radhës sipas paraqitjes. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën. Kush është në emër të grupit le ta thotë vetë, të mos i pyes unë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që së pari në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ta përshëndes dhe t'i jap përkrahje mesazhit në emër të Grupit të Grave, të cilën e paraqiti deputetja Mexhide Mjaku, duke përshëndetur dhe duke përcjellë mesazhin që dhuna në familje të parandalohet dhe shoqëria kosovare të demokratizohet ashtu siç i ka hije dhe respekt të gjitha vendeve të përparuara, sidomos kombit tonë shqiptar.

Kolegë deputetë,

Më lejoni që sot në emër të Grupit Parlamentar t'i paraqes dy çështje që për mendimin tonë janë shqetësuese dhe mendoj që duhet të marrim përgjigje dhe kahe të domosdoshme pozitive nga Qeveria e vendit, Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në vend që institucionet e Republikës së Kosovës, konkretisht krerët aktualë të bëjnë të pamundurën që të avancojnë tutje agjendë proevropiane dhe euroatlantike, të fuqizojnë subjektivitetin e brendshëm dhe të jashtëm të saj, neve po na ndodh e kundërta.

Me këtë Qeveri dhe këta individë çdo ditë po marrim nga një përgjigje negative dhe mesazhe që Kosova po largohet nga rruga proevropiane dhe po dobësohet statusi i saj shtetëror. Dështimi i anëtarësimit të Kosovës në Interpol, mosmarrja e përgjigjes pozitive këtë vit për liberalizimin e vizave dhe çështja për të cilin unë dua ta ngre konkretisht sot është tërheqja e njohjeve nga shtetet, të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Këtë përgjigje jo vetëm që nuk e kemi në mënyrë zyrtare, por as Qeveria dhe as institucioni i saj i Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk e ka një përgjigje adekuate dhe korrekte para qytetarëve të vendit dhe para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është shqetësuese, më tepër se sa shqetësuese është fenomeni që nëse vazhdon me këto tërheqje të njohjeve nga shtetet të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës, atëherë neve po rrëshqasim jo vetëm në dobësim por edhe në atë që e kemi quajtur gjithmonë rrezik permanent të zërit të shteteve, të cilat janë kundër Republikës së Kosovës dhe fenomenit tjetër të diplomacisë serbe, e cila po mbizotëron mbi punën dhe aktivitetin dhjetëvjeçar të shtetit dhe të diplomacisë tonë kosovare.

Andaj, ne thërrasim që të kemi përgjigje, Kuvendi duhet ta dijë saktësisht se çka po ndodh me tërheqje të njohjeve, cilët janë raportet zyrtare nga këto shtete, cili është komunikimi ndërshtetëror, cili është komunikimi diplomatik dhe të mos mbesim zë i heshtur, po të shohim mundësinë dhe të shohim se si duhet të ecim tutje.

Ajo çka është e evidente që ne e kemi theksuar, shpëtimi i Kosovës do të ishte ndërprerja sa më e shpejtë e mandatit të këtyre institucioneve dhe shkuarja në zgjedhje të reja, pastrimi i plotë i politikës nga njerëz me të kaluar kriminale, për të bërë një Qeveri ndryshe, zhvillimore dhe të përgjegjshme.

Dhe një fenomen tjetër, një çështje tjetër që unë dua ta potencoj personalisht, po sot edhe në emër të Grupit Parlamentar është që rinia e Kosovës, nxënësit e shkollave në Republikën e Kosovës çdo ditë po kërcënohen nga trafikantët e drogave dhe shpërndarësit e tyre.

E lus Qeverinë e Republikës së Kosovës, i bëj thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme që ta shtojë aktivitetin mbikëqyrës rreth shkollave, fillore dhe të mesme dhe nxënësit dhe fëmijët tanë të mos bien pre e këtyre delikenteve, të cilët çdo ditë e më shumë po e rrezikojnë të ardhmen tonë.

Unë kam bërë pyetje parlamentare pak muaj më parë, nuk kam marrë ndonjë përgjigje, përpos përgjigje të statistikave, por sot është evidente që Kosova nuk është më vetëm vend transit, ashtu siç e kanë paraqitur shpeshherë organizatat kredibile ndërkombëtare, por po shndërrohet në përdorues dhe kjo po e shkatërron të ardhmen e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta-Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Besoj shumë se ky Kuvend disa herë ka diskutuar për të drejtat e punëtorëve, kemi pasur debate të tëra, pastaj kemi dalë edhe me rezoluta e rekomandime të shumta që e kemi obliguar Qeverinë që të marrë masa karshi numrit të madh të punëtorëve, të cilët po e humbin jetën në vendin e tyre të punës.

Një rast i njëjtë ka ndodhur edhe para disa dite në Pejë, në fakt, një i ri nga Peja ka humbur jetën, nuk mundi t'u përballojë plagëve që pësoi një incident të rëndë derisa ishte në vendin e punës. Veterani i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndërroi jetë mbrëmë pas incidentit që kishte pasur në vendin e punës, ku ai siguronte ekzistencën e tij.

Vdekja e tij e çon në 22 numrin e personave që e kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës vetëm gjatë këtij viti.

Ky Kuvend disa herë ka diskutuar për pasigurinë që e kanë punëtorët në vendin e tyre të punës, për vonesat në paga, për moskompensimin e pushimit vjetor, për abuzimin me kontrata për praktikantë si dhe për mungesën e mbrojtjes ligjore të këtyre punëtorëve, të cilët punojnë në kushte aspak të lehta.

Këta janë vetëm disa nga faktorët që kanë ndikuar që ky numër të rritet edhe numri i të vdekurve në vendin e punës të jetë shqetësim për institucionet e Republikës së Kosovës.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministri Reçica, kohë më parë ka deklaruar se ministria të cilën ai e udhëheq do të jetë e pakompromis ndaj shkelësve të ligjit.

Ai madje ka premtuar avancim të të drejtave të punëtorëve dhe ka premtuar po ashtu edhe rritje të numrit të inspektorëve.

Me sa jam e informuar, është planifikuar një rritje e numrit të inspektorëve dhe besoj shumë që ministria që ai drejton duhet të fokusohet që të ketë edhe përkushtim më të madh të këtyre

inspektorëve që të mos dalin në terren vetëm kur të ndodhin incidente të tilla, por të jenë përherë në terren për të inspektuar nëse ka shkelje të tilla ligjore me punëtorët, e veçanërisht ata të cilët janë në sektorin privat.

Jo vetëm ky rast i fundit, por edhe raste të tjera e shtojnë domosdo nevojën që bizneset dhe punëdhënësit të respektojnë ligjet, të cilat i përcaktojnë të drejtat e punëtorëve.

Kërkoj nga ministri Reçica dhe Inspektorati i Punës që të marrin masa ndaj këtyre shkelësve, në mënyrë që ky numër të mos rritet në krahasim me vitet paraqake.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** Në nëntor të vitit 2015 u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asociimit për Kosovën dhe prej atëherë janë bërë tre vjet prej kur është nënshkruar kjo marrëveshje.

Një vit pasi u miratua në Kuvend të Kosovës kjo marrëveshje, pra në nëntor të vitit 2016, Qeveria e pati shpjeguar projektin e masave që duhet të ndërmarrë Republika e Kosovës, në mënyrë që ta zbatojë këtë marrëveshje me përpikëri dhe kjo e ka kuptimin e kësaj që po quhet “Agjenda e Reformave Evropiane”. Kjo është një pako reformash që del prej obligimeve që Kosova i ka marrë përmes MSA-s, por afatin e përmbushjes, ashtu siç është lansuar fillimisht kjo agjendë e reformave, e ka pasur në nëntor 2018. Pra, pakoja e parë e reformave të Agjendës Evropiane është dashur të realizohej prej nëntorit 2016 deri në nëntor 2018. Tash jemi në dhjetor hyjmë të vitit 2018 dhe nëse e shihni, le të themi, nivelin e realizueshmërisë të agjendës, është me të vërtetë për çdo kritikë.

Prej 22 prioriteteve dhe 135 masave që ka pasur t’i ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës, deri më tash janë zbatuar më pak se gjysma e tyre. Pra, ka vonesa të pajustificueshme në implementimin e reformave në Kosovë dhe kjo tregon se sa larg është Kosova në rrugën e saj të procesit të integriteteve evropiane. Komisari Han ka pasur të vijë në Kosovë për ta shpallur pakon e dytë të reformave, të Agjendës së Reformave Evropiane në Kosovë, sepse ajo duhej të ishte kryer në nëntor të këtij viti. Krejt çka i mbeti Komisarit Han fatkeqësisht, ishte që ta lajmëronte dështimin e liberalizimit të vizave. Në vend që ta shpallte pakon e dytë të reformave, e Qeveria ta kishte kryer këtë në nëntor, faktikisht Komisari Han nuk pati çka të vijë për tjetër gjë përveçse për ta lajmëruar Qeverinë dhe popullin e Kosovës që procesi i liberalizimit të vizave ka ngecur dhe që Kosova qëndron shumë keq në këtë aspekt.

Siç dihet, kjo pakoja e parë e Reformave të Agjendës Evropiane i ka tri shtylla dhe secilën prej shtyllave, nëse i shqyrtojmë veç e veç, Kosova ka ngecje të mëdha. Për shembull, shtylla e parë është sundimi i ligjit, e këtu hyn edhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit në Kosovë. Nëse e shohim gjendjen e gjyqësorit dhe performansën e gjyqësorit, nëse e analizojmë vullnetin



politik të qeverisë karshi drejtësisë, atëherë kjo qeveri meriton shumë kritika dhe luftimi i korrupsionit në Kosovë nuk e ka vullnetin e mjaftueshëm politik që të jetë një mision i suksesshëm. Në anën tjetër, edhe sa i përket asaj shtyllës së dytë, që është ekonomia, Kosova në shumë raporte ndërkombëtare sa i përket të bërit biznes dhe konkurrueshmërisë nuk ka bërë hapa përpara, përkundrazi, në shumë raporte mendohet dhe vlerësohet që në të vërtetë drejtimi është shqetësues.

Po ashtu, sa u përket çështjeve sociale që është shtylla e tretë e pakos së reformave, ku hynë punësimi dhe arsimit, unë mendoj që Kosova nuk ka bërë, kjo Qeveri nuk ka bërë asgjë substanciale. Vetëm shikojeni punësimin në Kosovë, nuk ka kurrfarë përmirësimi, të rinjtë nuk po shohin kurrfarë perspektive për ta gjetur një vend të punës në Kosovë, papunësia është afatgjate dhe kronike, kurse sa i përket arsimit, nuk kemi edhe çka shumë të flasim. Arsimit, kualiteti i arsimit në Kosovë është i mjerueshëm dhe Qeveria nuk ka bërë asnjë strategji, asnjë plan konkret për ta nxjerrë Kosovën prej kësaj gjendjeje. Kështu që është me të vërtetë pikëlluese qysh kjo pako ka mbet krejtësisht vetëm një diskurs politik i thatë dhe elektoral.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

**FATON TOPALLI:** I nderuar kryeministër!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuara deputete e deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot kemi 16 ditë të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, më lejoni që në fillim të këtij deklarimi jashtë rendit të ditës të shpreh dëshirën, vullnetin dhe angazhimin e Partisë Socialdemokrate që këto ditë, këto 16 ditë kundër dhunës ndaj grave të kthehen në 365 ditë të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, sepse dhuna ndaj grave është diçka e përditshme dhe nuk është çështje e 16 ditëve.

E dyta që dua të shtroj para se të shtroj çështjen kryesore për të cilën ndodhem këtu, është deklarimi jashtë rendit të ditës të zonjës Deliu lidhur me të drejtat e punëtorëve, për të cilën unë pajtohem tërësisht dhe ju inkurajoj edhe juve, si shumicë në pozitë, që të vazhdoni këtë trend. Ajo që thjesht po më pengon është që ju keni shumicën parlamentare, ju keni Qeverinë, ju i keni ministrat tuaj, prandaj nëse thuhet vetëm fjalë, ato mbesin demagogji nëse nuk implementohen në praktikë. E ju, si shumicë parlamentare nuk keni asnjë problem për t'i realizuar ato, të cilat po i shtroni kështu vetëm si deklarime jashtë rendit të ditës.

Tema për të cilën unë ndodhem këtu ka të bëjë me Kuvendin dhe më shumë ka të bëjë me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

I nderuar zoti kryeministër,

Me sa mbaj mend unë, në fillim të mandatit tuaj keni deklaruar se do t'i ndaloni udhëtimet turistike jashtë vendit, udhëtimet e punës, e një varg udhëtuesh të tjera, të cilat, në fakt, deklarohen si udhëtime të punës, si udhëtime për punë, por në fakt dhe në thelb në përmbajtje nuk janë asgjë tjetër përveç se udhëtime turistike. Këtë që thashë nuk jam shumë i sigurt nëse kjo deklaratë ishte pikërisht kështu siç thashë unë, po me sa mbaj mend kështu ka qenë, e ju mund të më korrigjoni. Në të njëjtën kohë po i drejtohem edhe kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili gjithashtu mban përgjegjësinë e tij të caktuar së bashku me të gjithë ne deputetët që jemi këtu.

Fakt është që ministrat e ndryshme dhe komisionet organizojnë një varg takimesh pune jashtë vendit, si për shembull, për amendamentimin e një ligji, për përmirësimin e një ligji, thjesht punë, të cilat ne do të duhej t'i kryenim këtu në Republikën e Kosovës, madje në zyrat e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këto udhëtime zakonisht organizohen në Shqipëri, Greqi, Mal të Zi, Turqi, janë zakonisht udhëtime të panevojshme që ngarkojnë jashtëzakonisht shumë buxhetin e Republikës së Kosovës, në një kohë kur shumica e qytetarëve të Kosovës janë qytetarë të varfër, në kohën kur 26 mijë familje në Republikën e Kosovës që marrin asistencë sociale jetojnë diku me nga 1.60 centë në ditë, madje edhe më pak. Ndërsa, ne si Kuvend, si njerëz të përgjegjshëm, të zgjedhur nga qytetarët e Republikës së Kosovës harxhojmë, shpenzojmë thjesht kot për nevojat tona personale, për nevojat tona për të udhëtuar jashtë vendit dhe ndonjëherë për të bërë edhe shopping në këto vende.

Ajo që më duhet ta them dhe që është sigurisht kështu, që në shumë udhëtime shpenzohet më shumë kohë për udhëtimin, për drekat, darkat dhe mëngjeset se sa koha që shpenzohet vërtet për punë. Për një udhëtim e di që vetëm njëra rrugë ka zgjat 5 orë, rruga tjetër e kthimit po aq, drekat, darkat e mëngjeset diku edhe 9 orë të tjera, pra që i bie 19 orë të shpenzuara kot. Ndërsa, në komision është punuar vetëm 5 orë. Pse duhet të dalim jashtë vendit për të organizuar, për të kryer punën, të cilën duhet ta bëjmë brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës? Pse disa ministra dhe disa ministri duhet t'i dërgojnë deputetët për punë jashtë vendit, duke i korruptuar në njëfarë mënyre legale për t'i miratuar ligjet që ata i sjellin? Pse ky korrupsion brenda nesh? Pse nuk kërkohet përgjegjësi nga kryetarët e komisioneve, respektivisht nga komisionet, të cilat gjatë afatit kohor nuk i kryejnë ligjet këtu? Pse duhet të dalë jashtë vendit për të punuar për ligje? Pse duhet udhëtime turistike, e pse duhet ahengje të verës e rakisë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu!

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Sot kam dalë këtu për një çështje, të cilën e kam ngritur edhe disa herë. Por, së fundmi disa studentë të programit Master, “Udhëheqja arsimore”, na janë drejtuar si deputetë, si anëtarë të Komisionit për Arsimit për të ndërmarrë masa për të ndryshuar, pra për të bërë presion te Ministria e Arsimit për të ndryshuar Udhëzimin administrativ të vitit 2014 që është kriter, pra për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve.

Një shkresë nga komisioni i ka shkuar ministrit të Arsimit dhe uroj që shumë seriozisht ta marrë Ministria e Arsimit. Por, prapë një çështje, të cilën Ministria e Arsimit megjithatë mori një vendim për të mos u plaçkitur më mësimdhënësit, por tanimë unë kërkoj këtu që të gjitha pagesat që janë marrë nga mësimdhënësit, nga 250 euro, t’u kthehen atyre. Ngase, në certifikatat e lëshuara është nënshkrimi i zyrtarit të Ministrisë së Arsimit, është nënshkrimi i zyrtarit të GIZ-it, me të cilët kam biseduar me ta dhe ata vërtet janë të shqetësuar për këtë keqpërdorim dhe unë kërkoj nga Ministria e Arsimit që t’ua kthejë mësimdhënësve, secilit mësimdhënës që ka paguar 250 euro t’u kthehen të hollat, ngase është buxheti për trajnime në kuadër të MASHT-it.

Pra, gjatë kësaj kohe megjithatë ky trajnim që është mbajtur nëpër objektet publike, të cilat janë keqpërdorur duke u shpenzuar edhe energjia, edhe derivatet për ngrohje, në vend se të përdoren për nxënësit, për 21 ditë janë përdorur jashtë këtyre pagesave që janë marrë janë përdorur edhe objektet shkollore. Prandaj, edhe një herë Ministria e Arsimit e ka përgjegjësi që në kuadër të objektivave të veta të planifikojë, pra që ky Udhëzim administrativ të ndryshohet sa më parë dhe të mos krahasohet një trajnim me një program të Masterit që ka tre semestra dhe të nënvlerësohet, atëherë cilat janë politikat dhe pse thjesht ka programe të studimit, përderisa gjithçka mund të shkojë përmes trajnimeve apo përmes përfitimeve që shumë herë kanë ndodhur e ndodhin edhe sot edhe nga deputetët brenda Kuvendit të Kosovës që fatkeqësisht e kanë përdorur dhe po e përdorin edhe sot e kësaj dite këtë rrugë alternative për të përfituar në kurriz të mësimdhënësve. Urgjentisht kërkoj nga Ministria e Arsimit që të merret seriozisht me këtë çështje dhe t’ua kthejë të gjitha të hollat mësimdhënësve.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zafir Berisha!

**ZAFIR BERISHA:** Faleminderit, kryesues!

Pajtohem me gjithë shqetësimet, solidarizimet që u thanë deri tash nga kolegët, por sido që të jetë, unë në emër të Nismës Socialdemokrate nuk po mundem pa u fokusuar në çështjet që janë jetike për vendim dhe që lidhen me Kosovën. Me keqardhje them se shumë probleme të tjera po mbesin në rend të dytë për shkak të politikave të mëdha të Kosovës dhe rreth Kosovës.

Zhvillimet e fundit që po ndodhin në Kosovë dhe jashtë Kosovës për Kosovën mendoj se kanë nxjerrë si nevojë urgjente unifikimin e angazhimeve të forcave politike për interesin e vendit, sepse duke pasur këso qëndrime dhe mendime parciale në interes të politikës ditore, unë mendoj

se Kosova po mbetet në rend të dytë karshi interesave të ngushta partive, por edhe të individëve. Mosliberalizimi i vizave, mospranimi i Kosovës në Interpol, unë mendoj se nuk është çështje, as e kësaj Qeverie, as e Qeverisë së kaluar, por është çështje e të gjithë forcave politike e të gjithë qytetarëve, nga ku mendoj se ne duhet të marrim një mësim dhe të mendojmë pak më shumë për perspektivën e vendit tonë dhe për interesin e qytetarëve.

Mendoj se ne nuk duhet të biem viktimë si shoqëri dhe si shtet edhe në rast se nuk liberalizohen vizat. Kosova është Evropë dhe synon drejt Evropës dhe mendoj se nuk duhet dhënë hapësirë mendimeve e qëndrimeve të individëve dhe të shoqërive të caktuara që Kosova të rrëshqasë drejt Lindjes po qe se nuk ka liberalizim të vizave. Ne mund dhe duhet të rrëshqasim rreth vetvetes, të veprojmë dhe të mendojmë shqip, por jo për shkak të ndonjë qëndrimi momental që mund të ndodhemi, siç ka ndodhur dhe pritet të ndodhë rreth Kosovës dhe për Kosovën, ne të bëjmë hapa të ngutshëm dhe të gabueshëm edhe si rezultat i aventurierëve politikë, siç është edhe presidenti aktual, i cili me idetë dhe propozimet e tij shpeshherë shoqërinë tonë e vë në siklet dhe në pozita jo të lakmueshme.

Kosova më 2008 e ka shpallur pavarësinë e vet si shtet i pavarur, e cila vjen si rezultat i angazhimeve të qytetarëve në dekada dhe luftës titanike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj mbi këtë sakrificë dhe këtë mund mendoj se duhet të angazhohemi të gjithë dhe për këtë edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në korrik 2010 e ka dhënë mendimin e vet dhe të gjitha veprimet dhe qëndrimet e Kosovës si shtet duhet t'i marrim si tonat, pavarësisht pozicionit në të cilin gjendemi momentalisht.

Edhe qëndrimi dhe vendimi i Qeverisë për taksën, edhe dështimi i Qeverisë në ndonjë rast, kur është në pyetje veçanërisht Serbia, mendoj se nuk duhet t'i shfrytëzojmë për përfitime të politikës ditore. Kërcënimet e djeshme, veçanërisht që vijnë nga kryeministrja e Serbisë drejt Kosovës, duke e përmendur ushtrinë, forcën dhe luftën, unë edhe një herë mendoj se i takojnë së kaluarës. Por, gjithsesi, nuk jam i mendimit që ne këtë ta llogaritim vetëm si deklaratë të momentit, për shkak se ne qe e mbajmë mend mirë në fund të viteve të '80-a dhe fillim të viteve të '90-ta, zhvillimet të cilat më vonë do të jenë tragjike, kanë filluar nga deklaratat dhe qëndrime të kësaj natyre.

Mendoj se karshi këtyre kërcënimeve që i bëhen shtetit, ne duhet të kemi qëndrime të përbashkëta dhe është momenti i fundit që forcat politike në raport me situatën në të cilën gjendet Kosova të bashkohen dhe të krijojnë një platformë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, zoti nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Medie,

Kor diplomatik,

Unë sot kam një thirrje për ne të gjithë këtu që jemi. Kam një thirrje, një ftesë edhe për të gjithë liderët politikë që të bëjnë unifikimin dhe të dalim nga ky kolaps, nga kjo çështje që me të vërtetë nuk po na bën nder. Mos harroni se edhe pozita edhe opozita janë përgjegjëse për dështimin e Kosovës. Prandaj, nëse dikush do të dështojë, do të dështojmë të gjithë.

O sot, o kurrë, duhet të jemi unikë dhe të shkojmë përpara. Të mos ia bëjmë sikur një fjalë popullore “Për inati të resë, më vdektë edhe djali”. Hiqini interesat e ngushta politike dhe të dalim nga kjo çështje dhe të shkojmë përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është shteruar koha prej 30 minutash që e kemi në dispozicion për këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuara medie,

E mora fjalën edhe si reflektim i asaj që u diskutua, po edhe për interesin e temave që do t'i paraqes para jush, pa dashur të rikthehem te Interpoli, pra te mosvotimi ynë në Interpol, mosmarrja e votës, për mosmarrjen ende të liberalizimit, pra nuk është se na është hequr ajo e drejtë, por ende s'ka ndodhur marrja e liberalizimit. Mos e harroni fjalën “ende”, përdoreni ndonjëherë se vlen, edhe proceset e brendshme që po i kalojmë. Por, pa hyrë për t'i shpjegua e shtjelluar këto, më duhet të ju them për dy aspekte që kisha kërkuar ndihmën tuaj.

Serbia është mobilizuar në një narrativ të vetin dhe e shpjegon Kosovën si “vend që ka dalë prej binarëve të vet”, si vend që “po do t'i zgjidhë problemet me një kryeneçësi”, “me një arrogancë të caktuar”, “me mosdëgjueshmëri, edhe politike, edhe të sigurisë”. Për pjesën politike e të sigurisë argumentohet ose arsyetohet me faktin se Kosova nuk ka përmbushur pjesë të marrëveshjeve të Brukselit, pra AKS-në, dhe njëkohësisht e shfrytëzon shumë mirë vendimin tonë të fundit për masën 100% ndaj produkteve serbe të Serbisë dhe Bosnjës. Njëkohësisht, Serbia punon intensivisht me diplomatët e vet, me mediet e veta, me lobistët e vet, që ta paraqesë Kosovën si një vend i dalë prej kontrollit në siguri, për faktin se Kosova në njëloj padëgjueshmërie dëshiron ta krijojë ushtrinë e vet, e ushtri të cilën e ka për qëllime jo të

stabilitetit, ose të sigurisë, por për të krijuar destabilizim. Janë shumë proaktivë, punojnë intensivisht në këtë.

Sa i përket narrativit të josigurisë dhe jostabilitetit, ne të gjithë mund t'ua kthejmë përgjigjet e sakta dhe të qarta, e kurrkush prej atyre që jetojnë në Kosovë s'ka interes për jostabilitet, as shqiptarët si shumicë, as serbët, as ata të veriut, e as ata në jug. Në fakt, ne jostabilitetin, ose mungesën e sigurisë së paqes, e vuajmë dhe të gjithë punojmë për më shumë paqe, edhe NATO-ja, edhe institucionet e Kosovës, edhe populli i Kosovës. Të vetmit që i intereson ndonjë skenar për të mundur ta nxjerrë Kosovën të çrregulluar nga normaliteti është Beogradi zyrtar. Ata do të bëjnë përpjekje në mënyra të ndryshme për të ardhur deri te mundësia e ndonjë situatë të këfillë.

Populli i Kosovës është mirë ta kuptojë që ne si Kosovë kemi interes për stabilitet, kemi interes për vazhdimësi. Na kanë humbur disa hapa, i përmendëm, ata vërtet janë mungesa, pra mosanëtarësimi në Interpol, mosliberalizimi i vizave ende, por ne s'kemi interes që të mos e krijojmë një vazhdimësi në qëllimet tona. Pra, është interesi ynë.

Krijimi i Ushtrisë së Kosovës, mandatimi i ushtrisë javën që vjen, të premtën, me sa di unë është më 14, ashtu siç e keni në agjendë si Parlament, është proces i brendshëm, është vendim sovran i vendit dhe është në përputhje me Kushtetutën tonë, një kushtetutë ndër më të avancuarat në botë, për të drejtat e komuniteteve, për respektimin e konventave tjera ndërkombëtare, një kushtetutë që ngërthen ose përmban më vete vlerat më të avancuara të një demokracie dhe këtë e kanë konfirmuar të gjithë ata që na kanë përkrahur në këtë kushtetutë. Jo vetëm kaq, për formimin e Ushtrisë së Kosovës ne kemi zhvilluar biseda intensive me të gjitha palët e interesuara, pra me të gjitha palët e interesuara. E vërteta është se Aleanca e NATO-s po ashtu ka peshë të madhe në mendimet e veta, në ato që i shpreh për Kosovën, është e pranishme në Kosovë. Mirëpo, Kosova është e sigurt që asnjëherë nuk do t'i sjellë në rrezik marrëdhëniet me aleancën e NATO-s. Ne ende s'kemi aplikuar për anëtarësim në NATO dhe kur të aplikojmë është shumë me rëndësi që t'i kemi sqarimet e duhura për secilin vend anëtar të NATO-s.

Meqenëse jemi vend i vogël, jo për mosrespekt, por vend i vogël me mundësi të kufizuara, Fatoni tha "s'duhet udhëtuar tepër", në fakt ne mirë do të ishte të udhëtojmë kur duhet e të mos udhëtojmë kur s'duhet, nuk kemi mbërri që çdo qeverie anëtare të NATO-s t'ia shpjegojmë të vërtetën e transformimit të FSK-së, por ne i kemi plotësuar ato kushte, po them bazike, të sqarimeve për të ecur përpara me ushtrinë tonë. Pra, i kemi plotësuar. Me këtë, jo vetëm që s'do vihet në rrezik marrëdhënia jonë me NATO-n, por përkundrazi, nga ata që absorbojnë siguri, ne në të ardhmen do të ofrojmë siguri. I keni dëgjuar në këtë narrativin e tyre të militarizimit reagimet se Kosova nuk ka nevojë për ushtri ta ndihmojë paqen, se është atje, luftëtarët pra në lufta të huaja. E vërteta është, shikoni, ne kemi ligj kundër pjesëmarrjes në luftëra të huaja. Kosova ka ligj. Ata që shkojnë atje kanë sanksione ligjore prej Kosove, ndërsa sot në listën e pagesave të Serbisë, qoftë si veteranë, qoftë si zyrtarë të pensionuar, janë plot që janë në Ukrainë

dhe që janë në Siri, në anën e rusëve. Le ta dinë edhe Serbia, por le ta dinë edhe BE-ja, edhe NATO-ja, e vërteta është kjo, pra nuk i kanë hequr prej listës së pagesave. Krejt ata mercenarë që e rrezikojnë sigurinë e Evropës dhe që po e rrezikojnë sigurinë edhe atje, janë në listë të pagesave, i kanë në listë të pagesave.

Duke qenë kështu, të nderuar, ne do të ecim rrugës sonë me vendimin për ushtrinë. Nuk është militarizim, është një narrativ i qëllimshëm nga Serbia. Nuk i dedikohet krijimi i ushtrisë sulmit në veri, është rrenë e tyre qysh dinë ta bëjnë, e bëjnë gabim që e frikësojnë popullin serb. Ne do të ndërmarrim veprime sqaruese për serbët e Kosovës. Dje kam qenë në Plemetin, do të shkoj në çdo vend të Kosovës për ta sqaruar, se narrativi që u jepet nga Serbia është i qëllimshëm, është i rrejshëm dhe ju viktimizon juve, mos bini pre e kësaj.

Tek taksa 100%, shikoni, unë ju falënderoj për përkrahjen. E di se të gjithë e përkrahni me zemër. Nuk besoj se ka dikush që s'ndihet mirë sot në këtë Parlament për këtë taksë, mirëpo edhe duhet ta ndërtojmë një narrativ kundër mundësisë që Kosova të bjerë në gabime humanitare. Mënyra të tjera për të na detyruar ta heqim këtë nuk ka Beogradi zyrtar, por e ka një mënyrë të na krijojnë pasoja në planin humanitar, të na nxjerrin neve si ata që “nuk i respektojmë nevojat njerëzore”, që “s'dimë t'i ruajmë në situata emergjente ata që janë të rrezikuar”. Dogana e Kosovës, Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës janë vërtet kampione për respektimin e të drejtave njerëzore e humanitare. Kanë lejuar të mira humanitare në çdo rast humanitar pa asnjë pengesë, por kurrë s'përrjashtohet mundësia që do të inskenohet ndonjë rast i ndonjë vdekjeje natyrore diku në ndonjë spital në Kosovë, e të thonë se kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së kësaj e të kësaj...

Pra, skenarë të tillë edhe mund t'i presim bashkë. Ju kisha lutur që ta përkrahni narrativin e vendit tuaj, mos lejoni në këto periudha kur i kaloni këto etapa të ecim. Nuk dua të ju mbaj më shumë me fjalime edukuese, se ne të gjithë e ndiejmë njësoj atë që po e kalojmë si vend dhe nuk dua të kthehem në tema të tjera. Secili e ka të drejtën e vet, ata që janë në pozitë e kanë të veten, se kanë marrë përgjegjësi, ata që janë në opozitë e kanë të veten, unë e respektoj atë. Por, ju lus që në këto narrative ndihmoheni vendin e juaj, se është interesi i të gjithë neve.

Për fund, desha vetëm të ju them për proceset integruese. Shiko, Serbia ka për të provuar gradualisht t'i hapë kapitujt për vete. Ata edhe punojnë intensivisht që të gjendet forma të hapen këta kapituj. Edhe ne dimë këtë. Edhe e dimë që në Bruksel iu intereson që Serbia t'i hapë këta kapituj. Pra, e kanë interes në fund të fundit.

Çka bën Kosova në këtë rast? Po, mirë është që Parlamenti të arrijë ta gjejë formulën ta konsolidojë Kosovën si palë. Kosova i ka dobësitë e veta. Të gjithë i kemi mendimet tona se ku janë ato dobësi. Por, mirë është ta konsolidojmë si palë dhe njëkohësisht atë që Qeveria po e bën, se ne nuk po flasim, unë e dëgjoj debatin për një rezolutë, për një ligj, për të gjitha ato që ne

flasim në Parlament, por nuk është vetëm kjo. Ne jemi duke shkuar me Serbinë për një kontratë ‘comprehensive agreement’, pra gjithëpërfshirëse, ku çdo temë e mundshme që ndërlidhet ndërmjet dy vendeve do të bëhet pjesë e një dokumenti të madh.

Ta keni parasysh, nga kualiteti i njerëzve që marrin pjesë për këto tema, se nuk është veç a po e njohim njëri-tjetrin një ditë. Ata që thonë drejt është në detaje, nga kualiteti i njerëzve që marrin pjesë në hartimin e këtyre dokumenteve, do të varet kontrata në fund. Nuk është veç vullnet politik e patriotik e kombëtar e besnikëri ndaj vendit, është edhe shkallë e ekspertizës që duhet ta kemi. Pse po e them këtë? Si Qeveri jemi duke punuar në këtë kontratë. Ne jemi duke punuar intensivisht, por ne nuk jemi ata që shkojmë ta përfaqësojmë, ta nxjerrim në tavolinë. Kushdo që e përfaqëson Kosovën, që është dakordimi i Parlamentit, nuk do të shkojë veç me një letër të veten në xhep, kushdo qoftë, por do të shkojë me një material, në të cilin edhe ju do ta keni të dhënë mendimin juaj. Pra, nuk ka rrezik të ju befasojë dikush, ju siguroj në këtë.

Pra, në të kaluarën, ne kemi shkuar në diskutime, por na kanë dhënë materiale anash. Ja kjo kemi menduar se është qysh duhet të merren vesh të palët. Nuk është krejt ashtu. Kosova ka bukur shumë njerëz, ka bukur shumë ekspertizë, ka kapacitet në vend.

Ne po punojmë një kontratë të gjerë me krejt kapitujt e vet. Njëri nga kapitujt do të jetë tregtia e lirë dhe taksa dhe të gjithë do ta keni mundësinë, ashtu si ju kemi sjellë një herë raportin për marrëveshjet që kanë ndodhur deri tash, ta shihni materialin me të cilin vendi ynë do të prezantojë, totalin e materialit. Një pjesë janë klauzola politike, i kuptojmë, por mos harroni se do të jetë shumë me rëndësi krejt çka përmban një marrëveshje ndërmjet dy vendeve, një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Nuk e di dinamikën. Ajo që unë mendoj që është me rëndësi e që e dimë të gjithë, do ta kemi të pamundur dikush prej nesh të dalë, qoftë prej 17 Shkurtit, qoftë me dalë prej GJND-së. Pra, është e pamundur dikush ta nxjerrë Kosovën jashtë këtyre dy pozicioneve.

Edhe materialet që i përgatit Qeveria, i respektojnë pikërisht këto dokumente nga të cilat ne edhe ekzistojmë. Pra, nuk do të jenë materiale që në asnjë variant dalin nga kjo që po flasim sot. Ne do të jemi bashkë gjatë gjithë kohës, edhe këto ditë, edhe ditëve të tjera.

Ju lutem në momentin e diskutimeve të tilla të dy narrativëve që kemi, një të militarizimit ose të destabilizimit që po provohet nga Serbia të nxirret, dy, të daljes prej binarëve gjoja të integritit evropian e të interesimi për Evropë, ose të daljes prej binarëve politikë të Kosovës, mos i ndihmoni, nuk janë tanët, nuk janë tuajt, nuk janë të asnjë grupi këto. Dihet kush i ka këta skenarë, mos i ndihmoni. Kjo është një lloj paqeje dimërore që na bën hair të gjithë neve. Se kjo kalon, jo se ka për t’u hequr taksa, taksa nuk do të hiqet deri në marrëveshjen gjithëpërfshirëse, ku janë kapitujt e tjerë, ku është edhe kjo, por ushtria kalon më datën 14, kalon në mënyrë të dinjitetshme, pastaj hyn në një etapë tjetër.



Shiko, atë ditë që vendos Parlamenti ta çojë vendin në zgjedhje, atë ditë të gjithë ne i obligohemi, kurdo qoftë ajo ditë, por ju lutem këtë narrativ mos lejoni që Parlamenti pra të mos e japë pjesën e vet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kryeministër!

Atëherë po kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Por, para se të kaloj, nuk desha që ta aplikoj një praktikë që do ta bëjmë sa i përket pjesëmarrjes së Qeverisë, edhe ministrave në seanca. Ne, përveç shpalljes në faqen zyrtare, pas çdo seance do të tregojmë se kush ka marrë pjesë dhe kush s'ka marrë pjesë publikisht në përgjigjet që deputetët ua bëjnë ministrave.

Kësaj radhe nuk e kanë pasur informatën, por nga seanca e ardhshme besoj është një praktikë që bëhet dhe një presion që duhet t'u bëhet ministrave për të qenë në seancë.

Para se të fillojmë, dua që në emër tuajin, siç e dini, Kosova, përkatësisht Presidenti i Kosovës dje ka shpallur ditë zie. Ka ndërruar jetë ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Xhorxh Bush i Vjetër, e dihet qëndrimi dhe dashuria që e kemi për SHBA-të dhe për të gjithë presidentët me radhë, por Ai ka luajtur një rol të veçantë sa u përket interesave edhe të Kosovës, por edhe të vendeve kudo në botë që kanë luftuar dhe e kanë pretenduar lirinë dhe demokracinë. Por, neve na ka mbetur në kujtim më së shumti ai deklarimi publik dhe zyrtar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që Serbia e ka vijën e kuqe në qoftë se ndërhyr në Kosovë. Zoti Bush i ndjeri e deklaroi dhe presidenti i radhës nga partia tjetër e zbatoi një vendim të tillë.

Prandaj, ju lus që me një minutë heshtje Parlamenti të ngrihet në këmbë për të mbajtur zi për zotin Bush.

*(Një minutë heshtje)*

Atëherë zonja dhe zotërinj deputetë po fillojmë me pikën e radhës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Po fillojmë menjëherë. Deputeti Adem Mikullovc, pyetje për ministrin Uran Ismaili. Zoti Mikullovc, e keni fjalën.

**ADEM MIKULLOVCI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Sali Krasniqi është specialist për laparoskop. Është mjek, një nga mjekët më të mirë që kemi dhe është ekspert për laparoskop. Dy vjetët e fundit për shkaqe shëndetësore, zoti ministër, ai ka punuar me orar të shkurtuar. Tash i është thënë ose orarin e plotë, ose urdhëro në pension. I duhen edhe tre vjet për t'i bërë 65, për t'u pensionuar. Mendoj se një ekspert si Sali Krasniqin duhet ta mbajmë, pa makar që ta bëjë një operacion në muaj. Ta shpëtojë një jetë në muaj,

mjafton. Është nga të rrallët dhe shpeshherë kur janë në pyetje primariuset, mjekët, ekspertët, disa të Institutit të Mjekësisë, duhet të jemi pak më fleksibilë. Aq më tepër, unë atje e mora vesh në spital që ka intenca që krejt Reparti i Laparoskopisë të mbyllet, e të shkojnë pacientët tanë në të ardhmen te privatistët të paguajnë para prej xhepi. Apeloj që Sali Krasniqi të mbahet në punë edhe tre vjet, deri në pensionin e plotë.

**KRYETARI:** Zoti ministër, e keni fjalën.

**MINISTRI URAN ISMAILI:** Faleminderit, deputet Mikullovc!

Informatat që unë i kam marrë nga shërbimi spitalor, doktor Krasniqi as nuk është larguar nga puna, as nuk i është ndërprerë kontrata, apo marrëdhënia e punës. Në këtë rast, as nuk është suspenduar, ose pensionuar. Pra, ai është në një pushim mjekësor. Edhe pse ky rast nuk është suspendim, as ndërprerje e marrëdhënies së punës, duhet ta kemi të qartë secili nga ne që punëtorët, të cilët punojnë në spitalet tona, janë në një orar prej tetë orëve, për arsye se pacientët kanë nevojë për ta. Pra, në qoftë se fillojmë që të konsiderojmë që disa nga mjekët të punojnë sipas mundësive që ata i kanë, atëherë ne e rrezikojmë gjithë sistemin shëndetësor, për faktin që do të kemi një si ta quaj fontanë dëshirash të mjekëve të caktuar, të cilët thonë “unë mund të punoj dy orë, unë mund të punoj tri orë, ose unë mund të punoj gjashtë orë”.

Është e vërtetë që në qoftë se një operacion shpëton jetë, ai mjek është i rëndësishëm, mirëpo në qoftë se është në orar të punës tetë orë, e ka mundësinë t’i shpëtojë tri jetë, e jo veç një. Mungesa e mjekëve tanë, e sidomos kur dihet se Kosova e ka një numër të vogël të mjekëve për njëmijë banorë, atëherë secili mjek është e rëndësishme që ta respektojë orarin e vet të punës dhe të qëndrojë në punë. Pra, po flas në mënyrë të përgjithshme.

Në rastin specifik, atë që e ngrehët ju, ashtu siç thashë, ai ende nuk ka asnjë lloj shkëputje të marrëdhënies ose gjëra të tilla, por është në pushim mjekësor, mirëpo edhe si Kuvend, edhe si Qeveri, konsideroj që është një punë me pak rrezik në qoftë se ne fillojmë t’i trajtojmë individët në bazë të kërkesave individuale, e jo në bazë të asaj çfarë ka nevojë sistemi shëndetësor. Shumë nga deputetët këtu po besoj bile nga një mjek e kanë të njohur, të mos them disa që kanë më shumë. Po që se fillojnë ata t’i shfaqin, jo për sistemin shëndetësor, por për individët si individë për mjekë, atëherë do ta rrezikojmë seriozisht sigurinë e pacientëve dhe tërë sistemin shëndetësor.

Apeli im, ashtu si edhe i juve, është që të gjithë profesionistët shëndetësorë të qëndrojnë në spitalet publike, ta kryejnë punën në tetë orë, të cilat i kanë të përcaktuara me ligj, në mënyrë që pacientët tanë të mos bredhin nëpër spitale private për t’i kërkuar ata, por të jenë në spitale publike ku e marrim shërbimin të gjithë ne.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Mikullovc, pyetje shtesë?

ADEM MIKULLOVCI: Zoti ministër!

Unë pajtohem plotësisht, por mos të harrojmë se ka mjek edhe “mjek”, ka specialist dhe “specialistë”. Sali Krasniqi është ekspert, është një nga të rrallët, është vërtet një primarius që ka bërë mbi 21 mijë operacione me sukses. Atë njeri duhet mbajtur medoemos në punë, me zor. Edhe kur ta mbushë moshën, duhet kthyer bar një herë në javë të vijë në spital. Kjo është përgjigja ime.

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI URAN ISMAILI: Deputet, ju po flisni për diçka, e cila duhet të ndodhë jo vetëm nga një ekspert, por sot ne jemi duke investuar që çështja e laparaskopisë të shpërndahet në klinika të ndryshme, e të mos mbetet te një njeri. Sepse shumica e mjekëve edhe këtu që janë e dinë se sot shumë operacione mund të kryhen nëpërmjet laparoskopit, pra duke mos pasur nevojë për një qendër, por duke pasur mundësi që shumë pacientë ta marrin atë shërbim. Pra, ideja që ne ta koncentrojmë të gjithë shërbimin te një njeri, është ide paksa e rrezikshme për pacientët tanë, mendoj unë.

Në këtë rast, që qoftë se ju dëshironi që t’i mbetet veç dikujt, ai doemos dikur do të dalë në pension. Mos daltë sot, do të dalë pas tre vjetësh, pas katër vjetësh, mandej çka do të bëjë Kosova? D.m.th., çka do të bëjmë me atë qendër? Do ta mbyllim? Pra, qëndrimi ynë është që shkathhtësitë të cilat kanë qenë të koncentruara te një njeri, t’i shpërndajmë në sistemin tonë shëndetësor, që më shumë klinika të kenë mundësi të marrin më shumë shërbime, si ai, si profesori i nderuar, si secili mjek tjetër në Kosovë, i kanë dyert të hapura në institucione publike që ta kryejnë punën e tyre në orar të caktuar. Ata mjekë të cilët konsiderojnë se mund të vijnë në institucione publike me orar të cilin ia përshtatin vetes, po më vjen keq, po as ligjet e Kosovës nuk lejojnë dhe po besoj që edhe vullneti ynë politik si i Qeverisë ashtu edhe i Kuvendit duhet të jetë që oraret të mos krijohen sipas qejfeve kur të duash të hyhet dhe kur të duash të dilet, mirëpo sipas kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Republikës së Kosovës, pacientëve të cilët presin ndoshta në radhë shumë që të mund ta marrin një shërbim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Po ju ndihmoj pak edhe juve edhe bacës Adem, problemi i profesionistëve si profesor Sali Krasniqi dhe profesorëve të tjerë në Qendrën Klinike Universitare do të zgjidhet besoj me Ligjin e Pagave, ku do të vlerësohet se puna në QKUK është punë integruar e mësimdhënies së ofrimit të shërbimit shëndetësor. Besoj që edhe ky problem aty do të zgjidhet.

Po kaloj te pyetja, i nderuar ministër: Në Kosovë tashmë kemi afro 100 logopedë të diplomuar, ndërkohë fëmijët dhe të rriturit e shumtë që kanë nevojë për shërbime logopedike vuajnë mungesën e skajshme të këtyre profesionistëve. Aktualisht në Qendrën Klinike Universitare janë të punësuar 3 logopedë, prandaj shumë pacientë kanë vështirësi që ta marrin këtë shërbim.

Disa duhet që të udhëtojnë me kilometra nga zonat rurale për ta marrë këtë shërbim. Prandaj, i nderuar ministër pasi që jemi në prag të hartimit të buxhetit për vitin 2019, a keni planifikuar shtimin e numrit të logopedëve, e në veçanti që të ndërtohen apo të avancohen qendrat e logopedisë nëpër spitalet regjionale? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI URAN ISMAILI: Faleminderit!

I nderuar deputet, realisht është një pyetje të cilën edhe unë e kam ngritur me bordin pas kërkesës suaj, me bordin e SHSKUK-së dhe me menaxhmentin. Planet e tyre janë që brenda kësaj mundësie buxhetore e cila është, brenda numrit të lejuar të shtohet numri i logopedëve në mënyrë që të krijohet një shërbim jo vetëm në QKUK, po ashtu siç e ke cekur edhe në spitalet e përgjithshme.

Numri i cili është sot i punësuar është shumë disproporcion me numrin të cilin e kemi ët diplomuar dhe të cilët kanë mundësi të futen. Pra, ne kemi edhe një premtim të cilin po besoj që do e përmbushim edhe si Qeveri edhe si Kuvend që specialistët tanë, pra të cilët e kanë përfunduar të gjejnë hapësirë në institucionet publike.

Unë kam kërkuar nga ta që të dalim me një plan konkret, pra të shohin se cilat shërbime do të mund t'i bëjnë në QKUK dhe cilat i parashohin që ato të ndodhin në spitalet e përgjithshme. Po besoj që do të jemi në gjendje edhe gjatë leximit të dytë të buxhetit të shohim në qoftë se kërkohet, pra do të kemi mjaft kohë nga tani deri atëherë që ta shohim se cilat janë kapacitetet e nevojshme të cilat duhet bërë.

Të falënderoj edhe një herë për pyetjen, sepse po besoj që e ngre edhe vetëdijen e njerëzve që t'i shtojnë shërbimet sa më shumë. Faleminderit shumë!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufeta Srbica-Shinik.)*

KRYESUESJA: Pyetje shtesë ka zoti Bekim Haxhiu, urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Më tepër mund të them ndoshta si koment. Nëse ministër arrijmë që t'i hapim këto qendra të logopedisë nëpër spitalet regjionale, janë qendra të cilat nuk kërkojnë shumë investime. Vetëm

kërkojnë adaptime të hapësirave aktuale, sepse edhe në shumicën e spitaleve regjionale tona ka hapësira të mjaftueshme të cilat janë të pashfrytëzueshme, nëse arrijmë ne që me kohë t'i adaptojmë në mënyrë që pacientët të mos vijnë nga Prizreni ose nga Skenderaj ose nga Kaçaniku këtu, por atë shërbim ta marrë më afër atje. Sepse, janë qendra të cilat mund të adaptohen hapësirat ekzistuese të spitaleve regjionale. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Ministër? Nuk ka nevojë! Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sali Zyba! Pyetje për ministrin Uran Ismaili! Urdhëroni!

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesuese!

Për ministrin është çështja e sigurimeve shëndetësore. Zoti ministër e kemi parashtruar pyetjen edhe me shkrim, deri ku keni arritur me sigurimet shëndetësore dhe me sistemin informativ shëndetësor?

KRYESUESJA: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI URAN ISMAILI: Faleminderit shumë! Deputet do të mundohem që ta bëj ndërlidhjen sepse po besoj që arsyen pse i ke bërë dy pyetje në një, është për arsyen e ndërlidhjes së njërës me tjetrën.

Sa i përket sistemit informativ shëndetësor, ju e dini që ai ka filluar si projekt që nga viti 2011. Është paraparë të kryhet në tri faza dhe në kohën kur unë jam bërë ministër nuk e kam gjetur asnjërën nga këto faza të kompletuara.

Prandaj, ka pasur parregullsi të mëdha. Ju e dini vet edhe Kuvendi ka pasur një kërkesë për auditim. Është bërë një auditim dhe i ka vërejtur të gjitha ato parregullsi të ndryshme të cilat kanë ndodhur. Andaj, edhe si projekt ne kemi arritur që ta përmbyllim fazën e pilot-projektit duke ndalur mundësinë e çfarëdolloj keqpërdorimi tjetër, e në anën tjetër kemi filluar me Organizatën Botërore të Shëndetësisë ta rivlerësojmë projektin në mënyrë që t'i japim një dinamizëm tjetër dhe një ritëm tjetër e të mos jetë ritmi ai që ka qenë 7-vjeçarë.

Diçka tjetër është me rëndësi të dihet se në këtë kohë, po ashtu edhe kemi ndarë sistemin informativ të fondit. Dhe, ky sistem informativ i fondit është tejet me rëndësi nga ato platforma që lidh fondin e sigurimeve shëndetësore me institucionet publike shëndetësore, pra është mjeti i cili e mundëson që të kryhen transaksionet, pagesat dhe si i tillë është mjeti ndërlidhës.

Për sistemin informativ të fondit e kemi dakorduar buxhetin me Bankën Botërore. I kemi dakorduar edhe termat e referencës dhe do të fillojmë blerjen e atij sistemi gjatë këtij viti. Pra, është një proces të cilin e kemi ndarë në mënyrë që t'u krijojmë mundësi sigurimeve shëndetësore të fillojnë më herët sesa është paraparë.

Sa u përket sigurimeve shëndetësore, ne e dimë që është një mburojë financiare e rëndësishme dhe e nevojshme për qytetarët tanë. Viti 2019, unë e kam thënë që do të jetë deri në fund të vitit 2019, do të shohim një kompletim ose një realizim të sigurimeve shëndetësore.

Qëllimi ynë ka qenë që ta funksionalizojmë, ta organizojmë sa më mirë në mënyrë që të mos kemi probleme dhe në aspektin organizativ fondi i sigurimeve shëndetësore është realizuar. Kemi zgjedhur borin. Kemi zgjedhur drejtorin. Natyrisht, drejtorin e kemi zgjedhur së bashku me ambasadën britaneze, pra nëpër një proces mjaft transparent.

Është kompletuar tërë struktura administrative, po përpos që janë rritur kapacitetet, janë marrë edhe 5 ekspertë nëpërmjet Bankës Botërore, në mënyrë që ata të asistojnë çdo ditë në realizimin e këtij projekti. Pra, ata kanë qenë në financa, legjislacion dhe IT.

Një diçka tjetër, e kemi themeluar edhe njësinë SSHKUK, pra në spitalet tona, në mënyrë që ata të fillojnë të fokusohen në ngritjen e cilësisë, në realizimin e analizave për shpërndarjen e personelit shëndetësor. Nivelin e kërkesave dhe përgatitjet aktuale për kontraktim.

Sigurimet shëndetësor do të fillojnë do të përfundojnë deri në fund të vitit 2019, pra ashtu e kemi planifikuar që...

**KRYESUESJA:** Regjia, të lutem, fjalën ministrit!

**MINISTRI URAN ISMAILI:** Dhe janë përpjekje shumë të mëdha për arsye se duhet përgatitur dy institucione të ndryshme të cilat asnjëherë nuk kanë kontraktuar njëra me tjetrën dhe fatkeqësisht nuk janë përgatitur që të kontaktojnë njëra me tjetrën. Pra, edhe SHSKUK-në të gjitha spitalet tona. Të gjitha mjekësit primare, po edhe fondin e sigurimeve shëndetësore.

Ajo çka mund të themi është që tani me realizimin e sifit me fillimin e realizimit të sifit, me përgatitjen e fondit për sigurime shëndetësore, ne do të realizojmë edhe barnat jashtë-spitalore gjatë 6 muajve të parë, deri në përfundim të 6 mujorit të parë, do të realizojmë barnat jashtë-spitalore që do të jenë shërbimi i parë i fondit, ku qytetarët tanë do të jenë në gjendje të marrin barna nëpër barnatoret tona për sëmundjet të cilat i kanë dhe të cilat dakordohemi ne.

Pra, do të jetë shërbimi i parë i fondit dhe të shohim qytetarët tanë do të jenë në gjendje të marrin të mirat e para nga sigurimet shëndetësore.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Deputet a keni pyetje shtesë? Urdhëroni!

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesuese!

Zoti ministër thatë se më 2011 ka filluar si projekt, ndërsa ju iu referuat një auditimi, një të gjeture të auditimit, po në këtë seance, në fakt në seancën e mëparshme patët deklaruar këtu se, keni marrë një vendim për ta ndërprerë sa i përket sistemit informativ shëndetësor.

Të paktën unë s'kam mundur ta gjejë në raport të auditimit ku i referohet ose ku sugjerohet që të ndërpritet mundësia e vazhdimit të pilot-projektit për të cilin thatë se e keni përmyllur si pilot-projekt. Këtu në Kuvend e keni quajtur si të dështuar kur keni marrë një vendim që të mos vazhdoni as mirëmbajtjen.

Tash nuk po e kuptoj, se më pas keni vazhduar me një fond prej 500 mijë eurosh për ta mirëmbajtur. Domethënë ishte në kundërtënie secili vendim apo qëndrim i juaji, të paktën si deklarim këtu, në veprimet që i keni marrë më pas. Ndërsa, sa i përket sigurimeve shëndetësore ju e thatë një 6 mujor, po për besë duke e pasur parasysh atë proces aq të gjatë, me vite që do të kalojë, këta 6 mujorët çka do të përmbajnë në vete?

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Urdhëroni, ministër!

MINISTRI URAN ISMAILI: Faleminderit!

Ju keni thënë që pilot-projekti edhe ajo ka qenë pilot-projekt, pra nënkupton që është një projekt në fazën testuese, në qoftë se do të arrijë rezultatet e pritura, apo jo.

Në qoftë se projekti, pilot-projekti nuk arrin rezultat e pritura, atëherë është mundësia që të rishikohet projekti. Kështu funksionojnë pilot-projektet për çfarëdolloj projekti. Nuk është me rëndësi a është infrastrukturë, a është teknologji apo çka do. Në rregull, si i tillë pilot-projekti ka përfunduar. Kur ka përfunduar pilot-projekti ka pasur të gjitha ato të gjetura nga auditori. Si i tillë, ne nuk kemi mundur që të vazhdojmë me një pilot-projekt i cili i ka pasur të gjitha ato të gjetura. Se këtu i bie hip së të vrava zbrit së të vrava.

Sikur ta vazhdonin pilot-projektin, ju do të thoshit pse e ke vazhduar një pilot-projekt me të gjitha ato të gjetura. E tash, domethënë pse e ke ndal një pilot-projekt që ka pasur shumë të gjetura. Pra, pilot projekti e ka arritur fazën e përfundimit, jemi duke e rishikuar mundësinë me Organizatën Botërore të Shëndetësisë, si organizatë që ka njohuri për sistemet shëndetësore sesi ta zgjasim mundësinë që fazat tjera të projektit të jenë ashtu siç duhet.

Gjersa sa u përket sigurimeve shëndetësore, i nderuar deputet, unë thashë që shërbimet të cilat do t'i marrim në fund të 6-mujorit të parë, do të jenë barnat jashtë-spitalore, pra ekzistojnë sëmundje të cilat janë... Sot qytetarët tanë të moshuar shpeshherë marrin barnat të cilat duhet të marrin pra për tension ose për diabet.

Pra, sëmundjet të cilat janë të shpeshta dhe të cilat krijojnë çdo ditë shpenzime për qytetarët tanë, është një numër i caktuar i atyre sëmundjeve të cilat ne do t'i realizojmë nëpërmjet fondit të sigurimeve shëndetësore që t'i marrin pa para qytetarët tanë.

Pra, koncepti i barnave jashtë-spitalore është ky koncept që ta shpjegoja tash. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi. Pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Urdhëroni!

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

I nderuar ministër Gashi, një pjesë e trashëgimisë së lëvizshme kulturore me vlera të pakompenzueshme për vendin tonë, janë plaçkitur nga shteti i Serbisë në vitin 1998, 1999. Bëhet fjalë për 667 artefakte arkeologjike dhe 571 artefakte etnologjike që janë të vendosura në galerinë e Akademisë së Shkencave të Serbisë. Në muzeun e Beogradit. Në muzeun e Novi-Sadit dhe në muzeun e Suboticës.

Sipas një marrëveshjeje të arritur ndërmjet dy vendeve, këto artefakte të plaçkitura do duhej të ktheheshin për 120 ditë, tani kanë kaluar nga kjo marrëveshje shumë vite dhe asgjë nuk ka ndodhur. Deri më tani është kthyer vetëm “Hyjnesha në front”.

Zoti ministër, a ka kërkuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga Beogradi zyrtar që t'i kthejë artefaktet e plaçkitura?

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Urdhëroni, ministër! Kujtim Gashi e ka fjalën.

**MINISTRI KUJTIM GASHI:** Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar kryesuese e Kuvendit,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë ministra,

Çështja e kthimit të eksponateve, 677 eksponate arkeologjike dhe 571 eksponate etnologjike gjatë periudhës së vitit 2011-2012 kanë qenë temë e bisedimeve në kuadër të dialogut teknik.

Çështjet e adresuara në këtë kuadër kanë qenë mesa vijon: 1. Kthimi eksponateve arkeologjike dhe etnologjike të Muzeut të Kosovës. 2. Konsolidimi dhe kompensimi i dëmeve të luftës të shkaktuara në trashëgimi gjatë luftës 1998-1999. 3. Kthimi i dokumentacionit për monumentet e trashëgimisë kulturore, dokumentacioni i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. 4. Kthimi i koleksionit arkivor i Arkivit të Kosovës. 5. Qasja publike dhe profesionale në vendet e trashëgimisë kulturore.



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pasur ekipin që ka marrë pjesë në takim. Është mbajtur vetëm një takim i këtij niveli dhe është përfaqësuar nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore dhe nga një ekspert i jashtëm. Në këtë takim janë prezantuar tema të lartshënuara si një platformë. Të gjitha temat janë të shoqëruara me informacione dhe dokumentacione, kurse në rastin e ekspozitave arkeologjike dhe etnologjike posedohet dokumentacion i reversit, pra i librit të kthimit, i cili përshkruan numrin e ekspozitave, numrin e inventarit dhe përshkrimin. Këto ekspozite dhe gjithnjë sipas dokumentacionit të reversit janë marrë me qëllimi të ekspozimit.

Gjatë kësaj periudhe të dialogut teknik është kryesuar nga zonja Edita Tahiri. Dhe të gjitha çështjet dhe kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë adresuar me kohë sa i përket kësaj çështjeje shumë të rëndësishme për trashëgiminë kulturore të Kosovës.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Deputet, a keni pyetje shtesë? Urdhëro, Ismajl Kurteshi e ka fjalën!

**ISMAJL KURTESHI:** Zoti ministër,

Ne e dimë që Serbia nuk po i respekton marrëveshjet, mirëpo a po i njoftoni ju institucionet ndërkombëtare për këto shkelje, edhe pse edhe ato e dinë se Serbia vazhdimisht po plason të pavërteta. Para nja dy jave në Bruksel në lidhje me trashëgiminë kulturore përfaqësuesja e Serbisë nga pesë minuta që ka pasur një fjalim, katër minuta ka folur për gjoja shkatërrimin e trashëgimisë kulturore serbe në Kosovë. Jam i sigurt që edhe ne jemi aq aktivë që së paku ta flasim të vërtetën, le ta di bota që ata s'po i përmbahen kësaj marrëveshjeje, po ashtu edhe t'i kërkojmë prapë nga Beogradi vazhdimisht derisa t'i kthejmë ekspozitat që ata i kanë plaçkitur nga vendi ynë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Urdhëroni, ministër!

**MINISTRI KUJTIM GASHI:** Faleminderit, zoti deputet Kurteshi!

Sa i përket çështjes sa e ngremë ne, ju garantoj se çdo takim që kemi edhe me diplomatë të huaj, po edhe në takime të ndryshme ne vazhdimisht e diskutojmë si brengë, edhe e Ministrisë së Kulturës, por besoj fuqishëm që kjo çështje natyrisht duhet të adresohet edhe nga ambasadorët tonë që janë nëpër ambasadat në Evropë dhe përtej saj, po të njëjtën kohë jam shumë i bindur që këtë çështje duhet të adresojë edhe Ministria e Jashtme, si një mekanizëm shumë i rëndësishëm i Qeverisë së Kosovës, i cili natyrisht ka edhe takime të shumta.

Po të jeni të sigurt, nga çdo takim dhe çdo shkëmbim të informatave, ne theks të veçantë i kushtojmë kësaj çështjeje, sepse është edhe brengë jona si ministri, po natyrisht ka artefakte të shumta që janë në Serbi, duhet t'i kthehen Kosovës. Ne jemi në prag që edhe ekipin e ri, kurdo që të formohet, ta informojmë dhe kjo çështje të adresohet edhe në takimet e në bisedimet e

radhës, sepse si ministri dhe si Qeveri jemi të interesuar që sa më parë e sa më shpejt të gjitha artefaktet t'i kthejmë në Kosovë.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin zoti Shyqiri Bytyqi. Urdhëroni, zoti deputet!

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Zoti ministër, në Qendrën Korrektuese në Lipjan gjendet një numër i konsiderueshëm i të miturve që vuajnë dënimin bazuar në ligj.

Ministria e Arsimit është e obliguar sipas ligjit t'u sigurojë atyre vijimin e shkollimit brenda Qendrës Korrektuese. Po ashtu shteti ka obligim të ndikojë edhe në risocializimin dhe aftësimin profesional të të rriturve që gjenden në burgjet e Kosovës.

Zoti ministër,

Në nëntor të këtij viti Avokati i Popullit, përmes një shkrese që u është drejtuar institucioneve, e një kopje jua ka dërguar edhe juve, një kopje edhe Komisionit për Arsim, ka shfaqur shqetësimin e tij për mospërbushjen e obligimeve ligjore të MASHT-it në lidhje me shkollimin e të miturve në këtë qendër.

Zoti ministër,

Si është gjendja në këtë Qendër Korrektuese? A e keni vizituar ju ndonjëherë atë dhe çka po ndërmerr Ministria e Arsimit në shkollimin dhe aftësimin profesional të kategorive të lartpërmendura?

**KRYESUESJA:** Urdhëro, ministër!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** E nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet,

Faleminderit për pyetjen!

Po ashtu siç e theksuat edhe ju, ne e kemi pranuar më 23 nëntor të këtij viti raportin nga Avokati i Popullit me disa rekomandime. Ajo çka ne jemi duke analizuar si ministri dhe çka kërkojmë edhe sqarime nga Avokati i Popullit, sepse kemi ngatërime të termeve, flitet për edukimin e të miturve, ndërsa në shembujt që janë në raport flasin për arsimin e lartë. Po duhet të qartësohemi, është fjala për arsimin e lartë, për sigurimin e edukimit në arsimin e lartë apo për sigurimin e edukimit për të mitur.

Nëse fjala është për sigurimin në Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe në qendrat e tjera për të miturit, atëherë le të theksohet se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, unë si ministër, tash ne i kemi kryer obligimet tona.

Ne kur e kemi marrë dikasterin nën udhëheqje, ka pasur disa probleme në Qendrën Korrektuese në Lipjan, pikërisht në çështjen e aftësisë profesionale për persona të cilët gjenden brenda Qendrës Korrektuese dhe ka pasur një problem lidhur me materialin shkollor, si dhe disa probleme me mësimdhënës mes shkollës profesionale në Lipjan dhe Qendrës Korrektuese.

Mirëpo, pas kësaj ne kemi marrë masa dhe në dhjetor të vitit të kaluar 2017 e kemi miratuar Udhëzimin administrativ, i cili tashmë është publik dhe i zbatueshëm për Qendrën Korrektuese në Lipjan, po ky është Udhëzimi administrativ i lëshuar në dhjetor të vitit 2017 dhe qendrave të tjera korrektuese, ku qartë e rregullon shkollimin dhe edukimin e të miturve brenda qendrave korrektuese.

Me Udhëzim administrativ janë përcaktuar qartë obligimet dhe detyrat që dalin për MASHT-in, për Ministrinë e Drejtësisë dhe për komunat.

Ndërsa, nëse flasim pastaj për institucionet e arsimit të lartë, shkollimin në institucionet e arsimit të lartë, kjo është një çështje që na duhet shumë më shumë kohë për të analizuar dhe për të gjetur zgjidhje.

E para, duhet të bisedojmë me institucionet e arsimit të lartë, duke pasur parasysh se ka disa pengesa lidhur me akreditimin e programeve që janë të nevojshme, pastaj institucionet e arsimit të lartë, të cilat do të shprehin gatishmërinë për t'i pranuar këta studentë që gjenden në qendrat korrektuese, që do të jetë një çështje shumë më e ndërlikuar, shtoi kësaj edhe kosto shtesë që është një kosto goxha e lartë nëse flasim për individë, ashtu siç thotë edhe raporti, që duhet të sigurohet mundësia për shkollimin e lartë.

Pra, nëse flasim për shkollimin e lartë, mbetet që tutje të marrim masa konkrete se si ta zgjidhim problemin, nëse flasim për edukimin e të miturve, çështjet janë të zgjidhura dhe nga data kur është miratuar Udhëzimi administrativ ne nuk kemi pasur ndonjë ankesë ose ndonjë vërejtje nga Qendra Korrektuese e Lipjanit apo ndonjë qendër tjetër. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Deputeti Ismajl Kurteshi, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

**ISMAJL KURTESHI:** Ministër, pavarësisht nga kostoja dhe pavarësisht nga ndërlikimet, Qeveria, në këtë rast Ministria e Arsimit është e obliguar që t'i plotësojë obligimet ligjore ndaj kujtdo qoftë, edhe ndaj atij personi që është përmendur nga Avokati i Popullit dhe që kërkon t'i lejohet të shkojë në studime, do të thotë në arsimim të lartë, por po ashtu në atë dokument, po

edhe nga informata të tjera, edhe çështja e të miturve, shkollimi i tyre, ka jashtëzakonisht shumë probleme, sidomos me furnizimit me tekste shkollore dhe po ashtu me angazhimin e mësimdhënësve, të cilët do të duhej të ishin të rregullt, ashtu siç janë edhe nëpër shkollat kudo qoftë, domethënë në shkollat e rregullta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Urdhëroni, ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet,

Nëse është nevoja ta qartësoj edhe një herë, nga momenti kur është aprovuar Udhëzimi administrativ, ne nuk kemi marrë ndonjë vërejtje nga ndonjë qendër korrektuese lidhur me problemin e edukimit brenda qendrës për të miturit.

Ndërsa pajtohem plotësisht që tutje ne duhet të bëjmë zgjidhje edhe për edukimin dhe shkollimin e arsimit të lartë për persona, të cilët gjenden në qendrat korrektuese.

Mirëpo, konsideroj se primare ka qenë të zgjidhet problemi për të miturit që gjenden brenda qendrave korrektuese, e të cilat kanë pasur probleme në të kaluarën. Konsideroj që kjo çështje tashmë është e zgjidhur, na mbetet që me hapa të tjerë të bëjmë dhe të gjejmë zgjidhje edhe për shkollimin e lartë të tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin zotin Skender Reçica. Deputete, ministri nuk është këtu. Urdhëro, deputete!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetare!

Ministri nuk është këtu, unë do të paraqes vetëm çështjen, pyetjen do ta parashtoj në moment që do ta kemi ministrin këtu.

Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja që unë sot dua ta diskutoj para jush dhe që ju ka adresuar si pyetje parlamentare ministrit është:

Parlamenti i Kosovës në vitin 2014 miratoi një ligj që ua njeh statusin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe u jep atyre një pension mujor që nuk kalon përtej 220 eurove.

Në fund të muajit prill Qeveria e themeloi Komisionin për Verifikim dhe Njohje të Statusit të Viktimës së Dhunës, duke kryer procedurat nënligjore që mundësojnë nisjes e procesit.

Ligji parasheh që të mbijetuarat e dhunimit mund të aplikojnë për statusin me shkrim, pa pasur nevojë ta dëshmojnë me prani fizike atë që e kanë përjetuar.

Të mbijetuarat nuk janë të obliguara, por mund të paraqesin dëshmi mjekësore ose policore si provë të dhunimit.

Kohët e fundit kemi si informatë që disa kërkesa janë refuzuar. Ndërsa, gjithashtu të drejtën e shqyrtimit të kësaj ankese e ka prapë po i njëjti komision, i cili e ka refuzuar.

Ndërsa problemi tjetër, që është evidentuar kohët e fundit, është çështja e shqyrtimit të aplikacioneve, për arsye se anëtarët e Komisionit për Verifikim kanë edhe obligime të tjera.

Kështu që pyetjen do ta parashtrij në moment që do ta kemi edhe ministrin këtu prezent.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Urdhëro, deputet!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër,

Sipas Ligjit numër 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 15, vijueshmëria në shkollë, pika 5, për të promovuar vijimin ose zvogëluar braktisjen e shkollës, komuna organizon transport të sigurt dhe efikas për nxënësit në shkollimin e detyruar. Komuna mund të kërkojë pagesë, por edhe mund ta bëjë falas transportin shkollor.

Sipas këtij neni, nxënësit që jetojnë në zonën e mbulimit, por që janë në distancë prej 4 kilometrash nga shkolla, përveç nxënësve me aftësi të kufizuara, për të cilët ministria dhe komunat kanë obligim të sigurojnë transportet dhe vijueshmërinë në shkollë, është e obliguar të sigurojë transport.

Pyetja, i nderuar ministër, është, pasi që kemi parë shumë emisione dhe shqetësime të qytetarëve sa i përket rrezikshmërisë së fëmijëve gjatë vijueshmërisë së tyre në shkollë, pyetja është: a keni planifikuar që me anë të udhëzimeve administrative, por edhe me anë të buxhetit që distancën prej 4 kilometra të vijueshmërisë në shkollë ta zvogëloni në një distancë prej 2,5, edhe që kjo pastaj në bashkëpunim me komunat të sigurohet transporti i vijueshmërisë në shkollë që të zvogëlojmë do të thotë numrin e nxënësve që braktisin shkollën, sepse disa prej tyre edhe për shkak të kushteve të jetesës, disa për shkak të distancës së madhe nuk arrijnë të sigurojnë transportin, por edhe nuk mund të udhëtojnë për shkak se disa jetojnë edhe në zona rurale, ku edhe shpeshherë rrezikohen nga egërsirat ose nga qentë endacakë. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Urdhëroni, ministër!

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** Faleminderit, deputet Haxhiu, për pyetjen!

Atëherë, unë do ta kisha ndarë në dy grupe përgjigjen.

E para, kemi të bëjmë me termin “braktisja”, është një term shumë më i gjerë se sa shkaqet që mund të jenë për shkak të rënies së numrit të nxënësve në një shkollë të caktuar dhe komuna merr vendim që duhet të mbyllet dhe pastaj të sigurohet transporti për nxënës në një shkollë tjetër, është një term shumë i ngushtë në krahasim me termin që flasim, braktisje, sepse te braktisja janë edhe shumë faktorë tjerë që ndikojnë.

Lidhur me braktisjen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim edhe me komunat, me DKA-t, ka marrë masa konkrete dhe tash është ngritur një sistem i cili funksionon shumë mirë dhe i cili paralajmëron braktisjen e hershme të fëmijëve për shkaqe të ndryshme.

Pra, në këtë sistem, i cili është ndërtuar dhe është ngritur nga Ministria e Arsimit, secila shkollë ka mundësi të informojë në kohë dhe t’i identifikojë me kohë rreziqet, të cilat mund ta shpijnë braktisjen e hershme të shkollimit të ndonjë nxënësi të caktuar.

Ndërsa nëse flasim vetëm për shkak të rënies së numrit të nxënësve që ka disa faktorë të rënies, të themi edhe për shkak të lëvizjeve të ndryshme apo edhe të migrimit të ndryshëm që po ndodh, atëherë komuna e ka për obligim të bëjë menaxhimin dhe vendimin e merr për mbylljen apo mosmbylljen e një shkolle.

E ka obliguese sipas Udhëzimit administrativ nëse një shkollë mbyllet dhe distanca në shkollën tjetër është, siç e cekët edhe ju, mbi katër kilometra, atëherë duhet t’u sigurohet transporti.

Ndërsa nëse themi a mund të shqyrtohet kjo mundësi për ta zvogëluar distancën për të siguruar transport, konsideroj që ne mund ta analizojmë, ekspertët duhet ta analizojnë një gjë të tillë, sepse ndoshta kjo mund të na shkaktojë probleme të mëdha, pasi që në shumë vende, sidomos në qytete të mëdha, mund të jetë distanca 2 kilometra dhe obligohet pastaj komuna t’u sigurojë të gjithëve transport.

Megjithatë unë konsideroj që ne duhet ta analizojmë dhe të shohim se cila do të jetë distanca e nevojshme apo mund të bëhen edhe klasifikime vetëm në vende rurale, po kur është një rrezikshmëri më e madhe e fëmijëve për bartje.

Gjithsesi është çështje në bashkëpunim me komunat do të gjejmë zgjidhjen më të mirë për nxënësit.

Por ajo çka duhet të jetë e qartë për nivelin lokal, para se të mbyllen shkollat për shkak të rënies së numrit të nxënësve, duhet të bëhet së pari një plan dinamik, duhet të jenë të informuar me kohë prindërit dhe mësimdhënësit, pastaj mund të vijë deri te vendimi i mbylljes së një shkolle të caktuar.

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Deputet, a keni pyetje shtesë? Urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër!

Te çështja e braktisjes mendoj që është një temë e gjerë, por po flas vetëm te kriteri i sigurimit të transportit që ligji e përcakton distancën 4 kilometra, por që është e rregulluar edhe me udhëzime administrative, e rregullimi i udhëzimeve administrative është përgjegjësi e ministrisë.

Unë nuk pajtohem, ministër, që në qytete ka distancë prej 2 kilometrash, sepse po thuaj se të gjitha DKA-t e përcaktojnë regjistrimin e nxënësve në shkollimin fillor, parauniversitar në pjesën e lagjeve ku ata jetojnë dhe regjistrimin e kanë brenda një distance shumë mirë. Por, shqetësimi ynë është për nxënësit e zonave rurale, në veçanti ata të zonave malore, të cilët rrezikohen nga egërsirat dhe kemi parë që vërtet distanca është ndoshta tri kilometra e gjysmë dhe për të udhëtuar një fëmijë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Urdhëroni, ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar deputet,

Siç e theksova, jam dakord që ne duhet ta shqyrtojmë, por nuk mund të themi që mund të marrim vendim të menjëhershëm, sepse e para, duhet të sigurojmë për gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë transport, pastaj duhet të shohim se sa është kjo kosto shtesë që mund t'i ngarkojë DKA-t, sepse thjesht është të marrim një vendim të vullnetit të mirë, por duhet parë mundësinë se sa do të kenë mundësi pastaj DKA-t apo komunat ta zbatojnë një udhëzim, i cili mund ta shkurtojë distancën. Gjithsesi u mbetet njerëzve profesionalë që ta analizojnë dhe të shohim se sa është e mundur shkurtimi i kësaj distance.

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputeti Salih Zyba, pyetje për ministrin Fatmir Matoshi. Urdhëroni, deputet!

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryesuese!

Në mungesë të ministrit po e potencoj vetëm çështjen, ka të bëjë me ndërtimet e shumta të objekteve që po ndodhin në afërsi të zonës turistike në Brezovicë.

Ministri nuk është këtu për pyetjen e parashtruar, mirëpo nëse vizitojmë atë zonë turistike, nuk mund ta kuptojmë sot a është zonë turistike dhe në këtë sezon a është sezon turistike apo sezon ndërtimore.

Andaj, mbetet që t'ia shtroj këtë pyetje kur është prezent ministri.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet!

Ministri nuk është prezent.

Tani pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës...

*(Ndërhyrje)*

KRYESUESJA: Faleminderit, sekretar! Propozimi për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare më 6 dhjetor 2018.

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, ka bërë propozim me shkrim për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë propozimin. Urdhëroni, kryetar!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si Komision për Buxhet dhe Financa ne e kemi një propozim për plotësimin e rendit të ditës të seancës së sotme plenare për shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe nenin 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e *Projektligjit numër 06/L-136 për ratifikimin e marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria.*

Meqenëse është marrëveshje ndërkombëtare, kërkon 2/3 e deputetëve dhe meqenëse ka kaluar me pajtueshmëri të plotë nga të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare në komision, ju lus që ta propozoni si rend të ditës tani dhe t'i ftoni deputetët në votim dhe në momentin e parë që jemi 80 deputetë, ta hedhim në votim. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Atëherë, siç e dini, ne duhet të kemi shumicën, një shumicë e cilësuar në Parlament dhe 2/3 e atyre që janë deputetë duhet të votojnë për shmangie nga rendi i ditës dhe në të njëjtën kohë për t'u miratuar kjo duhet të votojmë me 2/3.

Sidoqoftë, unë ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare që të deklarojnë rreth kësaj në qoftë se dëshirojnë.



Besoj që askush nuk është kundër, nuk është diçka që ka nevojë të diskutohet. Po konstatoj që kryetarët e grupeve parlamentare s'janë asnjëri kundër.

Në sallë i kemi 51 deputetë, mendoj që nuk mund ta hedh në votim. Bini ziles një herë, mos po hyjnë deputetët në sallë, regjia.

*(Pauzë)*

Atëherë kemi kuorumin e duhur, ju lus që t'i zini vendet.

I lus deputetët të mos dalin nga salla.

Zoti Beqiri, a dëshironi të votoni?

Atëherë, në sallë janë 64 deputetë, po vijnë edhe të tjerë.

Siç ju njoftova, na duhen 2/3 e të pranishmëve për ta futur rendin e ditës, pastaj kur t'i kemi 80 deputetë, kur doni e fusim në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 68 deputetë me kartelë, 2 deputetë janë pa kartelë, bëjnë 70 dhe të gjithë kanë votuar për.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi kërkesën për shmangie nga rendi i ditës, për ta plotësuar rendin e ditës me pikën e propozuar dhe në momentin që kemi kuorumin e duhur, ne do ta hedhim në votim. Faleminderit!

Tani, po fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hamza, e ke fjalën!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** I nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush të prezantoj buxhetin e vitit 2019, si dhe vlerësimet për dy vjetët vijuese.

Fillimisht, para se të flas mbi përmbajtjen teknike të buxhetit, dua t'ju informoj mbi proceset që kemi ndjekur dhe në fund ka rezultuar me këtë propozim-buxhet që sot po e shqyrtojmë. Procesi

i përgatitjes së këtij buxheti ka filluar nga maji i këtij viti, menjëherë pas aprovimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Që nga atëherë Ministria e Financave ka zhvilluar diskutime gjithëpërfshirëse me të gjitha organizatat buxhetore, për të siguruar se ky draft-buxhet adreson dhe reflekton prioritetet e programit tonë qeverisës, gjë që do të mundësojë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Natyrisht se ne do të donim të bënim më shumë, por siç e dimë, mundësitë për financim janë të kufizuara dhe ne duhet të veprojme brenda këtyre mundësive, ashtu siç është paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Gjatë përgatitjes së këtij draft-buxheti prioritetet për financim janë bazuar në dokumente strategjike, si: programi i Qeverisë, e që mbështetet në strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik, programi për reforma ekonomike, strategjitë sektoriale dhe natyrisht Korniza Afatmesme e Shpenzimeve që reflekton këto prioritetet e politikave publike.

Projeksionet makrofiskale për vitin 2019-2021: Duke qenë se buxheti dhe përgatitja e tij është ngushtë e lidhur me ecuritë e përgjithshme ekonomike, fiskale e financiare, do të doja që në formë të përmbledhur t'ju informoj mbi projeksionet ekonomike të Ministrisë së Financave për periudhën afatmesme.

Rritja ekonomike e vendit për vitin 2019, e matur përmes rritjes së bruto prodhimit vendor, pritet të jetë 4.7% në terma real, ndërsa në ata nominal pritet të jetë 5.4%. Në kontekstin e periudhës afatmesme rritja reale pritet të jetë edhe pak më e lartë. Kjo rritje e projektuar pritet të mbështetet mbi të gjitha nga niveli i rritur i investimeve private dhe publike, konsumit dhe rritja e eksporteve. Publikimet e fundit nga Agjencia e Statistikave flasim për një performansë të mirë të ekonomisë tonë në vitin 2017 dhe në pjesën e parë të këtij viti dhe kjo nga bën që të ndjehemi komod se një ecuri e tillë me tendencë përmirësimi do të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Sa u përket çmimeve për vitin 2019 dhe vitet vijuese, pritet një stabilitet i theksuar ku inflacioni është projektuar të jetë pak mbi 1%. Unë mund të vazhdoj të flas edhe për elemente të tjera me rëndësi, siç janë komponentët e bruto produktit vendor, remitencat, si një burim i rëndësishëm i financimit të kërkesës agregate, bilancin tregtar, e tjera, por duke qenë se të gjitha këto informata i keni në materialet para jush, si aneks të buxhetit, unë do të ju kurseja nga këto detaje. Por, mbi të gjitha ajo që dua të them është se ky propozim-buxhet rrjet nga një bazë relativisht e fortë e performansës historike dhe asaj të projektuar të ekonomisë sonë. Para se të filloj të flas rreth kornizës fiskale, dua t'ju them se gjatë përgatitjes së këtij draft-buxheti ne kemi zhvilluar diskutime dhe konsultime të shumta edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe marrë në tërësi, si Ministria e Financave, edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë një pikëpamje përafërsisht të ngjashme si për rritjen ekonomike, edhe për kornizën fiskale të vendit tonë.

Tani më lejoni t'ju flas më në detaje për kornizën fiskle të vendit, pra për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit.

Të hyrat buxhetore: Projektionet mbi të hyrat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 dhe vitet vijuese janë të ndërtuara në këto parime: politikat tatimore do të jenë në mbështetje të sektorit privat, ku do të ofrojmë lehtësi të reja për këtë sektor. Administrimi i tatimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat do të përmirësohet tutje për t'ua lehtësuar punën tatimpaguesve. Do të merren veprime konkrete për uljen e aktivitetit informal, si një parakusht për konkurrencë të drejtë dhe trajtim të barabartë për të gjithë. Rrjedhimisht, duke u mbështetur në këto parime, presim që në vitin 2019 të hyrat totale për buxhet të jenë në vlerë prej 1 miliard e 949 milionë euro, gjë që paraqet një rritje prej 7,3% në raport me vitin 2018, ose në vlerë nominale një rritje prej 132 milionë eurosh. Kjo rritje e projektuar pritet të vijë kryesisht nga të hyrat tatimore, me një rritje prej 7,7%, ndërsa brenda të hyrave tatimore, tatimet direkte pritet të rriten në rreth 5%, ndërsa ato indirekte mbi 8%. Rritja e bazës tatimore, si: konsumi, investimet dhe importet prodhojnë nga 5 deri 6% të hyra shtesë, ndërsa pjesa tjetër nga 1 deri 2%. Do të arkëtohen duke përmirësuar administrimin e tatimeve dhe duke zvogëluar stokun e borxhit tatimor. Rrjedhimisht, një pjesë e të hyrave të projektuara pritet të vijnë si rezultat i masave tona administrative për përmirësimin e performansës në mbledhjen e tatimeve në vend, që do të ndikojë direkt në uljen e informalitetit.

Në këtë kontekst ne kemi pasur diskutime të hollësishme me Fondin Monetar Ndërkombëtar mbi identifikimin e këtyre masave dhe në bashkëpunim me Administratën Tatimore do të fillojmë implementimin e këtyre masave për të dhënë efektin e tyre gjatë vitit 2019. Për sa i përket projekcionit me uljen e stokut dhe borxhit tatimor, po ashtu në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar kemi përfshirë në draft-ligjin e buxhetit një nen që e lidh ekzekutimin e shpenzimeve me mbledhjen e të hyrave. Pra, në rast të mosmbledhjes së të hyrave ndikimi në shpenzime dhe në deficit do të jetë neutral. Sa u përket të hyrave jotatimore, ato priten që përafërsisht të mbesin në nivel të njëjtë përgjatë periudhës afatmesme, si ato të nivelit qendror, po ashtu edhe ato të nivelit lokal, për shkak se nuk kemi një performansë të mirë të komunave në grumbullimin e të hyrave. Mbi të hyrat buxhetore po ashtu, kemi planifikuar pranimin prej financimit dhe atë në vlerë prej 421 milionë, duke përfshirë 121 milionë projekt kredi sipas klauzolës, 54 milionë projekt kredi të rregullta, 140 milionë fonde nga procesi i likuidimit, 135 milionë instrumente direkte të borxhit. Duke u bazuar në këtë rritje të projektuar të të hyrave, plus financimit, kemi bërë propozimin për shpenzime.

Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike: Te shpenzimet, ashtu siç ju informova më herët, draft-buxheti propozon financimin e politikave me prioritet në programin qeverisës. Do të ketë rritje të theksuar për financim të projekteve kapitale me karakter publik, gjë që do të ndikojë direkt në rritjen e produktivitetit në sektorin privat. Rritje do të ketë për të gjitha kategoritë ekonomike, duke mbajtur një buxhet të balancuar midis shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre

kapitale. Rritje do të ketë edhe për nivelin lokal, financimi direkt përmes komunave dhe indirekt përmes ministrive dhe kjo rritje do të vijë vetëm nga të hyrat e grandit të nivelit qendror, për arsye se të hyrat e nivelit lokal vazhdojnë të jenë mjaft të ulëta dhe pa ndryshime nga viti në vit. Gjithsej, shpenzimet buxhetore do të vijnë në vlerë 2 miliardë e 365 milionë euro, që paraqet një rritje prej 261 milionë euro nëse e krahasojmë me vitin aktual, apo 12.5% më shumë. Në kuadër të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike kemi këtë renditje: kemi rritje të planifikuar prej 13% të shpenzimeve rrjedhëse, ku mallrat dhe shërbimet rriten për 27%, ose 72 milionë euro, duke reflektuar rritje substanciale të mallrave për komunat e Kosovës, rreth 10 milionë rritje për barnat esenciale dhe shpenzime të tjera në shëndetësi, mbi 20 milionë euro kemi adresuar vërejtjet e auditorit për keqklasifikimet e akumuluar për një periudhë të gjatë kohore. Subvencionet dhe transferet rriten për 16%, 83 milionë euro, ku mbi 30 milionë janë të dedikuara për rritjen e pensioneve bazike dhe kontributdhënëse, për ofrimin e financimit të plotë për skemat e filluara në vitin aktual, siç janë viktimat e dhunës seksuale, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe personat e paaftësuar në vendin e punës. Për rritjen dhe mbarëvajtjen e subvencioneve në bujqësi, si dhe për rritjen e subvencioneve të tjera.

Investimet kapitale, në anën tjetër, janë rritur për 11%, apo 75 milionë euro në raport me buxhetin e vitit 2018. Sa u përket investimeve kapitale, kjo rritje e shpenzimeve vjen si rezultat i përmbushjes së nevojave të mëdha të ekonomisë vendore për investimet në projekte me karakter publik, duke mundur financimin e shumë projekteve ekzistuese...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Regjia, vazhdojani fjalën ministrit!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Pjesë e rëndësishme e investimeve kapitale mbeten projektet, si: fillimi i autostradës Kijevë-Zahaq dhe rrugës Dollc-Gjakovë. Financimi shtesë për autostradën Prishtinë-Gjilan, për çka veç kanë filluar punimet. Vazhdimin e projektit të rrugës Prishtinë-Mitrovicë, fillimin e rehabilitimit të tërësishëm të linjës hekurudhore Hani i Elezit-Fushë Kosovë, Stadiumi Kombëtar, ndërtimin e shkollave dhe laboratorëve të rinj, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës spitalore dhe investimet e tjera për përmirësimin e infrastrukturës regjionale, lokale, infrastrukturës sportive dhe arsimore, rrjetit të ujit dhe të kanalizimit.

Kemi ofruar rritje për financimin lokal, ku granti i përgjithshëm është rritur për 7,1 milionë euro, apo në tërësi mbërrin në 181 milionë. Për shëndetësi 4,9 milionë, për arsim 14,7 milionë, është financuar për herë të parë edhe Ligji për kryeqytetin, Ligji për Prishtinën dhe Ligji për Obiliqin.

Shpenzimet buxhetore sipas sektorëve: Në kontekstin e propozim-buxhetit sipas sektorëve përmes programit të Qeverisë kemi vendosur prioritetet kryesore, të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyes në shpërndarjen e buxhetit. Në këto prioritete përfshihen: sundimi i ligjit, arsimi,

përkujdesja shëndetësore, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, qeverisja e mirë dhe kohezioni social. Institucionet përgjegjëse për sektorin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen marrin mbështetje të shtuar financiare prej 6% krahasuar me buxhetin e vitit 2018, duke tejkaluar për herë të parë shumën prej 200 milionë eurosh. Në krahasim me shpenzimet e vitit 2017, kemi vënë në dispozicion fonde për këto institucione në vlerë 30 milionë euro, apo 17% më shumë. Ndarjet buxhetore për sektorin e arsimit janë ngritur me 10% në nivelin qendror, duke përllogaritur edhe rritjen prej 9% të grantit komunal për arsim, totali i shpenzimeve për arsim planifikohet të jetë rreth 300 milionë euro. Një rekord i ri që dëshmon përkushtimin tonë ndaj këtij sektori. Në krahasim me shpenzimet në vitin 2017, kemi vënë në dispozicion 54 milionë shtesë, apo 23% më shumë në vit.

Për sektorin e shëndetësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe shërbimin spitalor universitar ndarjet buxhetore propozohen të rriten me 18% në nivelin qendror, veç kësaj, rritja edhe e grantit komunal për shëndetësinë primare është në nivel prej 10%. Buxheti i vitit 2019 parasheh gjithsej financim për shëndetësinë në rreth 234 milionë euro. Ndarjet për barnat esenciale janë rritur 20.3% krahasuar me vitin paraprak, shpenzimet kapitale për këtë sektor janë rritur 51%, nga 24.8 milionë në 37.6 milionë euro. Në këtë sektor kemi rritje prej 31% krahasuar me shpenzimin e vitit 2017, apo 55 milionë më tepër. Përmes projekteve të reja kemi rritur dukshëm financimin e aktiviteteve tona për mbështetjen e zhvillimit ekonomik, duke rritur shpenzimet kapitale me 11% në krahasim me buxhetin e vitit 2018, apo 64.5% më shumë se shpenzime në vitin 2017, rreth 300 milionë më shumë. Nga kjo rritje, 295 milionë euro financohen nga marrëveshjet e nënshkruara për kredi dhe nga mjetet e likuidimit.

Për qeverisjen e mirë dhe punë të jashtëm total financimi për këta dy sektorë është rritur për 14.8%, duke arritur vlerën në 123 milionë euro në krahasim me vitin 2018. Në fund, për të garantuar se rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe forcon kohezionin dhe zhvillimin social, buxheti është rritur dukshëm për sektorin e punësimit dhe çështjeve sociale, si dhe atë të kulturës. Për këta dy sektorë gjithsej financimi i planifikuar buxhetor është rritur për 13,7%, nga 453,8 milionë, në 515,9 milionë euro.

Kohezioni social, rritja e pensioneve: Krahas financimit të prioritetëve për zhvillim ekonomik, edukim, shëndetësi, jemi kujdesur që buxheti i vitit 2019 të ofrojë mbështetje për kohezion social, duke adresuar nevojat e shtresave më me nevojë. Me buxhetin e vitit 2018 për herë të parë kemi siguruar financim për katër skema të reja: pensionet për invaliditetin në punë, familjare, mbështetjen për qytetarët me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe mbështetjen për viktimat e dhunës seksuale, po ashtu kemi rritur ndihmën sociale apo asistencën për familjet në nevojë për 20%. Duke mbarëvajtur këto rritje, në buxhetin e vitit 2019, kemi siguruar edhe rritjen e pensionit bazik dhe pensionistëve kontributdhënës. Rritja për pensionet e moshës apo pensionet bazike do të jetë 20%, ndërsa rritja për pensionistët kontributdhënësë 15%.

Deficiti buxhetor dhe borxhi publik: Duke u bazuar në projeksionet e të hyrave dhe shpenzimeve, deficiti i përgjithshëm buxhetor për vitin 2019 pritet të jetë 2% e bruto produktit vendor, që është në linjë me kufirin e lejuar sipas Ligjit të financave publike. Mbi këtë deficit do të ketë financim shtesë përmes klauzolës për investime në shumë prej 121 milionë euro dhe nga fondet e likuidimit që vijnë përmes Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumë prej 140 milionë euro. Ky nivel i deficitit pritet të financohet me një kombinim të huamarrjes së brendshme dhe të jashtme, ndërsa niveli i huamarrjes pritet të ketë rritje, por që në asnjë mënyrë nuk e rrezikon qëndrueshmërinë e borxhit publik.

Në përmbyllje, më lejoni të përmbyll duke theksuar se ky propozim-buxhet ofron më të mirën për qytetarët dhe ekonominë tonë, duke pasur parasysh kufizimet që na imponohen nga shumë faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm. Ky propozim-buxhet është në linjë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, duke respektuar rregullën e deficitit buxhetor, rregullën mbi pagat dhe projektuar në nivel adekuat të bilancit bankar.

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që ne sot presim diskutime profesionale në përkrahje të buxhetit, po edhe kritika qëllimmira që ne do t'i adresojmë me kujdesin maksimal dhe pas diskutimeve dhe aprovimit të buxhetit në punën mes dy komisioneve besoj që ajo çka është e dobishme, çka është e mundshme, ne do ta akomodojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! E ftoj tani kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Abdixhiku, për arsyetimin e raportit. Kush? Në rregull! Atëherë, zonja Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për buxhetin dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 është proceduar në Kuvend në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Projektligji përmban kornizën makrofiskale për vitin 2019-2021 që pasqyron të dhënat për rrjedhjet makroekonomike aktuale, për treguesit makroekonomikë dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe ndikimet ekonomike në periudhën afatmesme. Përveç pjesës tekstuale, projektligji përmban edhe pjesën tabelare, me të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme sipas burimeve dhe strukturës së tyre për vitin 2019 dhe parashikimet për dy vjetët e ardhshme. Ajo që duhet vlerësuar në këtë draft-buxhet është parashikimi për rritjen e të hyrave dhe shpenzimeve, duke u mbështetur në

indikatorët e rritjes ekonomike. Në bazë të të dhënave për vitin 2019, rritja ekonomike parashikohet të jetë 4,7%, ndërsa rritja nominale ekonomike 5,4%, ashtu siç e tha edhe ministri.

Kjo rritje e projektuar pritet të mbështetet mbi të gjitha nga niveli i rritur i investimeve private, investimeve publike, konsumit, rritjes së remitencave dhe rritjes së eksporteve në vend, përmirësimi i kushteve kreditore si rezultat i rënies së interesave, vazhdimi i dërgesave nga diaspora, rritja e konsumit dhe investimeve private, rritja e investimeve publike nëpërmjet klauzolës së investimeve, rritja e importeve investuese dhe politikave fiskale më të mira. Të hyrat totale buxhetore do të jenë në vlerë prej 1 miliard e 949 milionë euro, burimet të të cilave janë tatimet dhe taksat, gjë që paraqet një rritje prej 7,3% në raport me vitin 2018, ose në vlerë nominale prej 132 milionë eurosh, sipas burimit të të hyrave nga tatimet dhe të hyrave të tjera direkte dhe indirekte.

Për sa u përket të hyrave jokatimore, ato pritet që përafërsisht të mbesin në nivelin e njëjtë përgjatë periudhës afatmesme, si ato të nivelit qendror, po ashtu edhe të nivelit lokal dhe planifikohen të jenë 208 milionë euro. Mbi të hyrat e rregullta janë planifikuar dhe të hyrat nga klauzola e investimeve në shumën prej 121 milionë euro, 54 milionë euro kredi të rregullta dhe 140 milionë euro nga fondet e likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi. Do të ketë rritje të theksuar dhe për financimin e projekteve kapitale me karakter publik, gjë që do të ndikojë direkt në rritjen e produktivitetit në sektorin privat. Rritje do të ketë në të gjitha kategoritë ekonomike, duke mbajtur një buxhet të balancuar midis shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale, rritje do të ketë edhe në nivelin lokal, financimi direkt përmes komunave dhe indirekt përmes ministrive. Shpenzimet buxhetore të planifikuara do të jenë 2 miliardë e 365 milionë euro, që paraqet një rritje prej 261 milionë euro, apo shprehur në përqindje, 12,5% më shumë se në vitin 2018.

Në kuadër të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për pagat dhe mëditje janë planifikuar 616 milionë euro, për mallra dhe shërbime 337 milionë euro apo 27% më shumë se në këtë vit, ku parashihen edhe 10 milionë euro për barnat esenciale, subvencione dhe transferet, 609 milionë euro, apo 16% më shumë se në buxhetin paraprak, ku parashihet buxheti për të gjitha kategoritë e përfituesve në bazë të ligjeve të veçanta, si për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, viktimat e dhunës seksuale si shpenzime, kurse shpenzimet kapitale prej 770 milionë euro paraqesin një rritje prej 11%, apo 75 milionë euro më shumë, në shumë monetare.

Në kuadër të këtyre shpenzimeve është planifikuar buxheti për financimin e projekteve të rëndësishme kapitale, siç janë: fillimi i autostradës Kijevë - Zahaq, financimi shtesë për autostradën Prishtinë - Gjilan, vazhdimi i projektit të autostradës për Mitrovicë, fillimi i rehabilitimit të tërësishëm të linjës hekurudhore Hani i Elezit - Fushë Kosovë, ndërtimi i shkollave dhe laboratorëve të rinj, rehabilitimi dhe zgjerimi i infrastrukturës spitalore, infrastrukturës sportive, arsimore, rrjetit të ujit dhe të kanalizimit. Projekt-buxheti përmban edhe

ndarjet për financimin e komunave në përputhje me Ligjin për financat e pushtetit lokal dhe si rezultat granti i përgjithshëm është rritur për 7,1 milionë euro dhe ka arritur shumën 181 milionë euro, granti për shëndetësi ka rritje 4,9 milionë euro dhe në total është 53 milionë euro, ndërsa granti për arsim është 14,7 milionë euro. Sa i përket deficitit buxhetor, është brenda kornizës ligjore të përcaktuar me Ligjin për menaxhimin e financave publike, po ashtu edhe bilanci bankar është brenda kornizave me 4.6% të bruto produktit vendor që është në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21. 11. 2018, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Ka vlerësuar se i njëjti i përmbush kriteret ligjore dhe Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të votojë për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës,

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës, buxheti, para se të jetë pasqyrë kontabël, është mjet zhvillimi. Në fakt, është mjeti i vetëm zhvillimor që shteti dhe Qeveria e Kosovës e ka në dispozicion, prandaj trajtimin e sotëm dua ta nis pikërisht nga analiza makro-ekonomike që shoqërohet me këtë buxhet, sepse kjo analizë ne argumentojmë që e shpërfaq më së miri gjendjen e tanishme ekonomike në Kosovë dhe gjendjen që Qeveria e projekton për dy vjetët e ardhshme.

Kjo gjendje në vetë fjalët e buxhetit që na prezantohet sot nëpërmjet rritjes ekonomike të parashikuar e prezantuar aty hedh poshtë gjithë programin qeverisës të prezantuar e të diskutuar mu në këtë Kuvend një vit më parë. Buxheti e devalvon në tërësi programin qeverisës. Kujtoj se në fushatën elektorale koalicioni qeverisës kishte pranuar rritje ekonomike deri në 10%. Vetëm tre muaj pas mandatimit, ky premtim ishte reduktuar në 8% në planin dhe programin e Qeverisë. Sërish 8% ishte impesive, porse në buxhetin e prezantuar nga ne rritja ekonomike nuk është as 10, as 8%, është në mesatare për tre vjetët e ardhshme 4,5% dhe, natyrisht, në rrethana si këto, çështja e parë që shtrohet, ose çfarë ndodh me dokumentin qeverisës që na është prezantuar këtu? A ka vlerë ky dokument më? A është i njëjti vetëm copë letre që na sillet në Kuvend sa për të thënë se e kemi një dokument dhe e kemi një plan qeverisës, apo është udhërrëfyes i Qeverisë së Kosovës e menduar dhe trajtuar mirë, sepse ka një diskrepancë thelbësore ndërmjet deklaramit qeverisës dhe implementimit financiar.



Kur këta bëjnë fjalë i japin imagjinatës bukur shumë, por kur mbajnë laps s'u del bash mirë. Puna e shtetit s'bëhet vetëm me imagjinatë, bëhet edhe me laps. Kur planifikojmë rritje ekonomike prej 8%, e kur e realizojmë gjysmën e saj, ne nuk e kemi zvogëluar një numër nga 8 në 4, nuk është kaq e thjeshtë. Ne e kemi përgjysmuar secilin progres tjetër në vend. E kemi përgjysmuar progresin në shëndetësi, në arsim, në rend dhe ligj, në zhvillim ekonomik, në punësim. E kur jemi tek punësimi, buxheti i tanishëm e konfirmon numrin më të rëndë që mund ta konfirmojë ky buxhet, vitin e kaluar janë humbur hiç më pak se sa 16 mijë vende pune. Ky është rezultati i modelit të tanishëm qeverisës. Tash secilën ditë të kësaj Qeverie humbin nga 44 vende pune në Kosovë.

Rritja ekonomike është indikator, është tregues i diagnozës ekonomike të një vendi. Për shembull, me 4% rritje ekonomike, Qeveria na thotë se Kroacinë e arrijmë për 30 vjetët e ardhshme, e Evropën për 60 vjet. Me 8 e 10% rritje ekonomike, kjo rrugë bëhet shumë më e shkurtër. Rruga për afrimin me një vend rajonal bëhet për 10 vjet, e Evropës për më pak se tri dekada. Qeveria po na thotë se rruga për Evropë është 60 vjet dhe kjo s'mund të jetë e pranueshme.

Sa i përket pjesës numerike, anës kontabël të këtij buxheti, gjëja e para që bie në sy është diskrepanca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve. Të hyrat rriten për 132 milionë, ndërsa shpenzimet për plot 261 milionë, dyfish më shumë se sa rritja e të të hyrave. Pra, ne po shpenzojmë më shumë se sa po gjenerojmë. Atëherë, nga mbulesa, nga këto para shtesë që mbulojnë diferencën e sivjetme, sikurse ato të vjetme dhe të dy viteve të ardhshme, janë dy burime kryesore që Qeveria i përdor.

I pari është borxhi publik, që këtë vit arrin në hiq më pak se 1,1 miliard euro, i dyti është fondi i privatizimit. Pra, për ta mbuluar diferencën vjetore tonën ne shpenzojmë paratë e gjeneratës së ardhshme nëpërmjet borxhit publik dhe e shpenzojmë pasurinë e gjeneratës së kaluar nëpërmjet mjeteve të privatizimit. U marrim para edhe fëmijëve që kanë për ta trashëguar këtë vend, por edhe pasurinë që e kanë ndërtuar gjenerata e shkuar. Do të ishte model i shkëlqyeshëm, kolegë deputetë, sikur të jepte rezultate, por s'po jep, sepse rruga për Evropë po mbetet 60 vjet, e në vit po i humbim 16 mijë vende të reja të punës.

Në terme interpretues të pastër financiarë ndodh kështu, sepse Buxheti i Kosovës është bërë buxhet social. Ky buxhet e ka humbur epitetin e buxhetit zhvillimor. Është buxhet i blerjes së paqes sociale në vend, në rend të parë. Qeveria, në pamundësi për t'u siguruar vende pune e mirëqenie qytetarëve tanë, ka vendosur ta blejë paqen sociale. Prandaj, për herë të parë në historinë e Kosovës, që nga themelimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës e deri më sot, kategoria e mbrojtjes sociale është kategoria me pjesëmarrjen më të madhe në buxhet. Plot 21% e buxhetit të vendit apo 465 milionë euro të buxhetit të sivjetmë shkojnë për mbrojtje sociale. Për

herë të parë kjo kategori e tejkalon kategorinë e zhvillimit ekonomik. Vetëm këtë vit plot 83 milionë euro shtohen në këtë kategori.

Janë 22 skema sociale aktive në vend e të tjera plot në ardhje, të cilat as që janë parashikuar në këtë buxhet. Këto skema, që të jemi të drejtë, nuk targetojnë të varfrit. Politika sociale ka kuptim kur targeton të varfrit, kur e ngre mirëqenien e një të varfri, kur e kalon nga varfëria dhe kur zbut nivelin e pabarazisë, atëherë politika sociale do të kishte kuptim. Por, a e dini sa u japim njerëzve në Kosovë në vit për ndihmë sociale? Nga 460 milionë euro për të varfrit shkojnë vetëm 30. Kategoria sociale është 30 milionë euro, pjesa tjetër 230 milionë euro janë të natyrës së skemave të meritës, të shpërblësës për një punë të bërë për Kosovën, dikush pse ka kontribuar në luftë, dikush pas luftës, dikush se ka dhënë mësim, se ka qenë mjek, gjykatës apo polic.

Vetëm për veteranë e invalidë të luftës jepen 100 milionë euro dhe përkundër skandaleve të shumta të Prokurorisë kjo shumë vazhdon të jetë në rritje edhe këtë vit. E tash, a mendoni se për një moment bëhet transformimi shoqëror që do të bënim sikur këto 430 milionë euro që i japim për meritë, pra jo për të varfër, t'i përdornim, le të themi, në arsim dhe shëndetësi? A e mendoni dot për pak Kosovën si do të dukej për 10 vjetët e ardhshme po t'i jepnim 5 miliardë euro këto para në arsim dhe shëndetësi dhe si do të dukej ky vend? Atëherë, ku mbeten prioritetet thelbësore të Qeverisë, brengat e qytetarëve tanë, ato në arsim, shëndetësi, rend dhe ligj dhe më e rëndësishmja në zhvillim ekonomik e punësim? Në arsim, as sivjet nuk ka transformim thelbësor.

Ne do të vazhdojmë edhe këtë vit me trendin e njëjtë, trendi i njëjtë ndërsa na jep rezultate të njëjta, na jep PIZA-n. Këtë vit ne i shtojmë fondet për arsim për 10%, por mbajeni mend, buxheti rritet për 12%. Pra, si proporcion i buxhetit të gjithmbarshëm, arsimi merr më pak këtë vit dhe intervenimet në arsim janë sinqerisht të papërfillshme. Paramendoni, për investime në teknologji informative në gjithë Kosovën japim 1 milion euro, për zhvillim të kurrikulës 50 mijë euro, 1 milion euro në teknologji, 50 mijë në kurrikulë, Kosova si komb shpenzon më pak se një shkollë fillore kudo në Evropë.

Në drejtësi, rend dhe ligj, fjalë që i mbajmë lart shumë, që themi gjithandej se lufta kundër korrupsionit, ndërtimi i gjyqësorit të pavarur është prioritet, kur vjen te paraja i shtojmë vetëm 6% dhe sërish si proporcion i buxhetit të gjithmbarshëm kategoria dhe sektori i rendit dhe ligjit merr më pak këtë vit se vitin e kaluar dhe rritja e këtij viti, mbajeni mend, vjen si rezultat i rritjes së pagave të Qeverisë vitin e kaluar dhe proceseve zinxhirore që kanë ndodhur në rend dhe ligj.

Në zhvillim ekonomik ne ndajmë 446 milionë euro, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve shkon në asfalt, e pjesa më e madhe e asfaltit është ndarë në bazë të kriterëve partiake në Kosovë. Tash edhe kjo kategori është rritur për 4%, pra merreni me mend, skema sociale i kemi rritur për 22%, por kategorinë e zhvillimit ekonomik, kategorinë që krijon vende të reja të punës për vetëm 4%.

Rritja e vetme e rëndësishme sivjet ndodh në shëndetësi për 37 milionë euro, por duhet thënë që as këtë vit qytetarët e Kosovës nuk do të kenë sigurime shëndetësore. Kosova vazhdon të ketë si proporcion të GDP-së kontributin më të vogël në shëndetësi në rajon. Shpenzojmë dyfish më pak se Kroacia, Serbia, Sllovenia e Maqedonia.

Në fund fare, LDK-ja shpreh keqardhje për mosshtimin e fondeve për mbrojtje. Flasim për transformim të FSK-së në ushtri, e për tre vjetët e ardhshme nuk ka rritje të buxhetit për ushtri. Nuk e di çfarë transformimi është ky, në qoftë se nuk kemi shtuar mjete financiare për të bërë njëmend ushtri, për tre vjetët e ardhshme, jo vetëm për këtë vit.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, duke marrë për bazë të gjitha argumentet e dhëna më lartë, se buxheti i sivjetmë është buxhet social e jo zhvillimor, që zgjeron borxhin publik e shpenzon asetet e Kosovës pa ndonjë efekt në punësim, që nuk bën transformimin në arsim, shëndetësi, rend dhe ligj, për të gjitha këto arsye dhe më shumë, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk e mbështet buxhetin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Diskutimi dhe miratimi i Projektligjit për buxhet është një nga ngjarjet më të rëndësishme, si për institucionet, sepse u hap mundësi atyre që t'i realizojnë programet e tyre për shtetbërje, integrim dhe zhvillim ekonomik, por është ngjarje shumë e rëndësishme edhe për qytetarët, sepse atyre u jep mundësi e për më shumë mirëqenie, për kushte më të mira jetese.

Në Projektbuxhetin e vitit 2019 shihet se Qeveria është e përcaktuar për ta realizuar programin e saj për një shtet me më shumë drejtësi, me më shumë mundësi për zhvillim ekonomik, për më shumë punësim, për më shumë stabilitet makrofiskal, për më shumë përgjegjshmëri në menaxhimin e financave publike.

Projektbuxheti i vitit 2019 është i ndërtuar mbi shifra reale të të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazuar në të dhënat e buxhetit, kuadri makroekonomik vazhdon të konsolidohet edhe më tutje nëpërmjet ruajtjes së deficitit buxhetor në masën 2%, ruajtjes së rezervës shtetërore prej 4% të bruto-produktit vendor, ruajtjes së nivelit të borxhit publik prej 16% të bruto-produktit vendor, ku vërehet një stabilitet sa i përket borxhit publik që kishte filluar të rritet me ritme të shpejtuara në Qeverinë e kaluar.

Këta janë tregues që dëshmojnë njëherësh edhe për përgjegjshmërinë fiskale të Qeverisë, përkushtimin për ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal, por edhe të krijojë më shumë hapësirë për të investuar në ekonomi, për t'i rritur pagat, për të trajtuar kategori të ndjeshme të shoqërisë sonë, si dhe për të ruajtur nivelin e lartë të investimeve kapitale. Nëse i analizojmë me kujdes shifrat e këtij buxheti, vërejmë se buxheti i këtij viti ka një ndryshim të madh në krahasim me buxhetet e viteve tjera.

Nuk mund këtu të diskutoj për buxhetin e vitit 2019 pa e përmendur punën e mirë të ministrit të Financave, zotit Bedri Hamza, që si gjithëherë ka treguar profesionalizëm në adresimin e prioriteteve dhe që janë në interes të qytetarëve. Nuk është e lehtë që në kushte të burimeve të kufizuara të të ardhurave publike të mbledhura të ndahen në përputhje me objektivat strategjike të vendit për prioritetet që synojnë nevojat më të ngutshme për zhvillimin ekonomik, rritjen e konkurrencës, si dhe për mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ndërmarrja e hapave konkretë në fushën e politikave fiskale, hapi pozitiv drejt fiskalitetit, lufta kundër informalitetit, si dhe veprimet konkrete në përmirësimin e mjedisit afarist, si aprovimi i vendimit për lirimin nga tatimi doganor për të gjithë prodhuesit për lëndën e parë, gjysmë-produktet, lirimi nga tatimi doganor për vijat e prodhimit dhe pajisjeve informative, si dhe lirimi nga tatimi i akcizës në lëndë ndihmëse, e cila merr pjesë në procesin e prodhimit, ka krijuar mundësi për zhvillimin e sektorit privat, por i ka dhënë edhe efektet në rritjen e të ardhurave buxhetore.

Nënshkrimi i disa marrëveshjeve financiare ndërkombëtare ka krijuar mundësi që nëpërmjet donacioneve dhe kredive të realizohen shumë projekte kapitale me interes për qytetarët, gjë që ka krijuar mundësinë edhe të ruhet niveli i lartë i investimeve publike, të cilat janë të paraqitura në buxhet.

Përmes politikës buxhetore të vitit 2019 vërehet se janë mbështetur prioritetet e përcaktuara për zhvillimin e vendit me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe nga masat e paraqitura në programin për reforma në ekonomi. Nëpërmjet buxhetit janë adresuar edhe shumë çështje të cilat janë ngrehur në Raportin e Progresit. Në buxhet vërehet se Qeveria është përkushtuar në realizimin e objektivave të saj dhe i ka përcaktuar pesë prioritetet: mbrojtjen; rendin dhe ligjin; shëndetësinë; arsimin; mbrojtjen e mjedisin dhe konkurrueshmërinë, duke mos lënë anash as drejtime tjera të funksionimit të shtetit dhe zhvillimit të vendit, pasi të gjitha institucionet e nivelit qendror, por edhe ato të nivelit lokal kanë reflektuar me rritje nëpërmjet këtij buxheti.

Të nderuar deputetë,

Të hyrat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2019 parashihet të arrihen në 1 949 000 000 euro, çka do të thotë se janë 132 milionë më shumë se në vitin 2018, që shprehur në përqindje janë 7%

më shumë se në këtë vit, kurse struktura e të hyrave si përqindje e bruto-produktit vendor është parashikuar të jetë 27,4%. Performansa e mirë e të hyrave buxhetore për këtë vit dhe masat e përmirësimit të të bërit biznes nëpërmjet ligjeve ka bërë që buxheti të jetë i rritur, por i bazuar në praktika të matura dhe në tregues realë.

Rritja e të hyrave të përgjithshme vjen si kontribut nga tatimet indirekte me pjesëmarrje 76%, tatime direkte me 14,8%, si dhe të hyrave jotatimore me 10%. Të hyrat tatimore direkte dhe indirekte përbëjnë 24,3% të të hyrave të përgjithshme, që marrin pjesë me 24,3% në përqindjen e bruto-produktit vendor, kurse të hyrat jotatimore dhe të hyrat vetjake marrin pjesë me 2,9% në përqindjen e bruto-produktit vendor. Ndërkaq, në projektbuxhet vërehet se sa u përket të hyrave jotatimore parashihet një rritje pak më e ngadalshme si pasojë e arkëtimit të dobët të të hyrave nga komunat. Komunat duhet ta përmirësojnë performansën e tyre dhe të gjejnë mënyra për një performansë më të mirë sa u përket të hyrave komunale. Komunat sikur janë mësuar ta marrin buxhetin e gatshëm nga grantet në nivelin qendror dhe nuk e marrin shumë mërzinë për të shtuar inkasimin e të hyrave në komunë. Çdo ditë kërkojnë që të bëhet sa më shumë decentralizim i aktiviteteve të tyre, kurse pak punë bëjnë për të gjeneruar të hyrat e tyre, të cilat janë të obliguar t'i gjenerojnë nëpërmjet ligjit.

Ndërkaq, totali i shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2019 është vlerësuar të arrijë në 2 365 milionë euro, ose rreth 123 milionë euro më shumë se në vitin 2018, me një pjesëmarrje prej 14,4% më shumë në vitin 2019, krahasuar me vitin që po lëmë pas. Shpenzimet rrjedhëse janë rritur për 13,1% krahasuar me vitin 2018, kurse shpenzimet kapitale janë rritur për 11%. Buxheti për vitin 2019 ruan trendin e lartë të investimeve kapitale prej 33% si pjesëmarrje në shpenzimet e përgjithshme, që janë 770 milionë euro për investime kapitale. Nga shpenzimet e parapara për investime kapitale në infrastrukturën rrugore janë planifikuar 35% të mjeteve, ku do të vazhdohet ndërtimi i rrugëve me prioritet nacional, siç janë ajo në drejtim të Mitrovicës, Drenasit, Skenderajt, në drejtim të Gjilanit, Pejës dhe rruga me interes nacional Deçan - Plavë dhe do të ndërtohen edhe rrugë tjera, për ta përmirësuar infrastrukturën rrugore në komuna.

Në përmirësimin e infrastrukturës në arsim, shëndetësi, ujësjellës dhe në përpunimin e ujërave të zeza në projekte të rëndësishme për kulturë, sport, shëndetësi, për përmirësimin e infrastrukturës në të gjitha komunat janë paraparë mbi 60% të mjeteve të parapara për investime kapitale.

Ne prej disa vitesh po përballemi me largimin e kuadrove tona, të cilat i ka financuar shteti, siç janë kuadrot në shëndetësi. Është e dhembshme të largohet truri profesionist në shëndetësi, por edhe në sektorët tjerë, dhe krejt kjo ka ndodhur për shkak të politikave të këqija, të cilat janë aplikuar në të kaluarën në sektorin e shëndetësisë. Është mirë që shëndetësia është vënë si prioritet i Qeverisë dhe se ky prioritet ka reflektuar edhe në shifrat e Buxhetit, ku vërehet se ka një rritje të buxhetit prej 18% në nivelin qendror, kurse granti komunal për shëndetësinë primare është rritur 10%. Rritja e buxhetit në 233,9 milionë duhet vlerësuar në shëndetësi. Në kuadër të

kësaj vlere shpenzimet kapitale janë rritur për 51%, nga 24,8 milionë sa ishin në vitin 2018, në 37,6 milionë, në vitin 2019. Ndërsa, ndarja për barnat esenciale është rritur për 20,3%, krahasuar me këtë vit që po e lëmë pas.

Nuk mundem këtu pa e përmendur punën e mirë që është bërë në këtë sektor nga ministri i Shëndetësisë për t'i adresuar shumë probleme, me të cilat është përballë ky sektor. E inkurajoj ministrin që të vazhdojë edhe më tutje për ta vënë këtë sektor në sistem, sepse sado që të investohet aty, nëse nuk vihet sistemi, është vështirë të arrihet efikasiteti në sistemin shëndetësor. Ne si shoqëri duhet të jemi të kujdesshëm në vendimet populliste që e shtojnë koston e kategorisë sociale. Këtu nuk duhet ta akuzojmë vetëm Qeverinë, por ta adresojmë edhe përgjegjësinë tek vetvetja jonë këtu në Kuvend, kur miratojmë ligje të cilat kanë kosto dhe bëjnë pjesë në kategorinë.

Megjithatë, buxheti është rritur për 16% në kategorinë sociale nëpërmjet së cilës do të paguhen kategori të dala nga lufta, pensionistët, personat paraplegjikë, tetraplegjikë dhe viktimat e dhunës gjatë luftës së fundit dhe po ashtu është paraparë edhe plotësimi i të gjitha kërkesave që kanë ardhur si pasojë e ligjeve të miratuara në Kuvend.

Prandaj, rritja e buxhetit është bërë në të gjitha ministrinë, është rritur buxheti edhe në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për 11%, në Zhvillimin Ekonomik për 67%, në Ministrinë e Bujqësisë është rritur për 2,3%, në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor për 32%, në Ministrinë e Administratës Publike për 10%.

Prandaj, ne si grup parlamentar e vlerësojmë edhe rritjen e buxhetit për nivelin komunal që është bërë me 9,1%, dhe si grup parlamentar do ta miratojmë buxhetin e vitit 2019 dhe kontributin tonë të mëtutjeshëm do ta japim në punën e mëtutjeshme në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku besoj dhe shpresoj shumë që do të kemi mundësi brenda kufijve buxhetorë të bëjmë rregullime të tjera të mundshme, të cilat janë me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

**ALBIN KURTI:** Të nderuar qytetarë të Republikës,

Deputetë të Kuvendit,

Ministra të Qeverisë,

Në Kosovë janë ndërruar qeveritë, janë shtuar qeveritarët, janë rritur shpenzimet e harxhimet, por nuk ka ndryshuar orientimi qeveritar. Buxheti i vitit 2019 është buxhet i shpenzimit qeveritar, e jo i zhvillimit socio-ekonomik. Është buxhet i shtimit të borxhit publik joproductiv dhe i deficitit buxhetor, e që do ta gërryjë edhe fondin e privatizimit.

Numrat e buxhetit janë problematikë, sepse korniza makroekonomike e makrofiskale është e gabueshme. Në faqen 7 dokumentohet se numri i kontove në administratën e Trustit Pensional përgjatë viteve 2017-2018 është rritur me 2%. Meqë, kontot hapen sapo dikush të fillojë një marrëdhënie pune, por nuk shuhen kur punëmarrësit largohen nga vendi i punës, i bie që kjo rritja prej 2% në fakt është shumë më e ulët, por edhe mund të rezultojë negative në rast se më shumë se 2% e pronarëve të kontove individuale e kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe, e dihet që në Kosovë ka shumëfish më tepër prekariat se sa proletariat.

Në të njëjtën faqe thuhet se pagat në sektorin publik janë rritur me 4,6%, kurse në atë privat me 0,6%. Ky konstatim, përveçse është i pasaktë, meqë nuk ka pasur rritje pagash të deklaruar në sektorin publik, del edhe kontravers për arsyen se tregon se politikat e qeverisë e shkatërrojnë kështu konkurrueshmërinë e sektorit privat, që natyrisht nuk kompensohet me favorizim të privatëve të privilegjuar. Kjo bëhet qoftë përmes humbjes së punëtorëve më të shkathët, të cilët ikin drejt sektorit publik në kërkim të pagave më atraktive qoftë duke i detyruar ata të paguajnë më shumë për të mbajtur punëtorët e tyre. Në çdo ekonomi normale punonjësit nuk shkojnë në sektorin publik për paga më të larta, por për më tepër siguri në punë.

Në të njëjtën faqe sërish pranohet roli i pakontestueshëm i remitancave në ruajtjen e stabilitetit ekonomik. Me një rritje prej 6,8% të tyre diaspora është kujdesur sërish që të ketë kërkesë të mjaftueshme për mallra dhe shërbime. Pamundësia e shfrytëzimit të tyre për qëllime produktive dhe rritje të së ardhurës kombëtare është dëshmi tjetër, është dështimi tjetër i kësaj qeverie. Ekonomia jonë, në vend të rritjes së stabilitetit përmes zvogëlimit të debalancit tregtar, po e ndjek rrugën e kundërt duke u mbështetur edhe më shumë në importe, të cilat po rriten më shpejt si në terma absolutë ashtu edhe në përqindje krahasuar me eksportet e vendit.

Parashikimet për rritjen e variablave makroekonomike janë kryesisht fontanë dëshirash dhe kjo vlen sidomos për investimet në sektorin privat. Kurse pjesa e investimeve publike, përveç që po kontribuon në rritjen eksponenciale të borxhit publik, fatkeqësisht mbetet pa ndonjë ndikim në rritjen ekonomike dhe në rritjen e mirëqenies. E vetmja variabël që ndikohet pozitivisht nga këto investime publike është pasuria individuale e pjesëtarëve të kabinetit qeveritar dhe e biznesmenëve të oborrit qeveritar.

Në faqen 11 thuhet se parashikimi i të hyrave buxhetore ndjek parashikimet e tjera makroekonomike, por kjo nuk është e saktë meqë edhe këtë vit parashikimi i të hyrave del të jetë i fryrë me synim të rritjes së kufijve të shpenzimeve buxhetore.

Kjo qeveri ka vazhduar të forcojë ndikimin e tregtisë ndërkombëtare në gjenerimin e të hyrave buxhetore, përkundërt faktit që në progresin drejt integritimeve evropiane kjo mund të shndërrohet në rrezik të menjëhershëm për stabilitetin fiskal të vendit. Një problem tjetër ka të bëjë me rimbursimet, sidomos të TVSH-së, që mbetet simbolik. Kjo për arsye se bizneset kanë frikë të kërkojnë riimbursim të TVSH-së pasi menjëherë kërcënohen me inspektime që rezultojnë

në gjoba të pajustificueshme. Kjo qeveri e ka bërë shtetin gjobitës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe shërbëtor për oligarkët.

Për vitin 2019 dhe vitet në vijim kemi degradim të vazhdueshëm të kualitetit të shpenzimeve buxhetore duke e bartur fokusin nga projektet me rëndësi që gjenerojnë punësim, apo nga bujqësia, drejt nismave sociale që në fakt nuk janë edhe aq sociale, por, më shumë partiake e populliste. Subvencionet dhe transferet janë kategoria që po rritet më së shpejti.

Kategoria e shpenzimeve për paga është e nënvlerësuar dhe nuk përfshin në tërësi implikimet që do të dalin nga politikat e pamatura por edhe nga vetë projektligji për pagat. Te komunat, në vend se të rritet autoriteti në vendimmarrje të komunave për shpenzime kapitale, duke shmangur investimet nga qendra për projektet lokale kapitale të cilat pastaj po keqpërdoren për të shkuar drejt komunave të privileguara, kemi rritje prej mbi 20% të shpenzimeve për mallra dhe shërbime që është krejt e palogjikshme meqë nuk ka rritje të asnjë çmimi për shërbimet publike që i konsumojnë komunat.

Deficiti i paraparë me siguri se do bëhet shumë problematik për arsye se në njërin anë parashikimi i të hyrave del të jetë më optimist sesa mundësitë, e në anën tjetër saturimi apo ngopja e tregut primar me bono-thesari dhe pamundësia e zhvillimit të tregut sekondar e bëjnë të pamundur financimin e mjaftueshëm brenda shtetit.

Investime kapitale në Trepçë as sivjet nuk ka, dhe kjo sigurisht që i rrit apetitet e Serbisë për veriun e Kosovës dhe Mitrovicën e ndarë në dysh. Në qeverisje, dashuria e përkushtimi maten me buxhet, e pikërisht këto mungojnë tek qeveria aktuale.

Kemi kryeministër, i cili me dialogun me Serbinë nuk merret, ia ka lënë këtë presidentit. Me buxhetin po ashtu nuk merret, nuk është këtu, ia ka lënë ministrit të financave. Thotë që po merret me ushtrinë që do ta bëjë, por s' do të ketë buxhet shtesë as për FSK-në. Atëherë shtrohet pyetja me çka merret ky kryeministër?

Kuvendi ka diçka mbi 11 milionë euro buxhet, kurse Zyra e Kryeministrit gati 18 milionë e gjysmë. Ja se me çfarë merret ky. E ne jemi republikë parlamentare, e jo republikë kryeministore, apo jo?

Zyra e kryeministrit i ka 615 të punësuar. Vetëm kabineti i kryeministrit i ka 75 të punësuar. Ndërkaq në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zhvillimin dhe përkrahjen e rinisë, e cila është mbi një e treta e popullsisë, janë vetëm pesë të punësuar. Ose, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka buxhetin sa gjysma e zyrës së kryeministrit. Ose, zyra e kryeministrit ka më shumë buxhet se i gjithë Shërbimi Korrektues i Kosovës i cili ka plot 1748 të punësuar. Ose, mbi dyfishin e buxhetit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës: Ne themi se jemi vend shumë i rrezikuar, mirëpo Zyra e Kryeministrit ka më shumë se dyfishin e buxhetit për AKI-në. Ose, për 30 për qind ka më shumë Zyra e Kryeministrit buxhet sesa Këshilli Prokurorial i Kosovës. E



thuhet që po e luftojmë korrupsionin! Ose, janë 75 të punësuar në kabinetin e kryeministrit e vetëm 70 te prokurorët specialë, ndërkaq te Avokati i Popullit është aty-aty, 78.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, dhe me Ministrinë e Inovacionit dhe të Ndërmarrësisë nuk përbëjnë as gjysmën e të punësuarve në zyrën e Kryeministrit. Kjo tregon pra, se kemi të bëjmë me gërryerje të buxhetit nga qeveria e cila e ka bërë shtetin e Kosovës si një byro për punësim, por që nuk të punëson jashtë byrosë për punësim, por të punëson vetëm në byronë për punësim. Pra, është një byro për punësim, që të punëson në byronë për punësimin i cili nuk ekziston jashtë byrosë për punësim. Ja çfarë i ka bërë kjo Qeveri e Kosovës me këtë kryeministër shtetit të Kosovës. Kjo është pra arsyeja, dhe këto janë disa prej argumenteve pse ne nuk do ta mbështesim buxhetin e propozuar për vitin 2019, dhe besojmë që një orë e më parë që kjo qeveri largohet nga detyra, aq më mirë do të bëhet për popullin e Kosovës. Ndërkaq, për fushat e veçanta të këtij propozim-buxheti për vitin e ardhshëm do të flasim deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti! Fjalën e ka nga PSD-ja, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dokumenti si dokument, këtu po e citoj një koleg, është i përgatitur mirë. Pra, në aspektin teknik e formal është mirë i përgatitur, informacioni është i bollshëm. Por, ja që informacioni që prezantohet në këtë buxhet është informacion i cili është ‘deja-vu’ e 18 vjetëve të fundit, veçse numrat ndërrojnë, mendësia është e njëjtë. Pra, numrat ndryshojnë varësisht prej nevojave të qeverive dhe orientimeve sa i përket partisë, por jo të mendësisë, ideologjisë dhe këndvështrimit se si duhet të zhvillohet ekonomia e një vendi. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm, sikur edhe shumë prej jush që buxheti i një shteti duhet të përcjellë njëllë mendimi strategjik mbi ekonominë. Pra, duhet të ekzistojë një mendim, një dokument, një vlerësim, apo të themi një planifikim strategjik, prej atij plani apo mendimi strategjik vjen një kornizë afatmesme, e prej asaj kornize afatmesme vjen një buxhet. Pra, planifikimi pak më i gjatë, një dokument i cili e mendon se cilat politika të themi për tre vjetët e ardhshme do të trajtohen, renditjen e tyre, e më pastaj buxheti si financim i politikës.

Por, për 18 vjet kemi parë konstruktin e njëjtë buxhetor. Ajo çka është brengosëse është që ekonomia reduktohet në infrastrukturë dhe ajo infrastrukturë reduktohet në asfalt, ndërsa punësimi, krijimi i vlerës së shtuar, lufta apo beteja kundër një deficiti tregtar të jashtëzakonshëm, e që na përcjell tash e 10 vjet, nuk shihet që trajtohet me ndonjë instrument politik, ndonjë intervenim politik të paraqitur në buxhet. Buxheti thjesht është një vazhdimësi e

mendimit të konstruktit ekonomik e financiar të 18 vjetëve të fundit. Në këtë konstrukt ekonomik financiar që na e prezantoni tash e 18 vite, apo më mirë të themi tash e 10 vjet kështu më saktë sa i përket llojit të buxhetit, rezultatet janë të qarta. Numri i njerëzve të punësuar në Republikën e Kosovës sipas vjetarit statistikor është diku 360 mijë. 360 mijë qytetarë të Republikës së Kosovës janë të punësuar. Prej 1,8 milion qytetarëve, normalisht këtu e heqim moshën e atyre që nuk janë të aftë për punë, por në demografinë, pra në strukturën e popullatës që e ka kjo Republikë e Kosovës, 360 mijë të punësuar është një numër jashtëzakonisht i vogël.

Në po të njëjtin vjetar statistikor na shpërfaqet edhe deficitin tregtar. Unë e kisha raportin e Ministrisë së Tregtisë e Industrisë në Komision për Zhvillim Ekonomik dhe aty e pashë që vetëm në nëntëmujorin e parë importet i kemi 2,6 miliardë euro. Për ta sqaruar krejt thjesht, 2.6 miliardë euro të parave tona për nëntë muaj kanë dalë prej kësaj ekonomie, janë jashtë procesit të qarkullimit markroekonomik të Republikës së Kosovës. Ndërsa, kemi shitur, apo kemi futur para në ekonomi në vlerë prej 264 milionë eurove. Këto janë problemet ekonomike të mëdha të kësaj republike. Pra, si mund ta zvogëlojmë deficitin tregtar, cilat janë politikat dhe numrat që në buxhet na tregojnë që e kemi këtë mendim dhe, në anën tjetër, si e bëjmë infrastrukturën në funksion të këtij modeli ekonomik. Pra, qysh ndërtojmë infrastrukturë që ndërton fabrika, që punëson, që zëvendëson importet, rrjedhimisht rrit të hyrat tatimore nga ato burime të cilat një strukturë buxhetore ekonomike do të ishte më mirë të themi dhe më e shëndetshme duke i pasur këto burime të të hyrave.

Pra, këtë pjesën të themi kështu të mendimit ekonomik, mënyrën se qysh është i paraqitur buxheti, e shohim që është e njëjtë. Nuk ka ndryshime. Çka ndërron, fatkeqësisht janë proporcionet. Kjo për mua është problematike. Për ta shpjeguar çka po mendoj me këtë, do t'i jap disa shembuj. Ministri e prezantoi buxhetin thashë në mënyrë të saktë normalisht, formalisht, proceduralisht në rregull, me numra që po supozoj unë janë orientime të plot ministrave të një koalicioni qeverisës jashtëzakonisht të madh dhe një kryeministri, i cili duhet të akomodojë krejt këto kërkesa, nevoja, apo pazare parazgjedhore. Këtë e kam të qartë. Një ministër, këtë e bën zoti Hamza e bën mirë, i akomodon këto kërkesa. 465 milionë euro, apo më saktë 465 milionë euro, të mos hyjmë në detaje, apo mbi 20 për qind e buxhetit të Republikës së Kosovës shkon vetëm për një ministri, për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Por, kjo ministri e ka një shkronjë në këtë akronim tepër, atë të punës, sepse në fakt merret vetëm me mirëqenie sociale. Por, nuk merret as me mirëqenie sociale, sepse mirëqenia sociale presupozon që politikat për të cilat po investohen i nxjerrin këta njerëz nga gjendja e rëndë dhe rrjedhimisht bëhen pjesë aktive.

Por, kjo nuk është politika të cilën ju e keni prezantuar, as në buxhet, as në mendim. Është thjesht mirëmbajtje e një strukture jashtëzakonisht të madhe të njerëzve që marrin para buxhetit për të akomoduar ku e di unë çfarë interesi partikular partiak. Kjo i bie mbi 20 për qind e buxhetit, apo më mirë të them 456 milionë euro të këtij buxheti janë subvencione dhe transfere.

Paramendojeni ministër nëse e implementojmë një reformë të madhe pensionale, një skemë pensionale me të cilën kombinohet një skemë solidare me këtë të vetëfinancimit dhe unë ju garantoj se me këso lloj skeme i kursejmë 100 milionë euro. E paramendojeni në qoftë se këto 100 milionë euro, ministër, në këtë planifikim buxhetor ia tregoni atij ministrit të Arsimit dhe atij ministri të Arsimit një kryeministër i vëmendshëm i thotë dëgjo: shkojmë në digjitalizim të arsimit. Pra, me 100 milionë euro kjo edhe mund të bëhet, por ne kemi vendosur kështu: Kemi thënë për shtatë për qind të popullatës, 20 për qind të shpenzimeve, sepse kështu i bie me këta numra këtu që i keni prezantuar, 456 milionë euro subvencione dhe transfere.

Ndërsa po themi për Ministrinë e Arsimit 70 milionë euro, apo pak a shumë 3,2 për qind e buxhetit për 30 për qind të popullatës. 30 për qind e këtij vendi është në arsim, në çerdhe, në shkolla fillore, në shkolla të mesme, në universitete dhe për këta i kemi ndarë 3 për qind të buxhetit. Në anën tjetër, themi që e kemi rininë, e cila është vlera jonë kryesore në këtë botën si të them të globalizuar, siç po i thoni ju, në anën tjetër investimet në ta dhe në përgatitjen e tyre për një treg të punës i kemi në terma banalë, sepse nuk kam term tjetër për ta shpjeguar këtë. Dhe, në fund fare, në ligjet që po na vijmë në vitin 2019, këtë farë 21-përqindëshin e shpenzimeve për Ministrinë e Mirëqenies Sociale, këtë të punës, ju lutem hiqeni prej akronimit, nuk ka lidhje kjo me punësim, as me punë. Kjo ka lidhje me mospunë dhe aq më keq ka të bëjë me krijimin e një përshtypjeje që politikat sociale janë këto që i keni prezantuar ju. Nuk janë këto politika sociale. Këto nuk janë as mendim që ndërlihet me mendim të ndërtimit të një rrjeti për, si të them, shtet social deri diku. Këto thjesht janë financim i koncepteve fatkeqësisht jashtëzakonisht problematike, por për të cilat çdo ditë e më shumë do të diskutojmë këtu në Kuvend.

Pra, ky buxhet, sipas Partisë Socialdemokrate, është një buxhet i cili e vazhdon atë avazin e vjetër të trajtimit dhe akomodimit të nevojave të qeverive. Dhe, normalisht ka shumë vend edhe për sugjerim, edhe për kritikë. Por, gjithsesi si konstrukt është i njëjti që e kemi parë për 18 vjet, pa marrë parasysh kush ka qenë në pushtet. Në fund fare, mund të konstatojmë edhe shkencërisht që me kësi lloj buxheti ekonomia përfundon këtu qysh është sot, sepse qe 18 vjet po e provojmë të njëjtën recetë dhe për 18 vjet vetëm 350 mijë njerëz na kanë hyrë në punë. Skemë sociale s'kemi, skemë shëndetësore nuk kemi, deficitit tregtar 10:1. Ky është përfundimi i këtyre instrumenteve që na i prezantoni tash e 18 vjet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Kuçi e ka fjalën.

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit kryesues!

Sot para nesh, para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Qeveria e ka sjellë për miratim Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi ynë parlamentar, Grupi Parlamentar i Aleancës, e unë në emër të tyre do të përpiqem t'i veçoj disa pjesë të veçanta që e bëjnë të veçantë buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Buxheti total për vitin 2019 është 2,4 miliardë euro, ose më saktë 2 miliardë e 365 milionë euro, buxhet i cili krahasuar me vitin 2018 është për 36 për qind më i lartë. Kthyer në vlerë monetare, 600 milionë euro më i lartë. Kjo as që ka ndodhur, as që ka për të ndodhur ndonjëherë për një periudhë kaq të shkurtër të kemi në rritje kaq të madhe të buxhetit në tërësi. Buxheti 2019 është më i lartë edhe se buxheti i vitit 2018 për 12 për qind, ose 161 milionë euro si vlerë monetare.

Të hyrat e planifikuara rriten krahasuar me vitin 2017 për 16 për qind. Pra, kemi të hyra shtetërore të planifikuara që të rriten krahasuar me vitin 2017 për 16 për qind. Krahasuar me vitin 2018, kemi 7,3 për qind. Një rritje solide e të hyrave buxhetore si rrallë më parë. Sa u përket shpenzimeve, për investime kapitale janë paraparë 770 milionë euro. Pra, edhe një herë, investime kapitale janë paraparë 770 milionë euro. Krahasuar me vitin 2017, janë 65 për qind më të rritura. Pra, kemi investime kapitale krahasuar me vitin 2017 për 65 për qind më shumë.

Mallrat dhe shërbimet janë të rritura 49 për qind krahasuar me vitin paraprak.

Subvencionet dhe transferet po ashtu kanë një rritje 20 për qind.

Ndarjet buxhetore nëpër sektorët e caktuar apo ministritë, më duhet të theksoj ende prin infrastruktura apo buxheti që i ndahet Ministrisë së Infrastrukturës, e cila merr pjesë në 48 për qind të investimeve kapitale. Pastaj Ministria e Planifikimit Hapësinor, që është një risi, merr pjesë me 11 për qind të investimeve kapitale, ose krahasuar me vitin 2018 për 34 për qind.

Po ashtu, e veçantë edhe si sektor në rritje mjaft të konsiderueshme është edhe buxheti i ndarë për shëndetësinë. Në total, për shëndetësi është paraparë buxhet në vlerë prej 225 milionë euro, ose 16 për qind më shumë se në vitin 2018. Disa parafolës të mi më kujtohet gjatë debateve që kemi pasur për buxhetin 2018 kanë bërë vërejtje të mëdha pse buxheti për shëndetësi nuk rritet. Ai është i rritur këtë vit, edhe atë për 16 për qind. Në prezantimet e tyre së paku nuk e përmendën si element pozitiv, sepse kërkesa ka qenë e tyre.

Po ashtu, më duhet të theksoj asnjëri nuk e përmendi prej parafolësve, së paku prej opozitës si diçka të mirë që buxheti në tërësi është 36 për qind më i madh se në vitin 2017, ose në qoftë se nuk i pëlqen përqindja, mund të thonë që janë 600 milionë euro më shumë. Kjo nuk ka ndodhur në asnjë periudhë të këtij shteti, e as gjatë atij vitit kur e kemi shpallur pavarësinë, pra kur ka kaluar buxheti prej UNMIK-ut në shtet të pavarur.

Po ashtu, është interesant të theksohet sepse ka rritje në disa agjenci që kanë të bëjnë me punësimin, si Agjencia e Punësimit, edhe disa institucione që kanë të bëjnë me funksionimin e

tregut. Këto i theksuam, sepse sipas analizës makrofinanciare ose dokument shtesë, që e falënderojmë ministrin sepse është hera e parë që dikush na ofron një analizë të tillë financiare dhe sipas kësaj analize del se edhe ajo është tejet zyrtare, e zyrtarizuar se punësimi, sipas Administratës Tatimore, ose numri i të punësuarve, i atyre që paguajnë tatim, që janë të punësuar janë 18 700 të punësuar që paguajnë tatim janë më shumë se në vitin paraprak. Pra, kemi zyrtarisht, të zyrtarizuar, të konfirmuar që janë 18 700 të punësuar më shumë, të cilët paguajnë tatim. Pra, kjo nuk ka ndodhur në asnjë periudhë kohore gjatë viteve të kaluara. Së paku kjo sipas të dhënave të Administratës Tatimore si institucioni më zyrtar, më përkatës për këtë.

Asnjëri prej kolegëve të opozitës nuk iu referua kësaj çështjeje që është shumë me rëndësi. U referuan me disa elementë periferikë të orientuar me një tendencë normalisht, ne e kemi parasysh që janë edhe opozitë, dhe i mirëpresim edhe kur t'i bëjnë ato tejkallime.

Sipas kësaj analize, po ashtu sipas këtij aneksi shtesë, GDP, që është treguesi më i mirë, ka rritje në terma realë, rritje reale në 4,7%. Ose planifikimi në terma nominal është 5,4%. Asnjë vend në rajon edhe rrallë ndonjë vend më gjerë se rajoni edhe në BE, nuk i ka këta tregues ekonomik.

Është diçka tjetër nga vijnë këto hyra, po këto janë reale dhe janë faktike. Asnjë vend në rajon edhe pak vende në Evropë i kanë këta tregues ekonomik. Pra, rritja e GDP-së është 4,7% në terma real edhe rritja nominale është 5,4%. Dhe gjatë asnjë periudhë e as të atyre që kanë qenë në pushtet s'e kanë pasur këtë rritje ekonomike.

Normalisht, që ne nuk jemi krejtësisht të kënaqur, edhe dëshirojmë që të kemi rezultate edhe më të lakmueshme, edhe kemi shpresë, sepse ky është një buxhet u shpresës. Ne kemi vërejtje ndoshta për ndarjet buxhetore. Të gjithë deputetët po i pyete veç e veç do të kenë vërejtje. Çdonjëri e kemi ndonjë projekt aty kah lagjia jonë, kah partia e vet edhe do të thonë që kemi vërejtje.

Edhe po të shikohen edhe do të ketë me siguri kërkesë të mëdha edhe prej atyre që e kundërshtuan këtë buxhet, do të ketë amendamente për projekte të caktuara.

Mua më duhet të them, sepse e kam edhe 1 minutë e diçka, edhe tendenca, ishte një tendencë të i jepet orientim partiak këtij buxheti. Unë i kam parë edhe i kam përcjellë disa prononcime të disa parafolësve edhe që janë thirrur në institutin GAP.

Unë po e marr vetëm një shembull, thotë Gjakova merr pjesë me 20,3% të Ministrisë së Infrastrukturës merr pjesë me investime kapitale. Gjakova, nuk është e vërtetë as qëndron për Gjilanin. Pse janë bërë këto shtrembërime ata e dinë. Unë i kam nxjerrë këto të dhëna në mënyrën time. Edhe një ekip prej 3 vetave kemi punuar dy ditë dhe mezi kemi ardhur në një konkludim.

Gjilani, edhe pse është më i vogël edhe me territor edhe me popullatë se Gjakova, merr pjesë me 5,64% në buxhetin, në investimet kapitale në tërësi. Kurse Gjakova është më e madhe me territor sepse i është zvogëluar territori Gjilanit, me 2,39%.

Do të më hidhërohet Ardian Gjini pse e ceka këtë edhe qytetarët ta dinë të vërtetën, po jam i detyruar. Mos i jepni orientim partiak se nuk qëndron. Ajo çka qëndron, vetëm për këtë vit jemi përpjekur që së paku ta bëjmë një balancë, edhe sidomos në aspektin gjeografik.

Unë i përgëzoj ata të cilët kanë punuar...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Hoti, në emër të Nismës!

**ENVER HOTI:** Faleminderit i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një ditë e veçantë për Parlamentin, sepse e kemi përpara propozim-projektbuxhetin për vitin 2019.

Dua të falënderoj ministrin për prezantimin që e bëri dhe dua të falënderoj Qeverinë për një punë të madhe që ka bërë në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për vendin. Dhe nga kjo që e kemi përpara si dokument dhe nga prezantimi i ministrit e pamë që për herë të parë kemi një buxhet me një rritje të tillë, që sigurisht do otë ndikojë në të ardhmen dhe në zhvillimin e gjithanshëm, shumëdimensional të qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit.

Parametrat dhe struktura e buxhetit është e hartuar mjaft mirë brenda ligjeve aktuale e cila paraqet qëndrueshmëri, realizim të buxhetit dhe e cila garanton një qëndrueshmëri fiskale do të thosha kështu.

Edhe këtu po shihet qartë se prioritet të cilat janë paraqitur nga Qeveria siç është Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe sistemi i drejtësisë kanë pasur rritje buxhetore për të cilat kanë nevojë qytetarët dhe do të ndihmojnë në fushat të cilat i përmenda.

Unë do t'i veçoj disa sepse kolegët më dhanë mjaft statistika të cilat nuk dua që t'i përsërisë, po dua të them se nga disa kolegë opozitarë të cilët ngritën disa çështje rreth Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si nuk iu ra në sy rritja që është mbi 80% për herë të parë krahasuar me vitin 2018 në Agjencinë e Punësimit. Dhe kjo do të ndikojë pozitivisht në avancimin e atyre nevojave që kanë sidomos të rinjtë në avancimin e tyre për përgatitjen e tyre profesionale në fusha të ndryshme të punësimit. Pra, është një intervenim apo një rritje buxhetore nga Qeveria që duhet përshëndetur.

Ose ngritja në Inspektoratin e Punës, që ka të bëjë direkt me ngritje 50% të pagës së inspektorëve dhe numrit të tyre, sepse ne po shohim se çfarë problemesh po kemi në vazhdimësi në zbatimin e Ligjit të punës, dhe mendojmë që kjo do të ndikojë shumë në luftën e informalitetit.

Unë mendoj se duhet veçuar edhe përmendur edhe rritjen e granteve nëpër komuna. Edhe pse duhet kritikuar komunat për mosrealizimin e të hyrave ose dështim në realizimin e të hyrave komunale.

Është me rëndësi që për herë të parë kryeqytetit i bëhet një ngritje e granteve mbi 10 milionë dhe kjo duhet përshëndetur.

Ne, po ashtu në investimet kapitale shkurtazi do të thosha që duhet vlerësuar investimet që janë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, sepse ato shkojnë direkt në shërbime për qytetarët. Në mbrojtjen e ambientit. Në trajtimin e ujërave të zeza. Në ngritjen e kapaciteteve të ujërave të pijes e tjera, të cilat për herë të parë po shihet që Qeveria po i ndryshon prioritet të cilat do të shkojnë direkt për qytetarët në shërbimet e tyre publike, dhe do të ndikojnë edhe në zhvillimin dhe në ngritjen e punësimeve dhe në hapjen e vendeve të reja të punësimit dhe në ngritjen e zhvillimit ekonomik.

Ajo çka dua edhe njëherë të them, i dëgjuam këtu ndoshta edhe fjalimet e përsëritura nga opozita duke aluduar në humbje të vendeve të punës, gjë që bie ndesh me statistikat, nuk është ashtu reale, dhe duke kritikuar skemat sociale. Këtu po e shoh një hipokrizi.

Unë mendoj që të gjithë mund të pajtohemi që ndoshta skemat sociale nuk janë në mënyrën e duhur, por nuk është barrë e vetëm e kësaj Qeverie apo e ministrit aktual. Kur po vjen puna që të miratohen projektet apo kategoritë sociale ne po i votojmë. Nuk po kemi guxim dhe vullnet politik që t'i ndryshojmë ato ose t'i ndalojmë ato skema të cilat vijnë si propozime të ndryshme nga të gjitha grupet politike, dhe duke mos pasur këtë guxim për shkak të ndonjë elektorati, atëherë kur kemi një ditë të tillë të veçantë duke trajtuar buxhetin e drejtojmë gishtin sesa mjete, kaq mjete hyjnë në skemat sociale.

Është e vërtetë që ndoshta është tejkaluar dhe nuk pajtoheni, mirëpo duhet marrë vullnet politik dhe guxim politik të gjithë dhe ta trajtojmë në themel këtë çështje.

Unë mund të kem vërejte të mjaftueshme me ata të cilët përfitojnë nga këto skema sociale, por ka hapësirë dhe në të ardhmen duhet të trajtohet kjo çështje në një mënyrë të ndryshme.

Ajo që është për t'u përshëndetur me këtë buxhet masat të cilat po i ndërmerr Qeveria në luftimin e informalitetit, mendoj se duhet përshëndetur sepse janë masa direkte të cilat do të ndikojnë në

zhvillimin e sektorit privat. Dhe këto masa të gjitha po merren përmes mesave ligjore që ne i përshëndesim dhe sigurisht do t'i përkrahim.

Edhe njëherë po them se, rritja buxhetore e cila ka ndodhur në të gjitha organizatat buxhetore, ne mendojmë se krijon një stabilitet për ato në funksionalitetin e këtyre organizatave buxhetore dhe ne si Grup Parlamentar Nisma Socialdemokrate, do ta mbështesim dhe do të punojmë shumë, dhe në mes dy leximeve do të japim kontributin tonë, nëse ka mundësi të ndryshohet diçka.

Po, ne mendojmë që ende jemi në deficite të papërshtatshme në raportet import-eksport. Kërkojmë ende masa shtesë në sektorin e bujqësisë dhe kjo nuk jemi atje ku dëshirojmë, por të gjitha këto do të trajtohen dhe do të zhvillohen gradualisht.

Ne e mbështesim dhe do ta votojmë projektbuxhetin për vitin 2019. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti Damka e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar 6+!

**FIKRIM DAMKA:** Sayın Başkan yardımcısı, Sayın Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri.

Kosova Cumhuriyeti'nin 2019 yılı bütçe tasarısında geneline bakıldığında geçen yıla göre arttığını ve bu artış içerisinde en çok dikkati çeken ve eleştirilecek nokta gelir ve giderler arasındaki ciddi bütçe farkıdır. 2019 yılı için öngörülen 416 milyon euroluk bütçe açığı 2017-2021 arasındaki 5 yıllık dönemdeki en yüksek gelir-gider dengesizliğinin olduğu yıl olarak görülüyor.

2017 yılı ile karşılaştırıldığında 600 milyon euroluk ek harcama kalemlerinin olması, dolayısıyla bu yüksek harcama kalemlerinin bütçedeki dengeyi bozması eleştirilecek en önemli konu olduğunu düşünüyoruz.

Sadece ülkemizde değil, Avrupa kıtasının da dahil olduğu geniş çaplı yaşanan ekonomik kriz döneminde harcamalarda kısıtlamaya gidilmesi gerekirken, gider kalemlerinin artması, dolayısıyla devletin borç yükünün altına sokulması doğal olarak vatandaşlardaki beklentiyi artırmaktadır, ki bu yıl borç yükü en fazla seviyeye ulaşmış durumdadır, bölge ülkelere baktığımızda yine borçlanma miktarımız kabul edilebilir durumdadır, ancak bu beklentiye karşılık vermek için tüm kurumların, mevcut çalışma kapasitelerinin artırılması gerekmektedir.

2019 yılı bütçesinde olumlu noktaların başında Sağlık ve Eğitime ayrılan bütçenin geçtiğimiz yıllara oranla artmış olmasıdır. Ancak bu artışlar yapılırken insana ve teknoloji arasındaki dengenin iyi korunması gerekir.

Özellikle yatırım projelerinin büyük çoğunluğu teknolojik ekipmanları kullanacak hekimlere, teknisyenlere değil de teknolojik ekipmanlara yapılırsa sorunların çözümünde çok fazla yol



alamayız. Önceliğimiz yetişmiş insan kadrosunu güçlendirmek, yeni hekimler yetiştirmek olmalıdır. İşte tam da burada devreye eğitim sistemi giriyor.

Eğitim sistemimizin ciddi reformlara ihtiyacı var. Eğitim politikaları, okul binalarını restore etmek yerine insana odaklanan projeleri baz alarak geliştirilmelidir. Eğitim bakanlığı tarafından yüksek potansiyelli öğrencileri desteklemek için ayrılan fon sadece 200 000€ iken başka projelerde örneğin belediyelerde süs ağaçların ekimine ayrılan bütçe 200 000 €uronun çok üstündedir, ağaçlara verdiğimiz önemi insan yetiştirmeye vermezsek, ülkemizin parlak geleceğinden söz etmemiz mümkün olmayacaktır. Bugün okularımızda araç gereç, laboratuvar eksiklikleri vardır, sadece bina ve boş sınıflar ile eğitim geleceğimizi inşa edemeyiz.

Bütçeye baktığımızda her yıl dile getirdiğimiz ve biz toplulukları yakından ilgilendiren ve devamlı takip ettiğimiz, Kosova’da yaşayan topluluklara yönelik çalışmalar yürütmekle görevli Geri Dönüşüm Bakanlığı her yıl hatırı sayılır bir bütçeyi yönetmektedir.

Ancak son yıllarda olduğu gibi bu yıl da öngörülen bütçe içerisinde planlanan harcama kalemlerinin çoğu Sırp topluluğuna yöneliktir. Son yıllarda Sırp toplumu dışında Kosova’da yaşayan Türk, Boşnak, RAE toplulukları ne yazık ki bu bakanlığın projelerinden faydalanamamaktadır.

Bu yıl da gördüğümüz üzere aynı durum 2019 yılı bütçesi için de devam ettirilmek istenmektedir. Talebimiz ilgili bakanlığa ayrılan bütçe içerisinde Sırp olmayan topluluklara yönelik konre projeleri içerecek kodun açılması ve bütçe ayrılmasıdır.

Bir diğer toplulukları ilgilendiren Başbakanlık ofisinde topluluklara ayrılan 1.7 milyon bütçeden bütün toplulukların almış olduğu payın akibetidir.

2018 yılında 1,7 milyondan topluluklara sadece 200 bine kullanmış olmalarıdır, ki Başbakana sene başında her topluluğa ne kadar pay ayrılması gerektiğini yazılı iletik ama bu pratikte gerçekleşmedi.

Bu yıl bu bütçenin her topluluğa şimdiden ayrılması gerektiğini talep etmekteyiz.

Bu ofis topluluk ofisi olmasına rağmen sırp topluluk dışında diğer topluluklardan çalışan yok, bu ofis her sene medyalarımıza destek sunarken bu sene hiçbir projeyi desteklemediklerini görmekteyiz. Bu sene bu her topluluk bütçe desteği nüfusa oranla belli edilmelidir.

Çalışma ve Sosyal Bakanlığı tarafından 2018 bütçesinde öngörülen Toplulukları destekleme ödeneği 2019 yılına kod olarak aktarılmıştır. Aktarılan bu ödeneğin yeterli olmadığını dolayısıyla artırılması gerekmektedir, Ayrıca 2020 ve 2021 yılı taslak bütçelerinde öngörülen ödeneklerinde artırılması şarttır. Finansi Bakanı ile bu konuda hem fikir olduğumuzu ve 2019 yılı bütçesinde bu değişiklik de sağlanacaktır.

Eleştiride bulunmak istediğimiz bir diğer konu da Kosova'nın tek Türk belediyesi olan Mamuşa Belediyesi'ne gerekli proje desteklerinin sunulmaması noktasıdır.

2019 bütçesinde yatırım projelerinin yaklaşık yüzde 50'sini oluşturan altyapı projeleri arasında Mamuşa'ya yönelik hiçbir proje bulunmamaktadır. Kosova nüfusunun 0.3'ünü oluşturan Mamuşa Belediyesi, Alt Yapı Bakanlığı tarafından hiçbir yatırım projesi desteği görmezken, Mamuşa ile aynı büyüklükte olan diğer belediyeler kişi başına 170 Euroya varan yatırım projesi destekleri almaktadırlar. Bu haksızlığın önüne geçilmesi gerekmektedir.

Bütçenin oluşturulmasında Mamuşa belediyesinin ülkedeki tek Türk belediyesi olduğu göz önünde bulundurularak, Mamuşa Belediyesi ile ortak hareket edilecek yatırım projesi destekleri yapılmalıdır. Bu çerçevede 2019 yılı bütçesine eklenmesini talep ettiğimiz 2 proje ile bu eksikliğin bir nebze de olsa giderileceğini düşünüyoruz.

Mamuşa'da bulunan Aile Sağlık Merkezinin, genel aile sağlık merkezine dönüştürülmesi ve buna ilişkin binanın ve kadronun sağlanması ve Anadolu İlköğretim Okulu'na sıfırdan yeni Spor Salonu'nun yapılması için bütçe ayrılmasını talep etmekteyiz.

Prizren'de faaliyette gösteren ve Kosovalı Türk çocuklarının çoğunlukta eğitim gördüğü Motrat Qirazi ilköğretim okuluna yeni Spor Salonu yapılması için 2019 yılı bütçesinden bütçe ayrılmasını talep etmekteyiz.

Bununla birlikte Türk toplumunun halen devam etmekte olan Türkçe kitap sorununun çözümü için ara formül geliştirilmelidir.

Kitap basımı ihalesini alan şirketler, Türkçe kitapların basımını ek maliyet gerektirdiğini bahane ederek, Türkçe ve Boşnakça ders kitaplarının basımını gerçekleştirmemektedirler. Bu sorunun giderilmesi için 2019 bütçesinde buna ilişkin kod oluşturularak ek bütçe ayrılmasını ve ayrılacak bu ek bütçe ile Türkçe ve Boşnakça kitaplarının basımının gerçekleştirilmesini talep etmekteyiz.

Bu ek değişiklikler yapılması kaydı ile grup olarak 2019 yılı bütçesini desteklediğimizi belirtmek isteriz. Teşekkür ederim.

**KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Hamza! Zoti ministër e keni fjalën!**

**MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar!**

Faleminderit deputetë të nderuar,

Duke e vlerësuar diskutimin tuaj, megjithatë mendoj se ka nevojë për disa sqarime. Sa i përket rritjes ekonomike duhet të pajtohemi se janë të dhëna zyrtare që nëse të kaluarën është bërë një lloj lavdi që unë e kuptoj edhe mirëkuptoj, që rritja ekonomike prej 4,1% ka qenë rritja më e madhe.

Nëse 4,1 është e madhe, atëherë 4,2, 4,3 është edhe më e madhe se 4,1 dhe 4,2. Pra, 4,2 dhe 4,3 është edhe më e madhe. Dhe ne vlerësojmë që për vitin e ardhshëm në një skenar të moderuar ku e kemi marrë zbatimin e projekteve të financuara prej klauzolës të investimeve vetëm 50%, ku pjesë të këtij skenari të moderuar nuk i kemi marrë investimet në projektin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike që ne presim që shpejt të fillojë, atëherë rritja ekonomike do të jetë në përputhje me planifikimet e programit të Qeverisë që ne kemi thënë 5-7%.

Ndërsa, sa i përket çka është premtuar në fushatë unë i kam programet e të gjitha partive politike. Nuk e di çka kanë premtuar e çka nuk kanë premtuar veç disa që i kanë premtuar as lapsi nuk i kapë as logjika e as matematika, por ajo nuk është pjesë me të cilën merrem unë.

Sa i përket vendeve të punës, nuk ka mundësi profesionalisht të shpjegohet, zvogëlim i vendeve të punës kur ki rritje ekonomike prej 4,2-4,3%. Kur ki regjistrim të ndërmarrjeve të reja në raport me periudhën e njëjtë të viti paraprak apo vetëm deri në shtator të këtij viti për 7404 ndërmarrje kur të dhënat e ATK-së, tregojnë që janë të punësuar në 3 mujorin e dytë të vitit 2018 në raport me vitin 2017, 18 700 të punësuar.

Kur të dhënat e trustit tregojnë që kemi një rritje të punësimit për 2% dhe kur nëse i referohemi anketave të Agjencionit të Statistikave, po, thotë që ka zvogëlim të numrit të të punësuarve po ka edhe zvogëlim të numrit të atyre që kërkojnë punë. Dhe në këtë rast kemi zvogëlim të normës së papunësisë, mirëpo kjo neve asnjërin nuk na vendosë në pozitë komode, se tek e fundit, a është norma e papunësisë 27 a është 29 apo 30 është e lartë dhe fatkeqësisht është më së shumti tek të rinjtë dhe tek gjinia femërore.

Sa i përket çështjes tjetër që ka diskrepancë mes të hyrave dhe shpenzimeve. Nuk ka diskrepancë mes financimit edhe shpenzimeve. Tash a i referohem cili burim i të hyrave apo cili burim i financimit, e shpjegova në paraqitjen time të parë.

Kaq janë të hyrat tatimore, pjesa tjetër financohet prej klauzolës së investimeve 121 milionë euro që nuk janë këto para veresi, këto janë marrëveshje të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës. Nuk kemi sjell ne këtu projekte dhe të themi ndoshta ia sigurojmë financimin.

Jo, jo! Marrëveshjet janë të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës dhe procedurat janë në zhvillim. Pjesa tjetër, të gjithë ne kemi diskutuar dhe kemi thënë që prodhojmë situatën ku mjetet nga procesi i likuidimit, në mënyrë ligjore të kthehen në ekonominë e Kosovës, dhe si rezultat i këtyre financimeve shtesë duke e përfshirë edhe borxhin publik që buxheti është ndërtuar 100% duke e respektuar ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ku deficitin i projektuar nuk është më shumë se 2%. Unë jam i sigurt që në realizim do të jetë më i vogël, po është i projektuar sipas ligjit dhe mënyra e financimit të deficitit është e paraparë prej financimit prej borxhit të brendshëm dhe të jashtëm.

Vitin e ardhshëm, kemi ndarë fonde që ne do ta bëjmë vlerësimin kreditor të vendit tonë. Dhe të shohim se cili është vlerësimi kreditor vendit tonë, dhe vendin ta përgatisim që të jetë pjesë e instrumenteve tjera duke e përfshirë edhe Eurobondin dhe ta ndryshojmë strukturën e borxhit publik. Gjithashtu, jemi në negociata me Bankën Botërore, unë besoj që do ta realizojmë që një pjesë borxhit publik për vitin e ardhshëm të jetë financim prej Bankës Botërore.

Buxhet social, këtu kemi një dallim, se kur po vijnë ligjet për popullizma shumica e deputetëve po rrahin gjoks bile po bëjnë garë cili po flet më shumë e më mirë për atë kategori e cili t'ju japë më shumë. Nëse duam ta ruajmë atë top prioritetin që është stabiliteti makrofiskal, atëherë Kuvend i nderuar, deputetë të nderuar, kujdes me ligjet edhe me iniciativat ligjore të cilat kanë kosto të lartë edhe nuk i targetojnë grupet që t'i nxjerrin prej varfërisë.

Ndërsa, kësaj radhe me buxhet janë targetuar grupet të cilat ua përmirëson gjendjen. Nuk ka deputetë edhe nuk dua të marr merita që dikush ose dikush të humb, po pensionet bazike, pensionet e pleqërisë pse janë rritur 20%, po më vjen keq nuk kam mundur më shumë se për 20% asnjë rezervë nuk e kam.

Pensionet kontributdhënëse për 15%, ndërsa vitin e kaluar janë buxhetuar, edhe më mos ta bëjnë deputetët ju kisha lutur që të aprovonin ligje të cilat nuk janë të buxhetuara.

Unë i kam gjetur tri skema që i kanë pasur ligjet e s'e kanë pasur buxhetin, skemat për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, skemat për viktimat e dhunës seksuale, skemat e personave të paaftësuar në vendin e punës, nëse dikush thotë pse janë rritur skemat apo përfitimet për skemat sociale për 20% nuk është mirë, e nëse e thotë që duhet pasur një korrektim të këtyre skemave dhe ata që s'e meritojnë të përjashtohen prej këtyre skemave, atëherë jam më shumë se në rregull dhe i lumtur.

Te çështja e veteranëve: Te çështja e veteranëve për numrin u diskutua shumë. Po, numri 35 mijë ka ekzistuar në shtator të vitit 2017, numri prej 34 mijë - 35 mijë është i shtatorit të vitit 2017.

Nëse dikush thotë që nuk ka ndryshim në prioritete, po ku shkoi rritja e buxhetit prej 261 milionë? Shkoi në arsim, shkoi në shëndetësi, shkoi në rend dhe ligj dhe shkoi në kategoritë sociale, të cilat kanë nevojë për përkrahje.

U diskutua këtu për borxhin publik. Fatmirësisht Kosova vazhdon ta ketë borxhin publik të ulët në raport me bruto produktin vendor 16%, po nëse i kthehemi historikut të rritjes së borxhit publik dhe e marrim vitin 2014 me vitin 2015, e kemi të rritur borxhin publik për tri pikë të përqindjes, apo shprehur në përqindje, për 30%. Ndërsa nëse e marrim vitin 2017 me vitin 2018, ne shohim që kemi një stabilizim të borxhit publik, si rezultat i politikave të kujdesshme, si

rezultat i rritjes së bruto produktit vendor, normalisht që është rritur edhe mundësia për rritjen e borxhit publik.

Te punësimi. I përmenda shifrat që ka ndodhur punësimi, nuk është në masën e duhur, sidomos kategoritë që i përmenda kanë nevojë për një trajtim tjetër.

Po, ka ndodhur rritja e pagave në sektorin publik vitin e kaluar, nuk është ajo që ndoshta ne dëshirojmë, po ka ndodhur rritja në përputhje me rritjen ekonomike dhe kjo ka reflektuar pastaj edhe në rritjen e pagave për sektorin publik, po kur flasim për paga në sektorin publik, gjithmonë duhet parë edhe sektorin privat, çdo veprim që ne sot këtu e bëjmë duhet parë sektorin privat, sepse bartës i rritjes dhe zhvillimit ekonomik duhet të jetë sektori privat.

Sektori privat është kontribuuesi më i madh në rritjen ekonomike dhe sektori privat është kontribuuesi më i madh në punësim.

Prandaj, gjithë fokusi ynë duhet të jetë që ne jo të kemi rolin e aktorit në ekonomi, po ne të jemi mbështetës i sektorit privat, që atje të zhvillohet ekonomia.

Për remitencat kam dëgjuar shumë debate, po nëse hyn në strukturën e remitencave dhe e sheh këtë strukturë, ne do të punojmë që të kemi politika të mira fiskale, të kem konkurrencë lojale, të kem trajtim të mirë të investitorëve dhe diaspora jonë ta sjellë kapitale dhe ta investojë në Kosovë. Ndërsa nëse hyn në strukturën e remitencave dhe i sheh që vijnë ka 300, 400, 500 euro, e dini sa vështirë është, për të mos thënë është e pamundur që t'i grumbullojmë ato edhe të themi të mos shkojnë në konsum, po le të shkojnë në investime, sepse shumica e familjeve i kryejnë pagesat për rrymë, për ujë dhe për ushqim.

Planifikimi i të hyrave, i fryrë! Jo, planifikimi i të hyrave është shumë profesional, shkon në përputhje me rritjen ekonomike, shkon në përputhje me rritjen e importeve të doganave, varësisht prej llojit të tatimeve dhe një pjesë në mënyrë shumë të kujdesshëm i jemi referuar zvogëlimit të stokut të borxhit tatimor.

Rimbursimi i TVSH-së. Ka pasur progres, sigurisht që ka hapësirë ende për përmirësim, po ka arritur deri në atë nivel që secili tatimpagues në mënyrë online mund ta përcjellë lëndën e vet ku e ka për çështjet e rimbursimit.

Te struktura e buxhetit. Kosova vazhdon ta ketë strukturën e buxhetit të mirë, duhet të vazhdojmë ta ruajmë. 33% e totalit të shpenzimeve të buxhetit me...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, vazhdoja fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: ...33% e totalit të buxhetit të shkojë në investime kapitale, bëni një analizë në vendet e regjionit dhe pak më jashtë, e shohim sa është pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e buxhetit.

Sa u përket iniciativave të reja ligjore, nuk e kemi lënë të bëjmë gabimin prej të kaluarës. Unë personalisht nuk jam pajtuar me disa iniciativa, prej disa tyre kam votuar kundër, edhe këtu në Kuvend e kam dhënë mendimin tim. Mirëpo, ka kaluar ligji në Kuvend, e ka financimin e sigurt.

Për pjesën e iniciativave ligjore që mund të vijnë gjatë vitit të ardhshëm, gjithashtu kemi qenë të kujdesshëm, ku nëse e vëreni dhe shikoni buxhetin, te Ministria e Financave janë do fonde aty, si kontigjenca, të cilat janë të dedikuara për mbulimin e kostos të iniciativave ligjore.

Sa i përket buxhetit të komunitat. Komunitat kanë autonomi të plotë sa u përket të hyrave vetjake. Ato mund ta përdorin për qëllimet që kanë nevojë.

Mirëpo, kur i marrim shpenzimet të mallrat, nuk do të thotë që shpenzimi për mallra automatikisht nënkupton shpenzim luks, nuk janë luks shpenzimet për mirëmbajtjen e projekteve. Është gabim të bëhet një projekt kapital e të mos sigurohet mirëmbajtja e atij projekti. Unë jam kundër rritjes së shpenzimeve për telefona, për derivate, për udhëtime pa nevojë, paarsyeshmëri, kundër këtyre të gjithave jam, po për mirëmbajtje të projekteve, për barna esenciale, për çështje të tjera, normalisht që i përkrah.

Te buxheti i FSK-së. 100%, jo më pak, 100% kërkesa e kësaj organizate buxhetore është përmbushur dhe kemi dhënë zotimin që në çdo fazë që këta kërkojnë buxhet shtesë, ne do t'i qëndrojmë mbrapa kësaj çështjeje. Për pjesë të tjera, janë pjesë të të gjitha institucioneve, po sa i përket aspektit financiar, as që e kemi diskutuar, kaq është kërkesa, që financimi. Në mbledhje të Qeverisë është ngritur një kërkesë për një buxhet shtesë, prapë e kemi aprovuar, nëse ka nevojë, këtu jemi.

Te buxheti i Zyrës së kryeministrit. Nuk jam këtu të luaj rolin e avokatit, të paktën, në asnjë moment ku për diçka nuk pajtohem, po duhet pasur qartë se në Zyrë të kryeministrit funksionojnë dy agjenci, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Agjencia e Veterinës së Kosovës, dhe nga totali i numrit të punësuarve në Zyrën e Kryeministrit, 350 u takojnë këtyre dy agjencive.

Prandaj, nëse ka ndryshim në strukturën e mallrave dhe shërbimeve të kësaj zyre, nuk do të thotë që është rritur luks, po është përmirësuar keqklasifikimi, se nuk ka logjikë që vaksinat të klasifikohen si shpenzim kapital, apo materiali për prodhimin e pasaportave, investim kapital,

apo blerja e librave, investim kapital. Prandaj, duhet parë brenda secilit institucion cilat agjenci janë dhe rritet buxheti për shkak se ka nevojë për përgatitje për regjistrimin e popullsisë.

Zoti Dardan Sejdiu,

Deputet i nderuar,

E përmende që ka ndodhur ndryshimi i numrave, e vlerësoj shumë lart edhe profesionalizim tënd, edhe korrektësinë tënde profesionale, diskutimin. Përveç që kanë ndryshuar numrat, se numrat e politikave janë të lidhura. Shpeshherë më ka rënë të dëgjoj edhe në raport me institucione të tjera duke thënë: “Jo, ne po flasim për politika”. Ok-eh, m’i lini mua numrat e ju bëni politikave ose mbulo politikave me numra, prapë jemi në rregull.

Përveç që kanë ndryshuar numrat, ka ndryshuar edhe financimi i prioriteteve. Nëse shikojmë rritjen e buxhetit, rritja e buxhetit ka shkuar në arsim, sigurisht i pamjaftueshëm, në shëndetësi, sigurisht i pamjaftueshëm, po nëse dikush thotë që nëse e krahasojmë buxhetin e vitit 2019 me 2017 për këtë sektor është rritur për 55 milionë, atëherë unë si ministër i Financave kam obligim të pyes ku është vlera për para dhe secili prej neve duhet të shpjegojë se këto financime shtesë a janë duke e dhënë vlerën e duhur. Do të thotë, kanë ndryshuar prioritetet në financim.

Deficiti tregtar.

Kosova qëndron mirë me stabilitet makrofiskal, stabilitet financiar, borxh publik. Kosova qëndron keq sa i përket deficitit tregtar e normës së papunësisë. Mirëpo, janë marrë veprime në politika fiskale që shkojnë në favor të ndërmarrjeve prodhuese, nuk po dua t’i specifikoj këtu, se veç i dini, e një pjesë janë në proces.

Sigurisht që këto s’mund të japin efektin e vet të plotë në një periudhë të shkurtër. Mirëpo, duhet ndryshuar edhe sistemin arsimor në Kosovë me qëllim që të prodhojë kuadro për nevojat e tregut, duhet të rritet produktiviteti i ndërmarrjeve private me qëllim që produktet tona t’i bëjë konkurrese në treg dhe ne si shtet duhet të fokusohem aty ku i kemi përparësitë kooperative.

Ne kemi deficit në tregtinë e mallrave, po kemi suficit në tregtinë e shërbimeve dhe në këtë drejtim besoj që politikave tona duhet të ecin tutje.

Më se e domosdoshme, s’është hera e parë, zoti Sejdiu, që po thoni, po me shumë të drejtë Kosova ka nevojë për një trajtim të skemave sociale, ka nevojë për një reformë pensionale, ka nevojë për një thjeshtësim të këtyre skemave dhe për një trajtim dhe fokusim drejt grupeve ku ne i largojmë prej atij kufirit të varfërisë dhe asnjë deputet nuk besoj që thotë se pagat janë të larta, po kemi nevojë t’i korrektojmë këto skema dhe të largohen prej këtyre skemave ata që nuk e meritojnë të jenë pjesë e këtyre skemave.

Deputetë të nderuar,

Deri tash, duke ju falënderuar për diskutimet tuaja shumë profesionale, më shumë se korrekte, jam në dispozicion tuaj dhe besoj që do të vazhdojmë prapë edhe nesër.

KRYESUESI: Mirë, replikë!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, ministër,

Në fakt, ministri bëri dy diferencime, të parën e bëri mes veti, institucionit të vet dhe Qeverisë, tha ne jemi Ministri e Financave, po kërkesat prej Qeverisë janë këto kur foli për mbrojtjen.

Dhe, i dyti, bëri diferencim mes Kuvendit dhe Qeverisë, tha ju deputetët po na sillni skema sociale, e ne si Qeveri po duhet t'i aprovojmë.

Po, në fakt, as buxheti e as qeverisja nuk shihen kështu, Qeveria është një, ka shumicën parlamentare, politikat e saj janë të prezantuara në këtë Kuvend dhe janë të aprovuar në këtë Kuvend, prandaj trajtimi i buxhetit bëhet si një, si i tillë janë dhe komentet tona.

Dhe kur komentet tona thonë që ju keni planifikuar në programin qeverisës si Qeveri rritje ekonomike prej 8%, por vini me buxhet dhe realizoni në mesatare 4.5%, do të thotë se ju keni korriguar projeksionet tuaja qeveritare, kaq, është i thjeshtë ky fakt.

E dyta, më vjen shumë mirë që e pranuat faktin që në buxhet, sepse këtë s'e kemi thënë ne, e thotë buxheti i Republikës në faqe 6, në paragrafin e fundit, se në bazë të dhënave zyrtare të punësimit në Kosovë këtë vit janë humbur 16 mijë vende të punës.

Unë më herët dëgjova këtu edhe kalkulime dhe llogaritje të Administratës Tatimore të Kosovës, të Trustit Nacional, në qoftë se ka nevojë, ne mund të mbajmë edhe ligjërata për punësimin formal dhe joformal dhe t'ju shpjegojmë çka është diferenca mes të punësuarve në të bardhë dhe në të zezë.

Njerëzit që paguajnë tatime jodomosdoshmërisht janë të vetmi që punojnë në Kosovë.

Pra, Agjencia e Statistikave e Kosovës që është institucion pranë këtij kryeministri që i merr 6 milionë euro prej këtij kryeministri, që është Zyrë e kryeministrit, thotë që janë humbur 16 mijë vende të reja të punës.

Dhe, në fund, buxheti, shpenzimet janë rritur për 600 milionë euro, atë që e thamë si Lidhje Demokratike e Kosovës dhe si parti të tjera opozitare është se pjesa më e madhe e rritjes nuk është në bazë të performansës buxhetore, është në bazë prej dy burimeve. I pari, fondet e



privatizimit, e dyta, huazimi prej institucioneve ndërkombëtare. Praj, prej 600 milionë eurove sa qenka rritur prej 2017-ës, 470 milionë euro janë të privatizimit dhe të borxhit, kaq është rritja, ky është fakt, ky është fakt i prezantuar në buxhetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, shpjegim shtesë.

MINISTRI BEDRI HAZMA: Unë jam ministër i Financave i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në të cilën kryeministër është zoti Ramush Haradinaj.

Çështja tjetër, Qeveria mund të propozojë një ligj, Kuvendi mund të dalë me iniciativa, po unë besoj që në një pikë të gjithë duhet të jemi të përbashkët që kur të vijë në rrezik stabiliteti makrofiskal, që s'është rasti me juve, zoti Abdixhiku, duhet pasur kujdes të largohesh prej politikave populiste, të cilat e rrezikojnë top- prioritetin e vendit, stabilitetin makrofiskal, po e dëmtojnë edhe strukturën e buxhetit.

Sa u përket shifrave, unë pajtoj në atë pjesën kur flasim që në bazë të anketave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka ndodhur kjo, mirëpo shpjegimi është pak më komplet, edhe ju e dini shumë mirë, jam i sigurt 100% se e dini, pse thoni kështu, e di që ju duhet, edhe unë ndoshta kisha thënë ashtu.

Po nëse u referohemi statistikave, atëherë del që numri i të punësuarve në tremujorin e dytë 2018 është 341 mijë, më 2017 ka qenë 357 mijë, dallimi del aty, por edhe numri i atyre që kanë kërkuar punë ka ndryshuar, në 2017-ën ka qenë 515 mijë, në 2018-ën është 484 mijë, e dallimi del 31 mijë e 200 më pak kanë kërkuar punë se sa në vitin paraprak dhe këtu del pastaj ana pozitive e atij punësimi.

Prandaj, do të thotë, qysh do le të jetë, ATK-ja, Trusti, numri i ndërmarrjeve të regjistruara kanë thënë që ka punësim pozitiv. Mirëpo, ne kemi normë të lartë të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu, e doni fjalën, se edhe zoti Sejdiu ka diçka.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Ministër, faleminderit për elaborimin e mëtutjeshëm të diskutimit.

Besoj që është tepër me rëndësi për hir të opinionit, sepse disa deputetë, por m'u duk që edhe ju e thatë sa u përket ligjeve që janë populiste edhe që vinë këtu e marrin votë, ne si Parti Socialdemokrate kemi pasur qëndrim të qartë, që besa edhe votë të qartë sa u përket ligjeve që po e rëndojnë buxhetin e Republikës së Kosovës.

Po më vjen mirë që në ministrinë tuaj ju si ministër jeni dakord që të futemi në reformë të thellë të sistemit pensional, duke e thjeshtësuar atë dhe duke e futur një koncept, i cili i bën dy gjëra: një, e zvogëlon barrën buxhetore, dy, e fut idenë e financimit për gjeneratat në periudhë tranzitore deri sa të dalin komplet në vetëfinancim.

Unë besoj shumë që kështu kursejmë mbi 100 milionë euro në vit, besoj shumë në kalkulimet që i kemi bërë si grup që me këto 100 milionë euro, të cilat mund t'i transferojmë në arsim.

Tjetra që po dua ta them është kjo.

Në buxhetin e Republikës së Kosovës tash e 10 vjet logjika e trajtimit të temave që lidhen me prodhim, përveç me politikë fiskale, nuk trajtohet assesi ndryshe, nuk mendoj që kjo është e mjaftueshme, mendoj që është e pamjaftueshme. Një kryeministër, një Qeveri kur e ka këtë deficit buxhetor shikon edhe mundësi të tjera intervenimi.

Sivjet e keni bërë një hap me këtë farë taksën, po kjo është edhe e pamjaftueshme që besa, nganjëherë po mendoj jo e duhura, por gjithsesi buxheti duhet të reflektojë intervenime të drejtpërdrejta në ekonomi që e zgjidhin problemin ose e trajtojnë problemin e deficitit tregtar dhe jo vetëm në shërbime, por edhe në zëvendësim të importe në prodhim të eksportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë shkojmë në pauzë deri në orën 15:30.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës.*

*Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shiniq.*

KRYESUESJA: Vazhdojmë me punimet e seancës, fjalën e ka deputeti Fidan Rekaliu. Urdhëroni!

FIDAN REKALIU: Faleminderit, e nderur kryesuese!

Fjala ime është në emër të Grupit joformal të deputetëve të rinj, në lidhje me adresimin dhe sfidat e rinisë për buxhetin e Kosovës për vitin 2019.

Është thënë shumë herë që të rinjtë janë e ardhmja jonë, por nëse të rinjtë nuk janë e tashmja, ata nuk mund të jenë as e ardhmja. Gjendja socio-ekonomike në vend, kualiteti i edukimit, përgatitja profesionale, politikat qeveritare dhe mbështetja financiare, janë vetëm disa faktorë, të cilët ndikojnë në të tashmen dhe të ardhmen e të rinjve. Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga numri i përgjithshëm i popullsisë prej 1.7 milion banorëve, 43% janë nën moshën 25-vjeçare. Por, njëkohësisht të rinjtë e Kosovës janë grup

mosha me nivelin më të lartë të papunësisë në Kosovë dhe në Evropë, si dhe më të papërgatiturit për tregun e punës. Papunësia te të rinjtë në 2018-ën është 55%, ose në nivel të njëjtë aty ku ishte edhe në vitin 2012. Nëse e shikojmë nga aspekti i vendeve të punës, vetëm 33 mijë e 113 të rinj të moshës 15 deri 24 vjeç janë të punësuar. Vetëm 15,6% të kontributpaguesve në Fondin e Kursimeve Pensionale janë në moshën 15-24 vjeçar. Njëkohësisht të rinjtë e përbëjnë grup moshën me shkallën më të lartë të pasivizimit të kontributeve në Trust.

Problem më shqetësues mbetet se 30,2% e të rinjve janë të papunë dhe njëkohësisht nuk ndjekin asnjë shkollim apo trajnim. Por, zbatimi i këtyre planeve është i mangët, përkundër funksionalizimit të Agjencisë për Punësim në Republikën e Kosovës edhe më tej nuk ka progres të mjaftueshëm në trajtimin profesional të grup moshave të reja. Licencimi i programeve të reja të aftësimi, akreditimit, e tjera. Po ashtu, tre vjet pas hyrjes në fuqi të strategjisë së Kosovës për zhvillim papunësia e të rinjve është ulur për vetëm 2.7% dhe është larg targetit prej 30%, të synuar deri në fund të vitit 2021. Me planin e veprimit për rritjen e punësimit të të rinjve 2018-2020 parashihet që më 2018 përqindja e të rinjve të papunë, të cilët nuk ndjekin arsimin ose trajnime të ulët në 24% të dhënat në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 tregojnë se kjo shkallë është ende mbi 30%. E një ndër arsyt pse planet strategjike, masat dhe objektivat e këtyre planeve mbeten vetëm në letër, është edhe buxheti i mangët, por në zbatimin e këtyre dokumenteve me projektbuxhetin e vitit 2019 vërehet një ngritje e buxhetit në tre sektorë kyç, ku mund të përfitojë rinia. Agjencia për Punësimin në Republikën e Kosovës, Departamenti i Rinisë në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Buxheti për sportet. Grupi i Deputetëve të Rinj të Kuvendit të Kosovës vlerëson faktin se buxheti i ARBK-së është i ngritur në 10.5 milionë euro me projektbuxhetin e vitit 2019, në krahasim me 6.3 milionë euro sa ishte në 2018-ën. Po ashtu, buxheti për rininë në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Rinisë thuajse është dyfishuar dhe ka një ngritje të buxhetit për sport. Por, buxheti për shërbimet e aftësimi profesional në kuadër të APRK-së ka mbetur thuajse i njëjti me atë të vitit të kaluar, kurse numri i të punësuarve në APRK që merren me aftësim profesional parashihet të ulët për dy pozita. Kjo është në kundërshtim me strategjinë e Kosovës për zhvillim 2016-2021. Agjendën për reformë evropiane, plani për reformën në ekonomi 2018, planin e veprimit për punësimin e rinisë 2016-2020, të cilat parashihnin rritjen e aftësimin e të rinjve dhe uljen e përqindjes së të rinjve të papunë, të cilët nuk ndjekin arsimin apo trajnime.

Gjithashtu, përkundër rritjes së buxhetit për rini në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sërish pesha e buxhetit për rini në krahasim me buxhetin total është vetëm 5.5%. Një rënie në krahasim me vitin 2016, kur buxheti për rini përbënte 8% të buxhetit total të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport është një ndër financuesit më të mëdhenj të organizatave joqeveritare, por financimi i organizatave joqeveritare rimore bëhet pa ndonjë strategji. Qeveria ende nuk ka aprovuar strategjinë për rininë 2018-2022, e cila është përgatitur dhe qëndron si draft. Andaj, duke marrë parasysh krejt këto që u thanë më sipër, Grupi i Deputetëve të Rinj rekomandon: rritjen e buxhetit për shërbimet e aftësimi profesional

në kuadër të Agjencisë së Punësimit, me qëllim të zbatimit të masave që dalin nga plani i veprimit për punësimin e rinisë 2018-2020. Aprovimin e strategjisë për rini 2018-2022 dhe alokimin e buxhetit për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, ndarjen e granteve për organizatat rinore në përputhje me objektivat e strategjisë, si dhe rritjen e peshës së buxhetit për rini në kuadër të buxhetit total të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Po ashtu, kërkojmë që rezoluta, e cila është miratuar nga 73 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të gjejë zbatim nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Naser Osmani, prej Grupit Parlamentar të LDK-së. Urdhëroni!

**NASER OSMANI:** Faleminderit, nënkryetare!

Deputetë të nderuar,

Ministra,

I nderuar ministër i Financave, edhe që nuk do ta kesh votën time, megjithatë të përgëzoj për punën që e ke bërë.

Ky është një buxhet i hartuar standard klasik, një buxhet, i cili i ka vetëm të ndryshuara numrat, ndërsa në strukturën e tij ka mbetur ashtu siç ka qenë krejt vitet e deritashme. Ajo që vërehet në rritjen e numrave, kryesisht në shpenzime, për diku 261 milionë, kryesisht ka të bëjë me rritjen e skemës pensionale apo atë siç e quaj unë, rritje e shpenzimeve në pjesën pasive të transfereve sociale. Nuk dua sot që të flas për deficitin buxhetor, i cili është 400 milionë, i cili parashihet që ai të mbulohet me të hyrat e brendshme dhe të jashtme, qofshin ato të AKP-së apo nga kreditë buxhetore, apo nga kreditë për klauzolën e investimeve, dua të përqendrohem vetëm në kategorinë e transfereve sociale që unë e konsideroj që ky buxhet nuk është as buxhet zhvillimor, sepse nuk ka mjete të ndara në kuptimin e zhvillimit buxhetor, edhe që këtu po dëgjoj deputetët kolegë të mi që thonë që ka 18 mijë të punësuar në vitin 2017. Mund të ketë 18 mijë të punësuar, po që kanë shkuar në Gjermani të punojnë, por jo në Kosovë, sepse shënimet që thirren në shënimet e Administratës Tatimore nuk përputhen me shënimet e Trustit Pensional dhe derisa kjo nuk është e përputhshme, atëherë ka edhe shumë dyshime, por edhe nëse është një rritje, atëherë është rritje përsëri prej kategorisë pasive, të atyre njerëzve që marrin përfitime nga Administrata Tatimore që përsëri konsideroj nuk është e qëndrueshme.

Ashtu siç nuk është ky edhe buxhet social, sepse është numër i vogël i atyre që marrin ndihmë sociale, sepse kryesisht mjetet shkojnë në skemat pensionale. Konsideroj që duhet pasur një vullnet politik edhe një hapësirë më të madhe menaxhuese në qeveri që skemat pensionale të rregullohen, qofshin ato bazike, qofshin ato të dala nga vlerat e luftës. Dhe, sot jam para juve vetëm të jap një propozim, të cilin dua ta përsëris vazhdimisht. Dua t'i propozoj kësaj Qeverie apo të këtyre kryetarëve të partive të koalicionit që kanë dalë nga lufta, të cilën e kanë sjellë në këtë gjendje kategorinë e veteranëve të luftës, që konsideroj se vetëm ata mund ta rregullojnë

këtë çështje dhe këtë kategori ta nxjerrim prej ligjit. Ta nxjerrim prej Ligjit të buxhetit dhe kategoria e veteranëve të luftës të mos figurojë më në Ligjin e buxhetit dhe shteti të mos merret më me këtë çështje. Po, kjo nuk do të thotë që ata t'i lëmë kurrkund, por kam një propozim që të formohet një fond jashtëbuxhetor që Qeveria të ndajë mjete në disa etapa, disa vjet që për atë fond, ku bëhen të gjithë veteranët aksionarë, të menaxhohet me një ligj dhe të rregullohet kjo çështje ashtu siç dëshirojnë ata, ashtu siç e përcakton ligji, apo të mos them të menaxhohet diçka ngjashëm qysh menaxhohet Trusti Pensional.

Derisa kjo çështje nuk rregullohet, ne vazhdimisht do të krijojmë një buxhet sa për të funksionuar, një buxhet, për të cilin s' do ta dimë cili është qëllimi i tij dhe do të vazhdojmë të bëjmë politika partiake. Po them partiake në kuptimin e asaj se edhe shpërndarja e mjeteve në investime kapitale, edhe pse shumica e projekteve janë vazhdimësi e projekteve të pakryera, konsideroj që këto investime apo kjo shpërndarje e investimeve kapitale është bërë kryesisht në lokalitetet prej nga vijnë edhe liderët politikë. Ka shumë investime në Deçan, ka në Gjakovë, po i them Blerimit, ka në Gjakovë goxha shumë, ka edhe në komunat, të cilat janë, si në Malishevë, në Mitrovicë, po nuk ka projekte në komunat që i udhëheq LDK-ja, apo është proporcioni 3 me 1. Prandaj, domethënë është një buxhet, i cili është bërë për të funksionuar edhe logjika, tek e fundit, është një projektion, është një buxhet i cili është i planifikuar, pavarësisht a është i mbështetur në indikatorët makroekonomikë, a është ky i drejtë apo ai i drejtë, apo është bruto produkti kaq apo nuk është, është me rëndësi që ky ministër ta ruajë rregullën fiskale, kjo është merita e tij. Krejt këtë buxhet, nëse arrin ta ruajë rregullën fiskale prej 2%, ndërsa të tjerat janë çështje të planifikimeve, kalkulimeve politike për funksionimin e shtetit në këtë formën e mjerueshme çfarë po funksionon.

Për të mos e zgjatur, propozimin që e kam dhënë, që mbetem mbrapa tij, është që kategoria e veteranëve të luftës që e ka hapur derën e pensioneve, skemës pensionale, e pritët të ketë ende pensione sipas ligjeve të veçanta dhe një Zot e di ku do të përfundojë kjo, që kjo të konsiderohet, të trajtohet në një mënyrë krejt tjetër, por jo nëpërmjet Ligjit të buxhetit, por me ligj të veçantë, që do të jetë jo pjesë e buxhetit në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu prej Grupit Parlamentar të PDK-së. Urdhëroni!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit! Kishin pasur dëshirë, po jam Partia Demokratike e Kosovës me krenari. Faleminderit, e nderuar kryesuese!

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa herë trajtojmë buxhetin e shtetit, është mirë që të bëjmë një rikapitullim apo një rivlerësim, ku ishim në të kaluarën, sot ku jemi me buxhetin e Republikës së Kosovës dhe objektivat e së

ardhmes. Buxheti i Kosovës në vitin 2007, kur Partia Demokratike e Kosovës erdhi në pushtet, ishte 776 milionë euro, ndërsa 11 vjet më vonë ky buxhet është 2 miliardë e 365 milionë euro, apo i rritur tri herë më shumë brenda 11 vjetëve. Kjo është bërë e mundur falë profesionalizmit të ministrit Bedri Hamza dhe objektivave të qarta ekonomike dhe programore të Partisë Demokratike të Kosovës, e cila mbetet parti konsistente në politikat e saj, vendimet dhe qëndrimet e saj.

Qytetarët e Republikës së Kosovës, sa herë trajtojmë buxhetin, sigurisht që ndërmend u shkon edhe koha kur ky buxhet trajtohej kur pagat e tyre ishin asistencë sociale, në nivelin e tillë. Sot çdo qytetar i Republikës së Kosovës në të gjithë sektorët, qoftë në arsim, në shëndetësi, në sektorin e sigurisë, apo të ushtrisë, policisë dhe drejtësisë kanë paga të dinjitetshme dhe këtë falë rritjes që Partia Demokratike e Kosovës e ka bërë në këta sektorë. Por, për vitin 2019 mendoj që sfida do të jenë skemat pensionale, apo thënë më mirë, avancimi i sistemit pensional të Kosovës do të jetë sfida kryesore për vitin 2019 dhe akomodimi i saj në kuadër të buxhetit për objektiva të qarta dhe stabilitet në skemat pensionale. Sfidë tjetër për buxhetin që unë e shoh, për buxhetin e vitit 2019, është akomodimi i Ligjit të pagave në kuadër të buxhetit të Kosovës, marrë parasysh kërkesat e të gjithë sektorëve. Prandaj, në Ligjin e pagave kam propozuar amendamente për të rirregulluar skemën e pagave në sektorin e shëndetësisë, me qëllim të ruajtjes së kuadrit profesional shëndetësor në Kosovë.

Gjithashtu, mbështetja edhe për sektorin e arsimit do të jetë një nga objektivat tona në kuadër të trajtimit të Ligjit të pagave. Kur jemi te mbështetja, unë do të dorëzoj dhe amendamente, së pari për të krijuar një mbështetje për zhvillimin ekonomik, si në ndërmarrësi, me ç' rast do të duhej një mbështetje dhe koordinim mes ministrive të lindjes dhe komunave për mbështetje të biznesit të vogël dhe biznesit të mesëm në Kosovë. Dhe, për të qenë në linjë të zhvillimit ekonomik, gjithsesi nuk mund të anashkaloj propozimin edhe për mbështetjen infrastrukturore për dy parqe biznesore, parkun e biznesit në Skenderaj, në fshatin Morinë, përgatitjen e infrastrukturës për të, si dhe vazhdimin e projektit të parkut industrial në Mitrovicë, konkretisht në Frashër, të vazhdojë ky projekt, sepse do të jetë në interes të zhvillimit ekonomik të këtyre regjioneve.

Te zhvillimi i sportit mbështetja ka qenë e evidente në vitin e fundit, por gjithsesi të prekshme kanë qenë edhe rezultatet e sportistëve tanë, si në mundje, ashtu edhe në futboll dhe mbështetja edhe me këtë buxhet për këto dy kategori është prezentë, për çka dua të shpreh falënderimin tim për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetjen që i bën këtij sektori, por që nëse është e nevojshme që të vazhdohet me projekte infrastrukturore, përveç meritave që ka i madhi Driton Kuka, dhe futbollistët tanë, atëherë sigurisht që edhe infrastruktura sportive duhet të ketë një mbështetje për këta. Dhe, kur jemi te mbështetja e sportistëve, në veçanti te krenaria e futbollistëve apo në atë që të gjithëve na bënë krenarë, nuk duhet harruar se kush është më meritori për hapjen e derës së afirmimit të sportit në Kosovë, në veçanti të futbollit. Pra rezultatet e futbollistëve tanë nuk do të ishin të mundshme pa legjenda e futbollit Fadil Vokrri dhe

propozoj që me buxhet të planifikohet shtatorja për legjendën e futbollit Fadil Vokrri dhe ajo të vendoset afër stadiumit me emrin e tij në Prishtinë. Po as Fadil Vokrri e asnjë prej përfaqësuesve tanë në sport e në kulturë nuk do të mund të arrinin këto rezultate pa luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj propozoj gjithashtu që te Agjencia për Komplekse Memorialë të ndahet një buxhet për ngritjen e pllakave përkujtimore për të gjithë të rënët në Republikën e Kosovës, buzë rrugës të ketë nga një pllakë përkujtimore për ta sepse kaluan 20 vite dhe në shumë vende gjurmët e luftës po humbin, derisa për kujtesën tonë historike dhe atyre që na vizitojnë do të ishte në nderin e të rënëve që të ngrihet nga një pllakë përkujtimore për të gjithë të rënët në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu do të parashtoj edhe disa amendamente dhe për të mos ju lodhur shumë, sigurisht projektin infrastrukturor për poligonin multifunksional sportiv në Skenderaj bashkë me pishinën gjysmë-olimpike, projektin të cilin e ka Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, mendoj që duhet të planifikohet dhe të akomodohet brenda buxhetit për vitet e ardhshme dhe këtë vit, vitin 2019, bashkë me sallën e edukatës fizike në shkollën “Fazli Grajçevci” në Shipol, si dhe shkollën “Harun Beka” në Gushavc. Një rrugë nga e cila kam kaluar shpesh gjatë luftës po e shoh që vit pas viti po mbetet anash se po qëllon mes dy komunave, të Vushtrisë dhe Mitrovicës, pra për rrugën Pantinë-Frashër, një rrugë e cila ishte një kohë rrugë e UÇK-së, por sot ka mbetur e patrajtuar edhe 20 vjet pas përfundimit të asaj lufte dhe kërkoj që të jetë pjesë e buxhetit.

Te trashëgimia kulturore kam një propozim që është pak më i veçantë, duket ndoshta edhe pak më afër në aspektin regjional, por që nuk mundem ta anashkaloj pa e bërë, sepse historia jonë e lavdishme, sidomos e Prekazit legjendar është e lidhur me emrin e tij, pra restaurimin e varrit të Prekë Kuçit, e të parit të Prekazit, dhe për atë që edhe e mban emrin Prekazi dhe të gjithë ne është mirë që të restaurohet varri i tij. Ne po parashtojmë kështu gradualisht buxhet pas buxheti, kërkesa, disa prej tyre edhe akomodohen, por që po ka një neglizhencë dhe një mosefikasitet të institucioneve përkatëse për realizimin e këtyre projekteve, për çka unë kam një vërejtje te ministritë e linjës. Kur ne e ndajmë buxhetin, planifikohet, por ministritë shkojnë ngadalë në realizimin e tyre. Është e pajustificueshme se si një mbikalim nuk mund të realizohet për një vit, ndërsa jeta e fëmijëve që nuk munden ta shfrytëzojnë atë mbikalim është në rrezik përditë. Ose nëse e ndajmë buxhetin për një stadium sportiv sindronik prej 200 mijë eurove, ndërsa brenda një viti nuk realizohet ai projekt. Apo projekti sikur ai i akademisë së parë ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Aqarevë dhe 50 mijë euro nuk mund të shpenzohen nga ministritë e linjës. Pra, pothuaj që përveç ndarjes së buxhetit, edhe një efikasitet të shtuar të institucioneve përkatëse në këtë rast të ministrive të linjës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi prej Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

SAMI KURTESHI: Faleminderit zonja kryesuese!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Anëtar të pranishëm të Qeverisë,

Ne sot po bisedojmë për buxhetin e vitit 2019 dhe sinqerisht të them në mesin e diku 150 mijë, apo 160 mijë shifrave është pak problem të gjendet njeriu, sidomos kur nuk e ka profesion e nuk merret tërë kohën veç me këtë çështje. Prandaj, pasi i dëgjova këto paraqitjet e përgjithshme unë do të fokusohem në dy çështje që kam interesim, natyrisht jo që të tjerat nuk janë të rëndësishme, mirëpo unë po fokusohem në dy çështje të rëndësishme: një është çështja e sistemit të drejtësisë dhe një tjetër është çështja e një skeme sociale që fatkeqësisht sipas këtij dokumenti të buxhetit në shtojcën e parë faqe 23 quhet edhe si rrezik, presion për iniciativa të reja për transfere sociale. D.m.th. hartuesi i buxhetit e sheh si rrezik. Mirëpo unë do t'i shfaq, sepse kur e kemi parasysh se këtu kemi mbi 20 skema të ndryshme pensionale, një pjesë e madhe e të cilave vërtet janë populiste, janë klanore dhe nuk janë ekonomike dhe ne i dimë saktësisht se cilat janë, por unë do ta paraqes një skemë sociale që është shumë e rëndësishme. Edhe kjo skemë sociale që është shumë e rëndësishme ka të bëjë me këtë fjalën hyrëse sot në seancë, me aktivizmin, ditët e aktivizmit e më konkretisht ka të bëjë me strehimoret për dhunën në familje. Për strehimoret e viktimave të dhunës. Që nga viti 1999, në Kosovë funksionojnë shtatë strehimore që ofrojnë shërbime për gra dhe për fëmijë, të dhunuara ose të larguara nga familjet në strehimore.

Sipas raportimeve, prej krijimit të njësitit të parë policor në vitin 2003 deri sot në Kosovë janë regjistruar nga policia mbi 20 mijë viktima të dhunës në familje, që 99 për qind të rasteve janë gra, vajza dhe fëmijë.

Kosova e ka nxjerrë edhe Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, e ka nxjerrë edhe Planin e veprimit, e ka futur edhe në Kodin e ri Penal dhunën në familje, mirëpo me gjithë këta mekanizma ligjorë dhuna në familje si dukuri nuk është duke u pakësuar dhe rrjedhimisht d.m.th. janë duke u rritur edhe shërbimet që duhet të ofrohen. Shteti i Kosovës sot për sot është i mbështetur vetëm te strehimoret dhe shërbimet që i ofrojnë ato strehimore. Zakonisht ne dy herë në vit, edhe sot e kemi bërë një përjashtim, me 8 mars dhe me 25 nëntor i mbushim grushtet me trëndafila e shkojmë nëpër restorante e u dëshirojmë çdo të mirë grave sepse ajo janë gjinia e bukur, e me disa fraza të tjera institucionale, jointitucionale të mëshirës edhe të një falsiteti dhe mandej harrojmë çka është duke ngjarë në 365 ditë, apo 363 ditë të tjera që mbesin. Strehimoret e viktimave të dhunës pra nuk kanë kurrfarë qëndrueshmërie, sepse nuk janë të futura në buxhetin e Republikës së Kosovës. As vitin e kaluar. Unë e shikova me shumë kujdes edhe atë kodin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nuk është aty. Realisht në vit, Ministria i ndal diku 20 mijë euro, 30 për qind prej tyre shkojnë për paga, kurse diku rreth 14 mijë euro shkojnë për të gjitha shërbimet e tjera për të gjitha strehimoret në Republikën e Kosovës.

Në krejt Republikën e Kosovës, nga hulumtimi që kemi bërë ne edhe vizitat janë 52 shtretër për këtë kategori të njerëzve. Në këta 52 shtretër vendosen nganjëherë 60 e 70 viktima, edhe



mesatarja që jepet për një viktimë të dhunës në familje në Kosovë është 4.5 euro në ditë. Tash llogariteni, aty kemi fëmijë, gra, vajza që s'kanë kurrfarë mundësie jetese edhe të strehimit tjetërkund. Edhe çka ngjanë në këtë republikën tonë të dashur? Kur dhunuesi që 99% të rasteve është mashkull shkakton dhunë, ai mbetet në familje si zotëri, kurse viktimat e dhunës nxjerrën nga familja edhe dërgohen që të strehohen.

Tash edhe kjo do të ishte në rregull, po kur e bëjmë një krahasim banal, nëse e merr policia dhunuesin edhe e çon në burg, për të i paguan shteti 20 euro në ditë, kurse për viktimën rreth 4,5 euro në ditë. Ky është absurdi në republikën tonë të dashur.

Lëvizja Vetëvendosje natyrisht që ka bërë edhe rekomandime, ka adresuar këtë çështje, dhe këtë vit më 15 mars 2018 Kuvendi e ka miratuar një dokument DO 486 numër, në bashkëpunim me të gjitha grupet, dhe njëra nga pikat e këtij dokumenti thotë: “Përfshirja e strehimoreve në planifikim e ardhshëm buxhetor për vitin 2019 dhe shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të jashtëzakonshme me rishikim të buxhetit për vitin 2018”.

As nuk u bë e para, as nuk u bë kjo e dyta. Janë në pyetje 20 mijë euro. Veç 5 zëvendësministra me shpenzimet e tyre sikur t'i kishim më pak, e të shtohet kjo shumë për pesë herë, kemi trajtim pak të dinjitetshëm të viktimave të dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Edhe këtë ne nuk e bëjmë.

Sigurisht, do të ketë para për të tjera gjëra, për lapidare, po për këtë nuk do të ketë. Prandaj, rekomandimi është që strehimoret në nivel vendi përveç certifikimit për shërbimet të cilat i ofrojnë, ato të institucionalizohen, ashtu që në buxhetin e shtetit ta kenë një zë buxhetor.

Shuma e mjeteve të alokuara në kohën e transferit për strehimoren në fjalë duhet të shumëfishohet e së paku të pesëfishohet edhe ajo bëhet veç 100 mijë euro.

100 mijë euro të dashur kolegë e zotërinj kanë të bëjnë me viktimat e dhunës që i shkaktojmë ne meshkujt në familjen tonë. Kjo duhet të mbrohet. Dëgjoni mirë, e zonja kolege ju lutem që ta kërkonin këtë me ngulm, sepse është fjala 99% për gra, vajza dhe fëmijë.

Çështja e dytë që dua ta ngriti është çështja e drejtësisë. Unë e shikova buxhetin për Këshillim Gjyqësor edhe Këshillin Prokurorial për vitin ardhshëm edhe për vitet tjera. Nuk është rritur numri i njerëzve aty.

Me ligjet për Këshillin Gjyqësor edhe për gjyqësinë në Kosovë, edhe Këshillin Prokurorial është kërkuar që për çdo gjyqtar dhe për çdo prokuror të ketë një bashkëpunëtor profesional. Nuk ka rritje të numrit të stafit për asnjë njëri. Është shtuar buxheti, por buxheti është shtuar vetëm për rritjen e pagave, po nuk është shtuar buxheti për kërkesën ligjore.

Unë e di si ministri thotë është kërkesë populliste. Jo, është kërkesë shoqërore. Është kërkesë institucionale. Është kërkesë e Komisionit Evropian për një reformë gjyqësore, e nuk ka kuadër të reformës gjyqësore për zhvillimin edhe forcimin e drejtësisë dhe për uljen e numrit të rasteve që janë duke pritur, por edhe për një punë më kualitative në Republikën e Kosovës të sistemit gjyqësor.

Unë e di se që njëzet vjet shumë njerëz këtu edhe në Kuvend edhe në Qeveri kanë thanë; rrofsh Maliqi se ligjin e bëjmë siç duam vetë, mirëpo kjo duhet të përfundojë.

Një nga arsytet që neve nuk na është dhënë liberalizimi është edhe mangësia në sistemin gjyqësor. Faleminderit shumë!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka ministri Bedri Hamza, urdhëroni!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, kryesuese!

Faleminderit deputet, zoti Kurteshi!

Kësaj radhe besoj që nuk ja ke qëlluar se çfarë do të them. E kam të kundërtën e asaj që e the, edhe t'u kisha lutur që ta përgatisësh një amendament, t'i drejtohesh Komisionit për Buxhet dhe Financa mes dy leximeve që të rriten fondet.

Shumën që kërkove, unë si ministër i Financave kam me ta përkrahur edhe besoj në vullnetin e mirë të deputetëve në Komision për Buxhet dhe Financa, duke pasur rëndësinë e temës që e ngritët, ne do të jemi në përkrahje të kërkesës suaj.

Ndërsa, sa i përket numrit të të punësuarve, buxhet është rritur për sektorin e drejtësisë. Edhe për Ministrinë e Drejtësisë. Edhe për Këshillin Gjyqësor. Edhe për Këshillin Prokurorial. Mirëpo, te numri i të punësuarve, Ministria e Financave e ka diskutuar këtë çështje me Ministrinë e Drejtësisë dhe e ka kërkesën kësaj; le të plotësohen fillimisht pozitat e paplotësuara, të aprovuara dhe të paplotësuara dhe pastaj kur të plotësohen këto pozita, ne jemi të gatshëm që të vazhdojmë tutje.

Po, për informatën tuaj po ju tregoj që ka pozita të paplotësuara edhe në Këshillin Prokurorial edhe në Këshillin Gjyqësor në raport me ato të aprovuarat.

Prandaj, kur të plotësohen këto, ne jemi të gatshëm që t'i mbështetim me pozita shtesë, ndërsa sa u përket pagave edhe kushteve të punës, besoj që zoti Kurteshi veç e dini që pagat i kanë shumë të mira, kushtet e punës të mira, sigurisht se kanë nevojë për përkrahje edhe më të madhe, edhe për kushte më të mira të punës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Ministër, faleminderit! Fjalën e ka ministri, zotëri Abelard Tahiri, urdhëroni!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar zoti Kurteshi, sa për informatën tuaj dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ju informoj se gjatë vitit 2017-2018 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, tashmë kanë filluar punën 94 gjyqtarë të rinj, si rezultat i përkrahjes financiare nga Ministria e Financave.

Janë në rekrutim e sipër edhe 37 që është në fund të procesit, pra rekrutimi, dhe në javën tjetër hapet konkursi për 27 të rinj. Pra, në total numri i gjyqtarëve të rinj brenda vitit 2017-2018 dhe në tremujorin e ardhshëm të viti 2019 do të jetë 158, e kjo do të thotë që i plotësojmë nevojat e Republikës së Kosovës sa i përket numrit të gjyqtarëve brenda sistemit tonë gjyqësor.

Sa i përket çështjes së bashkëpunëtorëve profesionalë, siç e tha edhe ministri i Financave, numri në total ka qenë rreth 295 për të dy këshillat për vitin 2018. Diku në masë 70% të tyre janë plotësuar. Në masë më të madhe është plotësuar nga Këshilli Prokurorial, mirëpo edhe Këshilli Gjyqësor po ashtu ka bërë progres në këtë çështje.

Janë 240 pozita të reja të paplotësuara në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Këto 240 pozita të reja, normalisht ne do t'i përkrahim në vazhdimësi, siç i kemi përkrahur për numrin e gjyqtarëve për numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë deri më tani edhe për vitin 2019. Pra, këto pozita do të plotësohen gjatë vitit të ardhshëm buxhetor, pra gjatë vitit 2019.

Është një numër rekord i gjyqtarëve, i bashkëpunëtorëve profesionalë, pra që janë pjesë e sistemit tonë gjyqësor e prokurorial gjatë këtij një viti e gjysmë më mirë të themi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ministër, faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Baftiu nga Grupi Parlamentar i PSD-së!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetare!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qëndrimet e grupit parlamentar për projektbuxhetin e vitit 2019 në aspektet e përgjithshme i dha Shefi i grupit tonë, e unë do të fokusohem në sektorin e shëndetësisë.

Ndonëse ka rritje në këtë sektor ashtu siç edhe tha edhe ministri Hamza, rritja është e pamjaftueshme me të cilën gjë edhe unë po pajtohem, ngase rritja e buxhetit për shëndetësi, ndonëse është për 30 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar, prapë se prapë Kosova është vendi i vetëm në rajon që ndanë më së paku buxhet për kokë banori në raport me bruto produktin mendor, si dhe vendi i vetëm në rajon që nuk ka sigurime shëndetësore.

Rreth 40% të shpenzimeve në shëndetësi paguhen nga xhepi i qytetarëve dhe ky është dyfishi i përqindjes së shpenzimeve të qytetarëve të Bashkimit Evropian që bëjnë për shëndetësi.

Çka është reale të them është se rritja e buxhetit për shëndetësi po bëhet nga viti në vit, por që kjo rritje është pozitive. Mirëpo, në anën tjetër, kjo rritje e buxhetit për shëndetësi nuk po reflekton në përmirësimin e gjendjes në këtë sektor që do të thotë që përveç që duhet rritur buxheti për sektorin e shëndetësisë, më shumë duhet edhe një menaxhim edhe më i mirë i këtij buxheti. Po ashtu, duhet që sa më parë të kemi sigurime shëndetësore, të cilat janë një garanci që të kemi një buxhet më stabil për shëndetësi dhe që të plotësohen nevojat për trajtim dhe shërbim të pacientëve.

Për Ministrinë e Shëndetësisë buxheti është 80 milionë euro, që po ashtu është një rritje për 14,5 milionë euro krahasuar me vitin 2018. Pjesa më e madhe shkon për mallra dhe shërbime, apo 42 milionë euro, ku është një rritje për 10 milionë euro për barna nga lista esenciale, por prapëseprapë qytetarët do të detyrohen të blejnë barna, sepse pa sigurime shëndetësore pacientët nuk do të kenë zgjidhje për barna esenciale. Kjo do të thotë se sigurimet shëndetësore janë baza që buxheti të jetë më stabil sa i përket shëndetësisë.

Në bazë të asaj që u tha paradite, në përgjigjen e një pyetjeje parlamentare nga ministri Uran Ismaili u pa se sigurimet shëndetësore janë shumë larg. Ai tha se do t'i kemi diku në fund të vitit 2019, mirëpo siç jemi mësuar tani e sa mandate premtime të tilla edhe prej ministrave të tjerë, edhe nga ky aktual, kemi në vazhdimësi, mirëpo çka është ajo reale nuk kemi sigurime shëndetësore.

Edhe buxheti për shpenzimet kapitale është rritur nga 14 në 21 milionë euro, që i bie 47 për qind më shumë, mirëpo prapëseprapë nuk janë marrë parasysh kërkesat nga klinikat të cilat kanë pasur nevojë, qoftë për shtim të hapësirës, apo edhe për aparaturë, për diagnostifikim të sëmundjeve. Si p.sh. klinika e Onkologjisë që ofron shërbime tanimë 24 orë, ka nevojë për zgjerim të hapësirës, por edhe për aparaturë për diagnostifikim dhe trajtim të sëmundjeve malinje. Komisioni për Shëndetësi e kemi vizituar këtë klinikë dhe ne u kemi premtuar se do të angazhohemi si komision që ndërmjet dy leximeve të Projektbuxhetit të bëjmë amendament dhe të përkrahim këtë klinikë. Një pjesë e investimeve kapitale janë vazhdim i atyre të vitit 2018.

Në buxhetin për vitin 2019, në investime kapitale nuk janë paraparë mjete për ndërtimin e një qendre rehabilituese për rehabilitimin e personave të varur nga substancat narkotike, me gjithë atë që strategjia kombëtare kundër narkotikëve 2018-2022 parasheh ndarjen e 200 mijë eurove për ndërtimin e një qendre rehabilituese.

Sa i përket buxhetit të planifikuar për SHSKUK-në, po ashtu ka rritje për 11,2 milionë euro. Mirëpo, këtu shohim se këtu ka vetëm dy projekte që është ai i Klinikës së Ortopedisë, zgjerimi dhe renovimi me vlerë 600 mijë euro dhe Projekti i ndërtimit të Klinikës së re të Nefrologjisë. Mirëpo, ka shumë projekte të cilat janë vazhdimësi e projekteve nga viti 2018.

Ne si Parti Socialdemokrate do të kontribuojmë që ndërmjet dy leximeve të Projektligjit për buxhetin për sektorët që për ne si subjekt janë shumë me rëndësi, e ku hyn shëndetësia, arsimit, mirëqenia sociale, që nëpërmjet amendamenteve në komisionet përkatëse të favorizojnë këta sektorë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit deputete! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj. Urdhëroni, deputete!

Regjia, fjalën, ju lutem! Deputete, a mund të kaloni në një vend tjetër?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Personalisht ndihem mirë që jam pjesë e kësaj legjislature, jo vetëm për faktin që këtë Qeveri e udhëheq lideri i partisë sime, kryeministri Ramush Haradinaj, por edhe për faktin që sukseset e kësaj qeverie shihen më së miri në buxhet, pra në shifra të cilat s'kanë si të jenë më të besueshme dhe s'ka çka të komentohet, sepse janë shifra, dhe shifra është shifër, edhe pse po dëgjojmë kritika.

E di që kritikën janë të shumta, sidomos të opozitës, kryesisht duke u bazuar në të dhënat të cilat mund të manipulohen, apo të thuhën ndryshe, vetëm me qëllim që t'i dezinformojnë qytetarët me qëllim që ta dobësojnë performancën shumë të mirë të kësaj Qeverie. Pra, me këtë buxhet nuk e di se çfarë mund të thuhet.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot Qeveria Haradinaj bashkë me ministrin e buxhetit na e kanë prezantuar buxhetin që është garant i zhvillimit ekonomik të viteve të ardhshme, një buxhet që ka trend të rritjes nga 1,7 miliard më 2017, në 2,3 miliardë në vitin 2019. Për dy vjet rritje prej 600 milionë euro. Vetëm për këto dy vjet të qeverisjes Haradinaj është rritur për 34 për qind më shumë. E di që me këtë buxhet u është dhënë prioritet arsimit, shëndetësisë, por edhe sektorit të drejtësisë, rend dhe ligj. Edhe mirë është që është klasifikuar në këtë mënyrë.

Po më vjen mirë që ka rritje edhe në buxhetin e shëndetësisë. Buxheti për shëndetësi është 233,9 milionë euro dhe ka rritje prej 30,1 milionë euro prej vitit të kaluar, gjë që e bën të mundur që shëndetësia të ketë një performancë më të mirë. E di që nevojat e shëndetësisë janë të shumta dhe që ka nevojë ndoshta edhe për më shumë, por prej vitit në vit po shohim që e kemi një rritje dhe kjo normalisht që do të ndikojë në një performancë më të mirë në sektorin e shëndetësisë. Rritja e shpenzimeve në shëndetësi mund ta përmirësojë edhe vlerësimin që e ka dhënë Komisioni Evropian për Kosovën, sepse në vitet e kaluara i ka pasur brengosje shpenzimet e ulëta publike në shëndetësi dhe ndoshta në këtë formë rritet edhe performanca nga vlerësimi i Raportit të Progresit. Shpenzimet që bëjnë për shëndetësi qytetarët e vendeve si Kosova 40 për qind,

Shqipëria 49,9 për qind, Mali i Zi 42,8 për qind nga xhepi i tyre, si përqindje e shpenzimeve totale për shëndetësi në vend llogaritet të jetë rreth dyfishi i asaj që shpenzojnë qytetarët e Bashkimit Evropian dhe kjo në vendin tonë e bën që Kosova nuk ka Ligj të sigurimeve shëndetësore.

Rritja e buxhetit në nivel qendror është 18 për qind, ndërsa në nivelin primar e kemi 11 për qind. Gjatë vitit 2019, vetëm 7 për qind, apo 1,5 milion e buxhetit do të investohen në projekte të reja dhe këto investime janë investimet në KPSH, që janë 1,4 milion, pajisja mjekësore për emergjencë në QKUK 50 milionë, që është një lajm i mirë për punëtorët shëndetësorë që punojnë në qendrën klinike në Emergjencë, sepse të gjithë jemi dëshmitarë të kushteve të vështira në të cilat punojnë këta mjekë dhe njëkohësisht është lajm i gëzueshëm edhe për qytetarët e Kosovës, sepse adresa e parë kur një qytetar i sëmurë u drejtohet institucioneve shëndetësore është Qendra Emergjente. Ndoshta ky duhet të jetë veç fillimi, sepse janë të pamjaftueshëm 50 milionë, po megjithatë me gjithë këto 50 milionë mund të stabilizohet deri diku ajo gjendja që nuk është e rregulluar. Investim i ri është kontrolli i cilësisë dhe sigurisë së gjakut në vlerë prej 120 mijë euro, ndërsa disa investime të tjera kapitale dhe që janë të domosdoshme në sektorin primar janë ndërtimi i një qendre kryesore të mjekësisë familjare në Gjakovë, në Gjilan, projekti dhe ndërtimi i Spitalit të Prishtinës, ndërtimi i Qendrës Trajnuese në Pejë, investimet në KPSH.

Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor e zënë vendin e dytë sa i përket rritjes së investimeve kapitale.

Pra, megjithëse prej vitit në vit kemi rritje të buxhetit në sektorin e shëndetësisë, kjo është e pamjaftueshme, sepse edhe me këtë përqindje të buxhetit nevojitet edhe një menaxhim më i mirë i këtij buxhetit, në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimeve shëndetësore në sektorin e shëndetësisë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka buxhetin më të madh, sepse përfshin skemat sociale dhe pensionet, 465,8 milionë euro. Sipas programeve, do të ketë rritje të buxhetit për pensione rreth 52 milionë euro. Kjo rritje bëhet për shkak, sepse do të ketë rritje të pensioneve bazike, që është një lajm i mirë për pensionistët. Mirë është që rritje të theksuar të buxhetit do të ketë për 85 milionë te Inspektorati i Punës, duke e ditur përgjegjësitë e këtij institucioni dhe ajo çka është e mirë, është se do të ketë rritje të numrit të të punësuarve në Inspektoratin e Punës për 10 persona, sepse ka qenë edhe kërkesë e shumë deputetëve. Ka qenë edhe kërkesë e Komisionit Parlamentar, por edhe kërkesë e Kuvendit të Kosovës, sepse ne e kemi parë së fundi numrin e personave të lënduar në punë, por edhe vdekjeve që kanë ndodhur si pasojë e mungesë së kushteve në punë dhe kjo është një mundësi e mirë që të inspektohen të gjitha këto ndërmarrje, në mënyrë që vdekjet në punë të zvogëlohen. Dhe, kategori të reja që janë përfshirë në këtë sektor janë invaliditeti i punës, pensionet familjare, pagesa e viktimave të dhunë seksuale që janë

kategori të reja dhe mirë që janë futur në buxhet dhe edhe këto kategori mund të kompensohen me paga që u janë përcaktuar nga buxheti.

Andaj, të nderuar deputetë, Buxheti i Kosovës është ky, megjithatë është munduar të shpërndahet në mënyrë proporcionale, edhe në raport me komuna, edhe në raport me institucione të nivelit qendror, por edhe në institucionet e nivelit lokal. Prandaj, është më se e drejtë që të përkrahet nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Prej Grupit Parlamentar Nisma, fjalën e ka deputeti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Para se të flas rreth buxhetit, më vjen shumë keq që më duhet ta bëj një hyrje për një koleg deputet, por që për fatin e keq nuk është në sallë. Ka disa herë që unë trajtoj tema shumë të rëndësishme në këtë Kuvend dhe nga ky deputet dhe nga disa deputetë të tjerë, edhe një deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pasi nuk është në sallë nuk po ia përmend emrin, i cili është zënë në një skandal me 84 mijë dollarë fals, është arrestuar madje mu në Drenicë, dhe ai ka të drejtë morale, qytetare të më akuzojë mua për viza. Të njëjtën gjë e bën sa herë që unë flas diçka kundër hajnisë shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca.

Unë sot këtu e kam marrë dosjen. Kam 900 emra me numra të telefonit, të cilët në mënyrë simbolik do t'ia dorëzoj Glauk Konjufcës, edhe ata të cilët e mbështetin Glauk Konjufcën që të marrin edhe të gjejnë se cili person...

KRYESUESJA: Zoti deputet, kthehuni në temë të lutem!

MILAIM ZEKA: Unë do të kthehem në temë dhe do të hyj në temë, kjo është parantezë, dhe ju lutem zonja kryesuese nuk kam dal prej temës. Këtë do t'ia dorëzoj, së pari do t'ia lë dosjen, pastaj do të flas. Edhe kjo është temë e Parlamentit, sepse nuk lejohet që një deputet të bëjë akuza përderisa një lëndë është në proces gjyqësor. E kam thënë dhe po e them publikisht para krejt kolegëve dhe të gjithë qytetarëve, në qoftë se Milaim Zeka, qoftë një qytetar të Kosovës e ka mashtruar, ose i ka marrë një euro për viza, unë jap dorëheqje nga posti i deputeti të Republikës së Kosovës dhe pres një javë ditë që të më japë përgjigje shefi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, pas një jave pastaj unë do t'i përgjigjem dhe do të flas me fakte shumë rrëqethëse edhe për ata deputetë të cilët kanë shkuar për trajtim neuropsikiatrik te Burdushi.

Pastaj shohim kush janë pacientët e Burdushit, kush janë hajdutët që u vjedhin paratë taksapaguesve dhe që shesin moral dhe patriotizëm këtu në këtë sallë të Parlamentit. Dhe do të flasim se kush është takuar edhe me BIA-n serbe, edhe është pështjellë me qebe që të mos e kapë Policia e Kosovës, për çdo gjë do të flas dhe për çdo gjë do të jem këtu në Parlament të

ballafaqohem me çdo faqezi të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili është hipokrit dhe do t'i shesë rrena e pallavra publikut dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Sa i përket buxhetit, unë nuk do të hyj të flas për katunde, për krahina, sepse Kosova është një hapësirë me 10 mijë kilometra dhe në ato 10 mijë kilometra unë nuk besoj që ministri, ish-shoku im i shkollës ka bërë ndarje d.m.th. krahinore të delegimit të buxhetit. Ajo që dua ta lus ministrin e Ekonomisë dhe Financave dhe Qeverinë e Kosovës që t'i zbresin në maksimum shpenzimet që janë marramendëse të zëvendësministrave, të udhëtimeve të deputetëve, të makinave të Qeverisë së Kosovës. E thërras edhe kryetarin e Parlamentit të Kosovës, edhe Kryesinë e Parlamentit të Kosovës që ta prishin kontratën të cilën e kanë bërë për 66 muaj, ku kanë marrë makina me qira, që do t'i kushtojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës 330 mijë euro dhe krejt këto para t'i orientojmë te çerdhet, te shkollat dhe te azilet e pleqve.

Gjithashtu dëshiroj që ministri ynë dhe Qeveria t'u japin prioritet spitaleve, arsimit, azileve të pleqve dhe mbi të gjitha çerdheve të fëmijëve. Në qoftë se ne nuk investojmë, në qoftë se Qeveria e Republikës së Kosovës i orienton paratë në asfalt, por jo në çerdhe të fëmijëve, në qoftë se ne nuk do ta kemi prioritet për pesëvjeçarin, dhjetëvjeçarin e ardhshëm që çdo fshat i Republikës së Kosovës ta ketë nga një çerdhe, ne nuk mund ta zhvillojmë këtë vend. Prandaj, zoti ministër, hiqini ato telefonatat pa kufi, privilegjet, ato kartelat që nuk e di ndoshta mund të ma japësh sa e keni, por e di që zëvendësministrat kanë kartela bajagi të majme, këshilltarët kanë shoferë me rroga shumë të majme, këshilltarët e ministrave, këshilltarët e kryeministrit, këshilltarët e zëvendësministrave kanë makina personale. Rrogat i kanë shumë të mëdha, e kanë edhe benefite shumë të mëdha, ndoshta Kujtimi e di ma mirë, se edhe ty ta patën kallur kerrin këtyre here, pastaj s'kishe para për të dalë e ta blesh veturën, por edhe keni qenë ministër, ministër shumë i respektuar për mua, edhe ti, edhe Arben Arbashi, edhe Imet Rrahmani, ministri i Shëndetësisë, duke e harruar zotin Zharku kështu, por kjo është brenga ime, zoti ministër. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Danush Ademi prej Grupit Parlamentar 6+.

**DANUSH ADEMI:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Ne nuk do t'i shkojmë rreth e rrotull në fakt këtij buxheti, por do të jemi pak më konkretë, sepse shumë është biseduar dhe gjithmonë e kemi votuar këtë buxhet, por tash më në fund jemi të shqetësuar. Janë ndarë 1,8 milion euro për ndërtimin e shtëpive dhe ne e dimë që kemi pasur përkrahje nga Ministria e Financave, por më në fund doli qëndrimi se ndërtimi i shtëpive është vonuar, pasi katër ditë para Vitit të Ri tenderi përfundon. Ne e dimë që në këtë vit nuk do të jenë në plan ndërtimi i këtyre shtëpive, por kërkojmë nga ministri i Financave që ky projekt i 1,8 milionëve të jetë në vazhdimësi. Në vitin 2019 duhet t'i shtohet edhe ai 12-përqindëshi i famshëm, meqë nga kryeministri është shtuar buxheti, besoj që edhe kërkesat e komuniteteve do



të shtohen. Besoj që ministri do ta ketë parasysh kërkesën tonë, sepse qytetarët, përkatësisht 159 familje janë duke pritur për ndërtimin e shtëpive.

Nëse fillojmë me të gjitha projektet të cilat parashihen në buxhet, por nëpër komuna kemi parë, në pjesët ku jetojnë komunitetet, komunat shumë pak i kanë marrë përsipër kërkesat e komuniteteve.

Prandaj, jemi detyruar si deputetë drejtpërdrejt t'u drejtohem ministrive përkatëse, sepse ata qytetarë, ato komunitete duhet të kenë mbrojtje dhe duhet të përfaqësohen nga deputetët e tyre, meqenëse në asnjë komunë ne nuk kemi kryetar të komunitetit tonë ashkali apo egjiptian.

Ata nënkryetarë që i kemi janë vetëm sa për sy e faqe, dhe asnjë kërkesë e tyre nuk është marrë parasysh. E kemi kërkesën e shtëpive në Ferizaj për komunitetin ashkali, e cila e ka vlerën 800 mijë euro, ku kërkohet që urgjentisht të ndërtohen 45 shtëpi për strehim.

Ndërtimi i ndërtesës kolektive për banim social në komunën e Suharekës. Ndërtimi i ndërtesës kolektive për banim social për komunitetin ashkali edhe egjiptian dhe atë rom në Komunën e Mitrovicës. Këtë kërkesë ia kemi drejtuar edhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale me shkrim, kërkesë të cilën e kanë pothuajse që një muaj në zyrat e tyre dhe nuk e kanë planifikuar që të kalojë në këtë buxhet.

Në Ministrinë e Infrastrukturës kemi parë që në ato vende që janë të banuara me komunitete kemi shumë pak në buxhetin e vitit 2019, që ato rrugica dhe infrastruktura e komuniteteve nuk ka marrë përkrahje, edhe pse i kanë pasur kërkesat e vazhdueshme. Në Ministrinë e Infrastrukturës jemi detyruar si deputetë t'i dorëzojmë kërkesat për çdo vend ku e kemi parë të arsyeshme.

Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Ferizajt në fshatin Dubravë në lagjen "Sallahane" dhe lagjen "Alit Ibish". Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Obiliqit në fshatin Plemetin dhe rruga "Avdullah Çerkezi". Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Suharekës në fshatin Suduçan, në fshatin Leshan dhe në fshatin Gelancë.

Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Lipjanit, fshati Hallaç i Vogël, rruga "Ismet Asllani", fshati Medvec dhe fshati Gadime. Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Pejës, në lagjen 7 Shtatori, rruga "Agim Binak Çelaj" dhe në fshatin Vitomiricë. Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Gjakovë dhe në fshatin Skivjan.

Po ashtu kemi kërkuar edhe nga Ministria për Zhvillim Rajonal, e cila është po nga ky grup, e cila asnjëherë nuk e ka marrë asnjë kërkesë parasysh. Ministrin Rasim Demiri i kemi drejtuar me kërkesë që së paku edhe aty të na pranohen kërkesat tona, mirëpo ai asnjëherë nuk i ka marrë

parasysh, edhe pse është ministër i Grupit Parlamentar 6+. Nuk kemi marrë përkrahje nga ai asnjëherë në vitin 2018.

Prandaj, jemi detyruar si deputetë t'i drejtohem me kërkesë drejtpërdrejt, e cila kërkesë është e protokolluar dhe besoj që në vitin 2019 do ta ketë më të qartë, sepse duhet të merren parasysh kërkesat e Grupit 6+ dhe të komuniteteve.

Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Mitrovicës në rrugën "2 Korriku". Ndërtimi i sallës ndihmëse në shkollën "Bedri Gjinaj" në komunën e Mitrovicës. Rregullimi i Parkut në fshatin Plemetin afër ndërtesave sociale në komunën e Obiliqit.

Rregulli i urës në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt. Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Fushë Kosovës, në lagjen 28. Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Lipjanit në fshatin Hallaç. Rregullimi i infrastrukturës në komunën e Ferizajt, fshati Dubravë në lagjen "Sallahane" dhe në "Alit Ibish".

Në Ministrinë e Kulturës kemi kërkuar që së paku të përkrahet edhe rinia e komuniteteve që të ketë mundësi që të zhvillojnë aktivitete sportive, ku kemi kërkuar ndërtimin e sallës sportive në fshatin Dubravë të Ferizajt, ku vlera e këtij projekti është 350 mijë euro.

Në Ministrinë e Bujqësisë, e cila asnjëherë prej që është formuar kjo ministri, komuniteti ynë ashkali dhe ai egjiptian asnjëherë nuk kanë fituar subvencione nga kjo ministri, së cilës i kemi kërkuar 1 milion euro për subvencione në vitin 2019 që së paku edhe komuniteti ynë ashkali të përkrahet me projekte konkrete nga Ministria e Bujqësisë.

Në Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve shpeshherë bëj pyetje a ekziston ajo ministri për komunitete, edhe pse asnjëherë nuk e shohim në Kuvend. E ka buxhetin ndoshta dy-tri herë më shumë se ministrinë tjetra, kurse komuniteti ashkali asnjëherë nuk merr mbështetje nga kjo ministri.

Prandaj, jemi detyruar që edhe në këtë ministri të drejtohem me kërkesa, ndërtimi i shtëpive për raste sociale të banimit për komunitetin ashkali në komunën e Prizrenit, Gjakovës, Podujevës, Pejës, Lipjanit, Shtimes, Suharekës, Gjilanit, Kamenicës, Mitrovicës, Vushtrrisë, Rahovecit, Istogut, Klinës, Deçanit, Obiliqit, Mamushës, Prishtinës dhe Ferizajt.

I tërë projekti nga kjo ministri, i cili ka vlerë për t'i mbuluar kërkesat për banim social nga kjo ministri besoj që nuk është ndonjë shumë e madhe, por vetëm njëherë të ndahen mjete, që për këtë ministri e ka vlerën 2 milionë euro.

Zyra e Komuniteteve, e cila është pranë Zyrës së Kryeministrit, e ka një buxhet në vlerë prej 1 milion e 700 mijë, por komuniteti ynë shumë pak fiton nga kjo zyrë, prandaj edhe kësaj zyre për komunitete i jemi drejtuar me shkrim që së paku ta ndajë fondin në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitet të cilat jetojnë dhe veprojnë në Kosovë. Jo të përkrahet vetëm një komunitet, të cilin në fund të vitit kërkesat i marrin dhe asnjëherë pothuajse nuk pranohen as 5%.

Prandaj, i nderuar ministër, ne kërkojmë që t'i keni parasysh kërkesat tona, sepse në të vërtetë komuniteti ka nevojë të përkrahet. Nuk kemi mbështetje nëpër komuna, sepse e thashë edhe në fillim, komunitetet vazhdimisht po heshtin. Komuniteti i cili unë e përfaqësoj, besoj që e meriton përkrahjen nga ky Kuvend, ngase ne si deputetë për mandatin e katërt asnjëherë nuk kemi qenë kundër Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, edhe pse prapë do ta votojmë, do të jemi për edhe në leximin e parë, edhe në leximin e dytë, por kërkojmë që kërkesat tona të merren parasysh. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti zoti Haxhi Avdyli. Urdhëroni!

**HAXHI AVDYLI:** Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Si anëtar i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, diskutimin tim do ta koncentroj në këtë sektor. Dhe, dua të them që rritja e buxhetit për shëndetësi është nismë që duhet përshëndetur, por prapë mund të them që kjo rritje nuk është e mjaftueshme, duke marrë parasysh që nuk është një rritje sinjifikante, siç është rritja e pagave të kryeministrit dhe ministrave, por është në rritje që duhet përshëndetur.

Por, mendoj që jemi ende larg që shëndetësia ta marrë atë vëmendjen financiare të duhur, duke marrë parasysh që niveli i GDP-së për shëndetësi është niveli më i ulët në Evropën Juglindore, e të mos flasim për Evropë.

Mbrojtja sociale po ashtu ka një rritje dhe ka një përqindje goxha të madhe, domethënë mbi 20 % të buxhetit dhe një rritje e tillë e buxhetit për kategoritë e ndryshme nuk përcillet edhe për kategoritë që lidhen me varfërinë, por për grupe të ndryshme, të cilat, faktikisht, shumë nga ato janë të afta për punë. Dhe, me këtë ne po krijojmë parazitë të buxhetit të shtetit dhe po ashtu po e dëmtojmë tregun e punës dhe po i destimulojmë njerëzit për të gjetur punë.

Sa i përket buxhetit për shëndetësi, ne po e shohim që ka pasur një rritje, por ky buxhet nuk po e përcjell ndonjë plan buxhetor për fillimin e sigurimeve shëndetësore, por po shihet që kjo Qeveri nuk ka kapacitete dhe vullnet politik për ta avancuar reformën financiare, duke e funksionalizuar fondin për sigurime shëndetësore.

Sistemi i Informimit Shëndetësor edhe nëpërmjet këtij buxheti rikthehet në pikën zero, duke i hedhur poshtë miliona euro të investuara në vitet e mëhershme, kryesisht edhe këta milionë që janë investuar nga donatorët ndërkombëtarë.

Tani, edhe nëse shohim parashohim buxhet për Sistemin e Informimit Shëndetësor, duhen vite që të funksionalizohet ai sistem dhe në të njëjtën kohë kjo ka për ta vonuar edhe funksionalizimin e sigurime shëndetësore, dhe më tutje kosovarët do të mbeten të vetmit qytetarë të Evropës pa sigurime shëndetësore.

Në këtë buxhet kemi parë shumë anomali, si për shembull në tabelën 3.2, në faqen 37 thuhet: “Pjesëmarrje e Ministrisë së Shëndetësisë në projekte”, dhe atë 3,3 milionë, pa specifikuar asgjë, çka flet dhe ku destinohen këto.

Buxheti për SHKSK-në ka një rritje, por kjo rritje zakonisht shkon në ndërtesa në shumë raste, ndërsa në të njëjtën kohë kemi shfrytëzueshmërinë e shtretërve në SHKSK, që është ende nën 50%. Po ashtu, kemi rritje për mallra dhe shërbime nga 10 në 15 milionë, pa treguar se çka e shkaktoi këtë rritje kaq të madhe.

Edhe pse ka rritje të buxhetit, kjo prapëseprapë nuk jep shpresë që ka për ta ndaluar zvogëlimin e shpenzimeve të qytetarëve të Kosovës për shëndet, që e bëjnë kryesisht nga xhepi i tyre për pagesat që bëhen në spitale private dhe spitale jashtë shtetit, sepse ne e kemi një përqindje goxha të lartë të financimit nga xhepi deri në 40%, që shkon për t’i mbuluar shpenzimet për shëndet.

Kjo rritje nuk do t’i zvogëlojë shpenzimet e mëdha që po i paguajnë qytetarët nga xhepi.

Ajo që bie në sy në këtë buxhet është që është rritur buxheti në dy ministritë; për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për stafin e Kabinetit të ministrit, dhe atë nga 270 mijë në 311 mijë, ndërsa ajo e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale, nga 264 mijë në 316 mijë.

Po ashtu, në këtë buxhet mund të themi që s’është për t’u krenuar aspak që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është ministria me buxhetin më të madh për vitin 2019, gati 26%. Domethënë diku 465 milionë euro shkojnë në këtë sektor duke rritur subvencione, transferet dhe ku mund të themi që nga viti 2011, që ishte diku nën 200 milionë, kemi arritur në 465 milionë.

Pyetja është; ku po e çojmë këtë shtet? Çfarë ekonomie po duam të zhvillojmë me këtë buxhet? Pse duhet që paratë e shtetit, në vend që t’i orientojmë drejt krijimit të vendeve të punës, po prodhojmë buxhet dhe ngarkesë të taksapaguesve vetëm që të blejmë qetësi sociale, edhe pse kjo nuk e avancon as ekonominë, dhe në të njëjtën kohë po e shkatërron atë ngritjen e vetëdijes së qytetarëve tanë për të kërkuar vend të punës, por po rritet vetëdija për të gjetur mënyra, apo për

të blerë ndonjë certifikatë sadopak që të futen në këto skema sociale, duke krijuar njerëz parazitë për buxhetin e shtetit.

Dhe, çka është më e keqja, në këtë buxhet për çështje sociale, nuk kemi një rritje sinjifikante, siç u tha edhe nga deputeti Abdixhiku për kategoritë e vërteta, për kategoritë e varfra që kanë nevojë më së shumti.

Me këtë ne nuk po krijojmë shtet social të barabartë në shërbim të të varfërve, por po krijojmë buxhet për kategori të ndryshme që, edhe pse mund të punojnë, në të njëjtën kohë ata po e ngarkojnë buxhetin.

Ne me këtë buxhet nuk po kontribuojmë për familjet, të cilat kanë shumë fëmijë, por edhe për pensionistët, që janë veçanërisht ata të cilët janë kontributdhënës.

Për vite të tëra është debatuar në këtë Kuvend dhe jashtë Kuvendit për mbrojtjen e punëtorëve në punë, për lëndimet në punë, për vdekjet në vendet e punës, por ky buxhet prapëseprapë nuk është duke i përkrahur nevojat të cilat ka Inspektorati i Punës për rritjen e kapaciteteve për të krijuar një mbrojtje më të mirë të punëtorëve.

Edhe pse ka një lëvizje, prapëseprapë kjo nuk është e mjaftueshme.

Prandaj, duke u bazuar në të gjitha këto të dhëna dhe shumë të dhëna të tjera të detajuara, ky buxhet për vitin 2019 nuk krijon bazë për zhvillim ekonomik. Nuk krijon bazë për punësim. Nuk krijon sistem shëndetësor komplementar, por shtet ku blihet paqja sociale, ku ka shpenzime enorme pa nevojë për rritjen e pagave për qeveritarët, për grupe të ndryshme të interesit, duke e rritur luksin e panevojshëm. Pagesat për grupe të ndryshme konsumuese, të cilat e degradojnë edhe e zhvatin buxhetin, po në të njëjtën kohë e dëmtojnë tregun e punës dhe e inhibojnë zhvillimin tonë ekonomik. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala!

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe të gjithë ju të pranishëm,

Sot, pra po e diskutojmë buxhetin e vitit 2019. Po bëhen që nga paraditja diskutime të gjata për e kundër. Po thuhet shumë fjalë dhe kjo më shpie te ajo fjala e urtë se fjalët e shumta janë fukarallëk.

Do të dëshiroja që diskutimi për miratimin e buxhetit të shtetit të përcillej me festë, sikur ndodh në shtetet e zhvilluara dhe të emancipuar, si bie fjala në Irlandë, tregonin dikur kolegët tanë

deputetë që kanë qëlluar në një vizitë zyrtare në këtë kohën kur është miratuar buxheti dhe gjatë tërë javës ata kanë qenë në festë gjatë miratimit të buxhetit vjetor.

Sesi të vijmë edhe ne tek një moment i tillë festiv duhet të marrim shembuj të mirë të këtyre shteteve, e mbi të gjitha të jemi bashkë pozitivë e opozitivë kur janë në pyetje punët që lidhen me të mirën e shtetit dhe të qytetarëve tanë.

A po ndodh një gjë e tillë te ne? Realisht, jo! Më lehtë na vjen të kritikojmë, ta shohim anën e errët të medaljes, madje të punojmë që të errësohet më shumë ajo anë. Marr shkas këtë që e them nga diskutimi i një kolegu nga opozita në sesionin e paradites, i cili, ndërmjet tjerash, tha se Qeveria ka hequr dorë nga Trepça, sepse nuk ka paraparë investime për këtë ndërmarrje. Ndoshta! Por, është mirë që së paku nganjëherë secili të bëjë me gisht nga vetvetja. Çka bëra unë për Trepçën, për aq sa kisha mundësi të bëj? Për të mos thënë asgjë s'keni bërë, diçka ka bërë, sepse kur ka qenë temë diskutimi Trepça para dy vjetëve e kanë bojkotuar seancën dhe nuk e kanë votuar Ligjin për Trepçën.

Prapë i njëjti avaz vazhdon duke e bojkotuar funksionalizimin e Ligjit për Trepçën ata që po bojkotojnë pjesëmarrjen në hartimin e statutit të Trepçës. Çka i thonë kësaj? Kësaj i thonë të derdhësh lot krokodili. Nejse, secili punën e vet e bazon në qëllimin se ku do të dalë, i bazuar apo jo në ndërgjegje, apo përgjegjësi.

Të nderuar deputetë,

Do t'i kthehem tash draft-buxhetit. Jam e vetëdijshme se në temat që përcillen me diskutime maratonike gati është e pamundur të mos përsëritësh. Po filloj nga një fjali e ministrit Hamza që tha "kujdes nga nismat ligjore që e ngarkojnë buxhetin".

Ministër, kjo është pjekuria jonë politike. Qasja populiste për ndonjë votë aty-këtu është shumë më e lehtë sesa të punohet diçka që e rregullon të ardhmen e qytetarëve tanë.

Ndërsa, fjalisë suaj ministër, unë do t'ia shtoj edhe këtë; mos abstenoni në miratimin e ligjeve që e rregullojnë klimën e të bërit biznes, që joshin investimet e huaja, që si rezultat do të kemi rritje të vendeve të punës, rritje ekonomike dhe mirëqenie për qytetarët tanë. Kjo është kërkesa ime, bashkëngjitur kërkesës së ministrit më parë.

Të nderuar,

Jam përpjekur që ta analizoj me vëmendje këtë dokument, po ashtu duke i dëgjuar edhe diskutimet e kolegëve të tjerë. Tani, ajo që e bën të veçantë këtë buxhet, është rritja e tij për 12 për qind krahasuar me vitin 2018, ndryshimi financimit të prioritetëve, rritja e investimeve kapitale për 65% krahasuar me vitin që po shkon, rritja 16% e buxhetit të shëndetësisë, e rritje të tjera nëpër dikasteret qeveritare.

Do të përpiqem ta pasqyroj para qytetarëve tanë anën e ndritur të këtij drafti, si dhe projektet e reja të përfshira në 2019.

Të nderuar,

Si deputete e komisionit të cilin e udhëheq, më lejoni ta falënderoj edhe NDA-në që na e ka sjellë një dokument të analizuar, aspektin buxhetor të linjave që i përgjigjen komisionit, në të cilin jam pjesë e tij bashkë me përfaqësues të tjerë të partive politike.

Buxheti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i planifikuar për vitin 2019, është rreth 11 milionë euro, apo rreth 2 milionë euro më i lartë se 2018-a.

Sipas ndarjeve ekonomike të buxhetit, kategoritë të cilat do të përfitojnë më së shumti janë shpenzimet kapitale dhe kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Ndërkohë të Ministria e Zhvillimit Ekonomik janë ndarë rreth 67% më shumë buxhet sesa nga viti paraprak.

Shuma më e madhe e rritjes së buxhetit vjen nga klauzola e investimeve, i gjithë buxheti do të menaxhohet nga njësia për politika dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike. Kategoritë ekonomike me ngritjen më të madhe të buxhetit janë: investimet kapitale, ngritje rreth 13 milionë euro, subvencione dhe transferet rritje mbi 36% më shumë se sa vitin e kaluar.

Nëse shikojmë ndarjet të investimet kapitale sipas departamenteve, pjesa më e madhe e investimeve do të menaxhohet nga njësia që e përmenda më lart dhe nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Rritja e investimeve kapitale nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të jetë rreth 41%.

Sa i përket madhësisë së projekteve kapitale, projekti për zbatimin e masave të eficiencës në ndërtesa publike është projekti më i madh në kuadër të Ministrisë së zhvillimit ekonomik, diku në vlerë mbi 7 milionë euro.

Ana e errët e kësaj ministrie është se sa i përket shërbimit gjeologjik të Kosovës nuk kemi asnjë ndryshim nga viti i kaluar.

Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës, 93% të investimeve kapitale do të ndahen për infrastrukturë rrugore, 4% për Departamentin e Transportit Rrugor, 3% për aviacioni civil.

Siç u përmend më lart, shumica e buxhetit kapital të kësaj ministrie përbëhet nga investimet në infrastrukturë rrugore.

Pjesa më e madhe e buxhetit të ndarë për infrastrukturë do të shkojë në rehabilitimin e rrugëve, do të ndahet për ndërtimin e autostradave. Ndërtimet e reja të rrugëve zënë 9% të buxhetit, mirëpo 95% të buxhetit për këtë nënprogram është vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara, mirëmbajtja e rrugëve zë diku 5%.

Kosova ka mjaft zona rekreative që unë mendoj që duhet, ka arsyeshmëri pse buxheti i kësaj ministrie shkon në infrastrukturë rrugore. Prandaj, kemi zona që frekuentohen nga vizitorë të shumët e që e bëjnë të vështirë rrugën deri tek ato vende. Prandaj, futja e projektit asfaltimi i rrugës Llapçevë - Ujëvarat e Mirushës mendoj që është shumë i qëlluar dhe është një projekt i ri i kësaj ministrie.

Rruga nacionale Deçan-Kufiri i Malit të Zi – Plavë, mandej ndërtimi i rrugës nga Vuçak - Tërdevc, projekt i ri që lidh fshatrat e disa komunave e që i jep gjallëri kësaj pjese. Asfaltimi i rrugëve në Komoran është vazhdimi i projekteve 2018 e rrugë të tjera që të mos i përmend të gjitha me radhë.

Buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është 44% më i lartë se i vitit paraprak sipas ndarjeve ekonomike të buxhetit, kategoritë që do të përfitojnë më së shumti nga rritja e buxhetit janë subvencionet dhe transferet, diku në përqindje i bie 67% dhe kategoria e shpenzimeve kapitale 35%.

Buxheti i agjencive të institucioneve të pavarura aty-këtu ka rritje, që mendoj se janë të qëlluara.

Po i përmend edhe disa projekte, të cilat janë shumë të rëndësishme që vijnë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është paraparë prapë ndërtimi i shkollave, shpresoj që të jenë të analizuar apo nuk e di a janë analizuar sa duhet nevoja e ndërtimit të tyre, kur dihet se këtë vit janë mbyllur disa shkolla në Kosovë për arsye të ndryshme, e që njëra nga to ka qenë edhe mungesa e nxënësve.

Tjetër projekt i rëndësishëm sa i përket ngritjes së cilësisë në arsim është pajisja me laborator të gjeoshkencave Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Kur jemi tek çështjet sociale, risi në këtë ligj është rritja është rritja 20% e pensioneve të moshës, mandej programi për banim social.

Me këtë ligj vëmendje i është kushtuar edhe mjedisit përmes projekteve, si krijimi i hapësirave gjelbëruese rekreative për fëmijë në disa komuna të Kosovës, mandej pellgjeve lumore pothuajse



në të gjitha komunat, ku ka raste të tilla po i përmend disa nga këto: rregullimi i shtratit të lumit Drenica, i lumit Klina në Klinë, lumit Krena në Gjilan, e tjera.

Projekti më i rëndësishëm është edhe projekt i kadastrës të patundshmërive dhe infrastrukturës gjeohapësinore. Një investim që konsideroj se është mjaft i rëndësishëm është investimi në kujtesën historike.

U është kushtuar vëmendje pothuajse në tërë Kosovën komplekseve memorialë, do t'i përmend disa prej tyre të radhitura në dokumentin e draft-buxhetit, jo nga rëndësia, por si projekte të reja të vitit 2019.

Kulla e Heroit Fehmi Ladrovi në Gllanasellë, pllaka përkujtimore në Çikatovë të Vjetër, memoriali i masakrës që i kushtohet familjes Deliu dhe Muliqi në Abri, ndërtimi i lapidarit në Korroticë të Ulët, lapidari i dëshmorëve të UÇK-së në Komoran, konservimi i shtëpisë në Paklek të Vjetër, ku janë masakruar e dhjetëra gra, pleq e fëmijë, edhe veprimtari Ymer Elshani, poeti për fëmijë, me gjithë familjen e tij.

Ky investim pra është tregues se kujtesa e sakrificës, e lavdisë, duhet të përcillet brez pas brezi.

Mandej është rregullimi i varrezave të dëshmorëve të UÇK-së në Viti dhe derdhja në bronz e busteve të veprimtarëve dhe heronjve vëllezërve Gursel dhe Bajram Sylejmani, në Kamenicë memoriali Metush Krasniqi, veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, shtëpia muze Ukshin Hoti në Krushë, si kujtesë historike e veprimtarit, figurës poliedrike të çështjes kombëtare Ukshin Hoti, lapidari i masakrës së Burgut të Dubravës, kjo duhet të jetë një kujtesë që s'duhet ta harrojmë kurrë dhe këtë çdo herë si kartë duhet t'ua vëmë përpara edhe atyre që na bëjnë presion për disa kompromise. Mandej, lapidari Zahir Pajaziti në Pestovë, në vendin e rënies, e të tjera. Këto dhe projekte të rëndësishme...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Drita Millaku e ka fjalën.

**DRITA MILLAKU:** Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Dhe kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë i propozuar nga Qeveria Haradinaj shihet qartë në lexim të parë se përkundër tendencës që e proklamoni se ka për qëllim prioritar financimin në fushat, të cilat për vite me radhë kanë qenë të pamjaftueshëm dhe të pakrahasueshme për nga financat dhe buxheti, siç është shëndetësia, arsimiti, pastaj skemat sociale dhe projekte të mirëfillta dhe të qëndrueshme zhvillimore.

Ndarja buxhetore, të cilën e ka bërë apo më mirë të themi e ka planifikuar për vitin 2019: Aty shihet se nuk dallon shumë nga buxheti paraprak sepse pjesa më e madhe e mjeteve buxhetore si destinimin që e kanë shpenzimet rrjedhëse me rreth 1,6 miliard euro, ku përfshihen pagat dhe mëditjet, pastaj subvencionet dhe transferet, një pjesë bukur e mirë shkon për mallra dhe shërbime.

Pra, nga këto shifra bie menjëherë në sy se e kemi një rritje të ndarjes buxhetore për mallra dhe shërbime dhe kjo gjë lë përshtypje se si një pjesë bukur e madhe e mjeteve do të keqmenaxhohen dhe do të keqpërdoren për lukse të tepruara, siç janë mjete të ndryshme, pastaj investime të panevojshme në objekte, inventarë të ndryshëm, të cilat janë në shërbim të ministrive të ndryshme, Presidencës, Kuvendit, e kështu me radhë.

Në investimet kapitale të parapara për vitin 2019 ky buxhet, pa dallim nga buxhetet e kaluara, orientohet në drejtim të investimeve marramendëse infrastrukturore, në autostrada, siç është ajo Prishtinë - Hani i Elezit, pastaj autostrada për Gjilan dhe ajo Kijevë - Zahaq. Pra, investime të cilat nuk do të arrijnë të kuptojmë kurrë se a kanë qenë të arsyeshme dhe urgjente të bëhen.

Duke e ditur shumë mirë gjendjen e rëndë socio-ekonomike në të cilën gjenden qytetarët e vendit, shkallën e lartë të papunësisë, pastaj investimet mjaft të pakta zhvillimore pa studim konkret fizibiliteti dhe joprofitabil.

Buxheti i propozuar për miratim, edhe pse më i larti për nga shifrat që nga paslufta, mbi 2 miliardë e 300 milionë, në mënyrën se si është planifikuar të shpenzohet nuk do të arrijë qëllimin e tij për të cilën mblidhet që t'u shërbej qytetarëve për nevojat e tyre, pastaj nxitjes së zhvillimit ekonomik, përkrahjes së shtresave sociale, zbutjes së varfërisë, investime të qëndrueshme dhe frytdhënëse në nxitjen e prodhimit vendor, pastaj ndryshimin e gjendjes në arsim dhe shëndetësi.

Pjesa më e madhe e mjeteve, të cilat janë paraparë të ndahen, kanë adresë dhe orientim tjetër dhe nuk do të arrijë t'i prekë kategoritë dhe fushat e sipërpërmendura.

Shpërputhjet e konsiderueshme kemi edhe sa u përket të hyrave të përgjithshme buxhetore kundrejt shpenzimeve të përgjithshme, dukuri kjo e cila çon në deficit të madh buxhetin në mbi 400 milionë, për mbulimin e këtij deficiti detyrohemi të hyjmë në borxhe publike dhe hua të jashtme, për të cilat pastaj detyrohemi të paguaj interes dhjetëra milionësh në vit, pra para të humbura.

Gjendja në arsim nuk mund të ndryshohet duke ndarë mjete në ndërtimin e disa shkollave, të cilat kanë qenë të planifikuara që të ndërtohen qe disa vite me radhë, por duhet planifikim afatgjatë, intensiv, duke u bazuar në modele paraprake frytdhënëse e rezultateve të shteteve të rajonit apo edhe më gjerë.

Projektet, të cilat do të përkrahen në fushën e shëndetësisë janë mjaft të pakta, pra është fusha në të cilën duhet të ketë kujdes të veçantë trajtimi, duke filluar dhe duke e ditur mjaft mirë gjendjen e qendrave spitalore anekënd Kosovës, ku në pjesën dërmuese të tyre mungojnë aparaturat esenciale dhe të domosdoshme për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve në nevojë.

Kjo Qeveri ka mjaft ministri, të cilat për nga rëndësia dhe funksioni që kanë janë të rëndësishme dhe të nevojshme për rregullimin e mirëqenies së qytetarëve, ministri të cilat thithin mjete të konsiderueshme buxhetore, siç është për shembull Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila në vend se një pjesë të buxhetit të saj t'ua dedikojë projekteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e banesave sociale, të cilat janë mjaft të domosdoshme për kohën që po kalojmë, por të cilat do t'u vireshin në shërbim edhe kategorive të ndjeshme sociale, kjo ministri harxhon buxhet në vetura, renovime të objekteve të saj.

Njëjtë ndodh edhe me ministrinë e tjera, siç është ajo e Punëve të Jashtme, Ministria e Mjedisit, pastaj ajo e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Inovacionit, e cila është dështim në vete dhe aspak frytdhënëse.

E metë tjetër e buxhetit në fjalë është se si dedikohen shuma të konsiderueshme parash për shpronësime për nevoja të krijimit të zonave industriale, pa një studim të mirëfilltë të fizibiliteti.

Pastaj, ky buxhet nuk na shërben dhe nuk na bënë të qartë neve si deputetë se sa është shifra e mjeteve të ndara për komunat serbe, a është bërë proporcionalisht me të hyrat vetjake të tyre, pasi që shumë mirë dihet se këto komuna vazhdimisht tregojnë performansë të dobët inkasimi të të hyrave vetjake.

Tani jemi në fazën ku tentojmë të themelojmë ushtrinë, mirëpo ndarja buxhetore për ta lë të mendojmë se a do të mund të kemi një ushtri sadopak të mirëfilltë, kur dihet se buxheti për vitin 2019 është diç më shumë se 2 milionë euro për FSK-në, për dallim prej vitit të kaluar.

Buxheti në fjalë, i sjellë për miratim, prek një dozë solidariteti të skemat pensionale, për të cilat rriten nga 75 në 90 euro.

Mjete të konsiderueshme financiare shihet qartë në këtë projektbuxhet se janë ndarë për agjenci të ndryshme buxhetore, siç është ajo e punësimit dhe e efikasitetit, të cilat as për së afërmi nuk e arsyetojnë angazhimin dhe funksionin për të cilin edhe janë krijuar.

Krejt në fund dua të them se i gjithë ky planifikim buxhetor, i cili është hartuar dhe miratuar nga kjo Qeveri, e cili na ka sjellë për të kaluar me votën tonë, nuk paraqet asgjë të re më shumë se sa buxhetet e kaluara, të cilat financonin në masë të madhe luksin dhe shpenzimet marramendëse pa

adresë të qëlluar dhe pa e prekur asnjëherë drejtpërdrejt kategorinë dhe fushat të cilat më së tepërmi ka nevojë për mbështetje dhe përkrahje financiare.

Edhe pse buxheti ka rritje, ai nuk po përcillet me rritje të kënaqshme ekonomike si dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me qëllim zbutjen e papunësisë dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Me qëllim që të rinjtë tanë të mos ndajnë mendjen të migrojnë jashtë vendit për një jetë më të dinjitetshme, atë jetë të cilën e ëndërrojnë, duhet t'ua ofrojmë ne këtu në vendin tonë, në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zonja Millaku! Vazhdojmë me zotin Blerim Kuçi. Driton Çausi, e ka fjalën.

**DRITON ÇAUSHI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

U tha shumë nga folësit paraardhës, nga kolegët, mbi problemet që ky projektbuxhet përfaqëson në terma të përgjithshëm ekonomikë.

Unë dua të ndalem shkurtimisht në dy çështje. E para ka të bëjë me arsimin dhe mbi të gjitha me arsimin universitar, pra duke evidentuar gjithashtu që ka probleme të shumta në pjesën parauniversitare të arsimit, me të cilat ne ballafaqohemi në punën tonë, ata që kanë qenë të angazhuar në universitet, me pasojat e mungesës së cilësisë që ofrohet në nivelin parauniversitar.

Sidoqoftë, ajo që bie në sy dhe që është në dukje të parë pozitive, është rritja e buxhetit për arsim prej 7%, prej 22,6 milionë euro. Megjithatë, kjo sidomos në këtë rast aspak nuk mund të përkthehet në një ndryshim në cilësinë, e cila ofrohet për studentët për nivelin universitar të shkollimit.

Do të ndalem në dy çështje në lidhje me këtë pjesë të sistemit të arsimit.

E para ka të bëjë me universitetet publike. Unë kam qenë personalisht skeptik që nga fillimi i hapjes së universiteteve publike në periudhën e pasluftës, nuk ka qenë rastësi që shumica prej tyre janë hapur në prag të fushatave elektorale dhe ajo që po shohim sot, është se kemi ndërtuar një sistem universitar me shtatë universitete publike, të cilat fatkeqësisht nuk ofrojnë as për së afërmi cilësinë dhe nivelin e shkollimit që do të prisnin të rinjtë dhe që do të duhej të plotësonin ato norma që duhet të plotësonin një universitet.

Për vitin 2019 janë ndarë 27.7 milionë euro për këto universitete, duke përjashtuar Universitetin “Hasan Prishtina”. Ne kemi pasur në Komisionin për Arsim përfaqësuesit, në fakt, rektorët e disa

prej këtyre universiteteve, secili prej tyre ka ngritur shumë çështje në lidhje me mungesat e mëdha që kanë në atë që ofrojnë si shërbim, si universitete.

Do të përmend këtu vetëm për ilustrim Universitetin e Prizrenit, paramendoni aty kemi 17 mijë studentë, ndërsa stafi i rregullt, pra profesorët dhe asistentët që janë në shërbim të këtyre studentëve është në numër të pabesueshëm, pra janë vetëm 105 profesorë dhe asistentë për 17 mijë studentë.

Shumë ngjashëm është situata edhe në universitetet e tjera. Unë mendoj që mbi të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit urgjentisht duhet të bëjë një proces të rivlerësimit, të rishikimit të gjithë këtij sistemi universitar. Unë jam i bindur që kjo tejkalon numri i universiteteve që kemi hapur, tejkalon kërkesat që një vend sa Kosova ka, nuk mund të gjejmë një model të ngjashëm me një numër të përafërt të banorëve ku kemi 7 universitete publike.

Po e marr një shembull, kryeqyteti i Gjermanisë, ku studiojnë studentët jo vetëm nga ai qytet, po nga gjithë Gjermani dhe nga gjithë bota, ka tri universitete të mëdha publike, me një numër prej 3.6 milionë banorësh, kurse ne kemi numrin e dyfishtë të universiteteve me një vend shumë me numër shumë më të vogël të banorëve.

Pra, mendoj që nisma e ministrit ka qenë e mirë për të vlerësuar, për një vlerësim të këtyre universiteteve, por e di që nuk ka ndodhur, nuk ka pasur asnjë rezultat deri më sot dhe s'ka ndryshuar asgjë.

Le të kuptohemi, e kuptoj që kjo nuk mund të jetë çështja më popullore, pra vlerësimi i idesë së ekzistimit të këtyre universiteteve, po gjithsesi besoj që pikërisht për hir të të rinjve ne duhet ta rishqyrtojmë komplet mënyrën se si këto funksionojnë, nëse duhen të jenë në këtë numër, ose duhet të ofrojnë ato fusha dhe drejtime që ofrojnë dhe nëse duhet reduktuar, duke u përshtatur nevojave të Republikës së Kosovës. Ne e dimë që kemi mangësi të mëdha të shkollave profesionale dhe po e shohim që në vend se të fokusohemi atje, ne humbim 27,7 milionë euro në vit për këto universitete dhe unë mendoj që fatkeqësisht një prej pasojave më të rënda nga gjithë ky ekspansion i universiteteve është dëmi që i është shkaktuar Universitetit Publik “Hasan Prishtina”. Mund vetëm të paramendojmë se sa më mirë do të ishte sikur gjithë ky buxhet ose një pjesë e madhe e tij të investohej në rritjen e cilësisë në Universitetin “Hasan Prishtina”, i cili gjithashtu është rënduar, kemi shumë profesorë nga Universiteti Publik “Hasan Prishtina” që japin mësim edhe në këto universitete të tjera, duke e ulur cilësinë e tyre.

Çështja e dytë është një temë e aktualizuar muajt e fundit nga një hulumtim që është zhvilluar nga një organizatë e quajtur “Integra” që ka të bëjë me Akademinë e Shkencave dhe Arteve. E kuptoj që gjithashtu mund të mos jetë popullore që të diskutohet ose të hapet një debat, por

mendoj që është koha e fundit që të bëjmë një gjë të tillë. Pra, po flasim për një institucion, i cili merr 1.6 milion euro për çdo vit, ku më shumë se, le të themi, 3/4 e buxhetit shkojnë për paga. Hulumtimi i “Integra”-s ka nxjerrë shumë fakte interesante dhe shqetësuese në lidhje me këtë institucion. Nga gjithë këto shpenzime, nga gjithë ky buxhet për gjithë këto vite të pasluftës kemi katër projekte kryesore, ndër to të kryera një monografi për Kosovën dhe një enciklopedi të shumëpërfolur, me shumë kritika për cilësinë e saj, përderisa detyra e Akademisë së Shkencave do të duhej të ishte shumë e çmueshme, do të duhej të ishte institucioni që drejton mendimin, punën shkencore, zhvillimin e projekteve shkencore në Republikën e Kosovës dhe në përgjithësi mendimin shkencor.

Është gjithashtu shumë shqetësuese që nga 22 anëtarë të rregullt, sipas këtij hulumtimi, të Akademisë së Shkencave, vetëm tre prej tyre kanë publikime në revista ndërkombëtare shkencore. Pra, po ju kujtoj, ky është nivel më i ulët se sa niveli që i kërkohet një asistent profesori në Universitetin e Prishtinës.

Kemi pasur pranim të anëtarëve të rinj, me kritere shumë të dyshimta, kemi mungesë të një zyre të ankesave, kemi kandidat me dhjetëra publikime në revista kredibile shkencore që nuk janë pranuar si pjesë e kësaj akademie dhe mendoj që urgjentisht kjo çështje duhet të shqyrtohet seriozisht, para se të vazhdojmë me ndarje të buxhetit, në mënyrën se siç ka ndodhur deri më tash.

Do të ndalem gjithashtu edhe te një diskutim që po bëhet në lidhje me orientimin e buxhetit në komunat, që një qeveri i kontrollon ose i menaxhon, udhëheq me to. Do të ishte më se e natyrshme në një vend të vogël si Kosova që zhvillimi ekonomik të mos nisej nga bazat provinciale, megjithatë jemi dëshmitarë që kjo pas luftës ka ndodhur rregullisht me qeveritë e Republikës së Kosovës,

U tha shumë që një pjesë e mirë e buxhetit është ndarë në mënyrë joproportionale në komunat ku udhëheq Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, unë një gjë të tillë nuk mund ta mohoj, mirëpo unë mund të dëshmoj që në komunën e Gjakovës nuk ka asnjë ndryshim cilësor nga fillimi i mandatit të kryetarit që vjen nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Kam qenë gjithmonë i bindur që premtimet kanë qenë një flluskë e madhe, e për këtë janë të bindur tani me qytetarët e komunës së Gjakovës. Kujtojmë shumë premtime që janë dhënë gjatë kësaj fushate që kam dilema që buxheti i Republikës së Kosovës do të mund t’i realizonte, e më së mirë është një hulumtim i GAP-it që e vlerëson punën e kësaj komune, ku kemi vetëm tri premtime të realizuara, nga 76 premtime që janë dhënë deri më tash.

Pra, unë nuk mund të pohoj një gjë të tillë që kjo ka sjellë një ndryshim, fakti që jemi thirrur në një...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi e ka fjalën. Nuk është. Gani, a e deshe fjalën ti, zoti Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Përshëndetje, zoti Haliti,  
Përshëndetje deputetë,  
Ministër Hamza,

Unë po mundohem t'i bëj dy kërkesa.

Kërkesa e parë është ndaj mediave, hiç nuk po më vjen lehtë të them, po ju lus, mos shpifni dhe mendoni të jeni sa më njerëzor, se unë gjithmonë në Parlament nuk vij i dehur, por kam një problem shëndetësor.

Kërkesa e dytë është, që 20 vjet jemi duke folur dhe jemi peng, unë si dhe të gjithë mërgimtarët janë duke u plaçkitur në kufij për Kartonin e gjelbër.

Unë shumë jam i interesuar edhe në Zvicër, çështja është për 5 deri në 10 milionë, ku kanë mbetur në këtë buxhet ato lekë që do të plaçkiten edhe vitet e ardhshme.

I nderuar ministër,

Pse nuk nxirret Kartoni i Gjelbër?

Pres që deri në votimin e dytë të bëhet një propozim konkret që të fillojë zgjidhja e këtij problemi. Nëse nuk zgjidhet, unë nuk e votoj, nëse nuk kemi konkret një propozim si ta kalojmë Kartonin e gjelbër, unë nuk e votoj buxhetin.

Këtu po i shoh 250 milionë për shëndetësi, a nuk është gjynah, zoti Leka, të bëhet asfalt, e këndeji të na vdesin fëmijët dyvjeçarë prej kancerit. A jemi ne njerëz që tash e 20 vjet që nuk patëm mundësi të bëjmë një sigurim shëndetësor? Apo është veç metoda më e lehtë të vidhet?

Shkoni një ditë në spital, shko në spital, ku janë fëmijët të shtrirë me kancer, aty të han byku, kërpuhat, kot blejmë aparate e nuk lëvizin punët.

Informaliteti, i nderuar ministër, i ke 2 miliardë që s'janë duke hyrë në buxhet. Këto i bëjnë firmat që janë të lidhura drejtpërdrejt me njerëzit më të fortë të Kosovës, mblidheni buxhetin.

Prokurimi, edhe njerëz të agjencive tatimore janë aq të këqij që edhe deputetit i lypin lek nëse vinë ta kontrollojnë firmën time. I kemi njerëzit më të pasur në Kosovë këta të Agjencisë Tatimore, po edhe këta të Prokurimit, e hapin fjalën përpara kur i blen djali shtatë shtëpi e banesa në Istog, që i ka shitur e i ka blerë me dhen e me qumësht të dhenve pesë banesa në Prishtinë.

Nëse nuk e mbledhim buxhetin, unë e di, i nderuar ministër, që e di edhe ti kah është më mirë. Po desha të pyes, të nderuar deputetë, sa deputetë kenë numër personal fiskal, sa deputetë i paguani tatimet përveç që e paguani të rrogës, a ka shtet që s'ka deputeti numër personal fiskal? Këtë s'e kam parë askund. Për t'u votuar buxheti, një ditë duhet të kthehemi nga e mara.

Sot më ka ardhur një ftesë: a ka mundësi të m'i gjesh 1 000 euro për t'ia blerë ilaçet për kancer fëmijës dy vjet, edhe aty keqpërdoret, se veç me njohshëm merret leku për t'i ndihmuar. Janë duke na shkuar miliona jashtë shtetit tonë, kemi kuadro të mira, u kemi blerë pajisje sa të duan. Veç një shembull po jua jap, nuk e di kush është pronari.

Pse "Auloka" merr miliona qe sa vjet, nga 4 milionë, për t'i kontrolluar policinë e shtetit, pse nuk shkojnë dy doktorë të shtetit t'ua japim rrogën 2 mijë euro, stacion për stacion e t'i kontrollojnë. Një ditë, të nderuar deputetë, se unë po ju shurdhoj duke u bërë burrë i mirë, mendoni që kemi njerëz që 20 vjet të komunës së Istogut që s'kanë ujë të pijes. Çka i duhet atij asfalti? Mendoni që kemi njerëz në Uçë që njërën dorë e ka grepin, nuk ka vend të punës, i duhet të dalë të marrë do dru, kthejuni një herë e përgjithmonë, qoftë kah Kibla, qoftë kah Vatikani, mendoni për popullin tuaj e mos ia pini gjakun.

Kemi një tjetër problem, kjo çështja e shpifjes, për atë çka e kam bërë, çka është e vërtetë dhe çka e di, secila gazetë me kënaqësinë më të madhe çka kam bërë në jetën time do ta bëj prapë, po mos shpifni, se ju kam duruar gjatë. Unë kam fëmijë, kam familje, kam nënë, kam pasur, kam shokë, lërimi shpifjet, se është e turpshme që me sëmundje t'i thuhet një djali 12 vjet që baba ka qenë i dehur në Parlament. Nëse Parlamenti nuk merr diçka, nëse në komisionin shtetëror që krijohet në Parlament nuk merr pjesë Presidenti, nëse në komision është i ftuar, nëse Presidenti e rrezikon deputetin me jetë ose gazetarin, e nuk merret kurrkush me të, kjo është e turpshme, këtij shteti s'kisha pasur qejf as t'i takoj. Presidenti i Gjermanisë është hequr veç që ka marrë kredi deri në 3% më lirë, ne s'guxuam kush t'ia përmendë zotit Thaçi që e kërcënoi gazetarin me jetë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Dreshaj! A ka dikush i Nismës? Veton Berisha e ka fjalën.

**VETON BERISHA:** I nderuar nënkryetar Haliti!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër Hamza,

Faleminderit që je këtu,

Fjalimi im kryesisht ka të bëjë me gjetjen e një zgjidhje apo gjetjen e mundësive të reja të një funksionaliteti më të mirë të buxhetit të vitit 2019, me qëllim që komunitetet të kenë qasje më të mirë dhe mundësi më të mëdha, të jenë përfitues të buxhetit.



I nderuar zoti ministër,

Duke iu falënderuar disa vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, komuniteti egjiptian ka qenë përfitues i disa të mirave nga buxheti i Republikës së Kosovës. Mbetet shqetësuese pamundësia për të arritur të kemi qasje në buxhetin e shumë ministrive me interes për ne. E, sidomos në ato linja ku ndahen subvencione dhe grante. Këtë që e them e kam të bazuar në të dhëna publike dhe në statistika zyrtare, ku komuniteti egjiptian dhe ashkalinj është përfitues minimal i tyre. Në përgjithësi, konsideroj se qeveria nuk ka ndonjë plan veprimi që buxhetin e tyre në dispozicion të ndajnë për të gjithë qytetarët e tyre barabartë. Vlen për t'u theksuar që gjatë vitit që po e përmbyllim, po ashtu edhe gjatë viteve të kaluara jemi të viktimizuar nga disa ministra të komunitetit serb, e të cilët edhe nga bojkoti buxhetin e tyre kanë arritur që tërë buxhetin ose në një masë të madhe të tyre e kanë drejtuar vetëm me komunitetin serb. E kjo praktikë mendoj se duhet të ndryshojë, mendoj dhe jam shumë i bindur, zoti ministër Hamza, se nëse vërtet dëshironi t'i jepni mundësi secilit në parandë publike, mendoj se në disa prej ministrive në kuadër të buxhetit ekzistent të tyre, ata duhet të ndajnë linja buxhetore të veçanta mbështetje të komuniteteve joshumicë.

Këtë po mundohem ta arsyetoj duke u bazuar në bazën kushtetuese dhe ligjore. Autoritetet qeverisëse të Kosovës, Qeveria dhe Kuvendi, janë të obliguar që të garantojnë në mënyrë pozitive të drejtat e komuniteteve joshumicë. Këto obligime manifestohen në forma të ndryshme, një ndër obligimet më të shpeshta është edhe obligimi për kuotat e përfaqësimit të komuniteteve në organet qendrore dhe ato lokale. Sidoqoftë, autoritetet qeverisëse u nënshtrohen edhe një herë obligimeve ligjore dhe kushtetuese për të mbështetur komunitetet joshumicë. Andaj, ekzistojnë baza ligjore për mbështetjen specifike të komuniteteve, duke filluar me Kushtetutën e Kosovës, strategjitë zhvillimore sektoriale, si dhe praktikën nga e kaluara në përcaktimin e kodeve të veçanta në Ligjin për buxhetin. Në veçanti, Kushtetuta e Kosovës në nenin 58, ku flet për përgjegjësitë e shtetit lidhur me garantimin e të drejtave të komuniteteve, përcakton se Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare. Për më shumë, ky nen po ashtu specifikon se Republika e Kosovës sipas nevojës do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive nëpërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomiko-shoqërore, politike dhe kulturore.

Nga kjo qartë mund të nënkuptohet se Republika e Kosovës është e obliguar që të marrë masa pozitive që do të ndikojnë në promovimin e barazisë dhe ky obligim ndërlidhet me të gjitha aspektet që do të mundësojnë një mirëqenie më të mirë ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Tutje, bazë shtesë ligjore mund të konsiderohen edhe strategjitë sektoriale, në të cilat ministrisë bazojnë punën e tyre, ku në mënyrë konkrete përcaktohen obligimet për sigurimin e kushteve të barabarta për të gjitha komunitetet. Për më shumë, kjo praktikë është e ndjekur edhe në të kaluarën, ku Ligji për buxhetin ka përmbajtur kod buxhetor të veçantë për komunitetet, për ministrinë e caktuara varësisht nga interesi, shembull e kemi Ligjin për buxhetin e vitit 2018, në

mënyrë konkrete është paraparë kod buxhetor për Ministrinë për Kthim, për investime kapitale, për Ministrinë për Mirëqenie Sociale, kod për komunitetet, për Ministrinë e Shëndetësisë, kod për programet mbështetëse për sistemin shëndetësor për komunitetet joshumicë. Andaj, rekomandohet që të përfshihen në kuadër të buxheteve specifike si në vijim: Ministria për Kthim dhe Komunitete, si një ndër bartësit kryesor të detyrimit për fuqizim dhe stabilizim të komuniteteve, në kuadër të linjës buxhetore duhet të parashihen fonde që do të destinohen për përmbushjen e objektivave të kësaj ministrie.

Ndër të tjera, në kuadër të programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përcaktohen se një ndër prioritetet e Ministrisë së Kthimit do të jetë mbështetja, stabilizimi, riintegrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik të komuniteteve. Për arritjen e këtij objekti duhet të planifikohen vazhdimësi e aktiviteteve, si: shpërndarja e materialit ndërtimor për familjet në nevojë, përkrahja e projekteve që kanë për qëllim krijimin e gjenerimit të të ardhurave dhe mundësisë së punësimit, riintegritit dhe stabilizimit të komuniteteve përmes përkrahjes, përfshirë edhe të shoqërisë civile. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: programi i Qeverisë së Kosovës përcakton se një ndër objektivat e kësaj ministrie është të krijohen programe për ngritjen e nivelit të komunikimit kulturor dhe bashkëjetesës në mes të kulturave të të gjitha komuniteteve etnike, fetare, apo gjuhësore në vend. Duke përfshirë edhe promovimin kulturor dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës edhe jashtë vendit. Duke u ndërlidhur edhe me obligimet e përcaktuara nga Kushtetuta për të siguruar ndihmë financiare për nismat kulturore të komuniteteve është pa dyshim e domosdoshme që në kuadër të buxhetit të kësaj ministrie të parashihen linja të veçanta buxhetore për aktivitetet kulturore të komuniteteve joshumicë.

Ministria e Administratës Publike duhet të ndajë linjë të veçantë buxhetore për implementimin e plotë të nenit 11 të Ligjit për shërbimin civil. Nen ky i cili kërkon kod të veçantë buxhetor që të plotësohet përfaqësimi i plotë në punësim të komuniteteve në institucionet publike deri në 10%. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: kjo ministri duhet të vazhdojë praktikën e përcaktimit të një kodit të veçantë buxhetor për komunitetet joshumicë, sikurse edhe në të kaluarën. Është me rëndësi të jetë e qartë qysh në fillim se kjo linjë buxhetore do të ndahet në kuadër të të gjitha komuniteteve varësisht nga numri i banorëve dhe kushteve ekonomike, që të shmanget ndonjë konflikt lidhur me atë se kujt i dedikohen këto fonde.

Linja buxhetore për ngritjen e mirëqenies ekonomike: Siç u argumentua më lart, Qeveria e Kosovës ka për obligim që të ndërmarrë masa që do të garantojnë kushte të barabarta për komunitetet, ndër të tjera duke garantuar një mirëqenie më të mirë ekonomike. Për më shumë, në kuadër të programit të Qeverisë ndër të tjera përcaktohet se Qeveria do të angazhohet në krijimin e mundësive për gjithëpërfshirje në arsimin primar dhe sekondar, integrimin dhe angazhimin e tyre në jetën publike dhe mbështetjen në aspektin e aktivizmit ekonomik të tyre. Një parakusht i veçantë do t'i kushtohet të drejtave të komuniteteve egjiptian dhe ashkalinj. Andaj, për të përmbushur këtë objektiv duhet të parashihen linja të veçanta për subvencione në kuadër të

ministrive kompetente, si në vijim: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, subvencione për mbështetje të bizneseve, Ministria e Bujqësisë, subvencione për fermerë në zonat rurale, veçanërisht për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që bien në kategoritë e grupeve të margjinalizuara, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e në veçanti Ministria e Zhvillimit Rajonal, një ministri e cila për mendimin tonë ka dështuar dhe shpresojmë shumë në buxhetin aktual kjo ministri do të ndryshojë qasje dhe do të bëjë më tepër edhe për vetë faktin që ekziston një ministër sipas marrëveshjes me Grupin 6+, që përfaqëson komunitetet joshumicë.

Ministria e Arsimit, në kuadër të MASHT-it, duhet të vazhdohen programet për mbështetje të arsimimit të barabartë të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, siç është përcaktuar në programin e Qeverisë me Kushtetutë e strategjitë e tjera kombëtare përkatëse. Kërkojmë që të shqyrtohet rekomandimi i Ambasadës Zvicerane për miratuar një buxhet të veçantë për fëmijët e komuniteteve që të kenë më shumë kushte për shkollim shtesë. Gjithashtu, Zyra e Kryeministrit për komunitete patjetër duhet të ndajë buxhet të planifikuar dhe të shpërndarë barabartë në të gjitha komunitetet. Statistikat flasin për monopol dhe ndarje të njëanshme në shumicë absolute për komunitetin serb.

Zoti ministër,

Besojmë fuqishëm që në mes të dy leximeve do të kemi hapësirë të mjaftueshme dhe duke kërkuar mbështetjen e të gjithë deputetëve tuaj dhe në veçanti deputetëve nga komunitetet joshumicë, jo serbë, të dakordohemi dhe të bëjmë më të mirën për komunitetet tona. Unë deklaroj mbështetjen me votë të projektligjit në leximin e parë, duke qenë i gatshëm për të dhënë kontributin tim në mes të dy leximeve. Ndërsa, mbesim në komunikim, në mënyrë që të bëjmë më të mirën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Islam Pacolli.

**ISLAM PACOLLI:** Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht i falënderoj të gjithë ministrat, e në veçanti ministrin e Financave për përgatitjen e këtij raporti apo propozimi, po sigurisht që është i përgatitur mirë, por ne nuk do të thotë që jemi të kënaqur me gjithçka që është propozuar, duke marrë parasysh që shumë pjesë të zonës së Gollakut kanë mbetur të pambuluara. Unë shpresoj dhe i bëj thirrje ministrit të Infrastrukturës që ta shqyrtojë dhe ta fusin në buxhet për leximin e dytë propozimin dhe hartimin e projektit të rrugës kah Liqeni i Badovcit që ndërkohë do të lidhet edhe me rrugën e Gjilanit dhe me pjesën komplet të Gollakut.

Kjo kishte për ta lehtësuar shumë lëvizjen e asaj zone, për arsye që deri më tani ka vështirësi të qasjes deri në Prishtinë dhe është për keqardhje që janë 15 km dhe bën 50 minuta deri 1 orë deri sa të futesh në Prishtinë. Prandaj, kjo rrugë që e kërkoj sot lehtëson shumë qasjen e qytetarëve dhe dikur më herët ka qenë edhe një shkollë katërvjeçare, e cila tani nuk është më fare në

propozim të buxhetit dhe Shtëpia e Kulturës në Vitinë e Marevcit dhe ato nuk duken ende këtu, po besoj që do të kenë hapësirë të rinegociohet kjo çështje për leximin e dytë. Natyrisht që e përkrahim buxhetin, po edhe buxhetet të jetë proporcional sikur vendet e tjera, do të thotë edhe për këtë zonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lutfi Zharku, le të përgatitet zoti Zenun Pajaziti.

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar!

Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po filloj me disa vrojtime mbi deficitin buxhetor dhe financimin e tij. Deficiti i rregullt buxhetor i projektuar është 416 milionë euro, gjegjësisht afër 6% të bruto-produktit të vendit, e që paraqet edhe nevojën për financim.

Kjo shifër është korigjuar në 145 milionë euro, e që është 2% e bruto produktit të vendit, në përputhje me rregullën fiskale pas zbritjes së kredive sipas klauzolës investive në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike. Megjithatë, mbetja prej 261 milionë eurosh konsiderojmë se financohet në mënyrë jo të përshtatshme. Ky financim konsiston në emetimin e letrave me vlerë në shumë prej 135 milionë eurosh, gjegjësisht rritje të borxhit të brendshëm publik dhe 140 milionë euro të hyra nga procesi i likuidimit, gjegjësisht privatizimit të ndërmarrjes shoqërore. E të dyja këto lloje të financimit kanë të metat e veta, rritja e borxhit të brendshëm publik që nuk lidhet direkt me projekte të caktuara kapitale nënkupton financim të deficitit buxhetor që, siç vërtetohet nga analizimi i kategorive të shpenzimeve, është shkaktuar nga arsye të tjera, siç janë pagat e mëditjet, apo subvencionet, transfere sociale, apo mallra dhe shërbime. Pasi që niveli i financimit të shpenzimeve kapitale me grante direkte është më i ulët se në vitin aktual. Financimi i këtij deficiti paraqet shpenzim joproduktiv të borxhit publik, në anën tjetër, fillimi i projekteve bazuar në të hyra jo të rregullta, siç janë të hyrat nga privatizimi, mund të çojnë në rritje të mëturshme të deficitit buxhetor në rast të mosrealizimit të këtyre të hyrave. Të gjitha vendet, të cilat kanë filluar projekte kapitale bazuar në të hyra jo të rregullta ose mbivlerësim të të hyrave të rregullta, kanë përfunduar në rritje të deficitit buxhetor, pasi që në një kohë të caktuar ato të hyra shteren.

Edhe Kosova ka kaluar nëpër këtë situatë në vitet e para pas pavarësisë, duke filluar projekte të mëdha kapitale, bazuar në të hyra jo të rregullta, siç janë dividendet e ndërmarrjeve publike, në veçanti dividenda nga Telekomit i Kosovës. Kjo ka imponuar që në vitin 2012 të fillojë huazimi i brendshëm për mbulimin e deficitit buxhetor, i përkrahur edhe nga huat prej Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në këtë rast duhet të ceket se ky deficit buxhetor nuk përfshin edhe obligimet rrjedhëse, të cilat në vitet e fundit kanë në qenë në nivele të larta. Duke u nisur nga rikategorizimi i shpenzimeve kapitale në mallra, që ka shkaktuar rritje të këtyre shpenzimeve në projektbuxhetin aktual, e konsideroj deficitin buxhetor si konstrukt arbitrar kontabël. Në këtë vijë

të analizimit të deficitit real buxhetor, projektbuxheti duhet të përfshijë edhe pasqyrën mbi obligimet aktuale rrjedhëse të Qeverisë, përkundër asaj se përdorim kontabilitetin bazuar në paranë e gatshme. Këto obligime kanë sjellë rreth 200 milionë euro në mënyrë konstante në vitin 2015-2017, gjegjësisht mbi 3% të bruto produktit të vendit. Kështu, nëse deficitit të projektuar prej 416 milionë euro i shtohen edhe obligimet rrjedhëse, vijmë në përfundim se kemi të bëjmë me deficit buxhetor prej mbi 9% të bruto produktit të vendit, e që në mënyrë serioze rrezikon likuiditetin e Qeverisë. Aspekt tjetër është edhe projektimi jo real apo tejet optimist i realizimit të projekteve kapitale përmes kreditimit të jashtëm. Përderisa është për t'u përhëndetur rritja e nivelit të investimeve kapitale, mbetet dilemë e madhe realizimi i tyre, e në veçanti i atyre nga kreditë e jashtme që parashihen në shumë prej 121 milionë eurosh. Gjatë këtij viti Qeveria ka dëshmuar se jemi shumë të pazotë në shfrytëzimin e kredive tanimë të nënshkruara. Pa përjashtuar natyrisht burokracinë e kreditorëve, kështu raporti mbi borxhin 9-mujor të këtij viti vërteton se borxhi i përgjithshëm i ratifikuar është afër 1,2 miliard euro, kurse është disporsuar afër 800 milionë euro, që do të thotë që 400 milionë euro është borxh i padisporsuar, gjegjësisht i patërhequr. Sipas raportit të cekur gjatë këtij viti ne kemi tërhequr vetëm 5.97 milionë euro që është dëshmi se edhe gjatë vitit të ardhshëm nuk mund të ketë përmirësime të mëdha.

Përpos kësaj, investimet kapitale vazhdojnë të dominojnë nga infrastruktura rrugore, përkundër rëndësisë së madhe që kanë rrugët në zhvillimin ekonomik të një vendi, tanimë është dëshmuar se ekonomitë e shumë vendeve, se investimet në shëndetësi dhe arsim krijojnë nxitje edhe më të madhe në zhvillimin ekonomik. Është e tepërt të flas mbi nevojën urgjente të investimeve kapitale në shëndetësi, në formë të aparaturave të ndryshme dhe përkrahjes së ngritjes profesionale të mjekëve tanë, apo pajisjes së laboratorëve të ndryshëm në shkolla dhe fakultete tona. Përfitimet afatgjata nga këto investime në zhvillimin ekonomik dhe social të kalojnë çfarëdo investimi në fusha të tjera. Kur jemi te rrugët duhet të theksohet se këto investime dominohen plotësisht nga projektet e filluara nga vitet e kaluara. Megjithatë, duhet të theksohet se buxheti i ndarë në projekte të caktuara kapitale nuk është në përputhje me zotimet publike nga Qeveria, kështu autostrada Prishtinë - Gjilan jo që nuk do të kryhet deri në vitin 2020, por vazhdon në vitin 2021, kurse pjesa Gjilan - Dheu i Bardhë as që është përfshirë në buxhet. E njëjta situatë është edhe me zgjerimin e rrugës Prishtinë - Podujevë, ku për vitin e ardhshëm janë paraparë vetëm 2 milionë euro, e që i bie më pak se 2 km.

Po ashtu, përkundër premtimeve publike të anëtarëve të ndryshëm të Kabinetit qeveritar, prapë nuk është përfshirë në projektbuxhet ndërtimi i kyçjeve të reja në autostradën "Arbër Xhaferi" dhe atë për komunën e Vitisë, në Gurëz, si dhe kyçja e re për Ferizaj. Siç e dimë për këto dy kyçje ekziston vendimi i Komisionit ndërministror nga qeveria e kaluar, prandaj ju bëj thirrje që këto dy projekte të përfshihen në buxhet, ose të anulohet vendimi për këto kyçje, në mënyrë që qytetarët e këtyre komunave të mos manipulohen me premtime të kota.

Në fund, në projektbuxhetin e këtij viti ka ndodhur një precedent që nuk dihet të ketë ndodhur ndonjëherë në vendin tonë. Ministër, jam në nivelin qendror që nga 2004, janë tri projekte kapitale rrugore, të cilat janë përfshirë në buxhet, por që nuk kanë mjete buxhetore të ndara në vitin 2019. Është zgjerimi i rrugës rajonale Pejë-Deçan, është rehabilitimi i rrugës rajonale Kijevë - Malishevë dhe rehabilitimi i rrugës rajonale E9, segmenti Pejë - Kuçishtë, që nuk kanë fare buxhet të ndarë në vitin 2019. Kjo nuk është gjë tjetër vetëm se po më duket që qeveria po na çon një mesazh apo një dëshmi se ky është buxheti i fundit që i paraqesim këtij Kuvendi, prandaj po mundohen që të zaptojnë buxhete edhe për vitet e tjera derisa janë në pushtet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zenun Pajaziti, le të përgatitet zonja Albulena Haxhiu.

**ZENUN PAJAZITI:** Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Meqenëse jemi në orët e vona, po mundohem të them vetëm diçka që është pak më e rëndësishme nga ato që unë vlerësova se është me rëndësi. Do të ishte mirë, herëve të tjera të jemi më eficientë edhe seancat t'i trajtojmë më herët, sidoqoftë po përmend vetëm diçka që ma merr mendja se është me rëndësi.

E para, vit pas viti kemi njëfarë mënyre të njëtrajtshme të profilit të buxheteve, ajo që na gëzon është që vit pas viti kemi një rritje dhe kemi linja buxhetore që janë në interes të qytetarëve. Por, ajo që mendoj që na mungon në debatin tonë është njëfarë mënyre planifikimi strategjik për buxhetin. Pra, nuk kemi ende njëfarë mënyre në përputhje me studimet e veçanta të shohim se çka e dallon një buxhet nga një buxhet tjetër, ta zëmë, a kemi nevojë për ujërat, a kemi nevojë për energjinë, për bujqësinë. Ta zëmë, vite të tëra kemi konsideruar që komuna e Vitisë ka potencial të jashtëzakonshëm për bujqësi, në anën tjetër s'kemi bërë asgjë për potencialet e ujit t'i trajtojmë më mirë ose, thënë më tepër, Ministrinë përkatëse nuk kanë sjellë ndonjë projekt të veçantë ose agjencitë që merren me ato, të njëjtën kemi edhe për komunat e tjera. Përveç kësaj që mendoj që duhet të thellohem më shumë në planifikimin strategjik, e që ka të bëjë pastaj edhe me fusha të tjera, nëse unë lexova javën e kaluar që në komunën e Gjakovës janë mbyll disa shkolla, duhet institucionet e arsimit ta bëjnë një planifikim, çka duhet investuar, çka duhet ndërtuar, në cilën mënyrë, për çfarë profili, ku duam ta orientojmë sistemin e arsimit, e tjerë. Dhe, në njëfarë mënyrë një herë edhe të japë dikush përgjegjësi nëse është bërë një shkollë për 1 mijë nxënës, e nuk janë as 200 nxënës, e diçka të ngjashme. Pra, mendoj që Ministria e Financave duhet të shtrojë pyetje për agjencitë e veçanta, në mënyrë që kur të bëjë planifikimin të ketë njëfarë baze në një studim të veçantë.

Një çështje tjetër është koordinimi. Agjencitë nuk koordinohen njëra me tjetrën, ta zëmë javën e shkuar unë bëra një pyetje në Universitet të Gjilanit për projektin që i kemi ndarë mjetet vitin e kaluar. Më thanë që nuk është bërë projekti, sepse komuna, me disa prej ministrive, Ministrinë e Arsimit dhe FSK-në, nuk janë koordinuar që ta lejojnë hapësirën ku duhet bërë projekti për

ndërtesën e re të universitetit. Ne nuk mund të kemi papërgjegjësi vit pas viti, edhe këtë vit të ndahet ai buxhet, prapë nuk do të ketë koordinim, prapë nuk do të ketë projekt, nuk do të ketë investim për universitet. Pra, në nivelin qendror duhet të insistohet të ketë koordinim mes institucioneve përgjegjëse, në mënyrë që buxheti të mos kthehet mbrapa. Edhe një segment që mendoj që duhet shtuar vëmendja, sepse pjesa më e madhe e buxhetit, zoti ministër, shkon për infrastrukturë dhe besoj që këto kanë qenë kërkesat për zhvillimin e vendit tonë, është mirë që tash e kemi një pamje më të mirë në këtë vend për shkak të rrugëve, por kemi edhe defekte në këtë drejtim.

Mendoj që këtu duhet po ashtu të ketë njëfarë lloj vlerësimi, edhe te projektet që bëhen me këto kompanitë vendore. Kemi me vite disa rrugë në Kosovë që punohet dhe nuk kemi ndonjë rezultat dhe kemi një rrugë tjetër nacionale që e kemi nisur, po ashtu me kompani vendore, pa e pasur një vlerësim se a është duke u punuar në dinamikën e duhur, a është kualiteti i duhur, a do të kryhen ato rrugë, si po punohet, e tjerë. Dhe, mendoj që këtu në Prishtinë e kemi njëfarë pasqyre të infrastrukturës, rruga e Vetërnikut është për mua pamja e infrastrukturës në Kosovë. Është një rrugë që për mendimin tim është bërë pengesë tash, ose një rrugë tjetër po ashtu në Vetërnik që çon në hyrje të rrugës së Gjilanit me Graçanicë. Një vit, prej pranverës e deri tash dhe s'është kryer ajo rrugë. Më shumë është bërë pengesë, është e vetmja hyrje në Prishtinë prej një qyteti ose një regjioni që bëhet kolona të gjata me kilometra jo vetëm gjatë verës, hyrja prej Gjilanit. Me një projekt që në vend se të zhblllokohej, është komplikuar edhe më shumë, edhe flitet pastaj jo është kjo kompani e filan biznesmenit, e filan politikanit, janë çështje që nëse ka informacione të tilla të çohen ku duhet, po ajo që është e rëndësishme është të ketë përgjegjësi, llogaridhënie, për projektet, të cilat merren të kryhen.

Mendoj që në këtë drejtim është momenti i fundit dhe të planifikohet shumë më mirë. Kur është fjala te koordinimi, e kisha potencuar edhe një diçka, planifikimi, koordinimi i nivelit qendror me lokal te infrastruktura. Kemi komunë ku potencohen, specifikohen një rrugë fshati, qyteti, disa rrugë fshatrash nga niveli komunal, nga Ministria e Infrastrukturës dhe kemi komunë, ta zëmë te Komuna e Kamenicës, shtatë fshatra përmenden me një linjë buxhetore, rrugë të shtatë fshatrave edhe janë lejuar 400 mijë euro buxhet. Duhet pasur njëfarë korrektësie, njëfarë planifikimi të barabartë në përputhje me kriteret që vendosen për komunat. Mendoj vetëm kështu mund të justifikojmë përgjegjësinë ose përgjegjshmërinë tonë ndaj shpenzimit të buxhetit. Mendoj që do të mund të jap personalisht ndonjë kontribut gjatë leximit dhe të propozoj diçka më konkrete gjatë trajtimit në leximin e dytë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, le të përgatitet zonja Shqipe Pantina.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Sa herë diskutohet lidhur me buxhetin, natyrisht fokusohem mbi ndarjet buxhetore për sistemin e drejtësisë, duke u bazuar edhe në faktin që e drejtoj Komisionin për Legjislacion dhe më bie

shumë shpesh të ballafaqohem me kërkesat e vazhdueshme buxhetore të institucioneve të drejtësisë dhe sfidave që i kanë ndër vite.

Në këtë kuptim unë kam qenë edhe në Komisionin për Buxhet në kohën kur është shqyrtuar në parim ky projektligj dhe aty po ashtu kam shprehur kërkesat, shqetësimet në raport me buxhetin për vitin 2019 që lidhen me institucionet e drejtësisë apo organizatat buxhetore që kanë të bëjnë me drejtësi ose që mbikëqyren nga Komisioni për Legjislacion. Dhe, aty domethënë kemi diskutuar për çështjet, të cilat nuk janë adresuar në buxhetin për vitin 2019 dhe unë besoj që është e rëndësishme që të adresohen edhe në seancë, ku po e shqyrtojmë buxhetin.

Së pari, unë nuk bie dakord me ministrin e Financave, ku thotë që të kemi kujdes që projektligjet, nëse e kam kuptuar qartë, natyrisht, projektligjet që nuk kanë mbështetje buxhetore të mos përkrahen, por subjektet, të cilat janë të njohura me Kushtetutë për të propozuar ligje në Kuvendin e Kosovës janë edhe deputetët, grupet parlamentare, komisionet, sikurse edhe Qeveria e Presidenti, prandaj edhe unë mendoj që kjo është mbi çfarëdo, si të thuhet, implikimi buxhetor. Prandaj, kur Kushtetuta na njeh të drejtën për të propozuar ligje, nëse ato ligje kalojnë në Kuvendin e Kosovës, atëherë Qeveria është e obliguar që të mos lejojë që ai ligj të përfundojë në sirtarët e institucioneve, por që ta zbatojë dhe të gjejë buxhet për të, siç po gjeni buxhet, ta zëmë, për vendimin e paligjshëm për pagat, që ka implikime të mëdha buxhetore, do të duhej që të gjeni buxhet edhe për projektligjet që aprovohen në Kuvend të Kosovës, që janë të rëndësishme, prandaj edhe nuk besoj që vlen ajo kërkesa e ministrit të Financave.

Tash, së fundi kemi qenë dëshmitarë të kalimit të shumë projektligjeve që lidhen me sistemin e drejtësisë. Pra, ky Kuvend tash së fundi tash së voni edhe disa të tjera kanë mbetur për t'u aprovuar, ka miratuar një pako të ligjeve që lidhen me sistemin e drejtësisë dhe e kam thënë edhe në atë mbledhjen e Komisionit për Buxhet, që në qoftë se e shikojmë buxhetin po duket që nuk ka njëfarë, si të themi, bashkëpunimi apo koordinimi ndërmjet ministrive përkatëse në momentin kur propozohet projektbuxheti.

Çfarë po dua të theksoj me këtë që është projektligjet që na kanë ardhur në komision për legjislacion, e që kanë implikime buxhetore e që kanë kaluar edhe në shqyrtim në këtë Kuvend, nuk është paraparë buxheti për to. Pra, ne tash së voni e kemi votuar projektligjin për Prokurorinë e Shtetit, aty kemi propozuar që secili prokuror ta ketë një bashkëpunëtor profesional. E di që e ka ngritur edhe zoti Sami Kurteshi, por po e ngriti sërish, sepse besoj që është e rëndësishme.

Është e pavërtetë që me buxhetin për vitin 2019 për Këshillin Prokurorial mund të adresohet kjo kërkesë buxhetore. Po ashtu edhe në Ligjin për Gjykatat tash së voni që e kemi aprovuar, secili gjyqtar duhet ta ketë një bashkëpunëtor profesional. Jo sikurse është aktualisht ta zëmë, që një bashkëpunëtor profesional vlen për tre-katër gjyqtarë apo pesë gjyqtarë, por secili gjyqtar për



shkak vëllimit të punëve që i kanë ta këtë një bashkëpunëtor profesional. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Nëse e shohim totalin buxhetor dhe në anën tjetër e bëjmë një kalkulim sesa është ndarë për sistemin e drejtësisë i bie 1,8% e totalit buxhetor. Mua nuk ma merr mendja, madje jam e bindur për këtë që me këtë buxhet që është ndarë për sistemin e drejtësisë do të mund të adresohen sfidat me të cilat përballlet sistemi i drejtësisë.

Unë jam kritike dhe Vetëvendosje në përgjithësi e kritikon kapjen e sistemit të drejtësisë, por jemi thellë të angazhuar që përbrenda këtij kuadri të propozojmë qoftë buxhet, qoftë dispozita të cilat e ndihmojnë sistemin e drejtësisë, ndonëse unë jam e bindur që pa e larguar Qeverinë aktuale nuk mund të kemi përmirësime në sistemin e drejtësisë, dhe në anën tjetër pa aplikuar vetingun. Domethënë është i rëndësishëm edhe vetingu, në mënyrë që të adresohet kjo.

Unë i kam analizuar po ashtu edhe buxhetet e shteteve tjera sesi e ndajnë për sistemin e drejtësisë dhe edhe në Ballkan, domethënë por edhe shtetet e Bashkimit Evropian, si të themi, 3,4 apo 5% ndajnë për sistemin e drejtësisë. Pra, ato qeveri që janë të interesuara ta forcojnë sistemin e drejtësisë atë e reflektojnë së pari në buxhet, sepse ju e dini shumë mirë që kur mund të ketë vullnet, ndonëse kjo Qeveri nuk ka, por në anën tjetër edhe nëse ka vullnet një qeveri, ajo duhet të harmonizohet me buxhet apo të përcjellët me buxhet.

Prandaj, unë nuk besoj që me këtë buxhet do të mund të adresohen sfidat dhe shqetësimet në sistemin e drejtësisë.

Çështja tjetër është, sapo ka kaluar në Kuvend Ligji për gjykatat siç e përmenda. Aty parashihet degë e Gjykatës Themelore në Han të Elezit dhe kjo ka kaluar, pra ai ligj ka kaluar edhe në shqyrtim të dytë, dhe unë nuk parë që ka ndarje buxhetore për këtë.

Komisioni për Buxhet me sa kujtoj ka thënë që janë 3 milionë implikime buxhetore. Po ashtu një çështje që është tepër e rëndësishëm që e kemi adresuar për vite radhazi, është departamenti special përbrenda Gjykatës Themelore që merret me lëndët e Prokurorisë Speciale.

Ky ka qenë një hap pozitiv në pakon ligjore për sistemin e drejtësisë, por natyrisht ka edhe implikime buxhetore, dhe këto implikime buxhetore nuk janë paraparë, sepse në këtë Departamentin Special parashihet të ketë gjyqtarë të profilizuar për lëndët me të cilat merret Prokuroria Speciale. Prandaj, unë besoj që është shumë e rëndësishme që të adresohet kjo.

Më tej, Agjencia Kundër Korrupsionit, unë e kam thënë edhe në komisionin për buxhet, janë një sërë ligjesh që kanë kaluar, qoftë Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit. Qoftë Ligji për

mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të dyja këto i japin kompetenca shtesë Agjencisë Kundër Korrupsionit, sidomos Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Nëse s'ka kapacitete profesionale dhe njerëzore Agjencia Kundër Korrupsionit, këto ligje do të mbeten thjesht të pazbatuara. Është e vërtetë që mund të duken që kemi nga ata që na përcjellin në këtë rast, edhe nga zyrtarët e Bashkimit Evropian që e përcjellin legjislacionin i cili kalon në Kuvend të Kosovës mund të duket që është hap pozitiv, por në qoftë se ai nuk zbatohet, natyrisht që nuk do të mund të kemi domethënë implementim të tij.

Tjetra që do doja të diskutoja është për Ligjin për pagat. Nëse vërejmë, domethënë nuk është paraparë buxhet për ligj me aq sa kam parë unë. Shtrohet pyetja se çka nëse ai ligj hyn në fuqi, nuk mund të paragjykojë nëse hyn apo jo, por çka nëse hyn në fuqi në këtë vit ose në janar të viti 2019. Për shkak se aty janë paraparë edhe shumë amendamente, sidomos për Shërbimin Korrektues të Kosovës që e përmendi edhe në fjalën hyrëse kryetari i Vetëvendosjes, Albini.

Po ashtu edhe për zjarrfikësit ka amendamente për zjarrfikësit për rritjen e koeficientit të tyre, por kjo pastaj nuk është adresuar në buxhet. Por, edhe për shumë çështje të tjera për të cilat tashmë i kemi adresuar amendamentet.

Në fund fare, ne si komision i kemi ftuar të gjitha institucionet që bien në fushëveprim të komisionit për legjislacion që të na i thonë vërejtjet e tyre në raport me buxhetin. Të martën në orën 13:00 ne e kemi mbledhjen e komisionit, ku do ta shqyrtojmë veç e veç secilën kërkesë buxhetore.

Tashmë veç ka nisur të vijnë në komision, sepse në komision për buxhet është thënë që ky buxhet sjellë në përputhje me organizata buxhetore, kërkesat e tyre, por që po del që nuk është ashtu. Pra, shumë prej kërkesave të tyre nuk i kanë marrë parasysh dhe për këtë, domethënë, ne do të diskutojmë në komisionin për legjislacion.

Unë po flas që të paktën si kryetare e komisionit do ta mbështesë secilën kërkesë që është e arsyeshme. Nuk ka kuptim që të mos i përkrahim kërkesat buxhetore të tyre. Ministri i Financave në komisionin për buxhet ka thënë që interesat ose kërkesat buxhetore të këtyre institucioneve nuk e rrezikojnë stabilitetin makrofiskal, prandaj edhe në qoftë se ka kërkesa, atëherë ato do të aprovohen ashtu siç e kam kuptuar.

Prandaj, ne do punojmë në këtë drejtim dhe do t'i adresojmë kërkesat e tyre. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën. Zoti Hamza e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, deputete Haxhiu!

Po është e qartë se kush ka të drejtë t'i sponsorizojë ligjet. Dihet kush ka të drejtë të jetë sponsorizues i ligjeve, po kushdo që t'i sponsorizojë ligjet është i obliguar që ta kërkojë deklaratën e ndikimi të vlerësimit buxhetor.

Pa këtë deklaratë ligji nuk mund të procedohet në Kuvend dhe nuk mund të ecë tutje. Nëse ka shmangie mes draftit të parë për të cilin jepet dhe lëshohet vlerësimi i ndikimit buxhetor edhe një drafti final, atëherë kostoja e këtij ligji ndoshta nuk mund të akomodohet brendapërbrenda buxhetit dhe sidomos për ligjet dhe për iniciativat që vijnë pasi që veç buxheti kalon disa procedura.

Sa u përket institucioneve të drejtësisë. Ka pasur rritje të buxhetit sinjifikant në raport me periudhat e kaluara. Nëse i referohemi buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe e krahasojmë vitin 2017 me vitin 2019, prej 17-18 milionë ka shkuar në 23 milionë.

Nëse shkojmë te Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2017, 8 milionë. Në vitin 2018, 11 milionë. Në vitin 2019, 14 milionë. Nëse shkojmë te Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në 2017-tën 19 milionë, 2018-tën 23 milionë, 2019-tën 28 milionë.

Nëse e marrim numrin e të punësuarve në raport me numrin e aprovuar në raport me numrin aktual të të punësuarve, del që Ministria e Drejtësisë i ka edhe 216 pozita të aprovuara të paplotësuara.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 283 pozita i ka të aprovuara të paplotësuara. Këshilli Prokurorial i Kosovës, 93 pozita të aprovuara të paplotësuara. Prandaj, kur t'i plotëson këto pozita, atëherë nëse ka arsyeshmëri të qëndrueshme, sigurisht se për kërkesat edhe për nevojat të arsyeshme ne do t'i kemi në konsideratë.

Ndërsa e kam thënë dhe po e ripërsëris se institucione, organizata buxhetore që kanë buxhet jo të madh, çdoherë ka mundësi që të financohen nevojat e tyre pa e rrezikuar stabilitetin markofiskal qysh është Agjencia Kundër Korrupsionit, sepse nuk ka ndonjë buxhet të madh i cili edhe kërkesa të mëdha të cilat do të mund ta rrezikonin stabilitetin makrofiskal.

Prandaj, në këtë drejtim besoj që pajtohemi në një pikë që, po buxheti është rritur, buxheti sigurisht se do të rritet edhe më shumë, po edhe numri i lëndëve që presin të zvogëlohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, replikë!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E para, unë nuk pranoj që Kuvendi i Kosovës, përkatësisht deputetët e Kuvendit të shihen si makina votimi. Që nënkupton që ata në momentin kur ka një nismë legislative nga Qeveria, kur procedohet një projektligj nga Qeveria në Kuvend të mos kenë të drejtën as të bëjnë amendamente edhe nëse kanë implikime financiare.

Për faktin se ne si deputetë i shqyrtojmë i analizojmë, takohemi me institucione që preken direkt nga ligjet dhe në këtë kuptim bëjmë edhe amendamente.

Fakti që kërkohet që të kemi kujdes në këtë drejtim, unë konsideroj që është i paqëndrueshëm. Po ashtu, edhe kur kemi nisma legislative, ne si grupe parlamentare, shumë prej tyre i ka proceduar Vetëvendosje edhe në këtë legjislaturë.

Nëse drejtorja e Kuvendit thotë që ka implikime buxhetore, e nëse ai ligj megjithatë kalon në Kuvend ju jeni të obliguar që të siguronit buxhet për atë projektligj që kalon në Kuvend, sepse është vullneti i deputetëve. Votojnë deputetët e Kuvendit që janë të zgjedhurit e popullit.

Edhe një herë po them, siç po i gjeni paratë për ata zëvendësministra që gati e ka mbërritur numrin 100. Siç i keni gjetur paratë për "Bechtel-Enka". Siç i keni gjetur paratë për vendimin e paligjshëm për rritjen e pagave, gjeni paratë edhe për projektligje që janë të rëndësishme për qytetarët e republikës.

Dhe tjetra, sa i përket rritjes së buxhetit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, a e dini pse është ajo rritje? Për shkak të vendimit të paligjshëm për rritjen e pagave që ka implikuar rritje edhe të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Jo për diçka tjetër.

Pra, siç e përmende numri i të punësuarve është i njëjtë, por rritet te pagat dhe mëditjet për shkak të vendimit që është...

KRYESUESI: Zoti Hamza kundër-replikë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Jo, unë jam i sigurt që deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të përgjegjshëm. Janë racionalë. Nuk propozojnë dhe nuk aprovojnë ligje të cilat e rrëzojnë buxhetin e shtetit, se nuk ka dikush këtu përgjegjësi më të vogël e më të madhe.

Prandaj, në këtë drejtim deputetët e Kuvendit të Kosovës janë shumë të kujdesshëm në ruajtjen e stabilitetit makrofiskal dhe propozojnë ligje të cilat kanë mundësi që të financohen. Ndërsa, sa i përket rritjes së buxhetit, po buxheti për sektorin e drejtësisë rritet për paga për mallra dhe shërbime se sektori i drejtësisë nuk ndërton as shkollë, as rrugë e as spitale, investime kapitale s'ka.

Bashkëpunëtorët profesionalë marrin paga edhe u ndihmojnë gjyqtarëve. Për tutje, është rritur edhe numri i të punësuarve. Janë rritur edhe pagat edhe teknologjinë informative ua blejmë më të avancuar hiç s'është problem. Asnjë shqetësim s'ka. Edhe te Ligji i Pagave që e përmende. Te Ligji i pagave te Ministria e Financave ka një pozicion në kuadër të Ministrisë së Financave buxheti që thotë që është një kontigjencë, e cila është e paraparë për mbulimin e iniciativave të reja ligjore. Aq sa e ke në Kuvend. E di shumë saktë, po lexoje në buxhet, e ke në buxhet dhe e gjen atë.

Do t'i dërgoj në ligjet të cilat aprovohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zonja Shqipe Pantina, le të përgatitet zonja Donika Kadaj-Bujupi.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, kryesues!

Faleminderit ministër që jeni këtu!

Besoj se dëgjuat mjaft kritika dhe vërejtje, por morët edhe lëvdata për buxhetin, kështu që unë do ju kursej nga të dyja. Kam dy pyetje të cilat po ashtu do të doja t'i shtroja edhe në formë kërkesash, qoftë për juve si Qeveri, por edhe për Komisionin për Buxhet dhe Financa.

E para ka të bëjë me një proces për të cilin Kosova tashmë është vonë. Është procesi i digjitalizimi të medias. Vendet e rajonit tashmë e kanë të përfunduar këtë dhe arsyeja pse kjo nuk është bërë në Kosovë, është se Qeveria ende nuk e ka miratuar strategjinë për digjitalizim dhe nuk ka ndarë buxhet për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme. Sepse kur flasim për infrastrukturë nuk janë vetëm autostradat mbi të cilat kalojnë automjetet që duhet shteti të kujdeset për to, por janë edhe një sërë po u them në thonjëza autostrada tjera, e një nga këto është edhe kjo që u shërben mediave në mënyrë që të kalojnë nga sistemi analog në atë digjital.

Unë bukur me vëmendje e shikova buxhetin, por nuk pashë ndonjë vijë të veçantë buxhetore që është ndarë për ndërtimin e infrastrukturës në mënyrë që të mundësohet procesi i kalimit nga analog në digjital për media.

Pra, kjo është pyetje dhe njëkohësisht edhe kërkesë që Qeveria më në fund t'i ndajë mjetet e nevojshme për të mundësuar kalimin e mediave, një proces pastaj të cilin ARKEP-i dhe KPM-ja duhet ta zbatojnë, por fillimisht Qeveria duhet të miratojë strategjinë edhe të ndajë buxhet.

Kërkesa e dytë që po ashtu është për ju po njëkohësisht edhe për Komisionin për Buxhet dhe Financa është që Qeveria e Kosovës, përkatësisht të gjitha institucionet në përgjithësi duhet të sigurojnë qasje të barabartë edhe në informata për të gjithë qytetarët e vet, në mënyrën që ata qytetarë mund t'i marrin këto informata. Nëse nuk mund ta bëjnë për çdo gjë, për çdo informatë që prodhojnë të paktën për ato që janë të domosdoshme.

Ajo çka dua të them është që qytetarëve të verbër t'u mundësohet që të kenë qasje në informatat që janë të domosdoshme për ta. E një nga to janë edhe ligjet të cilat i prekin direkt ose për të cilat ua lehtësojnë informatat që i marrin ata ua lehtësojnë jetën.

Kështu që unë do të kërkoja që një numër të tyre, natyrisht që jam e vetëdijshme që është e pamundur që çdo gjë të publikohet në alfabetin brail në sistemin brail, po të paktën një numër i ligjeve të cilat janë jo vetëm të nevojshme, por të domosdoshme për këtë kategori të qytetarëve, të printohen edhe në gjuhën apo në atë që e njohim si alfabeti brail, e kjo është përgjegjësi e Gazetës Zyrtare, e cila bie nën Zyrën e Kryeministrit.

Pra, këto dy kërkesa nëse ju nuk do t'i keni parasysh unë do t'ia parashtroj edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe shpresoj shumë që edhe ata do t'i kenë parasysh. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Donika nuk është këtu! Zoti Selmanaj e ka kërkuar fjalën.

**RASIM SELMANAJ:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të jem shumë i shkurtër në fjalën time. Parametrat dhe treguesit që i paraqiti ministri i Financave, zoti Bedri Hamza janë një ndryshim dhe trend shumë pozitiv që duhet vlerësuar edhe nga opozita.

Arsyeja pse e mora fjalën është se deputeti i LDK-së, zoti Naser Osmani, e përmendi Deçanin si komunë në thonjëza e privilegjuar me projekte, e unë do t'i sjelli disa fakte se a qëndron ky konstatim i deputetit.

Deçani vazhdon në disa projekte të cilat janë në vazhdim me vite të tëra. Po i përmend vetëm disa. Palestra sportive e që është në buxhet, janë të parapara edhe 150 mijë euro që të përmbillet projekti në tërësi, një projekt që ka filluar në vitin 2008.

Stadiumi i qytetit që figuron në këtë buxhet janë 100 mijë, por një projekt që ka filluar në vitin 2012. Pastaj disa rrugë në fshatin tim të lindjes në Glllogjan me kontratë të vitit 2017, e që gjatësia e rrugës është 5742 metra dhe disa kanale aty, është dashur që pjesën e mjeteve të mbetura që të mbyllet ky projekt t'i ndajë Qeveria Haradinaj. Dhe ka plot kësi shembujsh, po flas për Deçanin.

Projekte të reja në komunën e Deçanit mendoj se janë të balancuara me komunat tjera të Kosovës. Dhe, nëse dikush nga opozita mendon se ka projekte shumë në Deçan, unë si deputet sot e dje si kryetar mendoj se në Deçan është dashur të ketë më shumë projekte.

Deçani vazhdon të ketë prioritete të cilat ende nuk po ndodhin, si për shembull; rruga e qendrës apo zgjerimi i rrugës në mes të qytetit. Pastaj një rrugë transit e cila është shumë e nevojshme. Të dyja këto projekte komuna nuk mund t'i kryejë për shkak se ka mungesë të fondeve.

Po e përmendi se projekti është hartuar në vitin 2017 për zgjerimin e qendrës, por vazhdon të mbetet i tillë në mungesë të fondeve. Dua të ndalem te rruga Deçan-Plavë dhe do të jem në këtë rast edhe kritik, por do të kem edhe kërkesë konkrete.

I nderuar ministër, nga ajo që figuron në buxhet del se në vitin 2018 janë paraparë 2 milionë e 97 mijë e 643 euro, ndërsa në vitin 2019 janë zero cent. Mjetet që kanë qenë të parapara domethënë në 2018 tash janë bartur në 2019-ën, por këto mjete janë të harxhuara sepse kompania e cila e ka punuar atje i ka harxhuar këto mjete.

Në vitin 2020 janë të parapara 2 milionë, 2021 janë 5 milionë, ku në total projekti është 9 milionë. Kërkesa ime është që të paktën për vitin ardhshëm të bartën 2 milionë euro në mënyrë që në 2020 të mbyllet ky projekt sepse po stërzgjaten këto projekte jashtëzakonisht shumë.

Unë e falënderoj ministrin Lekaj për punën që po e bënë, por këtu tek rruga Deçan-Plavë, kërkoj që të paktën për vitin e ardhshëm të jenë 2 milionë euro.

E di që s'është etike që të përmenden regjionet sepse Kosova është një por po na imponohet tash ta bëjmë njëlloj krahasimi ose njëlloj analize. Për shembull në pjesën e Dukagjinit, deri në këtë vit që tash do të vazhdojë rruga deri në Pejë dhe pjesa e rrugës Klinë-Gjakovë, për vite të tëra asnjë metër autostradë nuk është e ndërtuar.

Krejt autostradave që janë ndërtuar në Kosovë, ne ju gëzohemi sepse janë projekte të mira, mirëpo edhe në Dukagjin ja që po vjen vakti, koha pra, që edhe atje të ketë projekte të këtij niveli.

Unë për fund dëshiroj ta bëj një falënderim publik për ministrin e Financave, Bedri Hamza, i cili edhe kur unë kam qenë kryetar në thonjëza ta them kështu kushtimisht kam qenë opozitë, ka qenë mbështetës dhe përkrahës i projekteve jo vetëm në Deçan, por edhe në atë pjesë.

Përndryshe, buxheti është lajm i mirë sepse ka rritje edhe ky trend shpresojmë që do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lekaj.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar,  
Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mendoj që buxheti të cilin e ka ndarë Ministria e Infrastrukturës apo Qeveria e Kosovës për infrastrukturë i përmbushë të gjitha kërkesat e qytetarëve pa dallime.

Dhe më çuditë fakti që shumë deputetë këtu e përmendin, jo në këtë komunë përqindja është kaq, jo në këtë komunë përqindja është kaq dhe më vjen keq që nuk janë mirë të informuar apo fare nuk e kanë lexuar materialin për buxhet dhe mund të flasin në hapësirë që nuk ju takon.

Ajo që mund të them, shikojini projekte që kur kanë filluar. Prej viti 2015 dhe asnjë për tri vite nuk ka përfunduar, vetëm kanë bërë teori në buxhet apo poezi për buxhetin dhe asnjëherë nuk kanë qenë të saktë në implementimin e projekteve. Dhe tani meqë për herë të parë në histori të Kosovës kanë filluar gjashtë autostrada dhe unë nuk e di, nëse doni t'i sanksiononi qytetarët, ju jeni deputetë, hiqeni gjithë buxhetin sa i përket asfaltit dhe ajo që është ish-qeveria, kam gjetur autostradë që kushton 87 milionë me një milion euro.

Dhe, tani më vini këtu më qani me lot krokodilit, më duket se është e tepërt. E keni përmendur autostradën e Gjilanit, e i kam gjetur me një milion euro dhe keni thënë se nuk do të vazhdojë, por është duke vazhduar. Edhe më vjen mirë për qytetarët e Anamoravës që do ta kenë një infrastrukturë moderne. Po ashtu, edhe Kijevë-Zahaq, tri vjet për gjashtë shtylla nuk kanë mundur që ta vazhdojnë projektin. Merreni buxhetin sa i përket implementimit apo mbështetjes financiare nga BERZH-i dhe IBF-i. Shiheni për tri vjet ka qenë turp që s'keni filluar asnjë lëvizje. Këqyreni tani ku kemi mbërri. Merreni autostradën për Mitrovicë. Tri vjet ka qenë marrëveshje e arritur nga Kuvendi, e miratuar, dhe s'keni lëvizur fare. Tani kanë lëvizur gjërat dhe më vjen mirë që edhe segmenti i dytë po fillon. Dhe për herë të parë kemi filluar të shpenzojmë paratë e huamarrjes që kanë fjetur në buxhetin e Kosovës dhe 198 projekte janë duke u zhvilluar në infrastrukturë dhe tani këtu mund të thoni, nëse doni kapeni shkurtojini krejt, ose nëse dëshironi më shumë, qitni edhe 100 milionë dhe ua përmbushim krejt kërkesat e juaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Lekaj! Fjalën e ka zonja Hykmete Bajrami. Le të përgatitet Mexhide Mjaku.

Regjia, shtype edhe një herë atë sustën!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Të nderuar deputetë!

Ministra,

Kabinet qeveritar,

Që, siç po duket, janë shumë të zënë me zëvendësministrat e tyre dhe sot kur votohet ligji më u rëndësishëm në Kuvend, instrumenti më i rëndësishëm që duhet të shërbejë për përmbushjen e premtimeve elektorale të koalicionit të 23 partive, asnjëri prej tyre nuk është këtu. Me të vërtetë,



ky është turp. Nuk ka sesi që quhet ndryshe, përpos që është turp që asnjë ministër nuk është këtu. Zoti Pal Lekaj erdhi tash në fund, edhe na tha se i ka gjetur 53 milionë duke fjetur, dhe ia ka dhënë “Bechtel-Enka”-s. Mirë ministër, shpenzoji edhe ato të tjerat krejt çka i ke gjetur, sepse qytetarët nuk kanë për të duruar shumë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti si instrumenti më i rëndësishëm, i cili duhet të jetë në shërbim të përmirësimit të jetës së qytetarëve të Kosovës, duhet të jetë në funksion të implementimit të një strategji kombëtare zhvillimore, të agjendës së reformave evropiane, të planit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Në fakt, nuk është i tillë. Sot u tha para meje nga shumë kolegë deputetë se ky është një buxhet shpenzues dhe aspak nuk është buxhet zhvillimor. Pa hyrë fare në detaje, vetëm duke e parë dhe analizuar tabelën 1 të buxhetit, ne e shohim që ky buxhet është buxhet social, është buxhet i mbledhjes së taksave dhe tatimeve dhe buxhet mandej i rishpërndarjes së klientëve dhe siç e tha një deputet më herët i rishpërndarjes të bizneseve të cilat janë në oborrin e kësaj qeverie.

Qeveria planifikon që të marrë 905 milionë euro tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH), ndërkohë që pagat edhe mëditjet e planifikuara me buxhetin e vitit 2019 janë hiç më pak se 616 milionë. Ndërkohë që subvencionet dhe transferet janë 609 milionë. Do të thotë, të dyja këto së bashku, paga e mëditje, subvencione dhe transfere i kushtojnë buxhetit të Kosovës 1 miliard e 125 milionë. E ne e marrim nga TVSH-ja, nga Dogana dhe nga tatimi në korporata jo këtë shumë. Më pak se këtë shumë. Çka do të thotë kjo?

Ne sot si institucione dënojmë qytetarët duke u mbledhur atyre TVSH-në 18 për qind. Gjithashtu mbledhim tatimin në fitim nga korporatat prej 90 milionëve, 120 milionë nga Doganat dhe këtë e shpërndajmë te sektori publik dhe te shërbyesit e tjerë që të blejmë paqe sociale. A është ky buxhet zhvillimor, ky nuk është buxhet zhvillimor. Në buxhet shkruan se pagat në sektorin publik të 80 e sa shërbyesve civilë u rritën për 4.6 për qind, ndërkohë po ashtu shkruan se pagat në sektorin privat janë rritur për 0.6 për qind. Prej kohës kur ne kemi bërë lëvizje të pagave, dhe kur pagat janë bërë më të larta në sektorin publik se në sektorin privat, sektori privat nuk po mund t'i marrë më këmbët e veta. Derisa privilegjet, puna, siguria është më e mirë në sektorin publik se në sektorin privat, ky shtet nuk ka për të pasur zhvillim. Kjo nuk kryhet brenda një mandati, po duhen disa mandate, por duhet pasur orientim. Atë çfarë po e shohim dhe çfarë kemi parë në vitin 2018 dhe atë çka po e shohim planifikimin për vitin 2019, kjo fare nuk qëndron. Qeveria po vazhdon t'i rrisë privilegjet e veta, këshilltarëve të vetë, të zëvendësministrave, dhe të gjithë të tjerëve. Ka rritur shpenzimet nëpër komuna për 20 për qind, pa treguar në fakt se pse janë rritur këto shpenzime. Të gjitha këto janë të patolerueshme.

Me këtë Qeveri u rrit numri i ministrive që merren me zhvillim ekonomik, por zhvillimi ekonomik në fakt ngeci. Të gjithë e dimë që kemi 16 mijë vende pune më pak këtë vit dhe të gjithë e dimë që investimet e huaja direkte janë për 43 për qind më të ulëta se në vitin 2017.

Ministritë të cilat u shpikën e disa prej tyre gati sa janë fantome nuk po kontribuojnë fare në zhvillimin ekonomik. Buxheti i tyre është simbolik, sepse ato nuk janë krijuar për të zhvilluar sektorin privat, por janë krijuar për të rehatuar militantët politikë.

Buxheti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është 11 milionë. Është i njëjti sa ka qenë vitin e kaluar, vetëm se është klauzola e investimeve që ia shton buxhetin 2 milionë, e ky është projekt me Bankën Botërore që është kryer mandatin e kaluar. Në fakt, veç duhet të fillojë tani.

Buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është 40 milionë, buxheti i Ministrisë së Inovacioni dhe Ndërmarrësisë është 12 milionë, buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është 6 milionë. Të katër këto ministri kapin shumën e total buxhetit prej jo më shumë se 70 milionë, ndërkohë që unë thashë ne marrim shumë, mbi 1.1 miliard taksa prej bizneseve dhe u japim atyre shumë më pak, 70 milionë, sepse pjesa më e madhe e buxhetit në këto ministri shkon në paga dhe mëditje.

Ky buxhet, lëre që është i vogël, por lë shumë për të dëshiruar edhe në shpërndarjen e tij. P.sh. te Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, i vetmi institucion i drejtpërdrejtë kontribuon në zhvillimin e sektorit privat është KIESA. KIESA ngel me buxhet të ulët, me kapacitete të limituara dhe në fakt kësaj agjencie i janë marrë edhe kompetencat, siç është ajo e implementimit të Ligjit për investime strategjike, kompetenca këto të cilat jashtëligjshëm u kaluan te Ministria e Diasporës, edhe sot e kësaj dite asnjë investitor nuk arriti të kualifikohet si investitor strategjik.

Te Ministria e Zhvillimit Rajonal, askush përgjatë këtyre 12 muajve nuk ka mundur të shohë një definicion. E kemi thirrur ministrin në Komision, ka treguar që ai me sekretarin dhe disa kolegë të tij i kanë bërë kriteret për t'i shpërndarë subvencionet. Askush nuk e di ku janë shpërndarë këto subvencione. Në fakt, subvencione kanë shumë ministri të kësaj qeverie, por nuk ka kurrfarë koordinimi dhe nuk ka kurrfarë targeti se cilët sektorë të ndihmohen dhe këto subvencione nuk e kanë as edhe një lidhje më të vogël me ndonjë dokument strategjik apo me ndonjë reformë e cila drejtpërdrejt kishte për të ndikuar në zhvillimin e sektorit privat.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik me buxhetin prej 40 milionëve, ne e dimë se sa ka kontribuar kjo ministri historikisht në zhvillimin e sektorit privat. Në fakt, kjo është një ministri që merret me subvencionimin e ndërmarrjeve publike të cilat janë mbushur me militantë partiakë e janë pajisur me menaxhmente e borde të padijshme dhe komplet partiake. Në buxhetin e kësaj ministri nuk ka asnjë fond të ndarë e rrjedhimisht nuk ka as strategji sesi të shpëtohet Telekom i Kosovës nga falimentimi. Të dhënat tanimë janë publike, Telekom i është pesë muaj para falimentimit të saj. E ne të gjithë e dimë lidhjen e Telekomit me Postën e Kosovës, sepse Posta mbahet nga qiratë që i paguan Telekom i Kosovës. As këtu nuk ka ndonjë strategji.

U përmend këtu që sektori i minierave është lënë komplet anash dhe për më tepër nuk është planifikuar asnjë buxhet për hapjen e minierës së re e cila do t'i shërbente projektit të ri të

energjisë. Sot energjia elektrike, furnizimi dhe çmimi i shtrenjtë i energjisë elektrike është në top-barrierat e zhvillimit të sektorit privat. Dhe çka ka bërë Ministria, e ka nënshkruar një kontratë dhe si duket i ka hasur tërë sharra në gozhdë dhe nuk po mund të lëvizë asnjë hap tutje.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, si të gjitha këto, edhe kjo ministri nuk kemi parë që ka bërë diçka tjetër, përpos që në takime të ndryshme ka mbledhur militantë partiakë dhe ju ka thënë që përgatitni plane të biznesit, sepse unë do t'ju jap para për t'i zhvilluar këto ide. Brenda kësaj ministrie kemi një shumë prej 355 mijë euro për pajisje të shkollave me pajisje të teknologjisë infomative. Është tepër interesant, sepse ky buxhet është dashur të jetë në Ministrinë e Arsimit dhe jo në Ministrinë e Inovacionit. Çfarë pajisjesh po planifikuaka kjo ministri të çojë nëpër shkollat e Kosovës me këtë shumë kaq të vogël, 355 mijë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Më fal, zonja Mjaku! Ministri Lekaj e ka fjalën.

**MINISTRI PAL LEKAJ:** E nderuar deputete, ish-ministre!

Kam respekt për juve, por për korrektësi ndaj deputetëve dhe qytetarëve ju them që prej fillimit të seancës kam qëndruar në Parlament. Në pauzë ndoshta nuk kam mundur të qëndrojë. Ndoshta, me siguri, për kolegët thatë, jo për mua. Prandaj, edhe kjo është diçka që me të vërtetë nuk di kur do të pajtoheni apo kur do të jeni të saktë në prononcimet e juaja. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Mjaku e ka fjalën.

**MEXHIDE MJAKU-TOPALLI:** Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si kryetare e Grupit të Grave Deputete, po flas në emër të Grupit të Grave Deputete. Bordi i Grupit të grave deputete ka mbajtur një takim dhe ka diskutuar për Projektbuxhetin e vitit 2019 dhe ka dalë me një përfundim, se: megjithëse Kosova është republikë demokratike ku të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë, në shoqërinë tonë kemi pabarazi të mëdha sa i përket qasjes në burime financiare në mes të burrave dhe grave. Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, gratë në politikë nuk mbështeten nga partitë e tyre dhe nuk u jepet e njëjta hapësirë krahasuar me burrat. Gjithashtu gratë diskriminohen në tregun e punës, në Gjyqësor dhe në Polici.

Buxheti i Kosovës është një nga instrumentet më të rëndësishme shtetërore me anë të të cilit adresohen problemet ekonomike, sociale, arsimore dhe kulturore. Kontribuues në buxhetin e Kosovës janë të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh gjininë, moshën apo etninë. Si i tillë, buxheti duhet t'i adresojë problemet e të gjitha shtresave shoqërore në Kosovë. Fatkeqësisht, megjithëse buxheti i Kosovës është një instrument i cili do të mund të adresonte shumë probleme gjinore në Kosovë, për arsyt e cekura më poshtë konsiderojmë se ky buxhet

nuk i adreson as për së afërmi pabarazitë gjinore në Kosovë. Megjithëse Ligji për barazi gjinore kërkon që perspektiva gjinore të futet në çdo fazë të procesit të planifikimit, të miratimit, të zbatimit dhe të vlerësimit të legjislacionit, në dokumentet e procesit të hartimit të buxhetit, nuk është bërë asnjë vlerësim i ndikimit gjinor. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 nuk paraqet një vlerësim të ndikimit gjinor. Madje termi gjinor përmendet vetëm tri herë në një dokument prej 73 faqesh.

Në Qarkoren e Buxhetit për Projektbuxhetin e vitit 2019, Ministria e Financave ka kërkuar që të respektohet Ligji për barazi gjinore, duke kërkuar nga organizatat buxhetore, përfshirjen e buxhetimit gjinor, si mënyrë për të bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore, mirëpo fatkeqësisht në asnjërën nga dokumentet e hartimit të Projektbuxhetit madje edhe në vetë draft-ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës 2019 nuk e shohim një vlerësim të tillë. Vetëm 12 nga 38 apo më pak se një e treta e komunave e kanë paraqitur buxhetin e ndarë për çështjet gjinore. Krahasuar me vitin e kaluar, buxheti për çështje gjinore në komuna ka rënë për 4 për qind.

Në Kosovë, vetëm 12 për qind e grave në Kosovë janë të punësuara, krahasuar me 45 për qind të burrave. Të dhënat tregojnë se gratë nuk kanë mungesë të aftësive sepse më shumë gra punëkërkuese kanë të përfunduar studimet bazë krahasuar me burrat, mirëpo struktura aktuale e ekonomisë së Kosovës, duket se nuk e përkrah punësimin e gruas. Një ndër arsye për këtë është edhe buxheti i Kosovës, i cili vazhdon të investohet në sektorë të cilët nuk gjenerojnë vende pune për gra, përdherisa 98 për qind e të punësuarve në ndërtimtari janë burra dhe vetëm dy për qind janë gra.

Gati gjysma e investimeve kapitale 44 për qind të këtij projektbuxheti janë planifikuar të shpenzohen në infrastrukturë rrugore. Ngjashëm sikur me investimet kapitale, edhe kategoria e subvencioneve do të shpenzohet në sektorë të dominuar nga burrat. Rreth 94 për qind e të punësuarve në shëndetësi janë burra, krahasuar me vetëm 6 për qind gra. Ndërsa të paktën 50 milionë euro subvencione do të shpenzohen nga buxheti i shtetit për këtë sektor.

Kjo strukturë e shpenzimeve të Buxhetit të Kosovës vetëm sa do të vazhdojë të thellojë papunësinë te gratë. Përveç mënyrës indirekte të krijimit të pabarazisë gjinore përmes investimeve kapitale, gratë dhe burrat përfitojnë në mënyrë joproporcionale nga pagat në buxhetin e Kosovës. 59 për qind e shërbyesve civilë në ministri janë burra, krahasuar me 41 për qind gra, ndërsa në nivel lokal ky dallim është edhe më i theksuar me 68 për qind të të punësuarve burra, krahasuar me vetëm 32 për qind gra. Pabarazia është edhe më e lartë nëse e shikojmë ndarjen gjinore në pozita drejtuese, me vetëm 28 për qind të grave krahasuar me 72 për qind burra.

Nëse i shikojmë statistikat për përfaqësimin e grave në nivele të larta drejtuese në shërbimin civil në nivel qendror, situata është edhe më alarmante. Nga 74 pozita të tilla, vetëm katër prej tyre janë gra, apo një grua për çdo nëntëmbëdhjetë burra.

Një mënyrë tjetër direkte e diskriminimit të grave përmes buxhetit është ndarja e benifiteve sociale. Përfituesit më të mëdhenj të benefiteve sociale, të cilat jepen për familjet me të paktën një fëmijë nën moshën 5-vjeçare janë pikërisht burrat 92 për qind, krahasuar me tetë për qind gra.

Analizat e shoqërisë civile në Kosovë kanë treguar se në rast që buxheti familjar menaxhohet nga gratë, atëherë gratë janë më të prira të shpenzojnë në shëndetësi apo ushqim të shëndetshëm për familjen. Kjo sugjeron se një fuqizim ekonomik i gruas në Kosovë dhe dhënia e një vëmendjeje më të madhe për fuqizimin e gruas përmes buxhetit do të rezultonte në një shoqëri më të shëndetshme në përgjithësi.

Kolegë të nderuar, ju lus për qetësi!

Prandaj sot po e diskutojmë Projektbuxhetin e vitit 2019, me qëllim që ky ligj i rëndësishëm të adresojë çështjet e pabarazive gjinore, Grupi i grave deputete rekomandojmë:

Të gjitha organizatat buxhetore dhe qendrore duhet të respektojnë obligimin që del nga Ligji për barazi gjinore për dhënien e sqarimeve sa i përket ndikimit buxhetor gjinor. Ministria e Financave duhet t'i mbledhë të gjitha këto dokumente dhe t'ia bashkëngjijë Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës në formë të aneksit. Agjencia për Barazi Gjinore duhet të kujdeset që çdo vit të mbledhë dhe të publikojë statistika në baza gjinore sa i përket përfituesve nga buxheti i Republikës së Kosovës. Të gjitha komunat duhet që ta publikojnë qartë në Projektbuxhet shumë e ndarë për çështjet gjinore. Ministrinë të mbledhin statistika gjinore lidhur me ndikimin në punësim të projekteve kapitale.

Dhe, në fund, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet që në mënyrë urgjente të reformojë mënyrën e dhënies së ndihmave sociale për përkujdesjen e fëmijëve, duke marrë parasysh se nënat në Kosovë kujdesen pothuajse në mënyrë ekskluzive për fëmijët, atëherë ndihmat sociale duhet të alokohen në masë të madhe te gratë përfituese të skemave sociale. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Fatmire Kollçaku e ka fjalën. Le të përgatitet Salih Salihu.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!

U tha këtu se ky buxhet nuk është buxhet zhvillimor, por është buxhet social. Por, megjithatë edhe ministri kur e mori fjalën tha që nga presioni i ju deputetëve, në njëfarë kuptimi që po bëni ligje popullsia. Unë besoj që këtu nuk i merr parasysh Ministria e Financave, ato propozime që

vijnë nga opozita, por po besoj që projeksionet e juaja buxhetore janë të Qeverisë suaj, programit, qoftë atij elektoral qoftë atij pastaj, prandaj unë besoj që nuk qëndroj, dhe unë besoj që ju nuk duhet t'i nënshtroheni presioneve, po mendoj të kuptimit të blerjes së paqes sociale, por që të jeni konstruktivë dhe kudo që janë kërkesat e paarsyeshme mos t'iu përgjigjeni atyre kërkesave. Prandaj, këtu kisha thënë prapë që nuk është social në kuptimin që e përmirëson situatën pikërisht të atyre qytetarëve që janë më në nevojë. Ju e dini që Republika e Kosovës është një shtet me rini, ku mbi 70 për qind e popullatës janë nën moshën 35-vjeçare, mirëpo fokusi i debateve në këtë shoqëri tash është te pensionet. Pse po ndodh kjo? Që të gjitha kategoritë, duke mos e pasur një perspektivë të qartë punësimi.

Ne folëm këtu sa është punësimi dhe sa po ndahen mjetet për punësim dhe tash qytetarët po shohin ku të rehatohen, në cilën skemë ta gjejnë veten, apo të futen edhe në dy-tri skema, sepse trendi është i tillë. Njëzet vjet ka shkuar mbrapshtë çdo gjë dhe ju e keni trashëguar një gjendje, por nuk mund të thoni se nuk jemi fajtor se shumë qeveri kanë qenë edhe nga subjekti juaj prej të cilit vini dhe kjo situatë e trashëguar është që tashmë në pamundësi të gjetjes së një vendi të punës, keni presion të madh nga individë dhe grupe që të rehatohen në skema. Kështu që ju thatë, janë edhe skema të tjera. Fatmirësisht që në këto skema ka edhe njerëz që do të përfitojnë me të drejtë. Është skema e re e grave, do të thotë viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, që padrejtësisht për 20 vjet nuk kanë përfituar. Është e qartë, por nuk është kërkesa e tyre që të bëhen pensioniste, por me siguri të kenë përparësi në punësim, të kenë përparësi gjatë marrjes së kredive, gjatë hapjes së bizneseve. Këto gra apo edhe burra që kanë qenë viktimë të dhunës seksuale, është shumë më mirë të përkrahen në forma të tjera, përveç kësaj shumë që një njëfarë forme kurrë nuk mund t'iu kompensojë ato çka kanë vuajtur.

U tha shumë këtu për dy sektorë për të cilat unë preferoj sot të flas, për shëndetësi dhe për Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie. Ashtu siç u tha, unë mendoj që shumë më mirë është të ndahet Ministria për Punë dhe Ministria për Mirëqenie, se faktikisht ne tanimë po veç po flasim për çështjen e skemave dhe nuk po flasim fare për punësim, sepse vetëm dy për qind nga buxheti total i është ndarë Ministrisë për çështje të punësimit. Prandaj, ndoshta sikur ta ndanim do të mendonim që më shumë mjete të ndahen për çështje të punësimit.

Po ashtu, unë e prek edhe një çështje kur thashë që nuk bëhet zgjidhja e shtresave të varfra. Ju e dini ministër që skema apo mbrojtja sociale, familjet që përfitojnë fonde, kur t'iu mbush fëmija moshën 5-vjeçare largohen nga përfitimi. Fatkeqësisht këtu bëjnë pikërisht ajo pjesa e popullatës më vulnerable apo mos të them më e prekur. Dhe kjo pse po ndodh? Me pretekst që kur fëmija i mbush 5 vjet, një prind e ka mundësinë që të jenë aktiv në tregun e punës, në kuptimin e kërkimit të punës, por ende pa u bindur që së paku njëri prind e ka siguruar punën, pikërisht ajo familje largohet. Do të thotë nuk përcillet situata qysh po rrjedh me këtë familje. Dhe, kjo është një padrejtësi që po përcillet vit pas viti. Prandaj, siç e thatë edhe vetë, që ne kemi obligim që të rishikojmë përfituesit e të gjitha skemave dhe njerëzit që padrejtësisht përfitojnë t'i largojmë dhe

mos të ndodhë ajo të gjithëve nga pak e askujt asgjë. Se në fakt, duke e shpërndarë ndihmën në këtë formë, nuk ia përmirësojmë jetën askujt. Duke i hequr ata që padrejtësisht përfitojnë, duke i larguar nga këto lista, mendoj së paku ta korrigjojmë këtë padrejtësi, që këto familje që po i lihen fatit, këta fëmijë kur ju rriten nevojat po ndodh që po i ndërpritet ndihma. Kemi shtëpi për përkujdesje të moshuarve, dy, një është në Prishtinë, një është në Gurrakoc.

Kisha pasur dëshirë që ju, ministër, t'i vizitoni, ta shikoni qysh është gjendja e 62 të moshuarve në Prishtinë këtu, që në fakt aty udhëheqësja e asaj qendre thotë që u mjafton tri herë në javë të kenë ujë të nxehtë, del dhe e thotë para mediave. A mjafton për një të moshuar që të ketë tri herë në javë ujë të nxehtë? Kjo është për keqardhje! Ne kemi obligim, ashtu siç mendojmë për mirëqenien e fëmijëve, të mendojmë edhe për mirëqenien e gjeneratës të tretë, sepse edhe këtu shumëkush shpejt del në pension, është i moshuar, mirë është të mendojë edhe për këtë kategori. Do të thotë, sepse ata nuk dinë ose së paku nuk kanë mundësi të dëgjohet zëri i tyre dhe ne e kemi këtë obligim.

Sa i përket çështjes tjetër që dua ta theksoj është shëndetësia. Ne e dimë që ka shumë prioritete, ka rritje të buxhetit dhe kjo është për t'u përshëndetur. Është e qartë që për momentin është duke u bërë revidimi i listës esenciale, ne jemi të interesuar që sa më shumë barna të përfshihen në listën esenciale, por ato që vërtet janë prioritete dhe nevojat më të mëdha të qytetarëve. Mirëpo, mendoj që edhe kjo ndarje që është bërë nuk do ta përmirësojë dukshëm situatën, sepse ju e dini që tash dy çështje më të përfolura në Republikën e Kosovës tash e 10 vjet janë: liberalizimi i vizave dhe Ligji për sigurim shëndetësor. Fatkeqësisht ligji është miratuar këtu, por nuk po zbatohet, ne ende nuk e kemi qoftë edhe një cent në Fondin e sigurimeve shëndetësore dhe është e qartë që zbatimi i mirëfilltë i Ligjit për sigurime së paku pesë vjet, të mos them edhe dhjetë vjet nuk do të kemi një zbatim të mirëfilltë dhe pa u mbush ai fond ende ngarkohet Buxheti i Republikës së Kosovës. Edhe ministri këtu tha që në 5-6 mujorin e parë do të kemi rimbursim të barnave, do të thotë do të kemi barna jashtë spitaleve, besoj në qendrat kryesore të mjekësisë familjare, ku njerëzit do të mund të marrin disa prej ilaçeve që janë prioritare sa u përket sëmundjeve kronike kryesisht.

Unë do të fokusohem sidomos në Klinikën e Onkologjisë. Besoj edhe ju, ministër, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës e dinë që rritja e numrit të njerëzve të sëmundjet malinje ka një trend të shtuar të këtyre pacientëve, sa që është vështirë edhe të menaxhohen këto raste. Ne e cekëm këtu si komision, kemi bërë vizitë, kemi bërë tryeza dhe është një kërkesë urgjente që besoj edhe ju, por edhe të gjithë deputetët e Republikës së Kosovës duhet të mendojmë mirë, ta mbështesim Klinikën e Onkologjisë, përkundër faktit që ka pasur aty risi, sepse është futur 24 orë kujdestari, ku ka 600% shfrytëzueshmëri të shtretërve, përderisa ka reparte në SHSKUK në Qendrën Klinike Universitare që nuk shfrytëzohen. Prandaj, nevoja urgjente është për një repart të ri për kimioterapi. Vetëm një ditë ju ftoj, ndoshta keni qenë, por ta vizitoni këtë klinikë dhe ta shikoni në dy dhoma, ku pacientët marrin poshtë në katin e parë kimioterapi dhe lart janë një

dhomë për burra, një dhomë për gra, ku marrin ata që kryesisht i nënshtrohen radioterapisë dhe shtrihen aty, sepse nuk kanë kushte të udhëtojnë, është plotësisht e pamjaftueshme, Është një kërkesë e cila thuhet se është paraparë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, por nuk është futur në buxhetin për vitin tjetër.

Do të thotë, nën një, reparti i ri për kimioterapi, i cili brenda kapaciteteve ekzistuese mund të bëhet diçka në QKU, mirëpo edhe aparatet për radioterapi. Ministër, njëri prej aparateve vazhdimisht prishet, është i vjetër 15 vjet, tjetri 10 vjet. Dijeni që një pacient që i nënshtrohet radioterapisë nuk ka kohë të presë derisa të servisohej një aparat. Po ashtu, një aparat i ri në momentin nëse sot blihet, nevojiten 9 muaj që të instalohet dhe të mos presim që të vjen situata urgjente ku do të duhej të gjejmë zgjidhje ku t'i dërgojmë pacientët që duhet t'i nënshtrohen radioterapisë. Këto unë besoj që ne si Komision për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie do ta amendamentojmë do të thotë, do ta parashtrojmë një amendament dhe unë besoj që dhe deputetët këtu të gjithë do ta përkrahin, por besoj edhe ju si ministër brenda atyre mundësive që keni të ndërhyri, ishte dashur ta shihni si prioritet, sepse pothuajse nuk ka familje në shtet që nuk është prekur. Nëse jo në familjen e ngushtë, besoj në familjen e gjerë. Dhe, ju e dini, përderisa kryesisht buxhetin në asfalt e çojmë, e kemi ministrin tjetër këtu, unë besoj që ju duhet ta shihni këtë si prioritet.

Është folur që 20% të buxhetit të shëndetësisë shkon për grante komunale, 41% për Qendrën Klinike Universitare, diku 30% për ministrinë dhe duke e ditur që mjekësia familjare synojmë t'i trajtojmë 80%...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Salih Salihu.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbase disa aspekte të përgjithshme të projektbuxhetit u diskutua nga shumë kolegë, veçanërisht nga Dardan Sejdiu, i cili e elaboroi shumë mirë, shumë qartë projektbuxhetin, i cili u pa se nuk është një projektbuxhet që garanton një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, porse veçse është një përsëritje e buxhetit të vitit 2018, kështu nga aspekti i ndarjes strukturore nëpër sektorë.

Unë sot do të kisha diskutuar pak për buxhetin për bujqësi. Shihet qartë që edhe këtë vit, si në vitin 2018 buxheti për bujqësi ka pak a shumë trend të ndarjes nëpër sektorë ngjashëm si më parë, megjithëse ka një lëvizje shumë të vogël prej 1.4 milion euro nga viti paraprak, por buxheti për bujqësi në përqindje është 2,6% nga buxheti i tërësishëm sa ka Kosova. Pra, nëse e shikojmë



në përqindje dhe e krahasojmë me vitin 2015, del se në vitin 2015 buxheti për bujqësi në raport me buxhetin e përgjithshëm ka qenë 3,6%, ndërkaq tash e kemi 2,6%. Pra, është një ulje në raport me trendin e rritjes së buxhetit të përgjithshëm në sektorin e bujqësisë. Ndërkaq, ky buxhet prej 61,4 milionë, e që pjesa kryesore shkon për grante dhe subvencione, pra për pagesa direkte, është ende i vogël në raport me buxhetin që e kanë vendet fqinjë. Pra, me këtë buxhet fermerin e Kosovës ne nuk mund ta vëmë në pozitë të barabartë me fermerët e vendeve fqinjë. Për shembull, Maqedonia ka buxhet për bujqësi mbi 113 milionë euro, ndërkaq Kosova po shihet se i ka diku rreth 50 milionë euro që shkojnë direkt për fermerin. Në anën tjetër e kemi të nënshkruar CEFTA-ën dhe me CEFT kuptohet tregti të lirë, Maqedonia mbase të gjitha imputet i ka të vetat, naftën, farën, plehun, preparatet kimike, ndërkaq fermeri i Kosovës të gjitha këto impute duhet t'i blejë, është i pakonkurrueshëm në treg me fermerët në regjion.

Unë mendoj se Qeveria do të duhej të mendojë pak më ndryshe sa i përket zhvillimit ekonomik, mbase sektori i bujqësisë është një sektor i rëndësishëm dhe që jep një kontribut në ekonominë e gjithmbarshme, 60% e popullatës është rurale, do të duhej që në vend të infrastrukturës apo paralel me infrastrukturën të ndahen më tepër mjete në Ministrinë e Bujqësisë dhe më tepër mjete t'i dedikohet sistemeve të ujitjes për ta rritur prodhimin vendor, më tepër mjete t'i dedikohen ndërtimit të kapaciteteve përpunuese, fabrikave, depove për ruajtjen e produkteve bujqësore, si dhe frigoriferët për ngrirje të produkteve bujqësore dhe pikave të grumbullimit. Kështu qysh është ky buxhet, nëse e analizoni, për shembull për skemat sociale ndahen 465 milionë euro, ndërsa për bujqësi, i cili sektor gati prodhon 1 miliard euro, sepse 1 miliard euro janë konsum për ushqim. Në vend që ne këtë konsumin që e kemi 1 miliard euro, që shumica prej tyre importohen, të investojmë më tepër dhe ta ndalim këtë 1-miliardësh brenda Kosovës, ne këtu investojmë vetëm 50 milionë euro, ndërkaq japim para kesh për skema sociale. Unë nuk jam ekonomist, por a më mirë do të ishte që ne me këto mjete ta ndërtojmë ose ta krijojmë një fond zhvillimor, i cili do të jepte kredi të buta për fermerë dhe për çdo vit së paku 20 milionë euro t'i ndajë, le të bëhen rreth 20 fabrika që do ta përpunonin produktin bujqësor dhe ta zhvillojnë industrinë ushqimore. Dhe, për 5 vjet nga 20 fabrika nga 20 milionë, bëjnë 100 milionë euro, ne do të kemi 100 fabrika. Dhe, i nderuar ministër, sikur Kosova t'i ketë sot 100 fabrika, kjo do t'i bie që çdo komunë do t'i ketë 3-4 fabrika dhe 100 fabrika sigurisht me 100 milionë ndërtohen, sepse nuk ka fabrikë që do më shumë mjete se 1 milion. Dhe, në një fabrikë 20 punëtorë mund të jenë të punësuar direkt në proces të punës, dhe do të jenë 200 deri 300 fermerë që e bien prodhimin në fabrikë.

Pra, me 100 milionë euro ne do të mund t'i punësojmë 3 mijë punëtorë direkt në proces të punës dhe 30 mijë punëtorë si fermerë që mund t'ia sjellin produktin kësaj fabrike dhe çka do të ndodh me këtë, do të punësohen 33 mijë vetë, të cilët do ta kenë një vend të qëndrueshëm deri në pension, do ta zëvendësojnë importin e produkteve ushqimore dhe do të krijojmë një stabilitet ekonomik, sepse ato prodhime vendore që krijohen nuk lejojnë që të na rrjedhë paraja jashtë vendit.

Dhe, në anën tjetër, në qoftë se e analizoni nëse të punësohen 33 mijë punëtorë, secili prej tyre paguan tatim në pagë dhe çdo punëtor vjetor, nëse rroga mesatare vjetore është 500 euro, ai punëtor paguan së paku 500 euro në vit, që i bie që 33 mijë punëtorë ka 500 euro në vit bëjnë 16 milionë e 500 mijë euro në vit dhe 5 vjet nga 16 milionë bëjnë diku rreth 82 milionë e 500 mijë, që për pesë vjet gati se komplet investimi që e keni ndarë për Fondin zhvillimor i kthehet përsëri buxhetit dhe kështu mendoj e ndalim importin dhe këtë 1-miliardësh e ndalim brenda Kosovës. Unë mendoj që veç të imagjinohej qysh do të dukej ekonomia e vendit tonë pas pesë vjetëve në qoftë se 1 miliard euro futet në tregun e Kosovës. Kjo do të ndikonte në ngritjen e përgjithshme të mirëqenies të qytetarëve të Kosovës dhe mendoj që nuk është vështirë për t'u bërë, por duhet pasur vullnetin dhe duhet secili sektor seriozisht ta mirëkuptojë njëri-tjetrin dhe të vendoset bërja e kësaj.

Unë do të kisha diskutuar për komunën e Vitisë. Komuna e Vitisë është e vetmja komunë që 20 vjet nuk ka asnjë projekt kapital. Komuna e Vitisë është ndarë, është copëtuar, iu ka ndarë Komuna e Klllokotit dhe të gjitha ato ndërmarrje industriale që i ka pasur, kanë mbetur në Komunë të Klllokotit. Komuna e Vitisë nuk ka dalje kah Maqedonia përmes fshatit Debëllde, komuna e Vitisë nuk ka dalje kah fshati Letnicë për Kumanovë, Komuna e Vitisë nuk ka asnjë fabrikë, asnjë depo e asnjë pikë grumbullimi, nuk ka as kyçje në Gërlicë, në pikën më të afërt në autostradën “Arbër Xhaferi”, prandaj këtu në këtë rast kisha pasur dëshirë ta pyes ministrin Lekaj, ministrin e Infrastrukturës, si qëndron puna me kyçjen e Vitisë në autostradë? A duhet të kërkojmë buxhet tash, apo keni planifikuar që nga buxheti që është paraparë për autostradë me “Bechtel&Enkën” që e keni kontratën të ndani mjete nga ai 10%? Nëse duhet, zoti ministër, të ndajmë buxhet, tregoni ta bëjmë si amendament ta kërkojmë te ministri Hamza dhe të keni domethënë buxhetin për kyçjen e Vitisë në Gërlicë.

Komuna e Vitisë i ka 8 mijë automjete, të cilët paguajnë tatim, taksën rrugore dhe qytetarët e Vitisë sot duhet të shkojnë mbrapa në Doganaj dhe aty 11 km të kthehen dhe të vijnë përsëri në Prishtinë. Pra, kyçja në Gërlicë, jo për qytetarët e Vitisë, por edhe për qytetarët e Gjilanit, Kamenicës, por edhe të Ferizaj, sepse fshati Gërlicë është në Ferizaj, do t'u mundësonte edhe gjysmës së komunës së Ferizajt, edhe komunës së Vitisë kyçje më të lehtë në autostradë dhe kjo do ta ndihmonte zhvillimin ekonomik të Vitisë, sepse përndryshe, ne kemi mbetur të izoluar dhe po të mos ishin mërgimtarët e komunës së Vitisë, Vitia nuk kishte mundur të ekzistojë, falë parasë që i dërgojnë mërgimtarët funksionon konsumi në Viti, domethënë ushqimi, tregtia me ushqim edhe funksionon sektori i ndërtimit. Përndryshe, Vitia do të kapitullojë.

Prandaj, zoti ministër, kisha pasur dëshirë një përgjigje nga ju, si qëndron puna me çështjen e kyçjes së Vitisë në autostradë në fshatin Gërlicë në autostradën “Arbër Xhaferi”? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Pal Lekaj e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet Salihu!

Keni plotësisht të drejtë që shfaqni shqetësimin tuaj sa i përket kyçjes në Gërlicë, ne vetëm kemi marrë vendim në Komitetin ndërmintor për kyçje në autostradën “Arbër Xhaferi” dhe unë mendoj që ne sa i përket buxhetit për autostradën në 10%-shin do të përfshihet edhe kyçja në Gërlicë, edhe një kyçje në Ferizaj.

Mendoj që ne jemi duke i projektuar këto dy kyçje dhe pasi të jetë projekti i gatshëm, do të fillojmë punën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani do t’ia jap fjalën edhe deputetes Emilija Rexhepi, ajo do të jetë e fundit për sonte. Ndërsa, pas saj do të vazhdojmë punën nesër në orën 11:00. Emilija Rexhepi e ka fjalën!

EMILIJA REDŽEPI: Hvala, potpredsedniče Parlamenta!

Poštovani ministri,

Poštovani poslanici,

Poštovani građani,

S obzirom da nam je na dnevnom redu danas prvo čitanje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosovo za 2019. godinu, i kao poslanik u trećem sazivu ovog Parlamenta mogu sa pravom reći da je za svaku pohvalu zato što u odnosu na budžet 2018. godine ima finansijski rast i ta će se sredstva prema strategiji Vlade usmeriti u obrazovnom sistemu, zdravstvenom sistemu, socio-ekonomskoj sferi, kao i sferi pravosuđa što jeste prioritet celokupnog kosovskog društva, i svi se sa tim trebamo složiti radi boljeg prosperiteta i bolje budućnosti svih građana.

Gospodu, u potpunosti podržavam sve moje kolege iz redova ostalih zajednica smatrajući da Vlada, odnosno određena ministarstva trebaju menjati svoju strategiju oko manjinskih zajednica da ne bi tražili uvek neke odvojene kodove za finansiranje naših zahteva koji dolaze od naših građana, kojih mi ovde zastupamo.

Ali moje iskustvo u ovom Parlamentu mi je dokazalo da bez tih odvojenih posebnih kodova za nas mi nemožemo ništa veliko postići, nego ćemo se zadovoljavati sa sitnim infrastrukturnih projektima, koje naši delegati ubacuju opštinskim budžetima na lokalnu, i taj je budžet usvojen i on će se ovde glasati.

Katastrofalno stanje je u Ministarstvu za zajednice i povratak, gde se svake godine vrši raspodela državnog novca samo za određenu grupaciju ljudi. Niko ne snosi odgovornost, niti se ta sredstva kontrolišu.

Isto takvo stanje je u Ministarstvu za ambijent i prostorno planiranje, gde pripadnici drugih naroda ne mogu doći do bilo kakvih investicija za svoj narod.

A s obzirom da ja lično dolazim iz opštine Prizren, gde se i nalazi nacionalnih park Šar, nema strategije za očuvanje prirodnih resursa, razvoja seoskog turizma, a pre svega razvoja planinskog turizma, kao prioritet.

Takođe, zahtevam od premijera Vlade i ministra Financija da hitno preispitaju Ministarstvu poljoprivrede gde putem grantova za 2018. godinu niko nije podržan od strane nealbanskog i nesrpskog naroda, a svi dobro znamo da veliki broj naših ljudi po ruralnim mestima živi od stočarstva, odnosno raznih poljoprivrednih grana, pa se ja lično pitam da li je moguće da niko od njih nije ispunio osnovne kriterijume konkursa, ili mi gospodo nismo ravnopravni narod?

Veton Beriša, moj kolega koji dolazi iz redova Egipćanske zajednice, je u potpunosti sve dobro objasnio, i ne želim ništa drugo da kažem, osim da podržavam svaku tačku koju je on danas spomenuo.

Takođe moje kolega Fikrim Damka govorio je o problemu Ministarstva obrazovanja i o problemu udžbenika na Bosanskom i Turskom jeziku.

Gospodo poslanici,

Predstavnici Vlade,

Da li je moguće da skoro 20 godine taj problem postoji, a nijedan ministar ne želi rešiti svesno ili nesvesno, namerno ili nenamerno.

Taj problem prevoda udžbenika i dalje je aktuelan, a sada će biti još više intenzivni zato što ministar obrazovanja želi da ugasi Direktorijat za manjinske zajednice u MONT-u, sigurno tri radnika, tri pripadnika manjinskih zajednica smetaju. Naravno da mi to nećemo da dozvolimo.

Takođe, gospodo, danas ovde u sali čujem glas poslanika 6+ Grupe, gospodina Danuš Ademi, moju koleginicu Hikmetnu Bajrami, i druge kolege koji govore o neradu ministra Rasima Demirija, ministar za Regionalni razvoj, koji dolazi ispred Parlamentarne grupe 6+, koji je uzurpirao Ministarstvo za svoje lične i partijske interese, ja o tome neću da govorim s obzirom da sam bošnjakinja i da me je sramota, ali vi pogledajte samo njegovu Facebook stranicu, i sami ćete videti što on to radi, i čime se bavi.

Tako da premijer Vlade, a pre svega unutrašnji, odnosno državni revizor treba preispitati način tenderisanje projekata, grantova i subvencija državnog novca.

Ako smatrate gospodo da to je to partijsko usko grupno ministarstvo, onda neka tako ostane.

Ali ja vas molim sve ovde kolege poslanike, nemojte da kroz prizmu Rasima Demiri gledate bošnjački narod. On je samo predsednik jedne male partije DSB, koja je članica koalicije Vakaf.

Mi poslanici koji predstavljamo Bošnjake, Turke, Gorance, Aškalije, Egipćane i rome moramo svi zajedno biti jedinstveni i solidarni po pitanju Ministarstva za trgovinu i industriju i Ministarstva za inovacije, zato što samo preko tih resursa imamo šansu da zaposlimo naše ljude, a do sada nismo u tome uspjeli.

A to su važna ulaganja za otvaranje fabrika, za razvoj proizvodnje, razne inovacione centre, koje prate moderno društvo. Tu vidim uključenje mladih ljudi, stručnih u različitim oblastima.

Ja lično podnela sam amandmane Komisiji za budžet i financije, i odnosi se na malo veće infrastrukturne projekte u svim mestima gde žive Bošnjaci u Prizrenu, Peći, Istoku, Dragašu, Leposaviću, ali i da se zahvalim ministru Financija, ministru Infrastrukture, ministru Kulture, omladine i sporta, a naravno našem premijeru Vlade što sam naišla na razumevanje oko ovih prioritetnih projekata za Bošnjačku nacionalnu zajednicu, a odnose se na vodovodnu i kanalizacionu mrežu, sportske stadione i kulturne sale, nastavak ulice po selima, podrška završnici Bošnjačkog kulturnog centra u Prizrenu, izgradnja stambenih kuća za socijalne slučajeve, ali i povratnike, i otvaranjem inkubatora ili zadruga za naše poljoprivrednike, kako bi lakše plasirali svoju robu na tržište.

Posebno nastavljam na podršci koji smo dobili od strane Vlade, odnosno ministra za Infrastrukturu na sanacije velike erozije zemljište u Nebregoštu, gde čekamo skoro godinu dana na realizaciju tog projekta, ali ministru Financije što je odobrio, takođe u saradnji za ministrom Infrastrukture, da napokon krenemo realizaciju regionalnog puta Prizren-Rečane-Prevalac, a takođe prioritetan put je bio Žur-Dragaš, što vam se zahvaljujem što ste ubacili u budžetu, ali takođe ministre za Infrastrukturu nadam se da ćete nam odobriti još malo veća sredstva da popločamo, odnosno asfaltiramo ulice koje su sad aktualne u opštini Peć, odnosi se na Vitimiricu, 20 godina niko nije uložio ništa u tom delu, ali takođe ostale su nam i u opštini Istok 4 do 5 ulica, imamo od vas odobrenje, nadam se da ćemo u narodnoj godini i to realizovati.

U svakom slučaju, moja zahvalnost u ime Bošnjake zajednice za budžet za 2019. godinu ide premijeru Vlade, ministru Financije, ministru Infrastrukture i ministru Sporta i kulture, zato što su naši zahtevi naišli na razumevanje samo kod tih ministara. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, punën do ta vazhdojmë nesër në orën 11:00. Mirupafshim!

\* \* \*

*E premte, më 7 dhjetor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 6 dhjetor*

*Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.*

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me seancën plenare. Fjalën e ka Valentina Bunjaku-Rexhepi, nuk është, Korab Sejdiu, urdhëro, deputet!

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë që jeni këtu sado pak,

Kisha pasur dëshirë që sot të filloj pak jashtë teme, me një ngushëllim për familjen Gjurgjeala, për vdekjen e zotit Bujar Gjurgjeala, që është një njeri që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë për këtë vend në kohë shumë të vështira.

Njëkohësisht shumë prej nesh e njohin vetëm për kontributin që e ka dhënë në aspekt politik, por ai është edhe një njeri që ka dhënë shumë edhe për sportin e Republikës së Kosovës, kështu që i qoftë dhe i Kosovës i lehtë, ndërsa familjes ngushëllimet më të sinqerta.

Vazhdojmë me temën.

Kohë më parë Kosovës iu ka vesh një nofkë sui generis dhe besoj që edhe sot ky termi sui generis po na përshtatet në fakt dhe edhe sot, sepse besoj që në pak vende ndodh, nëse diku ndodh, që të paraqitet buxheti i një Qeverie për aprovim para Kuvendit dhe të mungojë pothuajse tërë Qeveria. Falënderojmë ministrin që ka qëndruar edhe dhe, edhe sot qenka këtu, po në fakt, ndoshta më së paku duhet të jetë ministri, sepse në aspektin teknik nuk shoh që ka ndonjë problem me buxhetin. Po fatkeqësisht po mungojnë ata, të cilët ishte dashur që nëpërmes këtij buxheti t'i tregojnë prioritetet e Qeverisë edhe të tregojnë se kah po shkon vendi.

Sidoqoftë, më lejoni që fillimisht t'i paraqes nja 2-3 komente të përgjithshme për buxhetin, e pastaj të fokusohem më shumë në sferën, të cilën ndoshta edhe e njoh pak më mirë se të tjerat.

Shihet qartë, edhe nga një shikim i këtij projektbuxheti, por edhe nga diskutimet që i patëm dhe që në fakt ky është një buxhet, i cili më shumë është shpenzues, se sa që krijon pasuri dhe mirëqenie për qytetarët e këtij vendi.

Pra, shihet qartë që mungojnë investimet e qarta, veçanërisht ato kapitale që prodhojnë pasuri për vendin dhe që prodhojnë një të ardhme më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Përpos asaj, po më vjen shumë keq që edhe në këtë projektbuxhet Qeveria po tregon që e shikon buxhetin edhe paranë publike si diçka të veten personale dhe që mund ta shpërndajë në asi

mënyre që, në fakt, diskriminon ndaj disa qytetarëve dhe e shpërqendron buxhetin në komunat, veçanërisht në ato komuna që u përkasin kryetarëve nga radhët e partisë së kryeministrit.

Sidoqoftë, po futem në pjesën e projektbuxhetit që ka të bëjë me drejtësinë dhe dua të jemi pak të sinqertë, veçanërisht Qeveria.

Nuk ka takim, nuk ka seancë që ne nuk flasim për drejtësinë si prioritet, për nevojën e këtij vendi që të kemi sundim të së drejtës e kështu me radhë. Në fakt, edhe ministri i Drejtësisë dje në takim edhe me ambasadorin e ri amerikan e theksoi rëndësinë e këtij sektori.

Të shohim a është bërë me këtë projektbuxhet prioritet i kësaj Qeverie.

Kemi përafërsisht diku, sipas një kalkulimi, ku e futa edhe Ministrinë e Drejtësisë, edhe pse është pjesë e ekzekutivit, diku 75 milionë, 74,93 milionë alokim të shpenzimeve për drejtësi.

Prej tyre, diku 23 milionë janë për Ministrinë e Drejtësisë, 23 milionë e gjysmë, që në fakt 17 milionë janë të planifikuara për sistemin korrektues. Nëse e përkthejmë këtë në përqindje, i bie diku 3,17% nga buxheti total që është i alokuar për drejtësi ose nëse hiqet Ministria e Drejtësisë 2,17%. A mjafton kjo për të shtyrë përpara një sektor që ne të gjithë po pajtohemi, pavarësisht pozitë apo opozitë, që është prioritet.

Ministri dje shumë mirë e potencoi që rritja e buxhetit është 12,5%, a është e saktë ashtu? Po, në fakt, rritja për sektorin e Drejtësisë, sipas një kalkulimi të vrazhdë, i bie diku rreth 6%.

T'ju testoj pak në fizikë, nëse e ke një veturë që ecën 12,5 kilometra në orë dhe një veturë tjetër që ecën 6 kilometra në orë, çka ndodh me atë veturën që është duke lëvizur pothuajse me gjysmën e shpejtësisë.

Tash ta marrim parasysh edhe faktin që kjo veturë po niset shumë më mbrapa, sepse të gjithë e dimë që sektori i drejtësisë po lëngon. Atëherë vijmë deri te konkludimi që, në fakt, nuk mund ta quajmë prioritet drejtësinë dhe njëkohësisht të mos i alokohet rritje së paku të barabartë edhe proporcionale se si po rritet në tërësi buxheti.

Tash prej kësaj rrjedh pyetja: A është planifikuar sa i përket pjesës së drejtësisë përmbushja e obligimeve ligjore sa u përket bashkëpunëtorëve për Këshillin Gjyqësor, përkatësisht gjyqtarët, bashkëpunëtorët për prokurorë, implikime të tjera financiare që burojnë nga Ligji për gjykatat, i riu, i cili posa është miratuar, a janë harmonizuar planifikimet e shpenzimeve buxhetore me ligjin që është tek ne për pagat në sektorin publik.

Një shikim i thjeshtë për 2-3 vjetët e ardhshme tregon se nuk do të ketë ndonjë rritje të madhe të planifikuar në këtë sektor, përkundër faktin që në vazhdimësi po dëgjojmë edhe nga ministri i Drejtësisë që së shpejti të përfundojë rishikimi i sistemit të drejtësisë.

Dhe, në këtë rast, nëse do ta rishikojmë një sistem që nuk funksionon, natyrisht që prej nesh do të kërkohet që të investojmë edhe më shumë, prandaj 2-3 vjetët e ardhshme në kisha imagjinuar që do të parashihet një rritje përmbajtjesore e shpenzimeve në këtë sektor, fatkeqësisht nuk po e shoh së paku për tre vjetët e ardhshme.

Unë kisha pasur dëshirë që këto çështje të trajtohen, edhe dje u tha në njëfarë mënyre që e di që ka çështje që janë të planifikuara me ligj, por kur s'ka buxhet s'kemi ç'të bëjmë.

Në fakt, e kemi një qeveri që e ka dëshmuar veten që ligjin e sheh si rekomandim, e jo si obligim.

Kur është puna te obligimet ligjore për cilëndo Qeveri, çdo gjë tjetër opsionale duhet të lihet anash, sepse çështjet edhe obligimet ligjore duhet të përmbushen të parat, pastaj çka mbetet duhet të alokohet te investimet e tjera opsionale.

Për përfundim: A parasheh ky buxhet rritje? E vërtetë është, 12,5. Po a parasheh zhvillim ekonomik, është një pikëpyetje shumë e madhe dhe i kisha lutur të gjithë që ta kuptojnë dallimin mes rritjes së buxhetit dhe zhvillimit ekonomik. Unë nuk besoj që ky buxhet e bën atë.

Edhe e dyta, kisha pasur dëshirë që, në fakt, të jemi të sinqertë me qytetarët, të themi a është drejtësia prioritet apo jo? Nëse është prioritet, atëherë alokonim mjetet, nëse nuk është prioritet, atëherë të jemi të sinqertë, le të jetë Qeveria e sinqertë le të thotë për ne drejtësia aktualisht nuk është prioritet, sepse kemi të tjera prioritete që i kemi potencuar si më të rëndësishme për shoqërinë tonë. Po kështu edhe sinqeritet edhe të mos investohet në të, nuk besoj që po jemi të sinqertë ndaj qytetarëve, të cilët në fakt na kanë angazhuar t'i menaxhojmë këto fonde në të mirën e tyre.

Shpesh po vijnë ligje këtu tek ne që thonë, në rregull, ndoshta nuk janë të përkryera, po rregulloni me amendamente.

Ky projektligj fatkeqësisht nuk besoj që është një projektligj që mund të rregullohet me amendamente. Mund të krijojmë ndryshime kozmetike, po rrënjësisht nuk mund ta ndryshojmë ashtu edhe siç kërkohet për ta ndryshuar.

Rrjedhimisht, unë nuk mund ta përkrah këtë buxhet, me shpresë që të ketë një reflektim shumë të thellë nga kjo Qeveri se si po e shpenzon paratë publike. Faleminderit!



KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Selmanaj, urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, nuk do mend që Projektligji për buxhetin është një ndër ligjet më të rëndësishme të funksionimit të një Qeverie dhe shtetin në përgjithësi. Gjithashtu është e qartë që përmes buxhetit pasqyrohet kultura, mentaliteti, qasja dhe objektivat e një qeverie.

Dje gjatë tërë ditës pothuajse konstatim i përgjithshëm ishte që ky buxhet nuk është as social, sepse nuk trajton në tërësi rastet ose, them varfërinë, por më tepër ka të bëjë me kategoritë, të cilët ne i kemi dhënë një epitete kategoritë me meritë.

Ndërkohë gjithashtu u tha që nuk është as buxhet, i cili garanton zhvillimin ekonomik.

Unë në fakt pajtohem me këtë konstatim, sepse mënyra se si është draftuar ky buxhet, ky konstatim del të jetë i drejtë. Po cili është emërtimi që i shkon këtij buxheti, nëse nuk është as social, nuk është as në funksion të zhvillimit ekonomik, unë mendoj që përgjigjja është buxhet elektoral.

Kam përshtypjen që koalicioni qeverisës e ka detektuar situatën dhe gradualisht po e shef që Qeveria po shkon drejt rrëzimit, atëherë ka draftuar një buxhet, i cili ka më tepër karakterin krejtësisht elektoral.

Pse e them këtë, unë gjatë kohës sa merresha me monitorimin e proceseve të zgjedhjeve thosha që viteve të fundit ka ndryshuar vjedhja e votave, domethënë vjedhja e votave kam thënë ka ndërruar formë. Pse e kanë thënë këtë? Sepse kanë pa një emancipim të politikës, se ka gjetur mënyra të tjera se si të manipulojë me votuesit.

Nëse e shikojmë vetëm pjesën që ka të bëjë me kategori sociale, kap shifrën diku 465.8 milionë euro.

Nga ana tjetër, subvencione dhe transfere, krahasuar me vitin 2017 kemi rritjen në vlerë 103 milionë euro më shumë. Mallra dhe shërbime 111 milionë euro më shumë.

Dhe nëse e marrim edhe një shembull tjetër se si Qeveria gjatë vitit 2018 ka marrë vendime lidhur me shpenzimet e paparashikuara, kapin shifrën e 8.387 milionë euro, në total krejt këto dalin 687 milionë euro, 1/3 e buxhetit mund të shfrytëzohet ose mund të jetë në funksion të votave, ose them në funksion të asaj se si mund të fitohen zgjedhjet, prandaj nëse 1/3 e buxhetit është në këtë funksion, normalisht që s'mund të japim epitete tjetër këtij buxheti, përpos për t'i thënë që ky buxhet është i karakterit elektoral dhe nuk ka të bëjë fare as me zhvillim ekonomik

dhe s'ka të bëjë fare as me trajtimin, të them, e personave ose kategorive, të cilët në Kosovë konsiderohen si të varfër.

Unë do ta trajtoj pak edhe pjesën që ka të bëjë te rendi, ligji dhe siguria publike, sepse siç tha edhe zoti Sejdiu, me të drejtë rritja e buxhetit për 6% megjithatë duket sikur nuk ka gjasë të sjellë përmirësime në këtë sektor. Pjesa më e madhe kësaj rritjeje ose thënë pothuajse e gjithë kjo rritje shkon në rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në bazë të vendimit të mëhershëm, të cilën kryeministri e kishte marrë për t'u rritur pagat. Dhe, tash nëse ky buxhet aktual nuk parasheh rritjen e stafit për Këshillin Gjyqësor dhe as Këshillin Prokurorial, shtrohet pyetja që a do të arrihen objektivat për efikasitetin e rendit dhe ligjit. Nëse nuk punësohet staf shtesë, për të cilën duhet t'ju vë në kujtesë që diku 35 gjyqtarë të rinj që kanë kaluar procedurat e rekrutimit dhe presin të emërohen gjithashtu duket se ka informata jozyrtare që do të hapen diku në 60 pozita shtesë për gjykatësit e rinj, të gjitha këto nuk janë pasqyruar fare në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm, që i bie që përkundër deklaramit publik, përpjekjet ose them realiteti do të jetë krejtësisht ndryshe, sepse nuk ka adresim më në këtë projektbuxhet.

Është edhe një element tjetër që ka të bëjë me mjedisin. Ne së fundmi po ballafaqohemi me shqetësimet tona për nivelin e ajrit në Prishtinë dhe jo vetëm në Prishtinë, por në Kosovë. Shiheni një paradoks, te projektet kapitale për të gjitha komunat e Kosovës, projektet kapitale që kapin qoftë ndërtimin e deponive, qoftë krijimin e hapësirave të gjelbra, qoftë blerjen e kontejnerëve, në total e kap shifrën e 930 mijë euro. Domethënë, për gjithë projektet kapitale në Kosovë, në komunat e Kosovës, shifra është 930 mijë euro, kurse vetëm për një projekt të vetëm "Ta pastrojmë Kosovën" Qeveria ndan 1 milion e 200 mijë euro, domethënë për krejt komunat e Kosovës 930 mijë euro, vetëm për një projekt "Ta pastrojmë Kosovën" 1 milion e 200 mijë euro. Dhe, shtrohet pyetja "Ta pastrojmë Kosovën" është një organizatë joqeveritare, të cilën ne e kemi parë edhe sivjet që ka bërë disa aktivitete me Qeverinë, por mos harroni, për të ndarë buxhet për organizata joqeveritare ka Rregullore, mbi të cilën janë përcaktuar kriteret se si mund të ndahen paratë. Unë nuk e kam parë në projektbuxhet, por informatat jozyrtare më kanë thënë që edhe për vitin 2018 kjo organizatë ka marrë diku 800 mijë euro, po them, nuk është në projektbuxhet, por kam informata jozyrtare që për këtë projekt janë, domethënë që i bie në total 2 milionë euro. Ndërkohë po them edhe një herë, për krejt komunat e tjera nuk është kjo shifër, dhe në konsultim me disa kryetarë të komunave kanë thënë që sikur t'i kishim ne si komuna 2 milionë euro, do ta zgjidhnim problemin e shumë deponive dhe çështjen e mbrojtjes së mjedisit. Por, megjithatë ky është paradoksi.

Një çështje tjetër që ka të bëjë është edhe me rritjen e numrit të personave, të cilët mendohet që të punësohen në Administratën Publike, diku 518 persona priten të jenë në vitin 2019 të punësohen në Administratën Publike. Por, mos harroni, ne kemi pasur këshilla të vazhdueshme nga ana e Komisionit Evropian që ne duhet ta zvogëlojmë këtë staf, jo ta rrisim. E dimë ne që në Kosovë ka nevojë për punësim, por nevoja për punësim duhet të kapë sektorë të tjerë, jo sektorin

publik, sepse gjithmonë kemi folur që sektori publik është i stërngarkuar me mbi 80 mijë persona, ndërkohë ne tash po ia shtojmë edhe 518 persona të tjerë.

Në fund, unë dua të përmend edhe një projekt, i cili lidhet me një komunë të Kosovës është Komuna e Suharekës, ka të bëjë me shtëpinë e kulturës “Ukë Bytyçi”. Tash, për këtë projekt Komuna ka ndarë për vitin 2019, 150 mijë euro. Projekti në total kap shifrën mbi 3 milionë euro, me këtë logjikë të Qeverisë duhen edhe 30 vjet që të ndërtohet shtëpia e kulturës “Ukë Bytyçi” në Therandë (Suharekë). Prandaj, unë mendoj që nëse projektet e tilla janë të parëndësishme për Qeverinë, më mirë është të mos futeshin fare, se sa të bëjnë një lojë të tillë me këtë projekt, i cili bart edhe emrin e një personi jashtëzakonisht të rëndësishëm, jo vetëm për LDK-në, po për gjithë Kosovën.

Prandaj, me këtë konstruksion se si është menduar buxheti, me këtë buxhet, të cilin e thashë në fillim, krejtësisht elektoral, normalisht që vota pro do të ishte krejtësisht e pakuptimtë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka ministri Bedri Hamza. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryesuese!

Faleminderit, deputet Selmanaj,

E përmendët, jo vetëm ju, edhe disa deputetë të tjerë, por profesionalisht është e paqëndrueshme të thuhet se rritja e buxhetit është 12.5%, por nuk ka ndikim në zhvillimin ekonomik. A dalin këto para në konsum, a dalin në investime, kudo që dalin, e bëjnë impaktin e vet në zhvillimin ekonomik. Ka dallim nëse investimet janë më të mëdha, atëherë mund të flasim për rritje ekonomike të qëndrueshme, ndërsa janë konsum, rritja ekonomike vjen më shpejt, por për qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike mund të diskutojmë, por është total e paqëndrueshme se rritja e buxhetit nuk ka ndikim në rritjen ekonomike.

E dëgjova me vëmendje edhe e vlerësoj diskutimin tuaj, pak më herët e diskutuat që buxheti i drejtësisë nuk është i mjaftueshëm. Në fjalimin tim të parë kam thënë që të gjithë ne kishim dashur të kishte buxhet më shumë se kaq. Edhe për arsimin, shëndetësinë, për drejtësinë dhe për të gjithë sektorët, edhe e përmendët që është rritja e pagave në këtë sektor. Po, është rritja e pagave, mirëpo përveç rritjes së pagave, është rritja edhe e të numrit të punësuarve, edhe kërkuat rritjen e numrit të punësuarve. Por, në diskutimin tënd pak më vonë e kritikuat numrin e të punësuarve, edhe unë besoj që të gjithë ne duhet të pajtohemi që në sektorë të caktuar në Kosovë ka mbipunësim, ndërsa në sektorë të caktuar në Kosovë ka nevojë që të rritet numri i të punësuarve, por jo të kritikohet pse për 500 vetë qenka rritur numri i aprovuar i pozitive, janë rritur në sektorin e sigurisë, në sektorin e shëndetësisë, te Inspektorati i Punës dhe janë rritur në disa sektorë të tjetër. Te Sektori i Drejtësisë, edhe dje e thashë dhe po e ripërsëris, te Këshilli Gjyqësor janë të aprovuar dhe të paplotësuara edhe 283 pozita, janë të lira, janë të buxhetuara.

Këshilli Gjyqësor le të procedojë, le t'i plotësojë gjyqtarët, unë i uroj dhe besoj që i plotëson gjyqtarët edhe në ato profilet dhe në ato profesionet që duhet, mirëpo edhe 283 pozita i ka Këshilli Gjyqësor, ndërsa Këshilli Prokurorial i ka edhe 93 pozita të lira. Kur të plotësohen këto, me kërkesë të Ministria e Financave, ne sigurisht se do t'i përgjigjemi.

Sa i përket çështjes së ambientit, ne e dimë, edhe personalisht mendoj që duhet të vendosen prioritete më të larta sesa sot, sepse e dimë gjendjen e ambientit, e dimë që është duke u imponuar çdo ditë e më tepër si prioritet. Mirëpo, komunat kurrkush nuk i ndalon që edhe ato të ndajnë pak mjete më shumë prej buxheteve të veta, edhe ata kanë obligim të bëjnë një riprioritizim të prioriteteve tyre. Të lëvizin edhe ata pak në prioritete, e jo veç të pritët prej nivelit qendror, sepse nëse i shikojmë të hyrat e komunave që sa vjet mbesin në nivel të njëjtë. Mund të them që diku 7-8 vjet, 10 vjetët e fundit komunat e kanë nivelin e njëjtë të të hyrave, nuk mund të bësh projekte, nuk mund të zhvillosh projekte nëse s'i grumbullon të hyrat. Ata në një mënyrë, një pjesë e madhe e tyre vetëm presin prej nivelit qendror, edhe te cila ministri, cilat projekte po mund t'i vendosë. Prandaj, besoj që edhe komunat kur duan të kenë ambient më të mirë, duhet të kenë projekte brenda buxheteve të tyre, ndërsa prej nivelit qendror, unë besoj që ambienti definitivisht çdo ditë e më tepër neve po na imponohet që ta trajtojmë me një seriozitet më të madh se deri më tash. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Fjalën e ka Driton Selmanaj, për replikë! Urdhëroni!

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, kryesuese!

Në fakt, ministër, më shumë konstatove atë që thashë se sa më kundërshtove, megjithatë jemi për herë të parë keni thënë që domethënë mbrojtja sociale i ka tejkaluar çështjet ekonomike, diku 21% të këtij buxheti shkon për këtë kategori. Dhe, tash thënë të drejtën, edhe Suedia ka për të na marrë lakmi se çfarë qasje jemi duke pasur në kontekst të politikave sociale, por të mos harrojmë që 2 ose 3 partitë më të mëdha, të cilat janë pjesë e këtij koalicioni qeverisës janë të qendrës së djathtë, për të mos thënë krejtësisht të djathtë. Dhe, unë mendoj që duke u marrë me këto kategori, s'po flasim për varfërinë, po flasim më shumë për kategoritë në meritë, ma konfirmojnë atë që ky buxhet është elektorale, sepse mundësia për t'u përkthyer në votë kjo po ndodh.

Dhe, tash e dyta, unë nuk thashë kur fola për Administratën Publike, unë fola në tërësinë e saj, unë mendoj që diku s'kemi qare pa e reduktuar, po diku s'kemi qare pa e plotësuar, sepse ka nevojë, aty ku ka nevojë do të jetë. Por, unë po them që numri është i stërngarkuar dhe kërkesa e BE-së gjithmonë ka qenë mos se e keni shumë, prandaj ta shkarkojmë pak. Ideja ime është që të shkarkohet diku dhe të plotësohet ku ka nevojë. Në fund, për mjedis, mos harroni, një organizatë joqeveritare "Ta pastrojmë Kosovën", të cilën e kanë moto që disa vjet ia keni vendosur 1 milion e 200 mijë euro, mënyra se si shpërndahen për OJQ paratë ka kritere, ka rregullore, është Rregullorja, të cilën është aprovuar nga zoti Hoti, kur ka qenë ministër, prandaj nuk mundeni apriori një moto të një organizate tjetër ta ndani sot, sepse ka kritere për këtë punë dhe nëse kjo 1

milion e 200 mijë për një organizatë, për pastrim të Kosovës, nuk e kuptoj pse 1 milion e 200 mijë, e komunave për kontejnerë dhe për deponi 900 mijë në tërësi, këtu është paradoksi i madh dhe kjo që ju po thoni duhet t'i kushtojmë rëndësi, ju po i bie që po i kushtoni rëndësi një mundësie të re për manipulim eventual, sepse përmes një mekanizmi siç është një OJQ, mundësia për manipulim eventual është shumë e madhe. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Urdhëroni, ministër!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Zoti Selmani u pajtuam aty ku u desh të pajtohemi, po s'u pajtuam me aty ku s'u desh të pajtohemi. S'u pajtuam se s'pate të drejtë kur the që rritja e buxhetit nuk e përmirëson situatën sociale dhe nuk ndikon në zhvillimin ekonomik, këto nuk shkojnë. Edhe çështja tjetër, kur jemi te çështjet sociale, ku është rritur buxheti? Për cilat kategori është rritur buxheti? Dhe të mos mendojë dikush që nëse e ka bërë një rrugë në vend, ka për të fituar votat, nëse ua ka rritur pensionet apo pagat një kategorie, i fiton votat veç një parti, janë edhe shumë elemente të tjera. Pagat janë rritur, pensionet janë rritur për pensionistët që janë të pleqërisë, pensionet bazike, edhe pensionet kontributdhënëse. Çështje të tjera janë mbuluar skemat e ligjeve, të cilat kanë qenë të aprovuara dhe besoj që pajtohem se kanë qenë obligime ligjore.

Do të thotë, nëse unë nuk besoj që prej deputetëve, pa dallim politik, nuk ka dikush që s'pajtohet t'u rriten pensionet pensionistëve që i kanë pasur 75 euro, edhe kjo ua përmirëson pak gjendjen, por prapëseprapë s'ua zgjidh problemet, se prapë janë të ulëta. Prandaj, te çështjet sociale, edhe nëse marrim strukturën e buxhetit zoti Selmani, pjesëmarrja totale të investimeve kapitale vazhdon të jetë 33%, që është prapë nivel i pranueshëm, edhe unë uroj që edhe në të ardhmen të ruhet kjo, pjesëmarrja e investimeve kapitale. Nëse e krahasojmë buxhetin e Kosovës me vendet e regjionit edhe pak më larg, e shoh që investimet kapitale në shumicën e vendeve nuk e kanë as 10%. Prandaj, nuk mund të themi që është buxhet social, kur e dimë gjendjen e pensionistëve, gjendjen e shumë kategorive të tjera. Për pastrimin e skemave definitivisht besoj që ka pajtim qind për qind mes deputetëve. As familjet me asistencë sociale s'duhet t'i marrin ata që nuk e meritojnë, as kategoritë e tjera, këtu jemi dakord, por për lartësinë e pensioneve, rritjen e pensioneve nuk është gabim, unë mendoj që është punë e mirë edhe unë jam shumë i lumtur që është krijuar hapësira buxhetore që këtë kategori ta trajtojmë aq sa është e mundur.

**KRYESUESJA:** Faleminderit, ministër! Fjalën e ka deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj.

**LULJETA VESELAJ-GUTAJ:** Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është dita e dytë që ne po e trajtojmë njërin nga projektligjet më të rëndësishme të vendit, pra Projektligjin për buxhetin e vitit 2019.

I nderuar ministër Hamza,

Ju përgëzoj për punën shumë profesionale dhe me shumë përkushtim në planifikimin e projeksioneve ekonomike për vitin 2019. Puna gjithëpërfshirëse dhe me shumë përkushtim sigurisht që reflekton në rritjen e buxhetit të shtetit që nuk e ka pasur asnjëherë më parë Kosova. Rritja e konsiderueshme në sektorët e arsimit, të shëndetësisë, drejtësisë dhe dikasteret e tjera garanton një jetë më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Politikat e kujdesshme në planifikimin e të hyrave dhe aftësia për ta luftuar ekonominë informale me mekanizma të kujdesshëm profesionalë sigurisht që ndikojnë në rritjen e buxhetit të shtetit dhe është njëri nga treguesit për ditë më të mira për qytetarët e vendit. Sigurisht që ne di deputetë kemi kërkesa pavarësisht atyre rritjeve në sektorë të ndryshëm. Preokupimi im ka të bëjë me Ministrinë e Arsimit, ku konsideroj që vëmendje të veçantë duhet kushtuar edukimit dhe arsimimit parashkollor, sepse aty është baza e formimit dhe e zhvillimit dhe formimit të personalitetit të të rinjve, të cilët një ditë do ta udhëheqin vendin.

Po ashtu, rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet edhe arsimit profesional dhe arsimit permanent, apo arsimit gjatë gjithë jetës. Një theks të veçantë do ta vër te bashkëpunëtorët profesionalë, duke filluar nga kopshtet dhe në të gjitha shkollat në nivel vendi, kur e dimë se në gjithë Kosovën kemi vetëm 11 shkolla të cilat kanë bashkëpunëtorë profesionalë, siç është pedagogu, psikologu dhe sociologu.

Fokus i veçantë në Ministrinë e Arsimit duhet të jetë digjitalizimi i shkollave. Ne duhet të kemi kujdes dhe duhet të punojmë që shkollat tona ta kenë një sistem digjital në gjithë vendin.

Po ashtu, gjithandej Kosovës kemi probleme me ujin e pijshëm, duke u nisur nga Prizreni, Suhareka, Orllani dhe shumë komuna të tjera, ku qytetarët ballafaqohen me problemet e ujit të pijshëm. Pra, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Ambientit dhe Mjedisit duhet të kenë një kujdes në projeksionet, të cilat ia dedikon Hidroregjionit apo KRU-së për t'u siguruar qytetarëve të vendit ujë të mjaftueshëm të pijes.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Peticione dhe Persona të Pagjetur e ka monitoruar Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Raporti është shqyrtuar në seancën e fundit. I kemi dhënë rekomandimet, mirëpo nuk është votuar, dhe njëri nga rekomandimet është që Qeveria e Republikës së Kosovës në projektligjin për vitin 2019 të parashohë kosto financiare për rekrutimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi nga të gjitha komunat dhe në pesë ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo pozitë është e pambuluar në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-21 për mbrojtje nga diskriminimi. Pra, kërkoj nga ministri i Financave që ta ketë parasysh këtë rekomandim, edhe pse nuk është votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por ta marrë si shqetësim dhe ta fusë si kosto në Projektbuxhetin për vitin 2019.

Sa i përket Shtëpisë së Kulturës “Ukë Bytyçi” në Therandë, është e vërtetë që planifikimi nga Komuna është 150 mijë euro, por sigurisht kolegu Selmanaj nuk e ka informacionin e saktë, se para tri ditësh ministri i Kulturës i ka përcjellë edhe 300 mijë euro shtesë Komunës së Suharekës për finalizimin e punimeve të cilat i kryen kompania që sa më shpejt të realizohet ky projekt për shtëpinë e kulturës “Ukë Bytyçi” në Therandë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar qytetarë,

Deputetë,

Ministër,

Ndonëse Buxheti i Republikës së Kosovës do të duhej të ishte një nga instrumentet më të rëndësishme me anë të të cilit do të duhej të adresoheshin problemet thelbësore ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, nga analiza e Projektligjit vihet re se buxheti paraqet në masë të madhe një vazhdimësi nga vitet e kaluara, apo më saktësisht siç u përmend edhe më herët 82 për qind e investimeve kapitale të nivelit qendror janë vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara. Ashtu sikur e diskutova me ministrin e Financave edhe në mbledhjen e Komisionit, nuk është as buxhet i konsoliduar, as transparent. Për më tepër, nuk është as buxhet zhvillimor dhe sado që po paraqitet si buxhet social, nuk është as buxhet social, sepse nuk i favorizon shtesat më të varfra të shoqërisë, por kategori të caktuara, të cilat jodetyrimisht janë në gjendje më të vështirë sociale.

Ky buxhet akomodon lukse të shumta dhe u përmend se ka rritje prej njëmijë për qind të mallrave dhe shërbimeve e pagave në Zyrën e Kryeministrit dhe po ashtu rritje të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në Zyrën e Presidentit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale në nivel qendror, apo rreth 30 për qind i takojnë Ministrisë së Infrastrukturës, duke përfshirë dy të tretat e ndarjeve buxhetore të sektorit në ndërtimin e rrugëve. Pra, asfalti vazhdon të dominojë në shpenzimet kapitale, ndërkohë që vetëm ndërtimi i autostradave merr 78 milionë e 500 mijë euro, derisa fare pak, apo thënë më mirë aspak mjete janë planifikuar për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve të reja.

Te shpenzimet kapitale pothuajse kemi një buxhet që ekziston si rezultat i dështimit të realizimit të projekteve në vitet e kaluara dhe shtyrjes së realizimit të tyre prej vitit në vit.

Buxheti nuk parasheh ndarje për ligjet e reja, përveç për Ligjin për kryeqytetin. Pra, nuk janë paraparë shpenzime për Ligjin për pagat, për pakon e ligjeve të FSK-së, për përfitimet për lehonat, rezoluta për shtesat e fëmijëve, Projektligji për punëtorët e arsimit të viteve të ‘90-ta, e as për Ligjin e punës. Shihet pra se kjo Qeveri merr iniciativa sa për të thënë dhe sigurohet që të njëjtat të dështojnë pa filluar implementimi. Në anën tjetër, nuk është planifikuar asgjë në lidhje

me projektin për kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre në Mitrovicë dhe në komunat e tjera, përderisa komunave në veri të Mitrovicës shpenzimet e lejuara u rriten vit pas viti, përkundër rënies së inkasimit të të hyrave vetjake në këto komuna. Për më shumë, ka mungesë të të dhënave të sakta për fondet e destinuar për këto komuna.

Projektbuxheti nuk e merr parasysh as perspektivën gjinore, edhe pse është obligim ligjor sipas Ligjit për barazi gjinore që perspektiva gjinore të futet në secilën fazë të procesit të planifikimit, miratimit, zbatimit dhe vlerësimit të legjislacionit, vlerësimi gjinor i buxhetit nuk është bërë në asnjërin nga dokumentet e buxhetit. Nëse e bëjmë një vështrim të thjeshtë, ku siç e përmenda vihet re se gjyca e investimeve kapitale do të investohen në infrastrukturën rrugore dhe kur e dimë se mbi 95 për qind e të punësuarve në këtë sektor janë burra, shihet se gratë nuk do të përfitojnë nga ky sektor dhe në përgjithësi nga pjesa më e madhe e buxhetit të vendit, ashtu siç nuk përfitojnë as në shumicën e transfereve të tjera që janë planifikuar.

U tha se është rritur buxheti për sektorin e arsimit dhe unë dua të fokusohem pak te kjo pjesë. Ndonëse është përmendur se rritja është 10 për qind, ndërtimi i objekteve shkollore vazhdon të mbetet prioritet dhe kryesisht edhe këto janë projekte të vjetra, përkatësisht të filluara vite më parë. Totali i investimeve kapitale në arsimin parauniversitar është 10 milionë e 644 mijë euro, ndërkaq prej tyre vetëm 250 mijë euro janë për projekte të reja. Pra, nuk ka fare ndërtim të objekteve të reja, të cilat do të mundësonin qoftë përfshirjen e fëmijëve në edukimin e hershëm, qoftë përmirësimin e infrastrukturës shkollore në mënyrë që të shërbejë për përmirësimin e cilësisë. Pra, shpenzimet kapitale në arsimin parauniversitar vazhdojnë të dominohen nga shpenzimet për ndërtimin dhe renovimin e shkollave, me investime të papërfillshme në investime që e përmirësojnë cilësinë, si në pajisje laboratorike, apo në teknologjinë informative, e aq më pak në ndërtimin e institucioneve parashkollore. Pra, të gjitha mjetet e planifikuara janë po ashtu projekte të vazhduara nga vitet paraprake dhe nuk ka ndikim po e përsëris në arritjen e objektivave të përmirësimit të cilësisë dhe shtimin e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor dhe parafillor.

Shpenzimet për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë, aq sa janë destinuar, janë krejtësisht të papërfillshme dhe nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në përgjithësi në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Edhe pse investimi në zhvillimin e fëmijërisë së hershme tashmë është dokumentuar se është shumë i rëndësishëm dhe rrit produktivitetin e investimeve të mëvonshme në kapitalin njerëzor, buxheti nuk e ka prioritet investimin në institucionet e edukimit të fëmijërisë së hershme, edhe pse shkalla bruto e regjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç është vlerësuar me vetëm 15,7 për qind dhe kjo është adresuar si shqetësim edhe në Planin strategjik të arsimit të Kosovës për vitet 2017-2021.

Për më shumë, me gjithë rritjen e buxhetit për arsim, nuk është e qartë sesi kjo rritje do të mund të bëjë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit parauniversitar, apo se do ta rrisë



fare pak përmirësimin e cilësisë dhe shpenzimet në arsim akoma mbeten më të ulëta se mesatarja e shpenzimeve relevante në vendet e BE-së. Pra, krahasuar me ato vende, Kosova ende shpenzon shumë pak në arsim.

Do të doja ta veçoja një hap të mirë në këtë drejtim, e që është përkrahja buxhetore për punësimin e 100 e asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta. Jam mjaft e kënaqur që amendamenti që e kisha iniciuar vjet dhe nuk kishte marrë përkrahje nga ky Parlament, tashmë është pjesë e buxhetit dhe kjo duhet vlerësuar. Por, po ashtu duhet theksuar se numri i planifikuar vazhdon të mbetet i pamjaftueshëm për ta adresuar numrin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta, sepse sipas sistemit informativ të Ministrisë së Arsimit, kemi mbi gjashtë mijë fëmijë me nevoja të veçanta, të cilët e vijojnë mësimin në shkollat e rregullta të Republikës së Kosovës dhe pjesa më e madhe e familjeve të këtyre fëmijëve i paguajnë vetë asistentët për fëmijët e tyre.

Meqenëse u fol për ndarjen dhe favorizimin në komuna të caktuara, unë do të doja ta pyes ministrin për dy çështje: Në qershor të vitit 2018 u vu gurthemeli i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjakovë, në bashkëpunim me Qeverinë gjermane dhe atë zvicerane, dhe sa kam mundur të vërej nuk ka fare buxhet të destinuar për impiantin e ujërave në komunën e Gjakovës. Po ashtu, nuk janë ndarë mjete as për stadiumin e qytetit në Gjakovë, ndonëse ishte premtim i vazhdueshëm, qoftë gjatë fushatë zgjedhore, por edhe më tutje. Po ashtu, kisha pyetje për ministrin se si është menduar në këtë drejtim. A është kërkesë e Ministrive të linjës, apo pse nuk janë planifikuar mjetet për këto dy projekte?

Fare në fund dua të theksoj se sado që ne po punojmë që ndërmjet dy leximeve t'i iniciojmë çështjet që nuk janë adresuar dhe që do të ndihmonin në përmirësimin e sektorit të arsimit, shëndetësisë, sigurisë, drejtësisë dhe në përgjithësi të mirëqenies që qytetarëve, ky buxhet nuk parasheh dhe nuk mbështet projekte të reja kapitale apo nisma të reja të politikave që mund të kenë një efekt të rëndësishëm në promovimin e zhvillimit ekonomik. Ministri si duket s'i ka dëgjuar pyetjet mia. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ahmet Isufi.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Sot, por edhe dje e kemi rastin ta shqyrtojmë buxhetin, i cili i ka ardhur Parlamentit të Kosovës, e që në të vërtetë duhet ta japim kontributin tonë si deputet në mënyrë që të mund të kemi një buxhet sa më gjithëpërfshirës dhe sa më në dobi të qytetarëve të Kosovës. Është e vërtetë që e kemi një buxhet, i cili e ka një rritje të konsiderueshme dhe kjo është për meritë të Qeverisë dhe

të Ministrisë në këtë rast dhe po ashtu kemi nevojë që t'i kemi edhe vërejtjet tona lidhur me buxhetin, e unë i kam dy elemente të cilat duhet t'i përmend me këtë rast.

Vërejtja e parë është se buxheti kur ndahet në linja të caktuara, sidomos agjencive, komunave dhe të gjitha institucioneve, atëherë duhet të bëhet një ndarje e barabartë që mundëson një funksionim të të gjithë sektorëve, e që normalisht nga kjo përfitojnë pastaj në fund qytetarët e Republikës së Kosovës. Ajo që është me rëndësi është që t'i përgjigjemi edhe nevojës për projekte strategjike që duhen për vendin, e me këtë rast do të duhej ta përmendja sidomos pjesën kufitare, e cila nuk është trajtuar sa duhet, meqë kemi të bëjmë me pjesë të ndjeshme të funksionimit të shtetit tonë, e që ka nevojë për investime më të mëdha.

Mund ta kuptoj pse në të kaluarën s'ka pasur një interesim të shtuar ose të domosdoshëm të sistemeve, por tani nuk e kuptoj pse nuk ka një qasje më proaktive në drejtim të zonave kufitare, të cilat duhet të jenë edhe ekonomikisht, edhe për shkak të sigurisë, edhe për shkak të demografisë të jenë të trajtuara më drejtpërdrejt me Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ne kemi zona të cilat janë gati tërësisht të zbrazura, e në të njëjtën kohë ne flasim për territorin e Kosovës, për nevojën që të jetë i projektuar si territor i cili meriton një qasje shumë më pozitive. Për shembull, po e marr një zonë të cilën e njoh më mirë, zonën e Gollakut, që është e zbrazur tërësisht, ndërkaq ka resurse të jashtëzakonshme, sidomos në aspektin e bujqësisë, të blegtorisë dhe ju e dini që edhe tani trendët e jetës janë që të ketë cilësi më të mirë të ambientit e të jetës së qytetarëve. Prandaj, investimet në këto zona do të mundësonin edhe popullzimin, po ashtu edhe ngritjen e nivelit të cilësisë edhe të ushqimit, por edhe të jetës së qytetarëve.

Ajo që më brengos, e që është aspekti i dytë, është bartja e buxhetit ndër vite që shkon duke mos u shfrytëzuar dhe bartja e tillë konsideroj se është vetëm humbje e mundësisë për investime në dobi të qytetarëve të Kosovës.

Nuk e kuptoj nëse një komune për tre vjet me radhë i ndahet i njëjti buxhet në të njëjtat linja dhe nuk shfrytëzohet, konsideroj që është një dobësi e menaxhimit të buxhetit, dhe unë jam që në të ardhmen të ndahet buxheti aty ku shfrytëzohet racionalisht dhe aty ku është dobi e qytetarëve të Kosovës, në mënyrë që edhe buxheti të shfrytëzohet si duhet, por edhe nevojat e qytetarëve të plotësohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Prandaj, kërkesa ime për Qeverinë është që në të ardhmen ta bëjë buxhetin sa më aktiv në kuptimin e shfrytëzimit në dobi të qytetarëve të Kosovës dhe normalisht që në këto segmente që i përmenda në fazën e amendamentimit do ta japim edhe kontributin tonë si deputetë. Dhe do të kisha kërkuar edhe nga partitë politike që janë në Kuvend, e që e kanë mundësinë e amendamentimit t'i japin rëndësi kësaj çështjeje sepse është shumë me rëndësi.

Për çështje specifike normalisht se është faza e amendamentimit në të cilën do të kontribuojmë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti, zoti Zafir Berisha, urdhëroni!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesuese!

Natyrisht se Ligji për Buxhetin është ndër ligjet e rëndësisë së veçantë dhe duhet një qasje pak më serioze nga të gjithë mekanizmat, duke e përfshirë edhe Kuvendin.

Vërejtjet që jepen në drejtim të buxhetit janë të qëndrueshme, e shpeshherë më shumë të paqëndrueshme.

Buxheti për mendimin tim nuk ndryshon nga buxhetet e kaluara, as nga viti i kaluar, por as edhe në qeverinë e kaluar. Domethënë, natyrisht ka nuanca të ndikimit varësisht prej fuqisë politike që kanë partitë në pushtet, por kjo është më se normale se, në fund të fundit, subjektet politike që janë në pushtet e kanë premtuar dikë dhe natyrisht nuk mund të dalin gënjeshtarë, të thonë ma jep votën sot se nesër në qoftë se vij në pushtet bëj diçka, e kur të vijë në pushtet të mos bëjë asgjë. Këtë jo që po e bën kjo Qeveri, por e kanë bërë edhe të kaluarat, kështu që ndoshta nuk është nivel i duhur që të merrem me këto çështje.

Përqendrimi im te ato që janë prioritete dhe që janë në interes nacional është mirë të kemi unitet të të gjitha forcave politike.

Unë mendoj se të gjitha ministratë nuk i kanë shikuar të gjitha komunat dhe zonat e caktuara, për këtë unë do të flas pak për zonën prej nga vij, ku po mendoj se ministri Lekaj duhet t'i ketë në konsideratë disa nga projektet, të cilat Komuna e Prizrenit i ka paraparë, por që mundësitë buxhetore i ka të kufizuara që t'i realizojë. Shpresoj që deri në leximin e dytë edhe me kërkesë në formë amendamenti dhe me konsultim do të mbështeten disa nga projektet që më nuk janë projekte të partive të caktuara, por janë nevoja prioritare të qytetarëve në zona të caktuara, siç është rasti i një lidhjeje nëpërmjet një rruge dhe urës të rajonit të Hasit në breg-Dri me rajonin e Anadrinisë në Krushë të Vogël, projekt i cili është premtuar tash e 15 vjet më herët nga të gjithë dhe nuk është realizuar.

Është e vërtetë se është futur në buxhet, e ka një kod, mirëpo nuk janë të mjaftueshme me buxhetin e Komunës, prandaj po shpresoj se do të mbështet ky projekt nga niveli qendror. Edhe projekti që lidh lagjen Tusus - Bajramcurr dhe një pjesë së Hoçës së qytetit, gjithmonë në kontest të asaj se duke e rregulluar infrastrukturën me një pjesë ku pozita gjeografike mund ta shpëtojë edhe tokën e bukës, siç është duke u rrezikuar nga ndërtimet pa leje, jo veç në Prizren, por tash anekënd Kosovës.

Natyrish, lidhja e fshatit Bellushë me rrugën Zhur - Dragash është një çështje me rëndësi për faktin se lehtësohet qarkullimi në rrugën nacionale dhe e mundëson lëvizjen e rajonit të Opojës dhe Gorës në rast të caktuara më lehtë drejt qytetit të Prizrenit.

Mbështetja e zonës turistike në bjeshkët e Kabashit, edhe pse e ka një kod buxhetor, nuk është e mjaftueshme. Mendoj që këto dhe çështje tjera unë do t'i diskutoj edhe me ministrin, por sigurisht do të bëj edhe kërkesë me shkrim.

Ajo që më ra në sy është planifikimi për mirëmbajtjen e deponive nga Ministria e Mjedisit, që nuk është racionale për shkak se ne në regjion kemi deponi ilegale, për fatin e keq, jo vetëm që e ndotin ambientin, por edhe e rrezikojnë shëndetin e qytetarëve dhe natyrish bagëtive të cilat kullosin rreth atyre deponive, siç është rasti i deponisë në Zhur, si dhe mosmirëmbajtja e duhur e deponisë së Landovicës, për të cilën kemi folur disa herë në Kuvend, për rrezikimin që u ndodh banorëve, veçanërisht të Landovicës nga jo deponi.

Unë mendoj se Ministria e Mjedisit duhet të mendojë edhe për atë pjesë të Kosovës. Ajo që për mua është e papranueshme, që ka qenë e papranueshme, zoti ministër, e di që ke halle të konsultohesh me ministrin e Mirëqenies Sociale, por është si në opozitë si në pozitë që kam qenë, që është kod buxhetor, për mendimin tim antikushtetues dhe kundërligjor, është përcaktimi i investimeve mbi baza nacionale të objekteve të caktuara.

Unë mendoj se e kam thënë edhe në të kaluarën, edhe kur kam qenë në opozitë. Nuk po dua të hyj me emra konkretë, por nuk është ligjor dhe kushtetues që të nderohet një objekt, ta zëmë shkollor, ose i kulturës, ose i sportit për x, y komunitetin.

Zonja Emilija, nëse ke diçka për të folur, fol më pastaj. Por, unë po them e këtë, e kam thënë edhe më herët, po ta them edhe tash, meqë ndërhyre, domethënë po e di për çka e kam fjalën.

Nuk i kontribuon përcaktimit kushtetues të Kosovës dhe ambicieve të qytetarëve, ndarja mbi baza etnike është e papranueshme. Në arsim, në shëndetësi, në kulturë kudo qoftë, edhe në sport. Kështu që po e ripërsëris, e kam thënë edhe më herët, po e them edhe tash; unë natyrish që do ta votoj buxhetin, sepse e kam edhe kontributin tim këtu, por është mirë që disa gjëra të mendohen, jo vetëm për tash, por edhe për të ardhmen. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe kolegë deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të ndaj me ju mendimin apo diskutimin tim rreth Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Me vëmendje e kam lexuar këtë dokument që ka të bëjë me Buxhetin e Kosovës për vitin 2019, si dhe e kam analizuar në detaje këtë program. Personalisht dhe në emër të komunitetit rom, desha ta falënderoj Qeverinë në krye me kryeministrin Haradinaj, si dhe ministritë e saj për përkrahjen për komunitetin rom gjatë vitit 2018.

Sa i përket Buxhetit të Republikës së Kosovës, disa nga shtyllat kryesore të buxhetit për vitin 2019, e që është në interes të komunitetit rom, janë zhvillimi ekonomik, punësimi dhe arsimimi.

Duke qenë të vetëdijshëm që komuniteti rom jeton në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë ekonomike, buxheti i vitit 2019 i Qeverisë na lë të besojmë që me politikat e saj nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës, rritjen e mirëqenies, projekteve të mëdha zhvillimore që kanë të bëjnë me punësim, do të asistojë në përmirësimin e gjendjes aktuale ekonomike të romëve dhe në zhdukjen e varfërisë, si dhe daljen nga një humnerë 20-vjeçare.

Personalisht besoj, por gjithashtu edhe pres që buxheti i vitit 2019 i Qeverisë së Republikës së Kosovës të jetë gjithëpërfshirës.

Komuniteti rom, por edhe unë si përfaqësues i tij, pres që kjo Qeveri, së cilës i besojmë, së bashku me ministritë të jenë pranë komunitetit rom, duke e përkrahur atë nëpërmjet mbështetjes institucionale.

Besoj dhe pres që ky buxhet i këtij viti të jetë përkrahës në implementimin e strategjisë dhe planin e veprimit për përfshirjen e komunitet rom dhe ashkali, si dhe të objektivave dhe programeve të kësaj strategjie, si dhe përkushtimin e integritit të plotë të komunitet rom në shoqëri nëpërmjet sigurimit të përdorimit të gjuhës zyrtare sipas ligjit në fuqi, si rezultat i avancimit të të drejtave të njeriut, respektivisht respektimit dhe zbatimit të të drejtave të komuniteteve joserbe, me theks të veçantë të komunitetit rom.

Si deputet që e përfaqësoj komunitetin rom, besoj që Ministria për Komunitete dhe Kthim me një punë efikase dhe aktive do të ofrojë ndihmë afatgjate për personat e zhvendosur nëpërmjet ndërtimit të plotë dhe renovimit të pjesërisht të hapësirave të banimit, projekteve që garantojnë gjenerim, por edhe të punësimin, i cili garanton kthim të qëndrueshëm për të kthyerit, e po ashtu edhe nëpërmjet Ministrisë për Zhvillim Ekonomik dhe Ministrisë për Zhvillim Rajonal, duke i përkrahur bizneset e komunitetit rom.

Gjithashtu, pres dhe besoj që kjo Qeveri me buxhetin e vitit 2019 do të na ndihmojë në punësimin e komunitetit rom, në përmirësimin e situatës aktuale socio-ekonomike, në përkrahjen e të rinjve dhe grave rome dhe në përkrahje të bujqve dhe të fermerëve romë.

Prandaj, apeloj te Qeveria si dhe të ministrinë, që buxheti i vitit 2019 të jetë buxhet edhe për komunitetin rom. Gjithashtu, lus Qeverinë në krye me kryeministrin Haradinaj që mjetet e ndara në shumë prej 1,8 milion nga skema sociale e vitit 2018 të barten në vitin 2019.

Po ashtu presim përkrahje në projektet infrastrukturore në Prizren, sidomos në lagjen “Jeta e re” në shumën prej 150 mijë eurove dhe në rrugën “Janina” prej 120 mijë eurove, si dhe komunat tjera, siç janë: Gjakova, Peja, Fushë Kosova, Plemetini, Gjilani, Kamenica, Ferizaj, Novobërda, Shtimja, Theranda, Mitrovica në lagjen rome.

Mbetemi me shpresë që kjo kërkesë e jona të hasë në mirëkuptim të Qeverisë dhe ministrive dhe të gjejë zbatim nga ministrinë përkatëse, sepse edhe ne si komunitet rom jemi kontributdhënës në Buxhetin e Republikës së Kosovës për të cilin po diskutojmë sot, dhe meritojmë që së paku të trajtohemi të barabartë me të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi ka replikë me Zafir Berishën.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se gospodine Haliti!

I pored toga što ne želim da repliciram gospodinu Zafiru Beriši, s obzirom da smo i prijatelji Prizreni. Mi gospodine Beriša nismo x, y komunitet, i to trebata da znate, da vam bude jasno. Ja nikad nisam bila za odvajanje finansijskih kodova po ministarstvima. To zna i ministar Financija. Ali, iskustvo u ovom Parlamentu mi je pokazalo da samo na taj način možemo da damo doprinos svojoj zajednici. Zahvaljuem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha kundër-replikë!

ZAFIR BERISHA: Po më vjen keq, unë nuk thashë për askënd x, y, sepse nuk desha ta theksoj edhe në fund të fundit vetë u treguat se jeni prej atyre që i kontribuoni ndërtimit të objekteve mbi baza nacionale. Nuk është fjala veç për komunitetin boshnjak, por për të gjithë, meqë dole në shesh, po dua ta bëj me dije, objekti ku po ndërtohet 99,9% janë shqiptarë, nuk kanë të drejtë shqiptarët të zhvillojnë një aktivitet kulturor, shembull po e marr. Nuk jam kundër, mirëpo objektet aktuale dhe objektet që duhet të ndërtohen duhet të shfrytëzohen nga të gjithë dhe, në fund të fundit, unë prapë po rikthehem te ajo që e thashë në fillim, përcaktimi kushtetues i shtetit tonë. Dhe, në rast se ne edhe me ligj i kontribuojmë ndarjes, atëherë kush jemi ne dhe sa jemi në përputhje me atë përcaktim ligjor dhe kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti, kryetar i grupit.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Më lejoni të jap vlerësimet e mia për buxhetin e vitit 2019.

Vlerësoj që politikat e reflektuara në këtë buxhet nuk janë plotësisht në përputhje me nevojat që ka shteti i Kosovës.

Unë e kuptoj që diskrecioni për të bërë një buxhet për vitin e ardhshëm nuk është i plotë, sepse ka plot projekte që janë në vazhdimësi e sipër, por ajo hapësira që i mbetet në diskrecion ministrit, ministrive përkatëse dhe Qeverisë, besoj që ka pasur mundësi të përdoret pak më mirë për të targetuar prioritetet që ka vendi.

Po ajo që është më shqetësuese është që nuk është në përputhje edhe me objektivat e vetë programit qeverisës 2017-2021. Disa prej të cilave kolegët deputetë, edhe dje, po disa edhe sot po përmendet në veçanti të zhvillimi ekonomik dhe unë e dëgjova edhe arsyetimin dje që e dhatë sa i përket normës së rritjes ekonomike që potencialisht mund të ndikohet nga projektet e mëdha që mund të fillojnë eventalisht vitin e ardhshëm.

Më lejoni të ngre një çështje të programit qeverisës që nuk po reflektohet në këtë buxhet dhe këtu unë shoh pak shqetësim: çështjen e kalimit të arkëtimit tatimor nga kufiri në vend. Deri në vitin 2021 prapë të hyrat varen nga mbledhja e të hyrave nga doganat.

Tashmë me pakon fiskale, të ligjeve që prekin çështjet fiskale që i keni dorëzuar në Kuvend, besoj tash do të vijmë në shqyrtim, është paraparë edhe themelimi i një agjencie për mbledhjen e TVSH-së, ne nuk po lëvizim kah thjeshtësimi i agjencive që mbledhin të hyra dhe rrjedhimisht kalimi i mbledhjes së të hyrave në vend, po tash, ndoshta e sqaroni më vonë, po tentohet të komplikohet më tutje administrimi i mbledhjes së të hyrave dhe nuk pritet që të kalojmë te mbledhja e të hyrave brenda vendit.

Një çështje tjetër, në vitin 2019 82% e shpenzimeve mbulohen nga të hyrat buxhetore, 95% ka qenë këtë vit, më duket, ministër, vetëm 5% e shpenzimeve janë mbuluar nga të hyrat jo të rregullta buxhetore përmes kredive, huamarrjes ose përmes mjeteve të AKP-së, që nënkupton vashmëri më të madhe të buxhetit nga të hyrat jo të rregullta, që realisht ju e dini që rritet risku fiskal, sepse këto të hyra përveç nga huamarrjet nga marrëveshjet që janë të ratifikuara në Kuvend, këto të AKP-së janë subjekt i vendimeve që i ka Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Te shpenzimet rrjedhëse krejt rritja e të hyrave shkon te shpenzimet rrjedhëse, të cilat rriten me 27%, që në fakt bie ndesh me programin e Qeverisë, në faqen 36, ku thuhet që do të ketë

racionalizim të shpenzimeve publike. Unë kam parasysh që këto rriten, këto shpenzime korente janë të lidhur me disa skema sociale, po edhe shpenzimet për mallra dhe shërbime rriten.

E kam dëgjuar dje arsyetimin tuaj dje, kur keni thënë që disa investime kapitale është normale që të kenë edhe shpenzime të mirëmbajtjes së tyre, por kur hiqet ajo pjesë, prapë shpenzimet për mallra dhe shërbime rriten në mënyrë të paarsyeshme.

Pra, është rritur gjithashtu risku fiskal si rezultat i presionit për iniciativa të reja për transfere sociale, nëse dikush është brenda kësaj Qeverie që po mundohet t'ju bëjë presion futjes së skemave të reja në buxhet, jeni ju, po prapë dijeni që, besoj që ministri i Financave edhe në aspektin ligjor, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike i bie barra ligjore që ta ruajë qëndrueshmërinë e buxhetit, duke u siguruar që skemat që futen në buxhet nuk krijojnë paparashikueshmëri të shpenzimeve buxhetore për vitet që vijnë, duke u siguruar që skemat sociale që futen në buxhet të jenë mirë të targetuara, sepse tash po del që një pjesë shumë e vogël e shpenzimeve që shkon në skema sociale lidhen me varfërinë, e qëllimi i skemave sociale është varfëria, normalisht edhe pensionet e moshës, po në masë të madhe për varfërinë.

Te shpenzimet kapitale, është duke u ruajtur proporcioni i shpenzimeve kapitale brenda buxhetit, por tash vetëm 66% e shpenzimeve kapitale financohen nga buxheti i rregullt, 79% ka qenë këtë vit, 79% e shpenzimeve kapitale janë mbuluar nga buxheti i rregullt. Pjesa tjetër vjen nga fondet jobuxhetore dhe ju e keni parasysh riskun që vjen për shkak të këtyre, duke e rritur tash nevojën për financim të buxhetit prej 416 milionë euro.

Te shpërndarja e shpenzimeve kapitale nëpër komuna, është e qartë që kjo bëhet në baza partiake, investimet e reja.

Prapë këtu po citoj hulumtime të organizatave të pavarura, të cilat nxjerrin në shesh që nga 62 milionë që ka Ministria e Infrastrukturës që i çon nëpër komuna, 32% shkojnë në komuna që udhëhiqen nga AAK-ja, këto komuna kanë 18% të popullsisë.

Komunat që i udhëheq nga LDK-ja nga 28% të popullsisë, shkojnë 19% të buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës.

Ndërkaq te komunat që udhëheqin nga PDK-ja shpërndarja është e drejtë, është 13% e popullsisë, 13% të buxhetit.

VV-ja diskriminohet, vetëm 3% të buxhetit e merr.

Kur vjen puna te komunat që udhëhiqen nga PSD-ja, ku janë 13% të popullsisë, ato marrin 22% të buxhetit. Pra, bëhet fjalë vetëm për buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe unë e kuptoj



që ka plot projekte në vijim e sipër, po të kujdesemi që projektet e reja që fillojnë të marrim parasysh nevojat e komunave dhe jo kjo ndarja të bëhet mbi baza të tjera.

Te shpenzimet e tjera specifike, në veçanti dëshiroj edhe një herë të ngre çështjen shpenzimeve në Zyrën e Kryeministrit, ku parashihet të shtohet punësimi për 32 persona, nuk ka ndonjë arsyeshmëri të qartë, ku shkojnë këta njerëz dhe pse duhet të rritet punësimi në Zyrën e Kryeministrit që do të kushtojë një milion euro shtesë vetëm për pagat e këtyre njerëzve.

Ndërkaq, rritja e shpenzimeve për mallra brenda Zyrës së kryeministrit është për 6,5 milionë euro më shumë se në Qeverinë Mustafa, edhe nja 1,5 milion euro prapë shpenzime shtesë për subvencione brenda Zyrës së Kryeministrit.

Ministër,

Më lejoni të theksoj disa projekte minore, shumë të vogla, në Mitrovicën e Veriut në veçanti. Vitin e kaluar ne kemi dorëzuar amendamente si grup parlamentar për disa projekte në veriun e Mitrovicës, të cilat nuk janë zbatuar këtë vit, për arsye që ministritë përkatëse duhet t'i dinë, unë kam bërë edhe pyetje parlamentare, por nuk kam marrë përgjigje për këto. Për tri kulmet e shtëpive në Kodrën e Minatorëve, për fasadimin e shkollës "Aziz Sylejmani", për ndërtimin e shtëpive në lagjen "Kroi i Vitakut", në shkollën në Lagjen e boshnjakëve, në rrugën 'Sami Frashëri' dhe rruga "Tirana" që janë shpenzime që nëse krejt bëhen bashkë, nuk shkojmë më shumë se gjysmë milioni euro, duke qenë se edhe ju vini prej atij rajoni. Unë shpresoj që gjatë dy leximeve të këtij buxheti to t'i merrni parasysh.

Më lejoni të përmbledh në fund, vlerësoj që buxheti i vitin 2019 do të përballet me më shumë risqe fiskale se sa buxheti i këtij viti. Nuk ka përmirësim cilësor në strukturën e buxhetit, pasi shpenzimet kapitale mbahen njësoj sikur këtë vit, pra 1/3, edhe ajo 1/3 një pjesë më e vogël e tyre mbulohen nga buxheti i rregullt.

Dëshiroj të ngre një çështje edhe nga aspekti ekonomik, se rritja e vazhdueshme e huazimit të brendshëm përmes letrave me vlerë, ministër, ka rrezik të shkaktojë që ju e dini fenomenin 'crau denaut', që nënkupton zvogëlim të mjeteve për investime private, për shkak se ato mjete orientohen në financimin e deficitit buxhetor përmes huamarrjes nga banka.

Unë pashë që është rritur huazimi përmes letrave me vlerë 130 milionë euro, shto këtu edhe rifinancimin e huazimeve të mëhershme, besoj që duhet të jemi më të kujdesshëm që të mos shkaktojmë zvogëlim të investimeve private që bankat në Kosovë i financojnë.

21% e buxhetit shkon në skema sociale, po vetëm 3% për njerëzit që kanë nevojë, të sigurohemi që skemat të jenë të targetuar në bazë të nevojës që kanë njerëzit, e jo vetëm si shpërblim.

Shpresoj që disa prej këtyre vërejtjeve do të merren parasysh, minister, gjatë dy leximeve të buxhetit, në mënyrë që të kemi një buxhet të qëndrueshëm edhe për vitin e ardhshëm, po të sigurohemi që kjo qëndrueshmëri bartet përtej vitit 2019, në periudha afatmesme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka ministri, zoti Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit, ministër deputet, zoti Hoti!

Po filloj me këtë pjesën për projektet që i përmende dhe unë besoj dhe t'u kisha lutur që ta bësh një amendament gjatë punës mes dy leximeve dhe të gjitha ato për shkak të arsyeshmërisë, për shkak se kanë qenë edhe pjesë e buxhetit, do të jenë pjesë edhe buxhetit të vitit të ardhshëm dhe unë si ministër i Financave do t'i përkrah dhe besoj që do t'i përkrahë edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, po edhe të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, për shkak se vërtet janë projekte të mira dhe nuk janë projekte që kanë një kosto që e rrezikojnë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë buxhetore.

Më lejo vetëm t'i jap disa sqarime lidhur me disa çështje, siç është çështja e pagesës së TVSH-së në brendi. Ligji ka kaluar në Komision për Buxhet dhe Financa, ka kaluar në Qeveri, ka kaluar në Komision për Buxhet dhe Financa dhe unë pres që shumë shpejt të vijë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në moment kur të aprovohet ligji, ne prapë do të jemi shumë të kujdesshëm me zbatimin e kësaj reforme, sepse ne e dimë që nuk është e lehtë dhe besoj që me juve, minister, kuptohem shumë lehtë në këtë drejtim që duhet të jemi të kujdesshëm për shkak se jemi të interesuar të ecim në reforma, jemi të interesuar të krijojmë kushte më të mira për biznesin, po jemi të interesuar të ruajmë edhe qëndrueshmërinë e të hyrave për buxhetin e Kosovës dhe në moment kur të aprovohet ligji, ne do ta zbatojmë, po nuk kemi mundur në këtë moment pa kaluar ligji të planifikojmë diçka dhe të prejidojmë diçka, se koha kur do të kalojë e qysh do të kalojë, po ligji është në Kuvend dhe jemi duke iu përmbajtur asaj çka është e nevojshme dhe çka kemi premtuar.

Sa i përket mbledhjes së TVSH-së, nuk do të krijohet administratë e re, nuk ka nevojë të krijohet administratë e re, mund të ketë ndonjë riorganizimim edhe mi bazën e rekomandimeve të FMN-së brenda Administratës Tatimore, mirëpo kjo nuk do të krijojë institucione të reja në raport me këto që janë ekzistuese.

Sa i përket qëndrueshmërisë dhe mënyrës së financimit, në mandatin e parë si ministër kam pasur rregulla më strikte, më të forta, mirëpo ndërkohë është paraqitur nevoja dhe ne kemi pasur rregullën e deficitit që nuk ka lejuar të rritet përmes klauzolës së investimeve. Duke pasur për bazë nevojat e financimit, sidomos për projektet kapitale, ne e dimë të dytë që është bërë një

plotësim-ndryshim i kësaj rregulle dhe është lejuar mundësia më e madhe mbi atë deficitin primar përmes klauzolës të investimeve, po vetëm për projekte kapitale dhe kryesisht këto investime janë për projekte kapitale dhe është fat i mirë që pjesa dërmuese e tyre tashmë e kanë financimin e qëndrueshëm, sepse marrëveshjet janë të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës.

Buxheti është ndërtuar duke i respektua tri rregullat që janë në fuqi: edhe rregullën e pagave, edhe rregullën e deficitit primar, edhe rregullën e bilancit bankar.

Sa i përket rritjes së skemave sociale, vetëm te pensionet ka ndodhur rritja, po e kemi pasur një situatë ku tri ligje kanë qenë të aprovuara në mandatin e kaluar, po nuk kanë qenë të financuara, nuk kanë qenë të buxhetuara dhe janë të domosdoshme, mund të themi që nuk janë të domosdoshme, po e kemi bërë financimin e plotë edhe të atyre ligjeve.

Sa i përket rritjes së investimeve kapitale, rritja ka ndodhur 11%, sigurisht se një pjesë më e madhe të hyrave të rregullta shkojnë për financimin e shpenzimeve rrjedhëse, mirëpo nëse e marrim edhe të kaluarën sa ka qenë niveli i ekzekutimit të buxhetit, ne e shohim se pikun e kapitaleve e kemi mbërritur më 2012, pastaj e kemi pasur një rënie dhe viteve të fundit jemi sjellë aty diku rreth 400 milionë eurove, kjo e ka ndryshuar situatën.

Sa i përket Zyrës së kryeministrit, punësimet kanë ndodhur në dy agjenci, të them të drejtën, tash Agjencia e Statistikave dhe Agjencia e Veterinës, pse janë në zyrë të kryeministrit, kanë qenë edhe në të kaluarën, janë edhe sot, është çështje që ndoshta mund të diskutohet. Po rritja e punësimeve ka ndodhur kryesisht në këto dy agjenci, në Agjencinë e Statistikave dhe në Agjencinë e Veterinës.

Ndërsa sa i përket rritjes së buxhetit, pjesa më e madhe i atribuohet ndryshimit, riklasifikimit si rezultat i rekomandimeve të Zyrës së Auditorit, ku kemi një kalim prej kapitaleve në mallra dhe shërbime, sepse i kemi pasur edhe blerjen e vaksinave si investime kapitale dhe normalisht ka ndodhur ky riklasifikim dhe ka kaluar te mallrat dhe shërbimet dhe te disa kategori të tjera.

Dhe, te çështja letra me vlerë, që me shumë të drejtë e ngrehni, zoti Hoti, këtë vit ne kemi planifikuar që vitin e ardhshëm të ndajmë mjete buxhetore, ta kryejmë vlerësimin kreditor të vendit dhe ka nevojë vendi, ka nevojë që vendit të përgatitet për EUROBON, ta ndërrojë strukturën e borxhit, sepse kapitali dhe potenciali i brendshëm thuajse ka prekë atë pikun dhe mund të llogarisim që në pafundësi tregu i brendshëm do të mund t' i plotësojë nevojat për mbulimin e deficitit primar.

Gjithashtu jemi në diskutim me Bankën Botërore dhe unë jam shumë optimist që një pjesë e borxhit të planifikuar për vitin e ardhshëm për mbulimin e deficitit primar, që është 135 milionë euro, të jetë me Bankën Botërore, që është një instrument i ri, një DPL që ne ta shfrytëzojmë

diku për nja 50 milionë që të mbulojmë borxhin e brendshëm. Përndryshe, do të thotë nëse s'e bëjmë në kohë vlerësimin kreditor, s'e përgatitim vendin për të pasur EUROBON në një të ardhme, sigurisht se ose duhet planifikuar deficitin buxhetor në zero, ose nuk mund të llogarisim në potencialin e tregut të brendshëm. Dhe projektet të cilat ju i propozuat, zoti ministër deputet, sigurisht se do të jenë pjesë e buxhetit të Kosovës edhe për vitin 2019 dhe uroj që kudo që të vendosen, pastaj ato të ekzekutohen, jo vetëm të jenë pjesë e buxhetit, po edhe të ekzekutohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Mimoza Kusari.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Falënderoj dhe ndjesë kolegëve, se kërkova përjashtim për radhën, faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në trajtimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019, edhe këtë vit, sikurse vitin e kaluar, dua të theksoj që nuk është ky një debat midis nesh deputetëve dhe ministrit të Financave, edhe pse me shumë përgjegjësi e mbron gjithmonë buxhetin, është një debat, i cili duhet të jetë midis nesh dhe prioriteteve zhvillimore ose mungesës së prioriteteve zhvillimore të Qeverisë Haradinaj, të prezantuara përmes buxhetit të vitit 2019.

Në fakt, ky buxhet e tregon më së miri situatën në të cilën është vendi, e tregon normën dhe shkallën e lartë të klientelizmi që kjo Qeveri e ka prezantuar përmes këtij buxheti dhe e ka sjellë për miratim.

Në masë janë disa prej projekteve të bartura nga viteve nga Qeveria Mustafa, të vazhduara në Qeverinë Haradinaj, megjithatë nuk ka asnjë orientim të ri në raport me projektet zhvillimore kapitale, përveç se ka rritje të kategorive, të cilat e parashohin apo nxisin rritjen apo varshmërinë nga buxheti i shtetit, gjegjësisht rritjen e asaj çfarë e fillova, klientelizmit.

Në substancë buxheti do të duhej të përmbante ose të prezantonte prioritetet zhvillimore, të mirëmbajë dhe të menaxhojë nevojat dhe domosdoshmëritë si secili buxhet i shtetit si dhe të ngrejë vetëdijen dhe të shërbejë si orientim për politikën e shtetit për qytetarët e saj.

Çka u tregojmë qytetarëve të Republikës së Kosovës me buxhetin e vitit 2019?

E para, u tregojmë se ky buxhet nuk ka buxhetim gjinor, përmenden këtu rajonet, komunat, fshatrat, rrugë, komunitetet, ndërsa buxheti i Republikës së Kosovës tash e 20 vjet nuk arrin të ketë një buxhetim gjinor, të tregojë se cili është ndikimi i projekteve tona në 50% të popullatës, në gjysmën e popullatës së Kosovës, e cila gjithmonë përmendet qoftë si viktimë, qoftë nëpër

kategori të veçanta ose në ditë dhe në muaj të veçantë, në muajin mars, por nuk jemi në gjendje të përgatisim një buxhet, i cili e tregon ndikimin në 50% të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Tjetra, ky buxhet nuk e përmban asnjë orientim strategjik, kemi pasur seanca të jashtëzakonshme për çështje të energjisë. Kemi pasur diskutim dhe rezolutë për çështjen e projektit Kosova e Re. Kemi diskutuar tri qeveri radhazi për projektin e Brezovicës. Është folur e është bërë fushat për aeroportin e Gjakovës, është folur, është premtuar Zona industriale amerikane, a figurojnë ndonjëra prej këtyre projekteve me emër në buxhet? Asnjëra.

Qeveria e Republikës së Kosovës na tregon se e mirëmban situatën apo status quon duke i mbajtur në lista qoftë të pensionistëve, qoftë të kategorive të veçanta mbi 450 milionë euro, të cilat janë, në fakt, të buxhetit nga Ministria e Mirëqenies në subvencione dhe transfere, përderisa të gjitha subvencionet dhe transferet e ministrive të zhvillimit ekonomik: Ministria e Zhvillimit, Ministria e Tregtisë, Ministria e Inovacionit, të gjitha së bashku bëjnë jo më shumë se 11 milionë e 700 mijë euro.

Ndërsa subvencione dhe transfere nga Ministria e Arsimit janë 6 milionë e 41 mijë euro. Rrjedhimisht del se një shtet, i cili synon të ketë një orientim properëndimor dhe të gjitha partitë në pushtet, siç u tha më herët, janë të orientimit të djathtë, kanë të gjitha politikat e majta, bile-bile skajshmërisht të majta, si dhe në masë përjashtojnë një numër të popullatës nga planifikimi i saj dhe këta janë të rinjtë që synojnë vendet e punës dhe synojnë Perëndimin për një mundësi të jetës më të mirë dhe, natyrisht ata të aftësuar profesionistë ose ndërmarrës, të cilët duan të kenë një mekanizëm mbështetës nga shteti për idetë inovative apo idetë kreative.

Çka mund të themi, përderisa në kuadër të kategorisë Zonat industriale nëpër Kosovë kemi të ndarë për vitin 2019, 2 milionë euro, domethënë të gjitha janë së bashku, 2 milionë euro për zonat industriale nëpër Kosovë, ndërsa vetëm mirëmbajtja e autostradës Morinë-Merdar i merr 3 milionë euro. Ndërsa mirëmbajtja e autostradës tjetër, që është tash edhe në ndërtim, merr një milion euro, autostradës për Hanin e Elezit.

Të gjitha këto e tregojnë një koncept, i cili është mirëmbaj dhe menaxho situatën e krijuar edhe më herët, të vazhduar nga kjo Qeveri, zgjat dhe rrit nivelin e shpenzimeve, po rriti ato shpenzime të cilat për të realizuar e kanë ciklin shumë të shkurt. Domethënë, nëse i rrisim shpenzimet në projekte në të cilat do të kemi tender, e kemi ciklin shumë të shkurtër të kthimit të atyre mjeteve nëpër të gjitha linjat ku ato tenderohen.

Dhe këtu po flas për një zinxhirë të tanë të sistemit korruptim, i cili mirëmbahet nga këto projekte, duke filluar nga niveli më i ulët te niveli më i lartë, po ka pak shumë interesim për t'u investuar në ato projekte, të cilat e kanë ciklin më të gjatë të realizimit. Ato projekte, të cilat natyrisht nëse investojmë në zona industriale, nëse investojmë në ide inovative apo në

subvencione për idetë më kreative të të rinjve, të cilët po na bëjnë krenarë natyrisht të gjithëve kur po paraqiten, po kryesisht janë me projekte të donatorëve, atëherë aty nuk po kemi interesim, se për ta kthyer investimin në një ide kreative të ndërmarrësis duhen më së paku pesë vjet, neve na duhen mjetet shpejt, kjo është logjika e kësaj Qeverie. Na duhen ato mjete që investojmë, i nxjerrim 10%, 20% apo edhe 30% prej këtyre projekteve kapitale.

Nëse shikohet struktura e përgjithshme e ministrive dhe investimeve, Ministria e Infrastrukturës, natyrisht u tha shumë herë sot e dje, mbi 215 milionë investime në kapitale. Ministria e Shëndetësisë, në mallra dhe shërbime apo babra, 42 milionë, domethënë asfalti në raport me shëndetin e popullsisë në proporcion një me pesë.

Përderisa Ministria e Mirëqenies, si megaministri e kësaj Qeverie me buxhet, duke e rritur masën e madhe të klientelizmit i mban mbi 460 milionë.

Tash e kom një pyetje. Ne të gjithë folëm dhe u bë një debat shumë i madh për listat e veteranëve, u tha tash edhe prokuroria i ka gati aktakuzat e para. Nuk po e shoh që ka ndryshuar buxheti prej vitit të kaluar, në fakt, vetëm është rritur për këtë vit. Nëse ne kemi lista të cilat do të reduktohen, pse është rritur buxheti? Ose parimisht mendohet se do të reduktohen. Pse buxheti për listat e veteranëve komplet dhe invalidë shkon në 100 milionë euro, po lista komplet, buxheti i Ministrisë së Arsimit është në 60 milionë euro. Ministria e Arsimit në të gjitha nivelet e arsimit, prej parashkollor, deri në arsimin universitar dhe akademitë dhe institutet e tjera, domethënë ne nuk e kemi as qëllimin që të vëmë drejtësi në një element, i cili po shihet ashiqare që është një element, i cili ka masë të madhe të ndikimit dhe korrupsioni që është përcjellë.

Çka më bën përshtypje edhe një sferë tjetër, e cila me të vërtetë po degradon në masë të madhe. Shumë projekte kapitale, të buxhetuara prej Qeverisë Mustafa, të bartura te Qeveria Haradinaj, në këtë buxhet kanë ardhur me linjë të financimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjegjësisht mjeteve apo fondeve që kanë shkuar nga të gjitha asetet e vendit tone, nga asetet që janë ndërtuar me dekada të tëra, tash në këto hynë, për shembull, Kompleksi i tenisit në Gjakovë ka qenë i buxhetuar me buxhet të shtetit, pse duhet të pritët me buxhetin e Kosovës, pse tash një masë e madhe ka kaluar me fondet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që duhet të kalojë edhe një herë nëpër këtë Kuvend.

Njëjtë është Qendra Kulturore në Has, ka qenë e buxhetuar me Buxhetin e Kosovës, prapë masa më e madhe ka kaluar me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

E njëjta është me Qendrën e Mjekësisë Familjare, është nisur dhe është buxhetuar prej kohës së Qeverisë Mustafa dhe tash prapë ka kaluar 360 mijë euro, të gjitha kanë kaluar në Agjencinë e Privatizimit. Cila është logjika prapa këtyre, cila është logjika e financimit të objekteve të tilla me Fondin e Privatizimit? A nuk do të duhej të ishte një logjikë tjetër, ku do të investonit në zona

industriale, në parqe industriale, në ide kreative inovative, fondet e një periudhe të caktuar të industrializimit që ka qenë me sistemin e kaluar. Shtesë kësaj, po dua të flas edhe për dy elemente, të cilat i përkasin komunës së Gjakovës. Qendra Rinore në Gjakovë është kërkuar, të mos them, me vite e vite të tëra. Është thënë edhe është premtuar shumë që këtë vit do të bëhet. I lajmëroj të gjithë se Qendra Rinore e Gjakovës nuk është prapë në buxhet, është një qendër e organizatës 'MCA' që e ka, ka ndarë buxhet edhe Ministria e Kulturës, është organizatë ndërkombëtare, si nënkuptohet, qendër rekreative në fshatin Pjetërshan. Por, Qendra Rinore, e cila është kërkuar për të gjithë të rinjtë e komunës së Gjakovës, nuk është pjesë. Një aset tjetër, i cili nuk është dhe është premtuar shumë, është stadiumi i Vëllaznimit në Gjakovë. A e dini cilat komuna kanë përfituar me buxhetin e sivjetëm në stadione? Veç po jua përmend: Prishtinë, Deçan, Podujevë, Suharekë, Gjilan, Pejë, Ferizaj, Kaçanik, Prizren, tri stadione janë të Prizrenit, Rahovec, Drenas, Ratkoc Rahovec, Zhur Prizren, Kamenicë, Viti, Lipjan, Novosellë, Studençan të Suharekës, Mitrovicë, Dragash, Hani i Elezit, Gjonaj, domethënë është Gjonaj Prizren, është 3-4 Zhur, Prizren, e të tjera. Me krejt respektin për të gjitha, gjithkund duhet të investohet në sport, po a bën të di ku është stadiumi i Vëllaznimit në Gjakovë? Nuk është në buxhet stadiumi i Vëllaznimit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër Hamza e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit, deputete, zonja Kusari Lila,

Po, ku ka shkuar rritja e buxhetit? Ka shkuar në arsim, shëndetësi, ka shkuar në rritje të investimeve kapitale. Dhe, nuk besoj që shërbimet shëndetësore të përmirësuara nuk kanë efekt edhe te gjinia femërore. Unë pajtohem me atë që, po më shumë ky shtet duhet të bëjë për gjininë femërore, por shërbimet e këtij sektori nuk i përfiton veç njëra gjini, i përfitojnë të dyja. Në arsim përfitojnë të dy gjinitë, rrugët nuk i shfrytëzojnë veç meshkujt, po i shfrytëzojnë edhe femrat. Tash, a duhet bërë më shumë, pajtohem, por megjithatë do të thotë rritja e buxhetit ka shkuar në sektorët, të cilët i përmenda.

Nuk është buxheti për arsimin veç në Ministrinë e Arsimit. Arsimi si sektor në buxhetin e vitit 2019 i përfiton për herë të parë afërsisht 300 milionë, në nivelin lokal, qendror dhe nëpër universitete. Shëndetësia, për herë të parë fiton financim prej 234 milionëve. Diskutimet po e sipërfaqësojnë atë, e kam thënë edhe unë, po e ri përsëris, që secili nëse e përcjellim me vëmendje debatin, dikush thotë ka pak fonde për arsim, tjetri pak për shëndetësi, tjetri pak për infrastrukturë, krejt domethënë e kemi të qartë, po këto janë mundësitë reale për financim dhe duhet pasur të qartë që buxheti, nëse ekzekutohet dhe besoj që po, qysh është i planifikuar, është 261 milionë euro më shumë se sa buxheti i vitit 2018.

Te çështja e veteranëve, pse është buxhetuar në këtë nivel? Derisa nuk kryhet rikategorizimi, derisa nuk bëhet mbyllja e listave, Ministria e Financave ka obligim të veprjë sipas ligjit bazik. Prandaj, kur të ndodhë rikategorizimi, kur të ndodhë mbyllja e listave, atëherë mund të shohim se cilat do të jenë fondet.

Sa u përket mjeteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimi, është e rregulluar, është mirë që është e rregulluar që këto mjete mund të përdoren vetëm për financimin e projekteve kapitale. Nuk ka mundësi të përdoren për diçka tjetër dhe, tek e fundit, organizatave buxhetore edhe projekteve nuk është me rëndësi kah e ka bazën e financimit, kjo është me rëndësi për nivel pak më makro dhe për Ministrinë e Financave, po a e ka bazën e financimit prej të hyrave të rregullta, a e ka bazën e financimit prej kredive, a e ka bazën e financimit prej mjeteve të AKP-së, për projektin edhe për organizatën buxhetore, kjo nuk ka shumë ndikim të madh. Ndërsa, sa i përket zhvillimit ekonomik, ngarkueshmërisë me borxhe të Ministrisë së Financave, është çështje e ndarë. Ndërsa, i përmendët disa projekte, po janë projekte në vazhdim, projekte të caktuara, nuk po mund të ekzekutohen brenda 1-2 vjetësh. A pajtohem që duhet qenë dinamika më e mirë e ekzekutimit të projekteve, sidomos kapitale, gjithsesi. Mirëpo, ne nuk mund të themi hajde ka filluar rruga, autostrada për Gjilan, e ndalim, apo për Mitrovicë, apo për Shkup, apo për Pejë, janë projekte në vazhdim dhe nëse e marrim totalin e projekteve që janë në buxhetin e vitit aktual, del që diku rreth 80% sigurisht apo më tepër janë projekte në vazhdim që sigurisht që e kanë kohën e ekzekutimit për më shumë se një vit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, zonja Kusari Lila ka replikë.

**MIMOZA KUSARI LILA:** Faleminderit, ministër, për sqarimet! Por, buxhetimin gjinor unë nuk mendova që projektet janë me përfitim vetëm të njëjës gjini, por buxheti gjinor është proces, i cili duhet të ndodhë në ministrinë tuaj, i cili jep vlerësimin e saktë se sa është përqindja e përfitimit të njëjës gjini në raport me investimet kapitale që ju i bëni. E kam bërë sa kam qenë kryetare e Komunës së Gjakovës për tre vjet radhazi, është një provës shumë i mirë, unë besoj që keni kapacitete të mjaftueshme profesionale në kuadër të ministrisë që vitin e ardhshëm ose qoftë edhe rishikimin të vijë buxheti me vlerësimin e buxhetimit gjinor.

Unë nuk po them që këtu s'ka, domethënë përfitim nga të gjitha kategoritë, por duhet të jetë një vlerësim profesional, i cili e tregon. Sa i përket kapitaleve nga AKP-ja, nuk e kontestoj që duhet të jenë të investuara, po e them që pse nuk shkojnë në kuadër të projekteve të zhvillimit ekonomik, e përmenda edhe një herë është për keqardher me të vërtetë që zonat industriale të kenë vetëm 2 milionë për tërë Kosovën dhe të mos jenë zona, të cilat vetë edhe kryeministri, edhe të tjerët i kanë promovuar dhe keni marrë vendime të Qeverisë, nuk figurojnë askund në kapitale apo në investime, atëherë për çfarë po flasim. Nëse Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i mbështet në buxhetin e vet projekt-idetë apo edhe vendimet e qeverisë, kush do t'i mbështesë?



Dhe, tjetra është që, po, në kuadër të asaj që e përmende shumë saktë, edhe e kategorive të huave, për mua është me të vërtetë ende brengosëse niveli i ulët i investimeve në efikasitet të energjisë nga buxheti i Kosovës, ndërsa krejt është e vendosur te huatë apo edhe te fondet e donatorëve. Përderisa kemi projekte, të cilat mund të paraqesin rrezik, siç është projekti i Kosovës së Re, ishte dashur që kapacitetet apo edhe aftësitë në efikasitet të rritet masa, e jo të jetë aty, 78 milionë ishte krejt buxheti për gjithë Kosovën në një kategori që është huamarrje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zonja Kusari-Lila, të siguroj që gjithçka do të kërkoj edhe vetë do të interesohem gjithçka çka ke pasur mirë në aspektin e buxhetimit gjinor në Komunën e Gjakovës, atë praktikë të mirë do ta bart edhe në nivelin qendror. Hiç s'e kam atë shqetësim dhe atë problem. Ndërsa, sa i përket impaktit në rritjen ekonomike, do të thotë investimet kapitale kanë impakt në rritjen ekonomike, tash ne mund të diskutojmë disa projekte që a ishte dashur, po ato çka janë dhe kanë kontratë, duhet të përfundojnë, nëse s'përfundohet, i dimë pasojat me të cilat përballemi. Prandaj, investimet kapitale kanë ndikim në zhvillimin ekonomik, mjetet e AKP-së 100% është obligative dhe përdoren për financimin e projekteve kapitale, ndërsa sa u përket prioriteteve brenda investimeve kapitale, sigurisht se ai që është në pushtet, ai i cakton prioritetet, ndërsa pozita sigurisht ka prioritete të tjera dhe pret që kur të vijë ndonjëherë në pushtet ta bëjë implementimin e prioriteteve të veta.

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë, fjalën e ka zonja Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që e përcillini që dy ditë debatin për Projektbuxhetin e vitit 2019.

Diskutimet t'i dëgjosh një nga një, shumica po shihet që kishte pasur nevojë shumë t'u hyjmë reformave të thella zgjedhore, sepse shumicën e diskutimeve e kemi të koncentruar nga zonat elektorale dhe kjo po mendoj që është pak normale. Megjithatë në fillim të fjalimit tim më lejoni të falënderoj si anëtare e Grupit Parlamentar të PDK-së ministrin Hamza, jo vetëm për komunikimet që e ka pasur me neve, por vazhdimisht e kam përcjellë komunikimin me çdo deputet, edhe durimin. Nganjëherë edhe për kërkesat e joarsyeshme dhe e pranuar ose jo, ministër i nderuar, të kemi pasuri humane të kësaj Qeverie, kështu që kemi kohë një vit të të kritikojmë, por sot është edhe koha për të falënderuar për durimin dhe për përgatitjen e një projektbuxheti të arsyeshëm dhe të kuptueshëm edhe për ne, të cilët nuk jemi dhe të drejtuar profesionalisht ndaj ekonomisë, ndaj financave.

Fjalimin tim e kam ndarë në tri pjesë: pra, do të koncentrohem te propozimet për buxhetin që orientohet në agjenci, të cilat i monitorojmë, i mbikëqyrim si Komision Funkcional. Te buxheti

në nivel lokal sigurisht do ta kem koncentrimin edhe unë nga komuna e Vushtrrisë, kryesisht dhe te buxheti i përgjithshëm. Përgëzoh për rritjen e buxhetit në drejtësi, shëndetësi dhe arsim dhe sigurisht që jeni në një pozicion sfidues, kur dihet që vitin 2019 do të kemi edhe ushtrinë e Kosovës dhe do të ketë nevojë për një buxhet shumë të madh, po ashtu reforma në Administratën Publike, ku kemi ligje shumë sfiduese, të cilat do të paraqesin edhe ndryshim të linjave buxhetore, të skemave. Ndërsa, po filloj me nevojën që në këtë buxhet, në projektbuxhet të kemi pra të ndara mjete për digjitalizimin e transmetimit digjital. Pra, jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi ende këtë proces s'e kemi kaluar dhe kemi vazhdimisht kritika në Raportin e Progresit, kështu që ministri i ka dëgjuar me vëmendje kërkesat e komisionit, mirëpo duket që ende s'ka pasur hapësirë të vendoset një buxhet për procesin e digjitalizimit që duhet të kalojë vendi ynë në vitin 2019, sepse është momenti i fundit.

Te Kodi 0922 e kam parë, tek arsimi, pra, përkrahjen e nxënësve me potencial të jashtëzakonshëm, ku është një vlerë e ndarë prej 200 mijë euro dhe shihet që është një mendim shumë i mirë, i logjikshëm, mirëpo unë mendoj që është një vlerë ndoshta edhe e vogël, sepse jo vetëm këta nxënës, po edhe ata kujdestarë, të cilët kanë nevojë të rrinë, t'i mbikëqyrin këta nxënës, besoj që duhet të motivohen, sepse është një punë e veçantë që bëhet me ta dhe për herë të parë te ne në Ministri të Arsimit bëhet kjo ndarje buxhetore.

Po ashtu, ju përgëzoh për rritjen e pensioneve kontributdhënëse dhe të tjera dhe mendoj që do të kemi mundësi ndoshta, pse jo me rishikim që të ketë edhe rritje të vazhdueshme në këtë drejtim, ndërsa tani më lejoni të koncentrohem te projektet kapitale, për të cilat disa janë në fillim të procesit, disa të tjera janë në vazhdimësi. Për shembull, projektet kapitale të nivelit qendror 2019-2021, konkretisht unë do të kem propozim dhe sigurisht edhe amendament, te Kodi Buxhetor 14975, ku është ndërtimi i rrugës magjistrale Nedakovic- Smrekovicë -Vushtrri, ku mjetet janë të ndara afërsisht 2 milionë dhe shpresoj që kjo ndarje rezulton edhe me materializim të punëve. Pra, kjo rrugë nuk do të zgjidhte problem nëse nuk do të ketë një rrethrotullim pikërisht në vendin ku ndërlidhen dy zona të mëdha, Zona e Çiçavicës dhe e Shalës, ku frekuentojnë mbi 40 mijë qytetarë. Pra, është në fshatin Pestovë, ku ndërlidhen pastaj edhe si një bajpas, pra, me rrugën rajonale R220, e cila është në ndërtim. Ka nevojë për një rrethrotullim, i cili i ndërlidh fshatrat që lidhin, pra Shalë dhe Çiçavicë mu në fshatin Pestovë, ku ndërlidhet me Druar, Mihaliq, me fshatrat e Mitrovicës, me fshatrat e Drenicës dhe me fshatrat e Shalës.

Këtë do ta kem si amendament dhe unë shpresoj që do të përkrahet, pastaj po ashtu të njëjtën rrugë do të nevojitet rrethrotullimi mu pranë Burgut të Smrekonicës, ku ndërlidhen mbi 20 mijë banorë dhe nëse nuk do të ketë një rrethrotullim në këtë vend, do të ketë pengesë në qarkullim. Pra, nuk do të jetë ndihmë, por vetëm pengesë. Unë do të kërkoj që te projekti i madh R220, për të cilin kam ngritur vetë iniciativë me përkrahjen e kryetarit Veseli dhe Qeverisë së kaluar, që projekti të përfundojë në vitin 2019, sepse është një vështirësi shumë e madhe e qarkullimit të mijëra banorëve të këtyre anëve, meqenëse dihet që këta jetojnë, pra krejt prej aktivitetit bujqësor

dhe ka pasur jashtëzakonisht probleme këtë vit, për shkak që ka filluar ndërtimi, pastaj mirëmbajtja ka qenë shumë e vështirë, sepse rruga u bë e pamundur për qarkullim.

Te projekti, te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 10 vjet ka që Komuna e Vushtrrisë vit pas viti ka ndarë një pjesë të buxhetit për të participuar, më vjen mirë që ministri u kthi këtu, i Mirëqenies Sociale dhe i Punës dhe këtë do ta kem amendament, pra është fjala për një ndërtesë për familjet e dëshmorëve. Domethënë, është një pronë e ndarë nga komuna në kohën kur Bajram Mulaku si kryetar nga radhët e PDK-së e ka ndarë atë pjesë me Kuvendin Komunal dhe është e vetmja komunë që s'ka përfituar asnjëherë një ndërtesë sociale. Ato familje të dëshmorëve ka fëmijë, të cilët sot i kanë 20 vjet edhe jetojnë me axhallarë, pra kanë nevojë që të kenë një banim të vetin, dhe për këtë po besoj që do ta kem përkrahjen e ministrit të Punës dhe ministrit të Financave. Pra, do ta kem amendament që të fillojë në vitin 2019 ndërtesa për familjet e dëshmorëve, prona është legale dhe është e dhënë nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, për këtë besoj që do të kem përkrahjen. Pastaj, rregullimi i shtratit të lumit Sitnica, janë ndarë 100 mijë euro, janë shumë pak, sepse ka fshatra të tëra që kur vjen koha e vërshimeve, vjeshta, këta jetojnë prej bujqësisë dhe ato është e pamundur pastaj t'i mirëmbajnë, kështu që me rregullimin e këtij lumi, Sitnicës, shtratit, me shtimin e buxhetit do të evitohen këto probleme.

Tek Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë janë të ndara për memorialin e martirëve në Studime të Vushtrrisë 50 mijë euro. Ne kemi shumë nevojë që të shtohet ky buxhet, sepse kemi varrezat në qytet që janë për të gjithë ata martirë dhe të cilat është e pamundur t'i mirëmbahen, sepse s'ka buxhet komuna. Pra, këto janë disa nga propozimet, për të cilat disa prej tyre do t'i kemi amendamente dhe, po ashtu, ndërtimi i Palestrës sportive në Samadrexhë të Vushtrrisë është një projekt kulturor, por edhe shumë shpirtëror për ata banorë. Ka filluar që katër vjet, tash janë ndarë 150 mijë euro, mendoj që ky duhet të përfundojë në vitin 2019, sepse e dëmton ndërtesën që është në ndërtim që katër vjet, dhe ata mezi e presin, sepse janë komunitet sportiv dhe e kanë mirëpritur fillimin e ndërtimeve që po ashtu është projekt që ka filluar në kohën kur PDK kishte pushtetin në Vushtri. Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe besoj që gjatë amendamentimit do të kemi një punë të vazhdueshme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Ismajl Kurteshi.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit!

Përshëndetje për deputetët dhe qytetarët e Kosovës,

E di që është rëndë për ministrin t'i përcjellë të gjitha këto debate, por vërtet e kisha lutur ministrin e Financave që të jetë këtu dhe t'i dëgjojë propozimet e deputetëve në lidhje me projektbuxhetin që sot po e shqyrtojmë.

Unë jam fokusuar në buxhetin për arsim, kulturë, rini dhe sport, në pjesën që edhe këtu merrem me këto komisione.

Buxheti për arsim në vitin 2019 do të rritet për 22.6 milionë euro, ose 7%. Shpenzimet totale për arsim në vitin 2019 do të janë 324 milionë euro, ose 14% e buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Gjatë vitit 2019 në institucionet e arsimit në Kosovë do të punojnë 34 mijë e 220 punëtorë. Gjatë vitit 2019 numri i punëtorëve që planifikohet të rritet për 74, të gjithë ata do të punojnë në MASHT. Kurse, 34 prej tyre do të punojnë në administratë, derisa në Agjencinë Kosovare për Akreditim, që është agjencia më e rëndësishme në këtë vend, punojnë vetëm 5 veta, të cilët përkujdesen për 30 institucione të arsimit të lartë dhe mbi 30. Nga buxheti i planifikuar për investime kapitale do të ndërtohen vetëm dy shkolla të reja, që do të kushtojnë nga 700 mijë euro secila, kurse për inventar dhe laboratorë, që shumë u mungojnë shkollave në Kosovë, janë planifikuar të shpenzohen vetëm 1 milion euro. Për komunat në të cilat mësimi zhvillohet në tri ndërrime nuk është paraparë fare buxhet. Por, kabinetit të ministrit të Arsimit buxheti i është rritur 33%, ose nga 288 mijë euro në 382 mijë euro.

Buxheti i Ministrisë së Arsimit për vitin 2019 është paraparë të jetë 69,2 milionë euro, ose 21,4% të buxhetit të përgjithshëm të arsimit dhe 11,2 milionë euro, ose 19% më i lartë se në vitin 2018. Sipas kategorive buxhetore: për paga dhe mëditje janë planifikuar rreth 19 milionë euro, rritja në krahasim me vitin 2018 është 10%. Për mallra dhe shërbime janë planifikuar 17,1 milionë euro, në krahasim me vitin 2018 rritje është 7,2 milionë euro, ose 74% më e lartë. Shpenzime kapitale ka gjithsej 25,5 milionë euro të parapara, për subvencione dhe transfere janë planifikuar gjithsej 6 milionë euro, ngritja do të ketë 1,2 milionë euro, ose 25%. Buxheti për arsim në komuna në vitin 2019 është rritur për 10,3 milionë euro, ose 5%. Për arsimin në komunat e Kosovës janë planifikuar 218,8 milionë euro, ose 67,5% e buxhetit për arsim.

Në buxhetin e planifikuar për vitin 2019 nuk është paraparë buxhet i veçantë për hulumtime shkencore. Nga 22,2 milionë rritje për vitin 2019, 11,2 milionë i ndahen Ministrisë së Arsimit, kurse për arsimin e të gjitha komunave ndahen vetëm 10,3 milionë. Nga 11,2 milionë të Ministrisë, 7,2 milionë euro shkojnë për mallra dhe shërbime, ose 74% më shumë mjete se në vitin e mëparshëm. Në vitin 2018 shpenzimet kapitale do të ngritët vetëm për 1 milion euro, ose 4%, derisa kabinetit të ministrit buxheti i rritet 33%. Buxheti i Universitetit të Prishtinës do të rritet për 950 mijë euro, ose 3%. Buxheti i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, buxheti për kulturë në vitin 2019 planifikohet të jetë 58,2 milionë euro, ose 2,5% e buxhetit të shtetit. Në krahasim me vitin 2018 pritet ngritje prej 8 milionë eurosh, ose 16%. 4,9 milionë euro nga buxheti i rritur shkon në ministri, kurse 3,1 milionë euro rriten buxhetet komunale për kulturë, rini dhe sport. Buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të jetë 41,4 milionë euro, kurse ai i komunave do të jetë 16,5 milionë euro.

Gjatë vitit 2019 institucionet kulturore planifikojnë të kenë të punësuar 1 mijë e 440 punëtorë, pjesa më e madhe do të punojnë në ministri. Në ministri planifikohet të punësohen edhe 12 punëtorë të rinj. Buxhetin për kulturë nuk ndahet njësoj nëpër komuna: Hani i Elezit, Juniku, Ranillugu dhe Shtërpca nuk kanë planifikuar fare buxhet për kulturë, derisa Komuna e Lipjanit

për kulturë i ka planifikuar 10 % të buxhetit të komunës. Derisa buxheti i kulturës është rritur për 19%, buxheti për rini është paraparë të zvogëlohet për 14%, ose rreth 400 mijë euro, edhe buxheti për trashëgimi kulturore është zvogëluar 8%, ose rreth 450 mijë euro, që janë lajme të këqija dhe që do të duhej të ndërmerrej diçka që të mos zvogëlohet buxheti për rininë, derisa sporti e ka një buxhet solid.

Buxheti për inovacione dhe ndërmarrësi për vitin 2019 është 12 milionë euro, ose 22 për qind më i madh se në vitin 2018. Këtu po e përmend vetëm një fakt që pagat në këtë ministri, nga 260 mijë do të shkojnë në 370 mijë euro edhe pse nuk ka të punësuar të rinj në këtë ministri.

Zoti ministër po ju përkujtoj që në janar të vitit 2017 ky Kuvend ka miratuar rezolutën me të cilën arsimin e ka shpallur prioritet kombëtar. Në pikën e parë të rezolutës kërkohet rritje e theksuar e buxhetit për arsim. Me 7 për qind rritje, kur kësaj ia shtojmë edhe menaxhimin e dobët, vështirë që mund ta ndryshojmë arsimin. Arsimi nuk mund të ndryshohet me shkolla që punojnë në tri ndërrime, me mësues që janë pranuar në mënyrë të rregullt dhe nuk marrin rroga që dy vite, siç është rasti i 16 mësuesve të Fushë Kosovës ose me punë vullnetare të koordinatorëve të cilësisë, të cilët janë pranuar në mënyrë të rregullt, ose derisa vetëm pesë për qind e fëmijëve të Kosovës shkojnë në çerdhe publike dhe nëpër shkollat tona mungojnë pedagogët, psikologët, mjekët dhe të tjerët. Prandaj, kërkuj nga ju zoti ministër që ta futni në prioritet që kudo që ka shkolla me tri ndërrime, ato të eliminohen. Ministri i Arsimit në vitin 2017 ka premtuar se në vitin 2018 nuk do të ketë më shkolla me tri ndërrime, por të tilla ka nëpër Kosovës. Rreth katër mijë nxënës nga komuna e Gjilanit shkojnë në shkolla me tri ndërrime e me orë të mësimi 30 minuta, e pa mjete pune, pa laboratorë, e lëre më pa digjitalizim që është problem i nivelit të Kosovës.

Kështu që nëse këtë fushë e kemi shpallur prioritet nacional, duhet t'i rrimë gati me buxhet, por natyrisht nuk është buxheti i vetmi ai që e ngrit cilësinë në arsim, që është dobësi e jona dhe që është edhe një argument që del edhe nga një raporti i NDI-së. Unë shpresoj që ju do të reflektoni në këtë drejtim dhe do ta ndihmoni arsimin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Bedri, a deshe ta marrësh fjalën? Atëherë, ministri i Ambientit e ka fjalën.

**MINISTRI FATMIR MATOSHI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E mora fjalën për të bërë vetëm një sqarim për ndoshta një keqkuptim ose joinformim të drejtë në fjalimin e deputetit Selmanaj që ishte pak më parë në lidhje me projektet në fushën e mjedisit.

I nderuar deputet, 1,2 milion euro janë grante të ndara për komunat më të suksesshme në aktivitetin që jemi duke zhvilluar aktualisht, në fushatën ta pastrojmë Kosovën. Ky premtim dhe ky grant është shpallur më 15 shtator, është paraparë në buxhetin e Ministrisë së Mjedisit dhe kemi aprovuar edhe kriteret mbi të cilat do të shpërblehen pesë komunat më të suksesshme përgjatë këtij aksioni dhe këto 1.2 milionë euro do t'u jepen komunave drejtpërdrejt në projektet e tyre në fushën e mjedisit. Pra nuk ka të bëjë me një aktivitet të një organizate joqeveritare, përkundër respektit që kemi edhe për punën, edhe për angazhimin e organizatave joqeveritare në fushën e mjedisit dhe ndihmën që na e bëjnë përditë. Këto mjete do të përcaktohen nga task-forca Ta pastrojmë Kosovën. Do t'u ofrohen komunave dhe janë komunat ato pastaj që përcaktojnë se ku do të implementohen këto projekte. Gjithashtu them se janë 2,4 milionë euro në fushën e mjedisit dhe janë edhe 15 milionë euro të tjera që investohen në vitin 2019 në lumenjtë e Kosovës, në projektet e ambientit dhe të trajtimit të lumenjve dhe për këtë falënderoj edhe ministrin Hamza për bashkëpunimin, edhe gjithë kabinetin qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po zoti Selmanaj, replikë!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit zoti ministër për sqarimin! Por, në fakt, unë prapë kam dilema e mia. Pse ju këtë projekt e keni vendosur te projektet kapitale, jo te grantet ose subvencionet, sepse ju projektet e tjera i keni ndarë te projektet kapitale. Për shumë komuna keni thënë në filan komune ndërtimi i një deponie, në filan komune blerjen e 100 kontinierëve, filan komune ndërtimin ose mbjelljen e drurëve për hapësirat e gjelbra. Kurse te ky projekt keni thënë kështu: Projekti Ta pastrojmë Kosovën ka vlerën 1 milion e 200 mijë euro. Asnjë sqarim të detajuar. Sepse edhe nëse mund ta kuptojmë këtë si një shërbim që të ndahet prej dikujt, p.sh. për sensibilizimin e njerëzve, për nevojën për pastrimin e Kosovës. Kjo ka procedura, ka kriteret si shpallet. Mund të aplikojnë një mijë OJQ, 50 OJQ, 40 OJQ, dhe më pas në bazë të kriterëve ju mund ta zgjidhni një organizatë e cila mund të fitoj projektin me të cilin më pas bashkë me komunat e realizojnë këtë qëllim. Kjo më tepër është si shërbim, por kjo s'mund të futet te projektet kapitale. Ishte dashur të jetë te subvencionet dhe grantet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ministri, zoti Matoshi.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Ndoshta e sqaroj më tepër.

I nderuar deputet,

Bëhet fjalë për projekte kapitale. Ne nuk kemi mundur ta sqarojmë më tepër në buxhet, sepse nuk mundemi ta paragjykojmë a do të jetë Komuna e Prishtinës përfituese, a do të jetë Komuna e Gjilanit, e Vitisë apo cila komunë do të përfitojë. Por në task-forcë kemi vendosur që pesë komunat që kanë treguar rezultatet më të mira në fushën e ambientit do të shpërblehen me projekte në investime kapitale në vlerë 1.2 milionë euro. Këto 1.2 milionë euro do të përdoren për projekte të investimeve kapitale: rregullim të parqeve, rregullim të hapësirave gjelbërues, mbjellje të drurëve dekorativë, varësisht prej përcaktimit që e bën komuna e cila është shpallur

përfitues e këtyre fondeve. ose në fakt pesë komunat që do të shpallen përfituese të këtyre fondeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Balje.

DUDA BALJE: Hvala vam!

Poštovani potpredsedniče,

Poštovani poslanici,

Svi oni koji nas ispratite pored TV ekrana,

Danas raspravljamo o budžetu i verovatno ste imali priliku da od svih mojih prethodnika poslanike iz manjinske zajednice čujete praktično, isto znam da ministre imate problema s nama, ali mi imamo jako veliki problema s budžetom. Naši problemi nekako idu iz godine u godinu, i opet se vezuju za Ministarstvo za povratak, koje bi inače trebalo da bude naša Ministarstvo za zajednici i povratak, koje bi trebalo da bude naša adresa, međutim vi svi dobro znati da mi ostale zajednice od tog Minista- rstva nikad ništa nismo dobili, i nikada ništa nećemo ni imati i jav ma ministre, žao mi što premijer nije tu, mogu da u ime svih poslanika čak i predlažem da se ime Ministarstva promeni. To za povratak neka ostane, a ono za zajednice mislim da je banalan naziv za funkciju koju obavlja.

Ja se nadam daćemo i ove godine naći načina da naše zajednice budu deo ovog budžeta, kao i svake godine, i ministre ne mogu a da ne ponovim da nam je jako bitno rekonstrukcija puta Prizren - Prevalla - Cerje 115. Ona je uvrstena u ovom budžetu sa jednom određenom sumom, mi smo napravili amandman, a imamo podršku svi poslanike iz Prizrena da se ta suma poveća i da se već jednom taj put koji je jako rizičan dovede u red.

Podsteknutom ove sume x y, hoću ta kažem da meni je loše ukoliko svih poslanici iz većinske zajednici se osećate loše kada odvajate budžet za manjinske zajednice. Manjinska zajednica koju ja predstavljam, ona Bošnjaka jeste Kosovska zajednice, i mi jesmo kosovari i Bošnjaci, ona zajednica koja ne misli dobro Kosovo ona danas nije ovde prisutno na ovoj seansi. To može i da mi bude krivo, i ne mora da me bude krivo s obzirom na to da ste vi predstavnici albanske zajednice naravno da se više brinete o svojoj zajednici. Mi nažalost u ovom Parlamentu imamo i poslanice iz Bošnjačke zajednice, koja je samo da vam kažem ne znam kako da vam se izvinim za sve laže koje su iznošene juče.

Čudi me ona u Parlamentarnoj grupi AAK govori u krađi premijera, vlade i premijera, jednog Ministarstva za regionalni razvoj gde je permanentni sekretar iz te partije. Da li to treba te vi gospođe Teuta, i svi koji ste u toj Parlamentarnoj grupi da razumete da jedan član vaše Parlamentarne grupe govori o krađi vašeg Ministarstvo, odnosno ministarstva premijera koja je formirana od strane premijera, gde je permanentni sekretar ponovo iz vaše partije. Ja znam da tu

krađe nije bilo i znam da se ovde manipuliše lažima čiste radi dobijanja nekih poena koje naravno ne postoje.

Opet me to ništa ne čudi da je protiv vas kada je ona protiv svih Bošnjaka i protiv svih šesto radnih mesta koje Ministarstvo otvorilo, i protiv sudije Ustavnog suda koje bio Bošnjak, i protiv svi Bošnjaka koje inače ovde dolaze. Znači ne čudi me ništa. Ne čudi me da Ministarstvo za zajednice i povratak u kome imamo ponovo Bošnjaka za zamenika ništa nije uradilo, pa se ponovo ne pljuje po njemu, nego se pljuje po drugim ministarstvima, koje se nažalost nešto i rade. Hoću da vam kažem da upravo ta poslanica je pljuvala po maloj partije koalicije Vakaf, koja je najveća koalicija ovde koja postoje od posle rata, druga partija, odnosno koalicija formirana na Kosovu, i to je ustvari ona partija od koje dotična poslanica uvek gubi, ta partija nju pravih gubitnikom.

I ne razumom koliko ta partija treba da bude mala, pa koliko ona treba da bude velika, jer je gubitnik na svim i na svakim izborima. I ja opet kažem ne mogu da imam "respekt për ty" sa takvim osobama, i žao mi je što ste vi svi Kosovari i svi ovde vi kolegi juče morali da slušate ovako nešto. Nije ni čudo da se uvek pljuje po onome ko radi, da se ne pljuje oko onome koji ne radi, i ja ne razumem i da se bavim ni imenom, neću za spomenem ime poslanice uopšte, jer misom da to ne zasluzuje, i oću još jednom ministre da vam se zahvalim za sve što radili za našu zajednicu i ja sam sigurna da ćete i ono što ste radili, ono što ćete naravno uraditi, i evo gledam vas, i moram da vam kažem da je vaše ima puno puta u našoj zajednici zloupotrebljana od strane iste osobe. Znači u javnosti su iznosile projekti gde se spominjalo vaše ime koje vi niste nikad ni potpisali, niti ste imali zahtev za takve projekte. Takva manipulacija sa radi i sa predsednikom Skupštine, znači i to je nešto što se ponavlja iz godine u godinu.

Opet vam kažem to je nebitna osoba sa nebitnim rečima, nama sada je bitan budžet, bitno nam je da se svi amandmani koje smo dali, evo i kod Ministra za Sport i Kulturu, da nam budu uvršteni u budžetu, i da naša Bošnjačka zajednica, bez obzira na partijsku pripadnost, bude korisnik svega toga. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë? Ok! Edhe ti Teutë do replikë? Ok! Zonja Emilija Rexhepi, replikë!

EMILIJÀ REDŽEPI: Hvala gospodine Haliti!

S obzirom da sam jedina Bošnjakinja u ovoj Parlamentu, i to se odnosi na mene, i toliko sam nebitna da uzimam deset minuta prostora i hvala na tako dobroj reklami, i ponovo želim da se zahvalim ministru Financije, gospodinu Bedri Hamza, na svim projektima što nam je pomogao do sada, i ponovo želim da gospodina Rasima Demirija, koji je ministar za Regionalnih razvoj, pokušala sam juče da ga izvučem dosta od strane drugih poslanika koji su ga kritikovali, ali sada



ne želim. Sada želim da pozovimo unutrašnjih reviziju da preispita situaciju u Ministarstvo za ekonomski razvoj. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zonja Balje!

DUDA BALJE: Ja ne razumem ko ovde ima pravo da traže reviziju, jer znate šta - neznanje i kompleksi urade svašta. Ja se izvinjivam svima koji ovo slušate.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot po shqyrtojmë Projektbuxhetin për vitin 2019, pra njërin nga projektligjet më të rëndësishme i cili ka të bëjë me planifikimin, apo më mirë të themi me ndarjen buxhetore për vitin 2019. Ndarja buxhetore e cila ishte dashur të bëhet duke u nisur mbi bazën e parimeve të shëndosha dhe jodiskriminuese nga Qeveria, pra Qeveria nëpërmjet këtij projektbuxheti është dashur të bëjë ndarjen apo planifikimin e buxhetit mbi bazat e nevojave të qytetarëve. Mirëpo, nga ajo që shohim është e kundërta.

Nga ajo që kam analizuar nga ky projektbuxhet, kam arritur t'i vërejë këto çështje që do t'i theksoj në vijim. Shpenzimet për paga dhe mëditje vazhdojnë të mbajnë një pjesëmarrje të konsiderueshme të shpenzimet e përgjithshme. Subvencionet dhe transferet, pra shpenzimet për subvencione dhe transfere do të vazhdojnë të rriten edhe gjatë vitit 2019. Mallra dhe shërbime, po ashtu shpenzimet për këtë kategori në vitin 2019 pritet të rriten për 27,3 për qind në krahasim me vitin paraprak. Shpenzimet kapitale do të rriten vetëm me 11 për qind të buxhetit të vitit 2019 në raport me buxhetin për vitin 2018.

Pra keni theksuar se Qeveria ka prioritet ruajtjen e stabilitetit makrofiskal si dhe menaxhimin e përgjegjshëm të financave publike, mirëpo po dëshmohet e kundërta. Miliona që u ndanë për lobim të njohjeve, atyre për anëtarësim nëpër organizata ndërkombëtare e të cilat dështuan, kjo tregon më së miri se sa keni pasur menaxhim të përgjegjshëm të parasë publike.

Po ashtu vlen të theksohet se edhe shpenzimet e fundit të cilat u raportuan edhe përmes mediave, se gjatë muajit tetor Qeveria ka rritur dukshëm shpenzimet e luksit, ku për mallra dhe shërbime ka shpenzuar 15,8 milionë euro nga 10,3 milionë sa ishin shpenzuar gjatë muajit tetor të vitit 2017. Po ashtu në bazë të të dhënave të Ministrisë së Financave në kategorinë buxhetore të identifikuar në raport si subvencione dhe transfere gjatë muajit tetor të këtij viti janë shpenzuar 41,6 milionë euro, nga 31,3 milionë euro sa ishin shpenzuar në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Kjo më së miri tregon pra menaxhimin e financave publike sesi është duke ndodhur.

Edhe në vitin 2019 si duket do të kemi buxhet social, si rezultat apo mungesë e një strategjie për zhvillim të mirëfilltë ekonomik, si rezultat apo mungesë e planifikimit për nxitjen dhe promovimin apo mbështetjen e hapjes së vendeve të reja të punës për dy kategoritë të cilat janë më se të nevojshme, të mbështeten pra siç janë të rinjtë dhe gratë. Nuk mbështeten të rinjtë vetëm duke i lutur që të mos lëshojnë vendin, pra të mos migrojnë, por të rinjtë mbështeten me politika të mirëfillta për krijim të vendeve të reja të punës, krijim të mundësive për të jetuar një jetë të dinjitetshme.

Një shumë e konsiderueshme e buxhetit do të shkojë për Qeverinë me numër të madh të ministrave dhe të zëvendësministrave. Pra siç kemi vërejtur pothuajse kemi rritje të buxhetit për çdo kabinet të ministrave për shkak të rritjes së stafit nëpër kabinetet e tyre me zëvendësministra, këshilltarë, asistentë e shoferë.

Unë do të ndalem te ndarja e buxhetit për ministrinë. Te Ministria nëse ia analizojmë projektbuxhetin për shëndetësi, shëndetësia edhe pse e pro reklamuar si prioritet, mirëpo ka pasur një rritje, mirëpo unë konsideroj se nuk është një rritje e konsiderueshme e buxhetit për t'i adresuar problemet me të cilat ballafaqohet sektori i shëndetësisë, apo më mirë të themi me problemet që ballafaqohen pacientët tanë. Nuk ka furnizim me barna, pacientët detyrohen që ende t'i blejnë barnat nga buxheti i tyre familjar. Po ashtu, ende duhet të presin me muaj për të marrë shërbime. Rritja si ajo nuk besoj që do të ketë ndikim aq të madh në përmirësimin e këtij sektori. Sipas kësaj, qytetarët janë ata që do të pësojnë me shërbime jo të mira, mungesë në barna si dhe pritje të gjata në marrjen e shërbimeve të caktuara. Është planifikuar që në vitin 2019, te kjo ministri numri i punëtorëve të rritet për Ministrinë e Shëndetësisë të rritet për 100 punëtorë në vend që të kemi këtë numër të punëtorëve nëpër spitalet regjionale ku është theksuar se ka mungesë të stafit, pra ka ndodhur e kundërta.

Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale planifikohet të jetë 465,8 milionë euro. Krahasuar me vitin 2018, buxheti i kësaj ministrie planifikohet të rritet për 57 milionë euro, apo për 14%.

Kryesisht për shkak të rritjes së subvencioneve dhe transfereve diku 15%, ndërsa te kategoritë tjera ekonomike parashihet një rritje e lehtë e buxhetit, kurse te kategoria e shpenzimeve kapitale do të ketë një zbritje për 1 milion euro, në krahasim me vitin paraprak.

Te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mendoj se duhet të kemi buxhet edhe më të madh, si dhe të kemi prioritet përkrahjen e implementimit të masave aktive të tregut të punës, nëpërmjet të cilave do kemi një nxitje dhe përkrahje direkt për hapjen e vendeve të reja të punës, përkrahjen e të rinjve dhe të femrave në punësim.

Pra, buxheti për politikat e punësimit përbën vetëm 2% të buxhetit të kësaj ministrie. Kjo tregon më së miri se çfarë politikash të punësimit do të kemi për vitin 2019 nga Qeveria.

Te buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë, buxheti për arsim planifikohet të ketë ngritje për vetëm 7%. Shpenzimet për arsim janë planifikuar të jenë diku rreth 14% të totalit të shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Kjo tregon se sa është prioritet strategjik i kësaj Qeverie arsimimi dhe ngjitja e cilësisë në arsim.

Me këtë buxhet të planifikuar nuk do të ketë rritje të cilësisë në arsim, dhe përmirësimin e rezultateve në të ardhmen, Kosova edhe ka nevojë për investime në infrastrukturën fizike, mirëpo është i domosdoshëm, më mirë të themi urgjent investimi në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nga ajo që është parë në këtë projektbuxhet, shihet se në kuadër të Departamentit për Rini kemi një zbritje të buxhetit për 391 mijë euro apo minus 14%, krahasuar me buxhetin e vitit 2018.

Edhe pse nëpër konferenca e fushata deklarojnë se rinia është e ardhmja, siç po shihet nuk ka përkujdesje për të, e kjo tregon më së miri se sa është ndarë buxhet për rininë.

Tani po ndalem në ndarjen e buxhetit nëpër komuna, e me theks të veçantë, më konkretisht në Komunën e Klinës, së cilës i është ndarë buxhet në vlerën prej 10 milionë e 138 euro. Po ashtu, kemi edhe disa projekte kapitale që mbështeten nga ministritë apo Qeveria, disa projekte të caktuara të cilat konsideroj se nuk janë të mjaftueshme për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Klinës.

Unë do t'i veçoja disa projekte që janë të rëndësishme për Komunën e Klinës. Në këtë rast kërkoj nga Qeveria që t'i marrë parasysh këto projekte: ndërtimi i një aneksi të shkollës "Motrat Qiriazit" në Klinë, ndërtim që do të ndikonte në përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Komunën e Klinës. Ky projekt është planifikuar në kuadër të reformave të procesit arsimor për mësim ditor, si dhe për krijimin e hapësirave për trajnim të personelit arsimor në komunë, duke pasur për bazë rritjen e numrit të nxënësve si pasojë e lëvizjes së popullatës fshat - qytet.

Po ashtu, një projekt tjetër i rëndësishëm për Komunën e Klinës është ndërtimi i fushave ndihmëse sportive. Aktualisht në Komunën e Klinës ekziston vetëm stadiumi i qytetit dhe palestra sportive dhe nuk ka asnjë fushë ndihmëse sportive për zhvillim të aktiviteteve sportive, kështu që ndërtimi i fushave sportive mendoj se do të jetë më se i nevojshëm për të rinjtë e Komunës së Klinës.

Një projekt tjetër të cilin e kanë kërkuar banorët e fshatrave Qypevë e Ulët dhe Qupevë e Lartë është një rrugë, e cila lidh këto dy lokalitete me rrugën magjistrale Klinë - Gjakovë, kurse një

projekt i cili është shumë i rëndësishëm është projekti për asfaltimin e rrugës dhe trotuareve edhe tek Ujëvara e Mirushës. Siç e dini, parku i Mirushës është një nga zonat më të bukura që ka Kosova, dhe kërkoj një asfaltim të rrugës që do të ketë ndikim direkt në rritjen e numrit të vizitorëve dhe turistëve për ta vizituar këtë bukuri natyrore.

Pra, asfaltimi i rrugës, trotuareve, si dhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri i Kulturës, zoti Gashi e ka fjalën.

**MINISTRI KUJTIM GASHI:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Vetëm për sqarim edhe ndaj deputetit zotit Selmanaj, po edhe ndaj zonjushës Kalludra, sa i përket buxhetit të Ministrisë së Kulturës, përkatësisht Departamentit të Riniës, jo që ka zbritje, por përkundrazi ka rritje të buxhetit, por dallimi është tek kategoritë. Pra, kemi një zbritje te pjesa e kapitaleve për shkak se nuk ka nevoja të reja për investime kapitale në fushën e rinisë, përkatësisht për ndërtimin e qendrave rinore, sepse ne një pjesë tashmë po e përfundojmë, kurse te subvencionet kemi rritje për shkak të një programi të ri, të cilin e kemi paraparë edhe në strategjinë e re për rininë. Pra, e kemi një fond të rinisë dhe e ka një kosto prej rreth 1 milion euro, pra kemi një ngritje të buxhetit në Departamentin e Rinisë.

Kurse, zoti Selmanaj sa i përket Shtëpisë së Kulturës në Suharekë, ne gjatë vizitës e kemi konfirmuar një mbështetje shtesë për këtë projekt edhe me kontaktet që kemi pasur me kryetarin e Komunës, por edhe me kompaninë gjatë vizitës. Por, t'jua them të drejtën, tash me ridestininim të mjeteve ne e kemi ndarë një fond prej rreth 300 mijë euro për këtë projekt, por fatkeqësisht Komuna dhe kompania nuk i kanë kryer punët për mjetet të cilat janë ndarë, dhe na është dashur ta ridestinojmë këtë fond dhe ta drejtojmë në një projekt tjetër, sepse nuk ka pasur punime të përfunduara për aq mjete sa ne kemi ndarë.

Përkundër kësaj, ne në vazhdimësi kemi qenë të interesuar që këtë projekt ta përfundojmë vitin e ardhshëm, sepse edhe mjetet për këtë vit i kishim të ndara, por edhe për vitin e ardhshëm do t'i ndajmë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën. Zoti Selmanaj, replikë!

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, zoti ministër!

Në fakt, veç ma sqaro edhe pak, se nuk e kuptova qartë. Kur është menduar ky ridestininim i mjeteve prej 300 mijë eurove, sepse unë në projektbuxhet vetëm e pashë që në vitin 2019 figurojnë 150 mijë euro. Nuk ka sqarim tjetër.

Cila është mbikëqyrja juaj ndaj kompanive? Sepse nëse nuk një kompani nuk i kryen punët, atëherë unë mendoj që duhet procedura tjera, sepse me këtë trend...

Unë ju thashë më herët, por nuk ishit këtu, ky projekt kap shifrën diku mbi 3 milionë euro. Vjet kanë qenë më duket 100 mijë, sivjet 150 mijë, ndërsa shifra totale është 250 mijë. Me këtë trend i bie që edhe 30 vjet që Suhareka të mos ketë Shtëpi të Kulturës.

Prandaj, vetëm ma sqaro pak më shumë, sepse nuk e kam të qartë. Faleminderit!

**MINISTRI KUJTIM GASHI:** Faleminderit!

E para, për sqarim, për projektet të cilat bashkëfinanciohen, pra edhe nga komunat edhe nga ministria, në bazë të memorandumit duhet të ndahen mjete nga të dy palët.

Komuna e Suharekës nuk ka pasur mjete të ndara për këtë projekt dhe është dashur që i gjithë financimi të bëhet nga Ministria e Kulturës.

Gjatë vizitës që kemi pasur në maj, jemi zotuar që kompania t'i vazhdojë punimet dhe ne me rishikim të buxhetit t'ia ndajmë 300 mijë euro. Meqë nuk ka ndodhur rishikimi i buxhetit, ne po ashtu kemi kërkuar nga kompania që t'i vazhdojë punimet, sepse me ridestnim do t'ia ndajmë mjetet. Por, nga kontakti i fundit që kam pasur me kryetarin e komunës, më thotë që të mos ndajmë mjete shtesë për shkak se kompania nuk i ka përfunduar punimet në bazë të marrëveshje, edhe në bazë të zotimit ne që e kemi pasur.

Sa na përket neve si ministri, kemi qenë të gatshëm që ta realizojmë zotimin tash me ridestnim të mjeteve, por fatkeqësisht Komuna dhe kompania nuk i kanë kryer punët e veta. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, zoti Beqa e keni fjalën.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot dhe dje kemi diskutuar për Projektligjin për buxhetin. Konsideroj që Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës është moment shumë i rëndësishëm si për institucionet e vendit, ashtu edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Është e kuptueshme se Qeveria apo koalicioni i cili i ka fituar zgjedhjet, nëpërmjet buxhetit pretendon ta realizojë programin e vet qeverisës për një jetë më të mirë për qytetarët, si në zhvillimin ekonomik, për hapjen e vendeve të punës, për një arsim më të mirë, sundim të ligjit

më efikas, reforma në drejtësi, avancimin e shëndetësisë, sportit, kulturës dhe në përgjithësi që ta lehtësojë jetën e qytetarëve të vendit të vet.

E kam analizuar buxhetin, nuk jam ekonomist në këtë rast, por e kam parë me vëmendje këtë projektbuxhet. Kemi një rritje të investimeve kapitale, e cila rritje konsideroj dhe në bazë të atyre analizave shihet që ka impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, në prioritetet nacionale, në përmirësimin e infrastrukturës; në arsim, shëndetësi në ujësjellës, në përpunimin e ujërave të zeza, infrastrukturë sportive etj. Por, kemi edhe sfida të cilat besoj që nëpërmjet këtij buxheti, Qeveria e Republikës së Kosovës të paktën ka pretenduar që të bëjë në zgjidhje.

Sfidë e jona është ikja e kuadrove nga vendi nga të gjitha fushat, ndoshta edhe nga punëtorët e thjeshtë, por sidomos kemi pasur ikje të kuadrove të nivelit të shëndetësisë. Por, kur i kemi parasysh hapat që i ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë, e kemi një rritje për buxhetin e ministrisë prej 19,8%, dhe besoj që kjo do të ndikojë në këtë sferë.

Te skemat sociale u shpjegua shumë, kemi një rritje 16%, por pasi është edhe ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, nga ai kisha kërkuar që të shikojë me theks të veçantë, edhe pse ka bërë hapa, te Inspektorati i Punës ne çdo ditë po ngremë çështje në Parlament për humbjen e jetës që po e pësojnë punëtorët në Republikën e Kosovës.

Vetëm këtë vit deri më tani kemi dhjetëra të lënduar. I kemi 22 qytetarë të vendit që kanë humbur jetën në vend të punës, andaj të shikohet edhe kjo pjesë që të forcohet Inspektorati i Punës, si nga numri, por edhe infrastrukturë, që të kemi një zhvillim në këtë sektor, sepse konsideroj se është një prej sektorëve më të rëndësishëm.

Te arsimi e kemi një rritje 10,5%, siguria publike 6%, zhvillimi ekonomik e ka një rritje më të theksuar - Ministria e Zhvillimit Ekonomik 67%, por kjo ka impakt te ndërmarrjet publike, gjë që do të ndikojë sidomos në ujësjellës dhe kanalizim.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 11%; Ministria e Sportit, 16%; edhe në Inovacion kemi një rritje, që mendoj që po ndikon te ndërmarrësit e rinj, edhe start up i kemi 22%. Në përgjithësi, të mos ndalemi në përqindje, por shihet që shumica e sektorëve kanë rritje.

Unë nuk do të ndalem te projektet të cilat janë në këtë buxhet, sepse u thanë edhe nga kolegët deputetë, kemi shumë projekte që kanë vazhduar nga vitet paraprake, por kemi edhe nisma të reja.

Edhe pse ne jemi një zonë zgjedhore, i kam parë projektet nga zona që vij, shumica prej tyre që i kemi diskutuar, si në nivelin lokal, por edhe me ministrin e Financave dhe me Qeverinë janë të

përfshira, por do të ndalem në dy-tri pozicione. Nuk qenka ministri i Financave këtu, por do të shikoj t'ri rregullojmë edhe nëpërmjet amendamenteve.

E kemi një rast të ndërtimit të një shkolle fillore në Ponoshec. Ponosheci është në Komunën e Gjakovës, e ky projekt ka qenë që 4-5 vjet, komuniteti nuk e ka pranuar një shkollë të atij projekti që nuk ishte sipas kërkesës së komunitet, por ishte më i vogël, kurse tani është paraparë ndërtimi i shkollës për tre vjet, 37 mijë euro. Nuk po e kuptoj ngase me 37 mijë euro nuk ka asnjë mundësi që të mendohet ndërtimi i shkollës, por këtë duhet ta shikojë edhe ministria, por edhe Qeveria në përgjithësi, në të kundërtën duhet ta bëjmë një amendament.

Në të njëjtën kohë e kemi përfundimin e punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra, aty janë shtuar edhe 3 fshatra, janë 31 fshatra të Komunës së Gjakovës, kryesisht janë të Rekës së Keqe, sepse në pjesët tjera është duke u punuar dhe projektet janë në përfundim e sipër.

Janë ndarë 150 mijë euro që janë të pamjaftueshme për këtë projekt dhe është kërkesë e regjionit atje, në këtë rast edhe e ujësjellësit regjional “KUR Gjakova”, që të shikohet mundësia të përfshihet në buxhet, në të kundërtën na imponohet që nëpërmjet amendamenteve ta bëjmë ndërmjet dy leximeve.

U tha këtu nga disa kolegë që qendra rinore, përveç një qendre që është duke u bërë në Pjetërshan të Komunës së Gjakovës, që është edhe me donatorë, nuk është paraparë, edhe pse është premtuar. Është një pajtim ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale që objekti i QKMF-së në Gjakovë, ku stafi do të kalojë në objektin e ri, që QKMF-ja të rinovohet dhe të mbetet qendër rinore, që janë pajtuar atje edhe komuniteti, në këtë rast edhe rinia, por megjithatë duhet të shtohen mjete për renovimin e kësaj qendre, se nuk ka mundësi të jetë e gatshme menjëherë pa pasur paraprakisht një investim.

Në të njëjtën kohë, ishte ministri i Kulturës këtu, tash nuk qenka, është premtuar stadiumi, tha ka shumë stadione, edhe shumë mirë që ka, stadiumi i klubit futbollistik “Vllaznimi” në Komunën e Gjakovës. Kisha kërkuar, e di që është e pamundur, se këto janë mundësitë buxhetore, që ndoshta të ndahen shuma të mëdha, por të paktën ta kemi një amendament ose nëpërmjet nesh si deputetë, ta kemi një kod buxhetor për stadiumin që të nisë dhe ta kemi praktikisht, por jo vetëm të flasim politikisht, por ta kemi një hap konkret.

Nuk qenka këtu ministri i Financave, e as ministri i Zhvillimit Ekonomik, por janë edhe disa projekte të mëdha që kanë ndikim edhe në regjionin e Kosovës, sidomos për ujë të pijes, u tha edhe nga kolegët. Është diskutuar edhe në nivel të ministrave dhe në nivele të Qeverisë në përgjithësi, sidomos për furnizimin me ujë të pijes për dy komuna.

Në këtë rast ndoshta për Komunën e Suharekës ndërron destinacioni, sepse në bazë të analizave të fundit të bëra nga ujesjellësi “Gjakova”, duhet të furnizohet nga liqeni Radoniqit në Gjakovë, është bërë projekti. Dhe, në njëjtën kohë edhe Komuna e Malishevës të dy projektet janë dorëzuar në Qeveri, kisha kërkuar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe ai i Financave ta shikojnë mundësinë që të paktën nëpërmjet grandeve të implementohen këto projekte, sepse është e mundur, dhe ajo pjesë e Kosovës, e në veçanti Malisheva ka problem me burime të ujit, kurse është e mundshme të furnizohet sipas projektit “KUR Gjakova”.

Unë nuk dua të them diçka tjetër. Do ta jap kontributin tim ndërmjet dy leximeve, por kisha kërkuar edhe nga kolegët dhe sidomos nga opozita që kur të vijë momenti edhe këta të bëjnë amendamente dhe ne u premtojmë që unë të paktën si deputet do t’i përkrah, por në të njëjtën kohë me kusht që edhe këta duhet të jenë pjesë e votimit të atyre amendamenteve dhe buxhetit, dhe jo vetëm të flasim “hajt pak” dhe të mbetet vetëm debat. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë, meqenëse një pjesë e deputetëve ka dalë nga salla dhe është koha e drekës, po marrim pushim deri në orën 15:00. Ju kisha lutur që në orën 15:00 të ktheheni në sallë, ta përfundojmë debatin dhe pastaj të shohim se kur e votojmë.

\* \* \*



*Vazhdimin e mbledhjes plenare, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, fjalën e ka zoti Imet Rrahmani,

IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, kaq pak që jeni këtu,

Të nderuar qytetarë,

Sepse Qeveria ende nuk po na bashkohet, si duket nga lëvdatat e mëdha që i pati ministri Hamza i morën mësysh e tash nuk i kemi këtu, jo që kam çka të them diçka jashtë çka kanë thënë kolegët, po së paku të jap mendimin lidhur me propozimin për Ligjin e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Këtu shumë çka u tha, mirë e keq, po një fakt është që rritja e buxheti në përmasa që është prezantuar është një rrjedhë normale dhe e pritshme për vendet siç jemi ne.

Çdo vit, çdo ministër ka dalë dhe ka thënë që këtë vit e kemi buxhetin më të madh se vitin e kaluar, sepse Kosova jo që është nisur nga zero, po Kosova në këto dy dekada ka qenë minus prej shkatërrimeve, luftës, shkatërrimit të ekonomive familjare, bizneseve, infrastrukturës, e të tjera dhe janë nisur prej minusit e kemi ardhur në zero, edhe është normale që ne të zhvillohemi dhe çdo vit të kemi një rritje të buxhetit në parametra çfarë po prezantojmë. Nuk është diçka që na duhet të gëzohemi dhe të kënaqemi, po është krejt rrjedhë normale.

Dhe, kjo rritje ekonomike çfarë po prezantohet tash, nuk është diçka që mund të mohohet, por nuk është diçka që edhe mund të na kënaqë neve dhe të themi që jemi në rrugë shumë të mirë, sepse ajo zbrazësia mes zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe zhvillimit ekonomik të vendeve e në regjion dhe sidomos të Evropës është shumë e madhe dhe me këtë trend na duhen edhe shumë e shumë vjet që ne të arrijmë përmasat zhvillimore ekonomike dhe buxhetin e vendeve edhe në regjion, edhe në botë.

Unë dua të ndalem në dy sektorë, sa për të thënë mendimin dhe për të lutur edhe ministrin, po edhe Qeverinë që t'i marrin parasysh.

E para, sektori i parë është ambienti.

E tha edhe ministri Hamza në një fjali, çka më pëlqej që tha se çështja e ambientit po na imponohet si urgjencë dhe ne detyrimisht duhet të merremi me të. Po në ligj të buxhetit unë sa kam mundur të vërej janë disa çështje që nuk korrespondojnë me nevojat për ambientin. Për shembull, për pyllëzim janë paraparë vetëm 320 mijë euro, gjë që është shumë pak në raport me dëmet që po u bëhen pyjeve të Kosovës. Çdo ditë dëgjojmë në radio tona që japin porosi që nëse vazhdon ky trend i dëmtimit të pyjeve, brenda 20 vjetëve Kosova do të mbetet pa pyje, e 320

mijë euro për një vit për projekte të pyllëzimit të hapësirave të dëmtuara ose atyre të zhveshura, është mendoj shumë pak.

Sikur që mendoj që është pak edhe 150 mijë euro për krijimin e atyre shiritave sigurues për mbrojtjen nga zjarri. Këtë vit fatmirësisht nuk kemi pasur shumë zjarre, po viteve të kaluara zjarret i kanë shkatërrua dhe shkretuar pyjet e Kosovës.

Kur jemi këtu, e kur jemi te problemi i ndotjes së ajrit, unë kam dy propozime, mendoj që Ministria e Financave është mirë ta ketë një vijë të veçantë buxhetore, e cila për vitin 2019 do të shfrytëzohej vetëm për fillimin e një studimi të fizibilitetit, i cili do të zhvillohej në të gjitha komunat e Kosovës, për krijimin e hapësirave të gjelbëruara në përmasa pak më të mëdha se këto parqet që i kemi nëpër qytete, me dy e tre hektarë, po në përmasa më të mëdha, të cilat për ta eliminuar mundësinë e dëmtimit në të ardhmen do të futeshin në zona të mbrojtura me qëllim që gjeneratave të ardhshme t'u lëmë sadopak hapësira të mbrojtura në vendbanimet që gjithnjë e më shumë po i rrisin dhe po i shkatërrojnë edhe tokën bujqësore, por po e shkatërrojnë edhe ambientin.

Pra, propozimi im që do ta bëj edhe si amendament është që Ministria e Financave të ketë për vitin 2019 të planifikuar një sasi buxhetore të mjeteve, e cila do të shfrytëzohej për studim fizibiliteti që do t'i detyronte komunat të ndajnë hapësira për të mbjellë drurë dhe të krijojnë parqe më të mëdha.

E dyta çështje që do të shfrytëzohej nga ky buxhet është krijimi i deponive për materiale inerte në të gjitha komunat.

Komuna e Gjilanit e ka bërë një hap të tillë, unë mendoj që çdo komunë në Kosovë duhet ta ketë të paracaktuar një hapësirë, ku materialet inerte qytetarët e Kosovës do t'i deponojnë, e ky aksioni i tanishëm, që duhet përshëndetur për pastrimin e hapësirave të Kosovës, të ketë qëndrueshmëri dhe të mos na krijohen deponi legale të detyrueshme, të themi, sepse qytetarëve nuk ua marrin ato deponi dhe nuk kanë ku t'i hedhin.

Për të mos qenë lokalist dhe për të treguar se ne jem këtu deputetë të krejt Kosovës, unë dua ta prezantoj një kërkesë të dytë, e cila lidhet me Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media.

Është premtim i këtij komisioni që u është bërë shqiptarëve të Plavës dhe Gucisë që ne do të punojmë që Qeveria e Kosovës do të ndajë mjete për hapjen e trasesë së rrugës Deçan-Plavë. Amendamenti do të vijë nga komisioni dhe sigurisht që do të gjejë përkrahje, se është premtim i të gjitha partive.

Fusha e dytë që do të prek detyrimisht, meqenëse vij nga fusha e shëndetësisë. Është për t'u përshëndetur rritja e buxhetit, qoftë nëpër përmasa monetar, qoftë edhe rritja e vendeve të reja të punës, por duhet theksuar që e kem obligim në të ardhmen edhe për shumë e shumë vjet që ky trend i rritjes së buxhetit në shëndetësi që po vazhdon prej shumë kohëve të mbahet dhe ndoshta edhe të shtohet, sepse edhe shëndetësi është prej sektorëve të nënfinancuar, sepse ende GDP ose përqindja e GDP-së që ndahet për shëndetësi është e pamjaftueshme nga ajo çka duhet dhe nga ajo çka dëshirojmë.

E dyta këtu, kur është fjala te buxheti për shëndetësi e tha një shpjegim ministri Hamza, po unë kisha pasur dëshirë t'ia bëj edhe një pyetje ose një kërkesë që ai të dalë e të na sqarojë që mjetet që vijnë të parapara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit kur ka ai shpresë që do të zhblllokohen dhe do të fillojnë të shfrytëzohen.

Në shëndetësi janë disa projekte të mëdha, kapitalet, të cilat janë paraparë në këtë formë të financimit.

Zonja Lila i përmendi disa, unë po dua të shtoj që edhe spitali i Ferizajt që është kontraktuar komplet është paraparë të fillohet të punohet prej mjeteve që janë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sikurse që janë edhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe disa projekte të tjera në shëndetin publik dhe gjetiu për shëndetësi.

Dua të di që këto mjete kur planifikohen të zhblllokohen dhe si do të shfrytëzohen.

Tjetër diçka që dua të them për shkak të kohës është se kjo shpërndarje buxhetore nuk e ka respektuar strategjinë sektoriale të shëndetësisë dhe prioritetet, të cilat i parasheh ajo.

Dje indirekt kam kuptuar nga diskutimet se SISH-i edhe SIF-i janë duke u ripërsëritur në financim, kam parë edhe 5 milionë euro për SISH, kam menduar që ato do të përdoren për shtrirjen e rrjetit, por sa e kuptova unë, aty do të riinvestohet prapë në softveri, softveri ka qenë i testuar, i pilotuar, së paku kolegët nga VV-ja tash edhe PSD-ja e dinë sa ka funksionuar ai në Prishtinë dhe është pilotuar në vitin 2016 dhe ka qenë i suksesshëm, mbi bazën e kësaj edhe është bërë marrëveshja KSV 017.

U përmend që do të bëhet SIF-i, unë ju garantoj që ky në vitin 2016 ka qenë i testuar dhe ka qenë në fazën e popullimit me të dhënat e të gjitha organizatave të tjera që marrin pjesë në popullimin e SIF-it.

Nëse këto kanë ndodhur, do të thotë nëse softueri për SISH ose për SIF është kthyer në fillim, kanë humbur miliona euro dhe unë këtu jam i gatshëm dhe ftoj Prokurorinë e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale që të fillojë hetimet nga fillimi i kontraktimit të softverit të SISH-it që

quhet Avicena deri ditën e sotme, përfshirë edhe periudhën kur unë kam qenë ministër. E ftoj edhe në Prokurorinë të shohim se çka ka ndodhur, nëse kjo ka ndodhur, është kriminale.

Edhe një diçka për ta shfrytëzuar kohën është që në Ligjin e buxhetit për vitin 2019 nuk janë paraparë mjetet mbështetëse për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Kjo qeveri ende nuk e ka të qartë që është themeluar Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe kjo Ministri e Shëndetësisë tash ka hequr dorë nga sigurimet shëndetësore. Sikur të kishin qenë serioz nuk do të ndodhnin këto ndryshime, dhe sikur të kishin qenë serioze përpjekjet për të vazhduar aty ku e kemi lënë ne, atëherë së paku Ligji për sigurime shëndetësore do të vinte në Kuvend, i cili ka qenë edhe i plotësuar dhe i ndryshuar dhe do të bëhej miratimi që ka qenë si kusht të ecet tutje.

Unë duke shpresuar që ministri Hamza do të kthehet dhe do të na japë shpjegime për mjetet, na jep shpjegim kur mendon që t'i...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar!

Me qëllim që t'i jap disa sqarime për disa çështje që i ngriti deputeti.

Sa u përket mjeteve nga AKP-ja, këtë vit do të thotë 100% qysh kanë qenë të planifikuara, kanë ardhur në buxhetin e Kosovës, u janë vendosur në dispozicion organizatave buxhetore për shpenzim dhe pjesa e madhe e tyre veç janë ekzekutuar.

Sa u përket projekteve për vitin e ardhshëm, unë pres që në fillim të vitit, mbi bazën e bisedave para se t'i planifikojmë në buxhetin e Kosovës, me strukturat udhëheqëse, në këtë rast Bordin, menaxhmentin e AKP-së, para disa kohe e kemi biseduar detajisht se cila është mundësia e cilat janë mjetet që pa asnjë pengesë mund të transferohen në buxhetin e Kosovës. Jemi dakordua që për vitin e ardhshëm prej këtij burimi ne t'i planifikojmë 140 milionë euro dhe presim që në fillim të vitit të ardhshëm mjetet të jenë pjesë e buxhetit të Kosovës, me qëllim që ne organizatave buxhetore të kemi mundësi t'ua bëjmë alokimin sipas planifikimeve të tyre për rrjedhjen e parasë dhe ato do t'i kemi në dispozicion për shpërndarje.

Pjesa e dytë ka të bëjë me sigurimet shëndetësore. Sigurimet shëndetësore në momentin kur fillon të zbatohet ligji, kur fillojnë të mbledhen në fondin apo në buxhetin e Republikës së Kosovës te Ministria e Financave, i kemi dy pozicione, njëra është 20 milionë, tjetri është 10 milionë dhe ato janë të dedikuara për mbulimin e kostove të ligjeve të reja, të cilat s'janë të specifikuar në buxhet. Dhe nëse është ajo çka unë e di dhe kam si informacion, që në tremujorin e fundit të këtij viti të fillojë, atëherë del që buxheti i Kosovës duhet t'i ketë afërsisht rreth 5 milionë euro për këtë çështje.

Do të thotë, nuk është pengesë pjesa e mjeteve, të cilat janë të obliguara t'i paguajë të punësuarit me rastin e fillimit të implementimit të këtij ligji, për pjesën tjetër është pjesë e organeve dhe organizatave buxhetore të cilat merren me këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani, urdhëro!

IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Kjo te sigurimet shëndetësore e kam të qartë, se jam ballafaquar me këto probleme.

Unë desha ta shpreh një shqetësim se nëse këto mjete të AKP-së na vonohen, atëherë kemi projekte që kanë filluar dhe nuk do të mund të realizohen me kohë, edhe ashtu kemi një vonesë në realizimet e tyre në raport me atë se kur janë nënshkruar kontratat ose kanë filluar projektet siç janë planifikuar në aspektin kohor.

Ka projekte që edhe në vitin e kaluar, unë i kam potencuar këtu brenda shëndetësisë, projekte, investime kapitale, të cilat nuk kanë filluar fare, ato janë prapë të riplanifikuara prej buxhetit të Kosovës. Ndoshta ka qenë mirë që ato projekte të futen në këtë kategori prej AKP-së, se projektet të cilat janë duke u zhvilluar të kenë buxhetim nga buxheti i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Një sqarim më herët, zoti deputet, që e dhashë, do të thotë për organizatën buxhetore tek e fundit nuk ka rëndësi burimi i financimit. Ligji është në fuqi, Bordi është i kompletuar, menaxhmenti ekziston, kanë mundësi të vendimmarrjes dhe unë pres që në fillim të vitit të ardhshëm mjetet janë pjesë e buxhetit të Kosovës dhe projektet sa i përket konstruksionit financiar nuk do të ketë nevojë, as arsye të vonohen, për pjesën tjetër është përgjegjësi e organizatave buxhetore.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Abdyl Salihu.

ABDYL SALIHU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi hyrë në ditën e dytë të debatit për projektbuxhetin për vitin 2019.

Nga diskutimet tuaja, të nderuar kolegë, deri më tani janë trajtuar çështje nga më të ndryshmet që adresojnë preokupimet e qytetarëve të të gjitha shtresave dhe moshave dhe për këtë shpreh admirimin tim të sinqertë.

I dëgjova me kujdes, pa dashur t'i përsërisë ato të cilat u thanë, me shumicën prej jush ndaj mendime të njëjta apo të përafërta, ajo që unë mendoj që nevojitet tani është t'i harmonizojmë veprimet tona në kohë dhe hapësirë që t'u mundësojmë jetësimin në praktikë institucioneve tona përgjegjëse.

Ky akt vlerësoj se është parakusht për funksionimin e rregullt të institucioneve shtetërore në përgjithësi dhe institucioneve, si janë ato të arsimit në veçanti, duke filluar nga niveli parashkollor deri te ai universitar, për të cilat do të flas edhe nga pozita e anëtarit të Komisionit Funkcional për këtë sektor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Para rreth një viti në këtë sallë për herë të parë e pata edhe unë një diskutim, po me të njëjtën temë, ka pasur diskutime atëherë pro edhe kundër, edhe gjatë këtij viti është shkruar dhe folur shumë se si niveli i arsimit është në gjendje të keqe, se nuk është bërë asgjë apo shumë punë janë bërë jo mirë, janë pritur me shqetësim të dhënat nga testi PISA apo edhe raporteve të tjera për nivelin jo të mirë të nxënësve fillorë dhe të mesëm, është shprehur shqetësimi se investimet në objektet shkollore nuk po përmirësohen, e tjera.

Atë kohë kemi pasur zotimin e ministrave të linjës së bashku me ministrin e Financave për rritjen e ndarjeve buxhetore për 22% për sektorin e arsimit për të arritur një total i shpenzimeve për arsim në 260.2 milionë euro për vitin aktual 2018.

Zotim ky i realizuar, kjo shihet edhe nga raportet periodike të publikuara për vitin aktual 2018, deri tani është realizuar, në të ardhmen presim dhe besojmë se këto investime do të përkthehen si rritje e cilësisë së arsimit, deri në kthimin e besimit, duke u afruar në realizimin e pritjeve të të rinjve dhe, për më tepër, duke risjellë shpresë për rininë tonë.

Më gëzon fakti se edhe projektbuxheti për vitin 2019 që e kemi para vetes, i prezantuar nga ministri i Financave, bashkë me parashikimet për dy vjetët vijuese, vazhdon të mbeten reformat në sektorin e arsimit, paralel me këto edhe një përmirësim gradual të cilësisë së arsimit, duke filluar nga niveli parashkollor, shkollimi profesional e deri te ai universitar.

Me pak fjalë rritja e buxhetit për sektorin e arsimit po vazhdon edhe me ndarje buxhetore për vitin 2019, shifrat tregojnë se kemi ngritje mbi 10% në nivel qendror, duke përlogaritur dhe rritjen prej 9% të grantit komunal për arsim, totali i shpenzimeve për arsim planifikohet të arrijë në 300 milionë euro, kjo dëshmon përkushtimin për mbështetjen e këtij sektori.

Jemi dëshmitarë se ky sektor ende ka shumë sfida nga niveli parashkollor, i mesëm, ai i lartë, e deri te kërkimi shkencor, sfidat e përafrimit të sistemeve arsimore dhe universitare në kuptimin e standardeve dhe cilësisë brenda vendeve të Bashkimit Evropian, ku synojmë të arrijmë, janë

shoqëruar dhe janë ndërlidhur ngushtë me reformat në shumë sektorë, duke përfshirë këtu mbështetjen e mjaftueshme buxhetore.

Ekonomia e hapur dhe tregu evropian pranon vetëm kuadro të përgatitura mirë, me dije, duke përfshirë këtu edhe dijen nga shkollat e veçanta profesionale.

Investimi në kapitalin njerëzor, si pasuri më e madhe e vendit, investimi në përgatitjen e çdo të reje dhe të riu në mënyrë të drejtë dhe të ndershme, vjen edhe si një domosdoshmëri ndaj nevojave imediate të zhvillimit të vendit tonë.

Pa e zgjatur më shumë për rëndësinë e arsimit, të nderuar kolegë, nga projektbuxheti për vitin 2019, ashtu si e paraqiti në ekspozenë e tij ministri i Financave, shihet se ngritja e cilësisë në arsim ka vazhduar të mbetet një ndër prioritetet kryesore. Nga një lexim i kujdesshëm shihet se janë të vendosura qartë dhe në formë gjithëpërfshirëse objektivat e sektorit të arsimit për periudhën afatmesme si: Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie.

Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe në metoda të avancuara.

Arsimin dhe aftësimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë.

Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimeve shkencore, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Rritja e përfshirjes dhe parandalimin e braktisjes në arsimin parauniversitar. Për herë të parë bashkë me projektbuxhet dhe ndarje buxhetore, krahas objektivave që synohet të arrihen, janë caktuar edhe treguesit kryesorë të performansës apo caku të testi PISA, rritja e numrit të fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe numri i mësimdhënësve të trajnuar për kurrikulat e reja. Kjo është për t'u përshëndetur si praktikë e mirë dhe mjet për monitorimin dhe llogaridhënien.

Krejt në fund, e përshëndes rritjen e buxhetit për sektorin e arsimit, duke shpresuar që rritja do të përcjellë krahas me reforma dhe arsim cilësor në këtë sektor. Prandaj nisur nga ajo që u tha deri

më tani dhe fakti se është tepër e rëndësishme që ne të fillojmë vitin 2019 me buxhet të aprovuar, ky version i prezantuar ka mbështetjen time dhe njëherësh kërkoj ose apeloj që të gjithë bashkarish ta aprovojmë në këtë fazë, me qëllim që të kemi kohë bashkarish të punojmë për të plotësuar amendamente të ato fusha, në të cilat vlerësojmë me prioritet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Bazuar në atë çfarë përmban projektligji për ndarjen e buxhetit dhe duke u bazuar dhe fokusuar në një analizë rreth buxhetit që ka të bëjë me FSK-në, na lë të kuptojmë se kjo Qeveri nuk e ka vullnetin për ta bërë një ushtri të mirëfilltë. 173 milionë e 701 mijë e 047 euro janë paraparë për tre vjet nga 2019 deri në vitin 2021, apo 11 milionë e 600 mijë e 502 euro më pak se në Kornizën Afatmesme, ku janë paraparë 185 milionë e 301 mijë e 047 euro.

Nëse e shikojmë strukturën e shpenzimeve dhe krahasimin me vitin aktual si te rekrutimi, si te investimet kapitale, duket qartë se nuk ka pasur prapa tij një vizion për formimin e ushtrisë. Unë kryesisht do të fokusohem në aspektet buxhetore të tri projektligjeve për ushtrinë. Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili përcakton kompetencat dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk ka ndikim shtesë buxhetor për periudhën 2019-2021. Buxheti i planifikuar për periudhën 2019-2021 është kështu, si në vijim: në vitin 2019 buxheti është planifikuar 53 milionë, ndërsa 57,8 milionë janë për vitin 2020. 62,7 milionë janë për vitin 2021. Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes, me të cilin bëhet riorganizimi dhe kalimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë në Ministri të Mbrojtjes, i cili përcakton kompetenca dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk ka ndikim shtesë buxhetor për periudhën 2019-2021. Në vitin 2019 buxheti i planifikuar do të jetë 3,8 milionë, në vitin 2020 gjithashtu 3,8 milionë dhe në vitin 2021 gjithashtu 3,8 milionë. Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në FSK, nuk ka ndikim shtesë buxhetor për vitin 2019-2021. Buxheti i planifikuar për periudhën 2019-2021, është ky: në vitin 2019 buxheti i planifikuar është gjithsej 53 milionë euro, 57,8 milionë është për vitin 2020 dhe 62,7 milionë është për vitin 2021. Gjatë zbatimit të këtyre ligjeve, kur paraqitet nevoja për financim shtesë, teorikisht mund të adresohen gjatë proceseve të rregullta buxhetore, pra gjatë proceseve buxhetore mund të ndahet buxhet shtesë për krijimin e ushtrisë së Kosovës.

Shtrohet pyetja, ku do të gjenden mjetet shtesë dhe cilat janë burimet ku do t'i kursejmë mjetet? Zoti ministër, unë edhe më herët ua kam shtruar këto pyetje në komision dhe nuk kam marrë përgjigje. Mjetet shtesë, mendojmë ne, për krijimin e ushtrisë mund të gjenden nga burimet financiare, me rritjen ekonomike në të ardhmen do të rriten të hyrat për buxhetin e shtetit dhe



rrjedhimisht do të krijohen mundësi për financimin e ushtrisë. Gjithashtu, qysh në buxhetin e vitit 2019-2020 mund të vendosen politikat që një pjesë e shpenzimeve buxhetore për shpenzimet kapitale të riorientohen nga ndërtimi i infrastrukturës së re rrugore ose projektet e tjera jo të domosdoshme kapitale në krijimin e ushtrisë, si: blerja e pajisjeve dhe makinerisë ushtarake, furnizimi i ushtarëve me pajisje dhe kushte të punës, ndërtimi i garnizoneve, poligoneve e depove, si dhe trajnimet e nevojshme të pjesëtarëve të ushtrisë. Nëse do të ketë vullnet pozitiv nga politika, atëherë brenda tre vjetëve të ardhshme mund të dyfishohet buxheti për ushtrinë pa ndonjë telashe të madhe.

Gjithashtu, një burim tjetër i financimit të ushtrisë është krijimi i partneritetit me ushtritë e shteteve mike, ku ato mund të ndihmojnë në krijimin e ushtrisë së Kosovës. Kjo mund të bëhet përmes dhurimit të pajisjeve ushtarake, trajnimeve të ndryshme, ndërtimit të infrastrukturës fizike ushtarake, e tjerë. Po lind pyetja, cilat do të ishin efektet e transformimit të ushtrisë në ekonominë e vendit? Ndryshimi i mandatit të FSK-së duhet të reflektohet në zhvillimin ekonomik të vendit. Më saktësisht, Qeveria e vendit duhet të ndërmarrë masa konkrete që ky transformim të ketë efekte pozitive në ekonominë e vendit duke nxitur prodhimin vendor. Siç e dimë të gjithë, çdo ushtri e çdo vendi ka nevojë për pajisje, makineri, veshmbathje, ushqim, e tjera. Të gjitha këto mund të sigurohen duke ndërmarrë masa që të ndodhin duke përkrahur zhvillimin ekonomik të vendit, në njërin anë dhe, në anën tjetër duke përkrahur ushtrinë. Sipas kornizës buxhetore të vitit 2019-2021, për buxhetin e MSFK-së, pjesë e së cilës është edhe FSK-ja, Qeveria e vendit ka planifikuar të ndajë vetëm rreth 2.5% të buxhetit të shtetit për MSFK-në dhe, më pak se 0,8% të bruto produktit të brendshëm të vendit.

Sipas standardeve të NATO-së, çdo vend duhet të ndajë më tepër se 2% të bruto produktit të vendit për buxhetin ushtarak, që në rastin e Kosovës do të duhej të mbërrinte në 150 milionë euro buxhet vjetor për FSK-në. Nga e kaluara, pas Luftës së Dytë Botërore, ka shembuj të shumtë ku shtetet kanë ndarë edhe 15% të buxhetit për ndërtimin e ushtrive të tyre. Kosova mund të rrisë dukshëm buxhetin e saj ushtarak, në mënyrë që të dalë faqebardhë ndaj sfidave që mund të presin në të ardhmen. Kjo rritje e buxhetit duhet të reflektohet përmes rialokimit të buxhetit nga investimet infrastrukturore dhe investimet e tjera jo të domosdoshme në zhvillim të ushtrisë. Pra, Kosova duhet të dëshmojë se është e gatshme të heqë dorë nga shpenzime të tjera, qoftë në infrastrukturë, qoftë në llojet e tjera të shpenzimeve për të investuar dhe zhvilluar ushtrinë e saj. Çfarë kërkohet këtu tjetër? Kërkohet guxim dhe vullnet politik, kërkohet shumë këmbëngulësi e dije... *(ndërprerje, pengesa në incizim)*, apo edhe frikë nga procesi. Nuk ka nevojë për tutor te koka me ankesa të përhershme se po ngutemi, ne thjesht po e bëjmë ushtrinë tonë që është e drejtë jona legjitime.

Po cilat do të ishin efektet ushtarake të transformimit? Kohët e fundit vërejmë një garë në rajon sa i përket armatimit. Kemi rastin e Kroacisë dhe të Serbisë, të cilat vazhdimisht po rritin shpenzimet ushtarake. Në një botë ku presidenti Tramp tërhiqet nga traktati me Rusinë për

moratorium të zhvillimit të armëve me rreze të mesme të veprimit, si dhe zhvillimet në rajon, ku Serbia po zhvillon gjuhën e saj kërcënuese ndaj vendeve të rajonit, e sidomos ndaj Kosovës. Duhet t'jua rikujtoj se në vitin 2018 Serbia kishte ndarë buxhet 500 milionë euro, duke ia shtuar edhe 300 milionë të tjera që ka blerë armatim më të sofistikuar, ku bëhet më se evidente që Kosova duhet të përshpejtojë krijimin e ushtrisë, në mënyrë që të jetë e zonja t'i dalë ballë sulmeve të armikut dhe rrezikimit të sovranitetit dhe integritetit të vendit. Natyrisht, kjo duhet të bëhet bashkërisht me NATO-n dhe aleatët e tjerë.

Dhe, krejt në fund, të nderuar deputetë, duke kuptuar rrethanat përreth nesh, assesi nuk guxojmë të ndihemi komodë përballë krejt realitetit, Qeveria shumë shpejt duhet ndërruar strategjinë e zhvillimit të ushtrisë, duke zvogëluar kohën e transformimit dhe shtimin e buxhetit për ushtrinë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri Hamza e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit deputet Sylja,

Nëse i ke pasur ligjet në dorë, besoj që i ke pasur ligjet në dorë, nëse ju ke referuar deklaratës financiare, besoj që e ke shikuar deklaratën financiare, përveç tjerave shkruan se aq sa ka nevojë, që kjo të ndodhë do të ketë mbështetjen e mjaftueshme financiare. Nga janë burimet financiare, në këtë pikë, besoj që gjithmonë duke të vlerësuar, besoj që më përgjegjësi e kanë ministrat e financave, edhe ata e dinë ku i gjejnë mjetet, edhe pas bisedave tua, zoti Sylja, që i kemi pasur në komision që të kam dhënë përgjigje, po ke të drejtë të mos jesh i kënaqur me përgjigjen, i kam pyetur përgjegjësit në Ministrinë e FSK-së, ish-kolegët tuaj, edhe ushtarakë, thashë: “Këqyre bre se zoti Sylja m’i ka ngrit këto shqetësime, mos keni gabu ju e keni lyp pak pare, a po ju nevojiten pare më shumë se zoti Sylja më ka thënë kështu”. Ata më thanë që, me gjithë respektin për zotin Sylja, por në këtë pjesë nuk ka punuar. Nuk është problem dhe nuk ka nevojë, se mund ta gjuaj edhe ta shtroj problemin në këtë formë: a po thua ti të shkurtujmë autostradën në drejtim të Gjilanit? S’ma merr mendja, por unë po them që ka mundësi të sigurohet financim i qëndrueshëm për këtë çështje të rëndësishme pa pasur nevojë të ndërhyjmë dhe t’i dëmtojmë projektet ekzistuese.

Më shumë se 1, 2, 3 alternativa ekzistojnë për këtë qëllim. Edhe një çështje që po dua ta them, shteti, buxheti i shtetit e financon Forcën e Sigurisë së Kosovës, ushtrinë e ardhshme të Kosovës, në mënyrë transparente, ligjore, e kontrolluar përmes Kuvendit, në mënyrë publike, përmes parasë publike dhe nuk ka nevojë që për këto qëllime të bëhet përpjekje që të prodhohen situata që ky institucion duhet të financohet edhe në mënyra të tjera alternative, të cilat nuk janë të nevojshme dhe nuk janë diçka që i kontribuojnë kësaj çështje. Prandaj, po e përmbyll, sa ka nevojë, kaq kanë qenë kërkesat e Ministrisë së FSK-së, dëgjime buxhetore 100% ia kemi mbuluar kërkesat, pa e negociuar, ku ka pasur edhe pjesëtarë të KFOR-it në ato dëgjime

buxhetore. Pastaj, në Qeveri është ngritur edhe një kërkesë shtesë për 2-3 milionë, unë si ministër i Financave e kam përkrahur automatikisht dhe çdo kërkesë që vjen prej organizatës buxhetore, në këtë rast ende që është Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës, do ta ketë përkrahjen e Ministrisë së Financave, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe, pa dallim politik, jam i sigurt të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhe, nuk besoj që është mirë të ngrihen dilema a kemi a s’kemi mjete? Kemi mundësi të financojmë, i vendosim drejt prioritetet dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë rezervë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Syla, replikë!

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti ministër!

Po, me këto që thatë, më le të kuptoj se vërtet Qeverisë i mungon strategjia për zhvillimin e ushtrisë. Nuk ka nevojë të presim çfarë neve na kërkojnë ata kur ne duhet ta bëjmë strategjinë tonë dhe të dimë, aq më tepër në këtë fazë kur ne duam ta transformojmë, të ecim përpara.

Dhe, unë vërtet nuk kam qenë në resorin e buxhetit, kur kam qenë edhe në FSK, por mbi të gjitha, ato çka kam lexuar deri sot edhe që kam përcjellë, kam parë se është një brengë se nuk është një qasje e cila të bën të kuptosh se është misteriozitet në krahasim me atë pompozitetin e deklarimeve që ka Qeveria për ta bërë ushtrinë. Pse nuk është paraparë që duhet të ndahet? Pse në buxhetin nuk ekziston ndarja e mjeteve që duhet bërë transformimin dhe ndoshta mund të jetë kjo një nguti jona, por ne të gjithë kemi dëshirë ta kemi ushtrinë, por tjetër janë deklaratimet, tjetër është veprimi konkret që duhet bërë rreth kësaj çështjeje aq të ndjeshme, aq të nevojshme dhe aq të domosdoshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Syla, besoj që ke relacione të mira me ish- kolegët e tu në FSK. Nuk është ndoshta në të drejtën time, por megjithatë duke i pasur edhe ato relacione e respektin personal, po të lus, shko një ditë vizitoi kolegët e tu, duke filluar prej hierarkisë më të lartë, ministrit, komandantit të FSK-së, dhe thuaji këto që unë po i deklaroj publikisht: a i ka përkrahur Ministria e Financave 100% kërkesat tuaja buxhetore. Ata kanë strategji, po unë besoj që ti e di, edhe besoj që ke qenë pjesë e atyre strategjive dhe të thuhet s’ka strategji, kur ti ke qenë aty, nuk është moti, atëherë bëhet pyetja çka paskeni bërë?

Ka strategji është në detaje e rregulluar mënyra e transformimit, koha, kërkesat, buxheti iu ka aprovuar sipas kërkesave të tyre jo më pak se 100%, nëse kanë ndonjë kërkesë shtesë, pyeti, prapë jemi këtu për t’ua plotësuar, prandaj të mos e lëmë që të bëjmë panik dhe të krijojmë hapësirë, të thuhet hajde tash të gjejmë forma alternative të financimit të ushtrisë. Ushtria financohet prej buxhetit të shtetit, prej parasë të taksapaguesve të Kosovës, në mënyrë ligjore,

transparente, Kuvendi e aprovon buxhetin, Kuvendit i prezantohen raportet financiare dhe i shikon në detaje kah kanë ardhur mjetet dhe kah kanë dalë mjetet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe ju kolege deputete,

I nderuar ministër, edhe në kohën kur kam qenë në opozitë të kam falënderuar për profesionalizmin, për korrektësinë, mirëpo sinqerisht tanimë unë edhe e kuptoj me këtë përmbledhje të buxhetit për vitin 2019 është e vështirë dikush ta lexojë, e shumë më e vështirë edhe ta kuptojë.

Kështu që sado që është i detajuar, unë për vete nuk është se jam profesioniste, por për ata që e hapin këtë përmbledhje në faqen e parë dhe i lënë 100 të tjera, e ndoshta edhe 200 e dalin në fund, unë nuk besoj që mund ta kuptojnë, por normalisht që janë edhe këto deklaratat që shumë herë u thanë sot dhe dje. Pra, shumë e sigurt në qeverisjen e udhëhequr nga kryeministri Haradinaj dhe partnerët, po sidomos me ju si ministër i Financave dhe të gjitha ato që ju i deklaruat, edhe për deklaratën financiare jam shumë e sigurt që në 14 dhjetor jo vetëm se do të kemi ushtri, por nuk do t'i mungojë buxheti asnjëherë, për këtë besoj që të gjithë e kuptojnë.

Buxheti për vitin 2019 është kthesa shumë e madhe, pasi që ka një rritje shumë të madhe krahasuar me vitet e kaluara, posaçërisht në vitet para këtij mandati qeverisës. Një rritje që është shkaktuar pa ndërhyrje në ekonomi dhe vetëm e vetëm nga forcimi i rendit dhe ligjit, nga liberalizimi i ekonomisë së tregut dhe lirisë më të lartë për të bërë biznes. Mund të quhet “buxheti i shpresës”, pasi që kjo rritje do të shkaktojë një kthesë të madhe pozitive në rritjen ekonomike të vendit menjëherë pasi që buxheti të lirohet nga shpenzimet e mëdha kapitale, siç janë: ndërtimi i autostradave me mjete financiare të buxhetit të Kosovës. Për fat, kjo qeveri do ta përfundojë më këtë investim, por do ta përfundojë me një shembull shumë të mirë, pa lënë anash asnjë komunë, pra u përmend autostrada për Gjilan, sado që qeverisja është e udhëhequr them pra nga kryeministri Haradinaj dhe partnerët, por nuk ka lënë anash asnjë nga autostradat, pa marrë parasysh nga cila komunë udhëhiqet, por buxheti ka shkuar në të gjitha komunat pa lënë anash asnjë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot Qeveria Haradinaj dhe ministri Hamza, na ka prezantuar buxhetin që është garant i zhvillimit ekonomik të viteve të ardhshme, një buxhet që ka trend të rritjes nga 1,7 miliard në 2017, në kohën e Isa Mustafës, në 2,3 miliardë në 2019-tën. Për dy vjet rritjeje prej 600 milionë euro, vetëm për këto dy vjet të Qeverisë Haradinaj buxheti është rritur pra për 34%. Normalisht se problematike dhe sfiduese janë, pra e them edhe një herë, projektet kapitale në vazhdim, ka prej

tyre që janë në vazhdim për më shumë se tre vjet që për shumë arsye nuk janë kryer duke u ndarë buxhet edhe me nga 20 mijë, 30 mijë apo 50 mijë euro, për fushata parazgjedhore, siç ka ndodhur në qeverisjen Mustafa. Dhe, fatkeqësisht shumë pra nga këto projekte kanë qenë në kohën e fushatës nga vitet e kaluara, posaçërisht, pra kjo praktikë uroj dhe besoj shumë që duhet të ndalet, pa marrë parasysh kush do të vijë në të ardhmen dhe besoj që kjo Qeveri Haradinaj edhe në këtë problematikë do të jetë një shembull i mirë për sanimin e kësaj problematike.

Posaçërisht, ky buxhet ka disa dobësi që në krahasim me anët pozitive janë të vogla, është buxhet që do të shënojë në histori kthesën e madhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes krijimit të vendeve të punës për të rinjtë, gratë dhe qytetarët e Kosovës në përgjithësi, përmes krijimit të lehtësirave biznesore më se të nevojshme në ekonominë e tregut dhe integritit shumë më të lehtë të Kosovës në ekonominë e madhe të Bashkimit Evropian. E përgëzoj edhe një herë dhe e mbështes ministrin e Financave dhe partnerët, kuptohet të gjitha, për buxhetin e këtij viti 2019 dhe uroj që duke filluar nga ky vit 2019 të realizojë në tërësi programin qeverisës dhe t'ia krijojë Kosovës perspektivën e plotë evropiane. Për shumë kolegë e kolege deputete, që edhe neve që vijmë nga cilido rajon, i kemi edhe shumë kërkesa që gjatë amendamentimit ne do të besojmë që do të ketë mundësi që ato të inkorporohen. Pa lënë anash që arsimit ka një rritje në total prej 300 milionëve, ashtu siç e tha edhe ministri i Financave, edhe shëndetësia me 234 milionë, por prapëseprapë arsimit ka nevojë edhe për rritje të tjera. Dhe, unë jam e sigurt që nuk do të mungojë edhe gatishmëria e ministrit të Financave për ta mbështetur në periudhat kur krijohet edhe mundësia. Është një kërkesë e Komunës së Gjakovës e vazhdueshme që stadiumi i qytetit, pra të Vllaznimit në Gjakovë të fillojë më 2019 dhe gjatë bisedimeve që kemi pasur edhe me ministrin e Kulturës, por edhe me ministrin Hamza, jam shumë e sigurt që në vitin 2019 në komunën e Gjakovës do të fillojë ndërtimi i stadiumit të Vllaznimit.

Për ata deputetë që janë të Gjakovës, por që Gjakovën e shohin veç në televizor, ju them që në Gjakovë po punohet. Impianti i ujërave të zeza që u përmend më herët këtu, për ata që nuk janë dhe nuk jetojnë atje, por janë të Gjakovës, unë ju them që unë po shoh çdo ditë duke u punuar, për ta parë a po punohet, duhet shkuar atje në vend. Dhe, është një investim i menaxhimit të mirë nga kryetari i Komunës, në bashkëpunim edhe me Qeverinë gjermane.

Gjithashtu, bukurinë e qytetit të Gjakovës po ia shton lumi Krena që them ka qenë e pamundshme, ndoshta e paimagjinueshme që do të realizohet për një mandat katërvjeçar, por po flasim për më pak se për një vjet që atje është duke u punuar me shpejtësi shumë të madhe. Të gjitha këto mund të shkojmë t'i vizitojmë në qoftë se nuk besojnë.

Kemi disa probleme të vazhdueshme për palestrat sportive dhe ankesat e kryetarëve të komunave për mosmenaxhimin e tyre pra. Qeveria qendrore duhet të mendojë jo vetëm të investojë në palestrat sportive në komunat e ndryshme, kemi pasur në Klinë dhe në komuna të tjera, që problem kryesor e kanë tani menaxhimin, mirëmbajtjen e tyre. Pra nuk kanë punëtorë për t'i

mirëmbajtur. Në këtë rast, e lus ministrin e financave mos të lejojë pra që investimet që kanë ndodhur pra të mbesin për shkak të mirëmbajtjes.

Kemi disa kërkesa, normalisht që fatkeqësisht numri i nxënësve çdo ditë po bie, mirëpo unë kërkoj që shkolla fillore në Junik “Edmond Hoxha” e premtuar për vite e vite të tëra ende nuk është filluar. Pastaj shkolla fillore “Leart Selimi” në fshatin Lumëbardh. Gjithashtu unë besoj shumë që në këtë vit, pra në vitin 2019, do të fillojë. Shkolla fillore që u përmend më herët edhe nga kolegu im Hajdar Beqa, gjithashtu është një shkollë që është në Damjan të Hasit, pra shkolla “Durak Ahmeti”.

Për punëtorët e viteve të ‘90-ta, ligji ka kaluar në Komisionin për Buxhet e Financa dhe nga fjala e ministrit të Financave unë besoj shumë, që ky ligj pra pritet në leximin e dytë dhe fillimi i zbatimit të tij do të jetë pra që në ditët e para, ngase kemi marrë edhe besimin e ministrit të Financave.

Për pensionistët kontributdhënës sado që e kanë një rritje prej 15 për qind, mirëpo kam bërë një kërkesë edhe për shkak të agjendës së Kuvendit, ende nuk po hyn në rend dite, se problemin kryesor këta pensionistë kontributdhënës e kanë te përvoja e punës që kërkoi udhëzimi administrativ, pra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të ndryshohet prej 15 në 10 vjet, ngase nuk është problemi i tyre, por është problemi i kohës së paraluftës që e dimë në çfarë rrethanash ata kanë punuar.

Megjithatë, unë e kam edhe një listë përpara të investimeve në Universitetin e Prishtinës që në qeverisjen e kaluar kanë qenë shumë minimale. Për mbamendjen e kolegëve që kanë qenë edhe mandatet e kaluara, ndërtimi i objektit për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore janë ndarë 700 mijë euro, pastaj rivitalizimi i laboranteve në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore janë ndarë një milion euro. Pra renovimi i objekteve universitare 800 mijë euro. Po flasim, s’po i përmend të tjerat, me qindra mija euro, sado që janë të pamjaftueshme.

Më duhet t’i kthehem pak një diskutimi të kolegut Selani i cili nuk është këtu për një qendër, pra projektin e Shtëpisë së Kulturës në Suharekë, e cila është nisur pa leje urbanistike dhe pa pëlqim urbanistik, është nisur në kohën e fushatë duke premtuar pra nga kolegu i tij Sali Asllanaj që po rregullohet brenda dy vitesh, mirëpo s’ka pasur buxhet të mjaftueshëm. Thashë pa projekt, pa plan urbanistik, pa buxhet, por në fushatë me dy dërrasa; janë fotografitë, mund t’i shohë zoti Selamanaj dhe i është dhënë normal një kompanie të LDK-së, që të gjithë qytetarët e Suharekës po më shkruajnë. Por, është edhe stadiumi në Suharekë që është marrë nga kompania e nipit të ish-kryetarit të Suharekës, i cili fare nuk komunikon me Komunën për të punuar në stadium. Uroj që zoti Selmanaj ta bëjë.

**KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ilir Dedë.**

ILIR DEDA: Faleminderit!

Ministër mua më vjen shumë keq që ju lënë juve kështu kolegët ju vetë ta merrni barrën e prezantimit të buxhetit, sidomos kur ka të bëjë me fusha të cilat ju direkt nuk i mbuloni dhe më duket që nuk do të mund të jepni përgjigje adekuate.

Edhe unë po fokusohem në dy fusha kryesore të cilat, që të mos përsëritem me kolegët e tjerë të cilët kanë diskutuar dje edhe sot. E para, prej buxhetit unë nuk e shoh si e interpreton Qeveria çnjohjet të cilat i ndodhin Kosovës. Po ju them, d.m.th. nëse ne e shohim këtë si luftim të sovranitetit të shtetësisë së Kosovës dhe nëse çnjohjet, sot ka qenë e 12-ta po më duket, i shohim si rrezikim të sigurisë nacionale, pse nuk reflekton kjo në buxhetin për politikë të jashtme. A ka Qeveria e Republikës së Kosovës koherencë ndërmjet qëndrimeve publike politike dhe përkthimit në politika afatmese të paktën të kësaj çka po ndodh me vendin tonë. Ne jemi duke e pasur këtë diskutim thuajse asgjë s'po ndodh rreth nesh dhe thuajse nuk po pakësohet numri i shteteve të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës. Ku është ministri i jashtëm, nuk është. Unë po dua me shifra. Ne për vitin e ardhshëm, apo ju, e keni paraparë buxhetin për politikë të jashtme 32.5 milionë euro, prej të cilave 23 milionë e gjysmë shkojnë për ambasadë. A ka marrëdhënie të reja diplomatike? A do të vendosen, a do të hapen ambasada në vende të tjera? A do të ketë politikë më agresive e frytdhënëse të jashtme Republika e Kosovës me shtetet të cilat na kanë njohur, e me të cilat përndryshe ende s'kemi vendosur marrëdhënie diplomatike? Jo. Kjo nuk e parasheh. Atëherë ku po flasim ne për sukses të vendit tonë? Nuk mund të flitet për suksesin e vendit tonë. Edhe një herë, ku është përgjegjësia e njerëzve kyq në këtë fushë? Pse nuk janë sot këtu? Nuk ka punë më të rëndësishme sesa të vijë sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe të diskutohet edhe si do të silllet shteti jonë karshi çnjohjeve. A të reflektohet kjo në buxhetin e shtetit tonë? Jo, nuk janë.

Se po mendoni hajt s'ka gajle që atje na ka çnjoftë edhe një shtet. Në vitin e ardhshëm nëse rritet ky numër, apo mendojmë se krejt kemi për ta zgjidhur nëpërmjet dialogut me Serbinë? Nuk e kemi të qartë. Kjo është vërejtja ime kyçe. D.m.th. jo që buxheti nuk ka mangësi të tjera, po e tregojnë që nuk ekziston politikë e mirëfilltë e Qeverisë, edhe është vazhdimësi e mosplanifikimit të mirëfilltë të projektimit të shtetit tonë në fushën ndërkombëtare. Dhe rrjedhimisht kur ne themi ne do të anëtarësohemi në të gjitha ato organizatat ndërkombëtare vitin e ardhshëm në buxhet, kjo nuk është e paraparë në buxhet, as e planifikuar, sepse janë vetëm llafe, nuk janë të mbuluara me veprime.

Edhe tjetra, e dyta, ka qenë, mua ende më vjen keq që Kuvendi i cili është institucioni më i lartë në këtë shtet prapë do ta ketë buxhetin më të ulët se Radiotelevizioni i Kosovës. Mos pritni mundësi që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta kryejnë punën e tyre mirë kur buxheti nuk është i tillë. Edhe këtu çdo deputet duhet ta ketë problem me këtë. Nuk mundemi ne të flasim për parimin e ndarjes së pushteteve, për kontrollin e mirëfilltë të legjislativit ndaj ekzekutivit, kur buxheti ynë është prapë i paraparë të jetë më i vogël se i RTK-së. S'jemi seriozë

zonja e zotërinj. Nuk jemi. A e kemi obligim që sa vjet që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ketë buxhetin autonom, mos të na e caktojë Qeveria. Është të paktën për mua hera e katërt për buxhet që e diskutoj çështjen e problemit të mbajtjes së qëllimshme të Kuvendit, institucion të dobët. Edhe kur dizajnohet një institucion të jetë i dobët, nuk mund ta kryejë obligimin e vetë kushtetues e demokratik. Edhe kjo duhet të jetë me rëndësi që të reflektohet për lexim të dytë.

Të dy çështjet po dua t'ju them, zoti ministër edhe politika e jashtme, edhe rrezikimi i sigurisë shtetërore dhe sovranitetit me çnjohjet për lexim të dytë, a edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

**BEDRI HAMZA:** Zoti Deda, faleminderit shumë për diskutimin.

Sa i përket buxhetit, ka rritje të buxhetit për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Unë nuk besoj që kanë mbetur punët pa u kryer për shkak të mungesës së parave.

Sa i përket buxheti për Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë gjithashtu mendoj se ka pasur financim, por tekefundit buxhetin e aprovojnë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe jo Qeveria. Ne e propozojmë, Kuvendi e aprovon. Dhe nëse Kuvendi dhe deputetët konsiderojnë që duhet të ketë para më shumë për këtë çështje, është në autoritetin e deputetëve. Por, frikësohem që po të hyjnë të bëjnë buxhetin për Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke pasur për bazë që deputetët kërkojnë llogaridhënie, disiplinë, transparencë, mos po e zvogëlojnë buxhetin.

Por, përndryshe aq sa kërkohet për Kuvendin e Republikës së Kosovës buxhet sigurisht se ne do ta përkrahim, për shkak se janë disa organizata buxhetore e në mesin e tyre është edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës që nuk e rrezikojnë stabilitetin makrofiskal. Nuk është kërkesa e deputetëve dhe e Kuvendit e atillë që mund të vijë vendi në një situatë që mos ta përkrahë. Prandaj, aq sa ka pasur kërkesë prej Kuvendit, ne e kemi financuar. Nëse ka diçka shtesë, pres edhe mirëpres ndonjë amendament gjatë punës në komisione dhe unë si ministër i Financave do ta përkrah. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti Deda e dëshiron fjalën prapë, replikë!

**ILIR DEDA:** Faleminderit!

Po ashtu siç edhe e thashë është dashur të jetë ministri i jashtëm sa i përket politikës së jashtme këtu, apo dikush tjetër nga Qeveria që është përgjegjës. Unë nuk thashë se s'ka para për t'u zbatuar politika e jashtme, po s'ka politikë të jashtme koherente drejt asaj çfarë po i ndodh vendit, Republikës së Kosovës. Dhe këtu ministër ju s'keni çka të thoni se nuk është fusha juaj, po pajtohemi.



Kurse sa i përket Kuvendit të Republikës së Kosovës, ne jemi Kuvendi i dizajnuar më i dobëti në Ballkan. Është i dizajnuar i tillë. Edhe buxheti për vitin e ardhshëm nuk e reflekton as rregullat e procedurës të rejtat të cilat do t'i aprovojmë. A po e dini? D.m.th nuk po reflektohet ajo çka ne po votojmë as për veten tonë. Po duhet pasur d.m.th. për të pasur seriozitet më të madh institucional, e këtu s'keni nevojë ju të më përgjigjeni ministër, sepse kjo ka të bëjë me neve këtu deputetët që jemi zgjedhur, duhet edhe buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës të jetë i dizajnuar i tillë, që të ketë hapësirë për këtë lloj serioziteti të cilin të gjithë e kërkojnë ndaj nesh e edhe ne prej vetes tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se unë s'po flas prej këtu se po dua të dalë poshtë, por fjalën e ka zonja Lirije Kajtazi. Kujtim, a po vjen pak këtu?

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Janë tamam dy ministra të cilëve do t'ua adresojë edhe fjalën time,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo të cilën dua ta prezantoj këtu është kujdesin të cilin e bëjmë edhe gjatë punës në Komisionin të cilin jemi, Komisionin e të Drejtave të Njeriut. Duke parë atë që ngacmon, atë të drejtë njerëzore, apo edhe acaron vetë qytetarët te pabarazia financiare e cila u adresohet atyre. Ndërsa, për ta parë më qartë këtë, të nderuar po e rikujtoj një çështje, rritja e pagës për vetveten që e pati bërë kryeministri, kapte vlerën shtatëfish më të lartë sesa paga mesatare e një shërbyesi civil, apo krahasuar me shërbimet sociale i bie që paga e Kryeministrit të arrijë vlerën e 29 familjeve përfituese, ose me pagën mujore të Kryeministrit ushqehen 145 persona nën asistencë sociale. Ndoshta këtë e përmend edhe një herë. E di që i jam adresuar drejtpërdrejt edhe ministrit të Punës dhe Mirëqenies, duke qenë njëkohësisht se është edhe kryetar i Këshillit Ekonomiko-Social, të cilit i duhet të baraspeshojë edhe zhvillimin ekonomik për të mos e cenuar atë, por njëkohësisht duke qenë të kujdesshëm për të gjitha kategoritë. Ndërsa do të ishte dashur më tepër që të jetë një intervenim më i shtuar, në mënyrë që qytetarët tanë të mos jenë të pakënaqur që pastaj të bien pre e shumë gjërave që për fat të keq po na ndodhin.

Si Komision, kemi vizituar shumë kategori të cilat kanë pësuar nga kjo pabarazi. Kemi vizituar të privuarit nga e drejta e lirisë apo personat nëpër burgje dhe ka qenë e dhimbshme që një pjesë e të rinjve atje, përveç aty është edhe pjesa tjetër e personave të cilët janë në Institutin e Forenzikës dhe kemi vërejtur që çështjet që duhet të mbulohen për ata janë jashtëzakonisht të pambuluara financiarisht.

Ka institucione të cilat e kanë problemin edhe statusit të tyre, ngase varen nga shumë ministri dhe asnjëra ministri nuk është përgjegjëse mjaftueshëm. Por, ka institucione që po ashtu varen edhe nga niveli i qeverisjes, lokal edhe qendror, dhe po ashtu mbeten të pambuluara financiarisht. Dhe në këtë kategori hyn pjesa e strehimoreve dhe edhe ne sot, besoj ju secili

deputet, e keni pranuar një shkresë edhe nga Rrjeti i grave të cilat prezantojnë shifra të cilat për çdo njeri të ndërgjegjshëm, përpos që duhet të ndizet alarmi janë edhe frikësuese për të parë se për çdo ditë rritet numri i viktimave të dhunës në familje. Kjo nuk vjen rastësisht. Vjen nga krejt pabarazia sociale të cilën e shohim dhe dallimet sociale që i ndodhin kësaj shoqërie. Si rrjedhojë e kësaj, kemi këto probleme, nga të cilat përveç një kategori po them që është ndoshta konsiderohet më e lëndueshme, e pëson çdo ditë, por më e dhimbshme është edhe ajo e fëmijëve dhe e nxënësve përgjithësisht. Nuk është dashur të tolerohet asnjëherë, duke qenë se bartim plagët e luftës, që shkollat tona të jenë pa psikolog, ngase kjo po ashtu ka ndikuar që ata të bien pre e abuzuesve të ndryshëm dhe dilerëve të drogës dhe numri i madh i përdoruesve me dhjetëra mijëra është shqetësues për secilin prej neve. Prandaj, adresimi i këtyre çështjeve në buxhet kishte për ta zbutur dhembjen e cila po e prek rininë, dhe po krijon pakënaqësi që ata nuk po e shohin perspektivën në vend.

Në buxhetin e vitit të kaluar kemi parë se për të rritur punësimin, ngase informaliteti ka ndikuar që ndoshta shumë të punësuar të diskriminohen në vendet e tyre të punës, por edhe përgjithësisht edhe shkalla e lartë e papunësisë që më së tepërmi u përshkruhet grave dhe të rinjve, kemi kërkuar që të shtohet numri i inspektorëve. Është bërë mirë që është bërë një shtim. Nuk jam krejt optimiste që do të drejtësohet padrejtësia, megjithatë shpresojmë që diçka do të ketë përmirësim. Gjëja e cila ka preokupuar popullatën këtë vit ka qenë edhe kualiteti i ushqimit të cilin e përdorim ne. Për këtë arsye besoj një kontroll më i shtuar në kualitetin e ushqimit do ta kishin bërë edhe vetë inspektorët sanitarë dhe shtimi i inspektorëve sanitarë natyrisht se do të ndihmonte po themi ta përmirësonte këtë çështje, të cilën edhe ju keni pasur gatishmëri në një mbledhje të Komisionit, ku kemi biseduar rreth dëmeve që po shkaktohen nga moskontrolli i ushqimit.

Krejt këto bashkë janë gjëra të cilat besoj se duhet t'i përmbajë ky buxhet, në mënyrë që të mos shkaktohet apo të thellohet edhe më tepër hendeku edhe gjinor. Nuk u ndala te ndarja buxhetore apo buxhetimi gjinor, buxhetimi i përgjegjshëm, ngase u përmend nga disa folëset më herët. Por ky buxhet duhet ta ketë parasysh, ta respektojë këtë, se është obligim ligjor, nuk është vetëm i thënë dhe shumë gjëra të tjera. Krejt këto do ta ulin hendekun gjinor, përgjithësisht social mes kategorive, në mënyrë që të mos manifestohet me forma të ndryshme të pakënaqësisë.

Presim që konkretisht këto t'i bartim si amendamente në mënyrë që të jenë të përfshira në këtë buxhet dhe që ta gjejnë zgjidhjen edhe brenda këtij viti, por edhe ato që janë obligime ligjore të bartura nga viti në vit.

*(Kryesimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Haliti. Pas tij deputeti Arbër Rexhaj.

XHAVIT HALITI: Zoti ministër Hamza!

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Së pari dua të përgëzoj ministrin Hamza që po përballet edhe me kërkesa të OJQ-ve që s'janë për këtë Parlament, edhe me kërkesa të tjera për të cilat do të thosha nuk është kompetent.

Në çdo qeveri, në çdo legjislaturë, çdo vit kur të miratohet buxheti dhe kur të diskutohet buxheti zakonisht ministrat janë rresht, të rreshtuar prapa Kryeministrit. Fatkeqësisht ne nuk e kemi këtë gjendje, por kemi tre përfaqësues, respektivisht katër përfaqësues të katër grupeve parlamentare, por që kemi ministra të cilët duhet të japin llogari dhe duhet të sqarojnë lidhur me buxhetin.

Unë kam një qasje tjetër ndaj buxhetit dhe ndaj diskutimeve, sepse nganjëherë për neve është krejt normale që të diskutojmë për interesa edhe elektorale personale, por edhe për interesat lokale të cilat qytetarët dhe ata votuesit na kanë porositur, se kanë kërkesa edhe individuale ndaj secilit deputet dhe ndaj Qeverisë, që me siguri i ka pasur parasysh të gjitha kërkesa.

Unë dëgjova që do të rritet buxheti i shtetit dhe është mirë, është e arritur, por desha ta kem një qasje tjetër lidhur me këtë. Ne po flasim për rritjen e buxhetit, por ne s'patëm një raport të saktë, të thukët se si do të rritet ky buxhet. Unë kam vërejtjet e mia për shembull se nuk ka një raport se cila është gjendja reale në raport shtet-taksapagues, shtet-tatimpagues. Pse po e them këtë? Vazhdimisht kemi vërejtje nëpër komuna të cilat nuk janë ose nuk arrijnë që t'i mbledhin taksat dhe tatimet dhe pastaj buxheti i shtetit duhet të ndërhyjë për t'i plotësuar nevojat e qyteteve dhe komunave respektivisht.

Do të dëshiroja të dija se cila është ndërhyrja shtetërore ose ndërhyrja e agjencisë së tatimeve, të taksave ATK-ja, në raport me këta që nuk paguajnë taksat dhe obligimet për shtetin. Sa kemi të dënuar, sa kemi në akuzë dhe pse nuk i paguajnë? Pse nuk ndërmerr konkretisht shteti masa ndaj atyre që abuzojnë me detyrimet që kanë ndaj shtetit dhe nda qytetarëve? Nuk ka obligim vetëm shteti ndaj qytetarit, por qytetarët duhet t'i kryejnë obligimet e tyre, me qëllim që shteti t'u bëjë shërbime atyre. Nuk e kam që qartë cili është rezultati. Cila është gjendja më thoni ministër te ndërmarrjet e mëdha private, të cilët abuzojnë me punëtorët e tyre dhe e shfrytëzojnë atë pjesën që do të thosha e kemi pagën minimale sa është 170 euro dhe duhet ta kemi parasysh se kush në Kosovë sot punon një muaj ditë për 170 euro? Shumica e këtyre ndërmarrjeve i paguajnë me rroga 170 euro përmes sistemit bankar dhe në fakt ua jepin pjesën tjetër të pagesave në zarf dhe a e dini pse, për të mos i paguar obligimet ndaj shtetit.

Nuk e di çfarë kontrolli ka Qeveria e Kosovës në raport me këto ndërmarrje që të mos i përmendi me emra se mund të dalë gjizë. Unë kisha kërkuar që të kemi të dhëna për këtë dhe ndoshta ka nevojë që Qeveria ta miratojë një ligj lidhur me këtë variant ose këto abuzime që bëhen me

buxhetin e shtetit dhe ndaj atyre që keqpërdorin. Se ajo është para e shtetit. Ata që s'e paguajnë obligimin ndaj shtetit, ata e vjedhin shtetin.

Të kenë masa ligjore për evazion fiskal, për fitime enorme të cilat nuk janë tatuar asnjëherë.

E përmendi dikush Agjencinë e Kontrollit të Ushqimeve dhe vërtetë ne e kemi një situatë krejtësisht jo në rregull, të mos e quaj abuzive sa i përket kontrollit të ushqimeve në Kosovë.

Kudo në botë ka dy organizata ose dy sisteme; një i bujqësisë që kontrollon ushqimin e kafshëve, që kontrollon bimësinë, që kontrollon gjithçka që ka të bëjë me bujqësinë dhe një tjetër që mund të jetë tek Ministria e Shëndetësisë ose kudo, por me obligim që të raportojë në Kuvendin e Kosovës.

Të raportojë para qytetarëve të Kosovës për cilësinë e ushqimeve që e përdorim ne sot dhe nesër dhe çdo ditë. Pra, nuk është në rregull, po mendoj unë, deklaratimet që ushqimet janë të mira, që nafta është e mirë, që nafta e ka njëfarë kontrolli të atyre që e shesin naftën e të gjitha të tjerat.

Një problem tjetër, se koha po ikën, është çështja e ruajtjes së florës dhe faunës në Kosovë, veçanërisht e pyjeve dhe lumenjve, të cilat për mua janë shumë shqetësuese. Dhe nuk e di a keni ndërmarrë diçka që ta rrisni numrin e punëtorëve ose rojet e pyjeve dhe të rregulloni një ligj i cili garanton rojën e pyjeve të cilat janë realisht mushkëritë e qytetarëve, të cilat janë duke u prerë pa kriter.

Bile-bile kam rastisur njëherë jo shumë herë, një roje e pyllit i cili është i ngarkuar për ta ruajtur pyllin ngarkonte dru për vete ose për dikë tjetër, nuk e dija.

Kështu që, unë mendoj që është e obligueshme që të shohim mundësinë e lidhjes së Kosovës me gazsjellësin TAP në Shqipëri me qëllim që me kohën të përgatitemi që ai fyti furnizues i Ballkanit dhe i Evropës që vjen përmes Shqipërisë ta furnizojë edhe Kosovën me gaz, për ta penguar dëmtimin e pyjeve, se vërtetë nevojitet edhe ngrohja, po mbi të gjitha do të sigurohej nëpërmjet saj edhe mbrojtja e qytetarëve të cilët ngrohen me qymyr dhe do të pastrohej edhe ambienti siç po themi ne.

Nuk kam qare pa e përmendur një situatë që ne po prodhojmë rrezik për qytetarët dhe për komunikacionin, veçanërisht do të përmendja autostradën Prishtinë - Pejë e cila shndërruar në një çfarë të them unë, por aty s'ka siguri as shoferi, as këmbësori, as çiklisti, as askush, sepse autostrada është e lidhur me oborre të shtëpive.

Unë nuk e di që ka kësi lloj autostrade diku në botë. Shihni mundësinë që të paktën pjesa tjetër e autostradës të kalojë siç kalojnë autostradat e krejt botës, larg zonave të banuara, sepse edhe ato

autostrada në Evropë kalojnë nëpër zona të banuara, në të shumtën e rasteve ose janë të detyruara ta shmangin ta bëjnë një autostradë tjetër ose bëjnë tunele për të mos e penguar komunikacionin dhe për të mos ndotur ajrin, dhe për të mos pasur me këmbësore, me çiklistë e ku ta di unë, të cilët do duhej të kishin një kalim tjetër përmes rrugëve nacionale dhe jo autostradave.

Desha them edhe diçka sa i përket çështjes së doganave, por ju e dini sa është kontrolli i qarkullimit të mallrave pa doganë dhe po besoj që do të ndërmerrni masa edhe më të ashpra që të mos ketë kalim të mallrave pa doganë në mënyrë abuzive.

Jam dakord plotësisht me Ilir Dedën që e përmendi buxhetin e Parlamentit. Kemi 10 vjet që Bashkimi Evropian kërkon që buxheti i Parlamentit të Kosovës të jetë i pavarur nga Qeveria. Kjo nuk po ndodh asnjëherë. Po e kemi edhe një situatë interesante që Buxhetin e Kuvendit të Kosovës është përpjekur dhe e ka zvogëluar vazhdimisht Komisionin për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës. Edhe kjo është e vërtetë.

Prandaj, janë disa çështje për të cilat vërtetë duhet t'i kemi parasysh. Dhe në fund, unë nuk e di, për pesë vjet 11 milionë fiks buxhet s'kemi më shumë. As më pak dhe as më shumë. Në qoftë se është kështu e prerë e marrim kështu siç është. Por, sa i përket buxhetit për arsim që u tha është rritur.

Ne e dimë që po prodhojmë siç e tha dikush kartonë dhe jo diploma, shumicën e rasteve në Kosovë. Prandaj, kësaj duhet t'i japim fund dhe po mendoj që nëpërmjet një sistemi të krijimit në njërin ose mënyrën tjetër të dhënies së subvencioneve për studentët e shkëlqyer me dhjetëshe, studentëve të ekselencës. Të bëhet një buxhet për këtë kategori dhe për fusha të caktuar të studimeve që duhet t'i kryejnë studentet dhe jo për t'u trajtuar njësoj sikur disa që shkojnë dhe marrin diploma me ata që mësojnë dhe nuk arrijnë të punësohen.

Mendoj që studentët, t'i quaj të ekselencës që i kam parasysh edhe unë edhe ju, duhet të mbështeten për shumë arsye. E para, që ata duhet të shërbejnë në Kosovë dhe ata duhet të jenë faktorët kryesor të zhvillimit të Kosovës.

Mbi të gjitha, zoti ministër të falënderoj për gatishmërinë tuaj për t'ju përgjigjur të gjithë deputetëve, por besoj që kolegët tuaj nuk janë në nivel të detyrës sepse është dashur që edhe ata të përgjigjen për fushat e tyre, edhe për pjesën e buxhetit që ka të bëjë me ministrinë ose që kalon nëpërmjet ministrive të tyre, duke përfshirë këtu edhe buxhetin që kalon dhe që i jepet për borde të ndryshme dhe agjenci të pavarura të cilat vërtetë janë shumë dhe disa prej tyre janë shumë abuzive. Faleminderit!

KRUESUESI: Faleminderit! Ministri Lekaj e ka kërkuar fjalën. Ndërkohë, vërej që Arbëri është tërhequr. Pas ministrit fjalën do ta ketë deputeti Valon Ramadani.

MINISTRI PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Sa i përket rrugës apo autostradës Prishtinë – Pejë, mendoj që është histori në vete dhe plotësisht pajtohem me atë që e tha nënkryetari i Parlamentit, zoti Xhavit Haliti.

Ajo që mund të them, traseja e rrugës Kijëve - Zahaq me gjatësi prej 32 kilometrash përshkon fshatrat Rigjevë, Gllarevë, Gjurgjevik i Madh, Klinë, Zajm, Drenoc, Sferkë i Thatë dhe lidhet me Zahaq me rrugën nacionale E9, ku tash është zgjeruar dhe ka përfunduar dhe mund t'i bashkohet kësaj autostrade.

I tërë i buxheti është siguruar nga IBRD dhe IBF dhe 38 milionë janë nga buxheti i Qeverisë së Kosovës. Ne do të përpiqemi që t'i ikim vendbanimeve dhe me të vërtetë që të mos kenë pengesa qytetarët.

Gjendja e tanishme është jo e mirë dhe pajtohem të gjithë dhe ky projekt është stërzgatur me vite të tëra. Por, do të fillojë në vitin 2019 dhe do të përfundojë në vitin 2020.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Ganimete Musliu. A nuk është këtu? Atëherë, fjalën e ka Valon Ramadani.

VALON RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Më lejoni t'ju rikujtoj pasi mund të keni harrua, nga debati i vitit të kaluar për buxhetin, se çdo vit ne me ngritje dore i paguajmë afër gjysmë milioni euro mbi 20 punëtorë të spitalit të Shtërpcës i cili nuk funksion fare.

Pra, edhe në këto momente kur po flasim, spitali për ndërtimin e të cilit janë investuar miliona euro që nga viti 2011, është jashtë funksionit. Ngjashëm banorët e fshatit Greme të Komunës së Ferizajt vazhdojnë të mos kenë ujë të pijes edhe pse nga buxheti i shtetit janë dhënë paratë për ndërtimin e ujësjellësit.

Në situatë të ngjashme, janë edhe Komogllava dhe shumë fshatra tjera të qytetit të Ferizajt, ku edhe pse gypat për ujësjellës janë vendosur që disa vite ata ende nuk kanë ujë të pijshëm e tashmë edhe rrjeti ka filluar të dëmtohet.

Qindra mijëra euro janë çuar dëm për ujësjellësin, ujin e të cilit nuk mund ta përdorin banorët fare, pasi është i papijshëm. Edhe më keq është situata me ujërat e zeza në të gjitha fshatrat e Ferizajt si dhe në komunat përreth.

Të respektuar deputetë,

Qytetarët që më së shumti kontribuojnë për mbushje e këtij buxheti për të cilin ne do të vendosim sot sesi ta shpërndajmë, përfitojnë më së paku nga shteti. Ferizaj i jep mbi 300 milionë euro në vit, ndërsa janë paraparë investime 51 euro për kokë banori nga buxheti i shtetit, apo dy euro më pak se Deçani i kryeministrit Ramush Haradinaj, apo Juniku që qeveriset nga partia e kryeministrit, ku investimet për kokë banori janë 169 euro.

Do të ishte shumë e mirëpritur dhe për t'u lavdëruar nëse shtohen investimet edhe më tepër në zonat edhe më të thella të Kosovës, por nuk është aspak e drejtë që nga rreth 62,4 milionë euro që parashikohen të investohen në komuna nga Ministria e Infrastrukturës, shumica më e madhe apo rreth 32% do të investohen në komunat e menaxhuara prej subjektit politik AAK.

Kjo është absurde të nderuar qytetarë. Buxheti i shtetit nuk është buxhet i familjeve të pushtetarëve që të mund ta orientojnë kah të duan, por janë taksa të secilit qytetar që paguan për përmirësimin e rrugëve, shëndetësisë e ambientit.

Praktikë e njëjtë e ndarjeve buxhetore është ndjekur nga të gjitha partitë në pushtet të cilat investimet i përkthejnë vetëm në votë e jo në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Për këtë arsye edhe në këtë buxhet kemi më shumë para që do të shkojnë në asfalt e paga.

Pra, prapë kemi një Qeveri të asfaltit që as këtë punë nuk e kryen siç duhet. Rrugët asfaltohen vetëm në lokalitete ku është në pyetje interesi partiak e jo për nevojat e qytetarëve.

Banorëve të fshatrave Tërn dhe Bablak në Ferizaj qysh nga paslufta u është premtuar asfaltimi i rrugës, madje edhe nga vet kryeministri i tanishëm. Por, të banorëve të fshatit Tërn e Bablak jo vetëm se nuk u është bërë rruga e re, por sa herë që bie shiu u vërshohen edhe shtëpitë.

Ngjashëm është gjendja edhe e rrugës në Mirosalë e disa fshatra të komunës sonë.

Të dashur qytetarë,

Nuk është pra buxhet i zhvillimit ekonomik, nuk është buxhet që përmirëson cilësinë e arsimit në Kosovë edhe pse është rritur buxheti në arsim.

Shpenzimet për arsim dhe përmirësimin e cilësisë, për shembull, pajisje laboratorike, aftësimin të mësimitdhënësve, hartim të korrikulimit janë të papërfillshme. Mbi 2/3 e shpenzimeve kapitale në arsimin parauniversitar janë projekte të vitit 2018. Pra, edhe në vitin 2019 prioritet në buxhetin e

Ministrisë së Arsimit pritet të jetë ndërtimi i objekteve shkollore, ku do të ndërtohen 38 të tilla, dhe një numër i sallave sportive. Mirëpo, problem në arsim mbete cilësia përgjithësisht e dobët dhe mospërshtatja e programeve të arsimit me nevojat e tregut.

Të nderuar e deputetë e të respektuar qytetarë,

Ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit, kjo tashmë u tha këtu, por për më keq ky buxhet ka filluar ta hajë edhe fondin e privatizimit i cili ka qenë shpresë në përkrahjen e prodhimit vendor.

Kur është ndryshuar Ligji për AKP-në, është premtuar që këto para do të shkojnë vetëm për projekte zhvillimore.

Të nderuar deputetë,

Këto para po shkojnë në mbulimin e gabimeve të Qeverisë. Ndër të tjera për të paguar dënimin e “Bechtel-Enka” për autostradën Prishtinë – Hani i Elezit.

Më kujtohet që vitin e kaluar kur po diskutonim për buxhetin, në bazë të ndarjeve buxhetore shihej se paratë ishin destinuar për luks dhe komoditet të qeveritarëve. Por, nuk kam besuar se situata do të përkeqësohej kaq shumë deri sot. Qeveritarët duket se nuk kanë dëgjuar fare nga ajo çfarë është thënë.

Në vend se t’i ulin lukset, kryeministri ia ka rritur pagën vetes dhe zyrtarëve të tij. Në vend se të na sjellin njohje e të na liberalizohen vizat, ministrat kanë shpenzuar para të qytetarëve nëpër ekskursionë nëpër Evropë.

Të nderuar,

Ky buxhet nuk i kryeministrit e i ministrave, po është i qytetarëve dhe duhet të destinohet për të mirën e tyre. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Valentina Bunjaku.

**VALENTINA BUNJAKU:** Përshëndetje, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Derisa ne po diskutojmë për projektligjin më të rëndësishëm të Republikës së Kosovës, fillim e mbarim ministri i Arsimit ka munguar dhe nuk është këtu. Ndryshe secili prej deputetëve i kemi sektorët e ndarë dhe në këtë rast ministri i Arsimit nuk ka qenë në sallë derisa është diskutuar për buxhetin e arsimit.

Ministri Hamza është këtu dhe i ka përcjellë prej fillimit kërkesat tona si deputetë sa i përket buxhetit, po për arsimin besoj që llogaridhënia i takon ministrit të Arsimit.



Ky projektbuxhet për vitin 2019 është i pamjaftueshëm sidomos në sektorin e arsimit. Derisa ministrat të cilët në vazhdimësi mungojnë në seancat e Kuvendit e sidomos edhe në kohën kur është duke u debatuar për një projektligj kaq të rëndësishëm, qytetarët tanë e kanë të qartë se këta ministra i marrin pagat e majme, mu nga ky Buxhet i Republikës së Kosovës.

Ne po diskutojmë sot për një projektligj kaq të rëndësishëm dhe buxheti i sektorit të arsimit është i pamjaftueshëm për arsim duke e pasur parasysh se arsimi është shtylla kryesore e një shteti apo i një vendi.

Duhet thënë thjesht se në sektorin e arsimit ka shumë problematika të mëdha dhe nuk ka mjete të mjaftueshme. Nuk kanë ndarë mjete të mjaftueshme as për psikologë, as për pedagogë dhe as për mbështetës, mësues mbështetës nëpër shkolla.

Këto mjete të cilat kjo Qeveri i harxhon nëpër dreka e darka për lobim jashtë vendit dhe i gjithë rezultati është kthyer bumerang duke marrë përgjigje negative, do ishte më e udhës që këto mjete të adresoheshin në arsim, sepse fëmijët tanë kanë jashtëzakonisht nevojë edhe për psikologë, edhe për mësues mbështetës, edhe për pedagogë nëpër shkolla.

Ne që sa muaj jemi duke e diskutuar projektligjin për mësimdhënësit e viteve '90-ta dhe unë e kam parë si anëtare e Komisionit për Arsim se ka pasur moskoordinim ndërmjet tri ministrive; Ministrisë së Punës, të Financave dhe të Arsimit.

Kemi pasur gjithashtu edhe vërejtje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe ato kërkesat e mësimdhënësve të viteve të '90-ta, SBASHK-u i ka adresuar te ne, dhe për mua për personalisht kanë qenë shumë të arsyeshme, sepse në atë kohë kur ata kanë nxjerrë kuadro të suksesshme dhe kanë dhënë mësim në kushte jo të mira, nuk është dashur që të diskutohet për kompensimin e atyre mësimdhënësve sepse meritojnë edhe më shumë sesa që ne u kemi ofruar.

Sektorin e arsimit duhet të jetë një ndër prioritetet e kësaj Qeverie dhe të gjitha qeverive në vazhdim, sepse shkollat tona kanë mungesë laboratorësh, kanë mungesë kabinetesh, infrastrukturë shkollore, mungon mësimi praktik, trajnimet e vazhdueshme, e çka nuk mungon në arsim.

Prandaj, dua të specifikoj komunën time, sepse vij nga ajo komunë dhe më dhemb shumë sepse grandit për arsim në Komunën e Gjilanit nuk është i mjaftueshëm kur dihet se janë afër 13 milionë, ndërsa janë paraparë 260 mijë euro nga participimi i çerdheve, shkollave dhe konvikteve ku ato janë të pamjaftueshme për një komunë të madhe siç është Gjilani.

Në Komunën e Gjilanit në investime kapitale janë ndarë vetëm 450 mijë euro dhe paramendoni se çfarë investimi mund të kemi ne si komunë me 450 mijë euro. Shumë kjo shumë e vogël për investime kapitale.

Jam e obliguar ta ngre zërin edhe për kampusin universitar ku faji gjithmonë është jetim. Por, një duhet ditur sigurt që Ministria e Arsimit nuk ka bërë asnjë hap konkret dhe nuk ka pasur mirëkuptim apo bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit që të fillojë punën për ndërtimin e kampusit e Universitetit “Kadri Zeka”, ku dihet qartë sepse këto dy ministri duhet të koordinohen mes vete, sepse Komuna e Gjilanit ka ndarë 7,2 hektarë tokë për ndërtimin e kampusit “Kadri Zeka” dhe ministrinë përkatëse nuk kanë bërë asnjë hap konkret që të fillojë ndërtimi i këtij kampusi.

500 mijë euro të vitit të kaluar janë bartur në këtë vit dhe puna ende nuk ka filluar në ndërtimin e këtij kampusi.

Komuna e Gjilanit e ka grandin për arsim afro 14 milionë euro, ku përafisht 3,2 milionë euro duhet të shkojnë për paga të mësimit, kur e kemi parasysh se Komuna e Gjilanit zhvillon mësimin në katër gjuhë dhe ky buxhet është i pamjaftueshëm.

Buxheti ndahet për kokë të nxënësve sikurse ndahet në të gjithë Kosovën, dhe ky buxhet i ndarë për kokë nxënësi bazohet në Ligjin për financa lokale, por në Gjilan duhet të ndryshohet sepse Komuna e Gjilanit është më specifike sepse mësimin e zhvillon në katër gjuhë.

Ne po kërkojmë cilësi në arsim, ndërkaq nuk jemi të gatshëm që planifikojmë një shumë minimale shtesë edhe për kujdestarët e klasave të cilët duhet të motivohen që të kanë motiv më tepër për të bashkëpunuar me prindërit, nxënësit.

Në mënyrë që të angazhohen më tepër rreth kujdestarive të klasave duhet që atyre kujdestarëve të klasave t’i jepet një shtesë minimale krahasuar me normën të cilën e kanë, sepse nëse duam të rritet efikasiteti dhe të kemi disiplinë dhe një arsim më të mirë duhet që të motivohen këta kujdestarë të klasave dhe t’ju mbetet barrë sikurse mësimit në mënyrë të lëndor.

Komuna e Gjilanit ka nevojë jashtëzakonisht të madhe edhe për infrastrukturë nëntokësore, për impiante të ujërave të zeza, e ku ky buxhet është i pamjaftueshëm. Dhe në këtë rast sinjerisht po më vjen shumë keq që ministri i Arsimit nuk është këtu dhe shumë ministra mungojnë, sepse ne kemi kërkesa jashtëzakonisht të mëdha si komunë dhe buxheti për arsim duhet të rritet nëpër secilën komunë e në veçanti në komunën tonë, sepse kemi shkolla në pjesë rurale ku kemi më tepër mësimit sesa nxënës dhe në këtë rast mësimi zhvillohet në katër gjuhë dhe Komuna e Gjilanit ka më tepër për buxhet apo ndarjen e një grani më të madh për arsimin.

Ne e kemi parasysh që edhe dje edhe sot u diskutua jashtëzakonisht shumë për shumë problematika të cilat ne i kemi këtu dhe secili prej nesh, unë personalisht kam ndarë pjesën e arsimit ku mendoj që në arsim duhet të investohet më shumë, edhe pse dje këtu u diskutua që në Ministrinë e Shëndetësisë kemi investuar jashtëzakonisht shumë më shumë se në Ministrinë e

Arsimit. Unë nuk jam kundër, po për të qenë njerëzit e shëndoshë duhet të kenë arsim të shëndoshë.

Unë mendoj që ministri i Arsimit duhet të bëjë përpjekje shumë më shumë që të rritet grandia për arsim edhe më tepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu e ka fjalën. A pate replikë a çka? Lejoja Teutës ta bëjë replikën se nuk e kam parë. Faleminderit!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Për kolegun deputet të Vetëvendosjes, po ia rikujtoj në qoftë se nuk di, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës udhëheqë në shtatë komuna të Republikës së Kosovës që janë 1/3 e komunave shqiptare në Kosovë, kurse Vetëvendosje e ka një komunë.

Dhe në atë komunë, uroj që buxheti që ka shkuar nga Qeveria Haradinaj që është buxhet që duhet të respektohet, të planifikohet drejt dhe të shpenzohet drejt, në mënyrë që aty të mos ketë ndërhyrje politike. Pra, mos harro, janë shtatë komuna, jo një, bëni matematikat, ndoshta ju dalin.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Valon Ramadani!

VALON RAMADANI: Faleminderit, kryesues!

Deputetja nuk më paska dëgjuar, fjalimin veç e ka dëgjuar aty ku është përmendur AAK-ja. Po unë e pata fjalimi kështu: Thashë: “Ferizaj jep mbi 300 milionë euro në vit, ndërsa janë paraparë investime 51 euro për kokë banori nga buxheti i shtetit”.

Deputetja e përdori atë, nuk po e diskutoj sa parti e sa komuna i ka. Mirëpo, do të ishte e mirëpritur sikur buxheti të ishte ndarë në atë formën qysh e thashë edhe gjatë fjalimit, se është e puna e kohës, ta kisha pasur një minutë.

Mirëpo, dy euro më pak se Deçani është ndarë Ferizaj. Ferizaj është qyteti që më së shumti e mbush arkën e shtetit nga bizneset dhe nga qytetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën. Më fal, Ganimete Musliu, të ka dalë emri prej sistemi.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

E di që jeni lodhur ndoshta që dy ditë, edhe kur ishte Valoni, më thirrët mua, prapë më thirrni mua, e thirrni Besën, po megjithatë e kuptoj, keni qenë shumë i angazhuar dhe ndodhin edhe këto.

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra që jeni të pranishëm,

Në veçanti ministër Hamza,

Është mirë që me të vërtetë të përshëndetet kjo seancë plenare, ku qe dy ditë rresht në mënyrë shumë komode dhe normale po kemi mundësi të diskutojmë për projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2019.

E them këtë, sepse nëse ju kujtohet, vetëm dy vjet më herët na është mohuar e drejta e diskutimit, na është mohuar e drejta e dhënies së kontributit në projektbuxhetin e Kosovës, ku e dini shumë mirë, dhuna që u shfaq në Kuvend dhe gazi lotsjellës.

Në atë kohë, besoj i kujtohet kolegut tonë Avdullah Hoti, që atëherë ishte ministër i Financave, i pata thënë: “Ministër, në këtë krahurë dhe fatkeqësi, i vetmi njeri me fat jeni ju, sepse kaluat shumë lehtë projektbuxhetin, pa asnjë diskutim dhe pa asnjë kundërshtim”.

Prandaj, sot jemi në një situatë krejt tjetër, shumë më të mirë dhe shumë më të favorshme.

Më vjen mirë për këtë frymë të punës së Kuvendit sot dhe uroj që puna e ministrit Hamza të jetë model edhe për punë të tjera në të mirë të vendit tonë.

Në bisedë e sipër me kolegët deputetë të secilës parti politike, të gjithë e pranojnë se ky është projektbuxheti më i mirë që na ka ardhur ndonjëherë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sikur që pajtohemi të gjithë që nevojat e vendit tonë i tejkalojnë mundësitë e këtij buxheti.

Ne duhet të mësohemi t’i gëzohemi ndarjes së buxhetit për secilën komunë dhe secilën projekt, sepse Kosova është jona dhe çdo investim në çdo cep të saj është investim në Kosovën tonë.

Pa dashur të futem në përsëritjen e projekteve dhe kodeve buxhetore që po diskutohen që nga dje, si deputete e këtij vendi më gëzon fakti që është rritur buxheti për shëndetësinë dhe arsimin, e mbi të gjitha më gëzon fakti dhe e përgëzoj ministrin Hamza për rritjen e pensioneve të pleqërisë dhe pensioneve kontributdhënës, sepse të vjetrit tanë, të cilët vuajtjet dhe maltretimet e tyre janë vetë historia e këtij vendi. Prandaj, zoti ministër, ju përgëzoj që keni marrë një hap të jashtëzakonshëm dhe uroj që edhe në vazhdimësi të gjeni mundësi që pensionistët të kenë një jetë më të dinjitetshme dhe jo të gjenden në situata shumë të rënda e të këqija, edhe atëherë kur ata kanë nevojë qoftë edhe për një ‘Paracetomoll’.

Jemi mësuar që në këtë Kuvend të dëgjojmë shumë për Mitrovicën kur duam të bëjmë fushatë elektorale ose edhe për të treguar që na dhemb shpirti për atë vend, por mendoj që nuk mjaftojnë vetëm deklaratat nga ura e Ibrit e kolltukët e ngrohta.

Mitrovica ka nevojë për investime në çdo segment të jetës. Sot dua të kërkoj nga ministri Leka që të trajtojë me prioritet infrastrukturën rrugore atje, sidomos rrugët që lidhin fshatrat veriore, siç janë Dedia, Maxhera, Batahiri, Bistrica, Kushtova e Ceraja, këtë unë e kërkoj sot për arsye të shumëfishtë, sepse kemi arsye shumëdimensionale që të investojmë në atë pjesë të vendit tonë.

I nderuar ministër,

Unë mendoj që nuk guxojmë në asnjë mënyrë ta lëmë të boshatiset ai vend atje dhe thjesht kjo të bëhet në mungesë të investimeve.

Përkundrazi, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuna e Mitrovicës do të duhej të trajtojnë me prioritet të veçantë atë pjesë të vendit.

I nderuar ministër Hamza,

E thashë edhe më lart që më gëzon çdo investim kudo që bëhen në Kosovë, ashtu siç më ka gëzuar përfshirja e projekteve kapitale të komunës së Skenderajt në këtë projektbuxhet.

Vetëm duke u trajtuar të barabartë në çdo komunë, ne tregojmë që e duam Kosovën të zhvilluar dhe të dinjitetshme, siç e meritojnë fëmijët tanë.

Dua vetëm një replikë të shkurtër ose një sugjerim të shkurtër për kolegën nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zonjën Teuta Haxhiu, e cila replikon me çdo deputet të opozitës këtu, është mirë që jeni shumë aktive. Po mos harro, e nderuar, se puna e opozitës është kjo, të kritikojë, sepse jo më larg se dy vjet këtu në këtë Kuvend për dy sera që i pati çuar ministri i Bujqësisë në Skenderaj, një deputete e partisë tënde ka qenë duke na i nxjerrë sytë. Kështu që të kemi mirëkuptim për njëri-tjetrin dhe ta përkrahim këtë projektbuxhet, sepse vërtet ministri Hamza ka bërë një punë të jashtëzakonshme dhe vlen kjo për t'u përshëndetur.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Haxhiu ka replikë.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, Ganimete, që ma dhe mundësinë, sepse harrova të them shtatë komuna, po edhe një iu ka marrë në tavolinë Gani Dreshës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zonja Gaxherri e ka fjalën.

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju ministra të paktë që për momentin jeni këtu, natyrisht këtij debati dhe kësaj teme me rëndësi të veçantë është munduar t'i bëjë ballë ministri i Financave vetëm dhe zoti ministër Hamza vërtet respektoj vullnetin tuaj, por nuk mund t'i përballosh çështjeve, ku ne këtu nga shumë fusha, shumë dikasterë do të drejtohem kur ti nuk e ke kabinetin komplet këtu që ishte dashur të jenë

dje dhe sot, kur nuk e ke shefin tuaj këtu dhe nga kjo shihet sa serioz është kjo qeveri, ku vërtet në çdo shtet normal diskutimi i projektbuxhetit është tema më e rëndësishme brenda vitit, nuk ka asnjë temë më të rëndësishme në çdo shtet demokratik normal se sa buxheti.

Ndërsa te ne, siç e kemi parë dje dhe sot, edhe prezenca e Qeverisë, por edhe numri i deputetëve të mazhorancës kuptohet, sepse opozita s'ka obligim t'ju bëjë juve kuorumin, mungojnë dhe kjo është pra serioziteti fatkeqësisht i vendit tonë dhe i buxhetit të Republikës së Kosovës.

Unë do të mundohem të ndalem në tri fusha, aty ku unë përfaqësoj, nga Komisioni për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ambient e Planifikim Hapësinor, dhe kisha dashur të ndalem pak edhe te Kuvendi, që disa kolegë të mi e prekën pak a shumë çështjen e buxhetit të Kuvendit.

Është e vërtetë që Kuvendi ka buxhetin më të vogël se Radiotelevizioni i Kosovës dhe është e vërtetë që trajtimi i deputetëve është i patolerueshëm më.

Është e vërtetë që janë 20 vjet pas luftës që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk kanë zyrë, deputetët nuk kanë staf mbështetës, deputetët nuk kanë transport. Ky është mandati i dytë që deputetët s'e kanë asnjë lap-top, s'e kanë asnjë kompjuter, e kanë të vetmen pjesë ku mund të kenë materiale 23 me 23 cm një kuti postare dhe ajo shpesh kur shkojmë e hapim, s'ka material fare në to, sepse dikush e ka hapur, e ka marrë, materialin tuaj e ka hedhur, etj., etj. Këto janë kushtet e deputetëve. Të mos flasim për deputetët, të cilët nuk janë sot në mandate dhe ata në çfarë gjendje janë e ku janë.

Të mos flasim për shpenzime që i bën Kuvendi i Republikës së Kosovës vetëm për servisim, po e marr, ato automjet që janë, nuk janë të servisuara në rregull ose për marrjen e veturave që po dëgjoj kolegët e mi këtu me qira.

E që unë po dua të jap një shembull konkret. Komisioni ynë ka vendosur të bëjmë vizitë te Kompleksi Memorial Adem Jashari, për t'i vizituar kullat në çfarë gjendje fatkeqësisht të mjerueshme janë.

Atë ditë s'ka pasur automjet, kam bërë kërkesë zyrtare te sekretari i Kuvendit, jam nënkryetare e komisionit dhe a e dini përgjigjja cila ka qenë. Nuk mundemi, veç nëse doni njërin udhëtim, dy udhëtimet nuk i siguron Kuvendi i Republikës së Kosovës, merre me mend!

Ndërsa këtu, këshilltarët, qoftë të sekretarit të Kuvendit, qoftë të nënkryetarëve, qoftë kryetarit, jo vetëm pagat që i kanë më të mëdha se deputetët me mëditje, por ata kanë udhëtime brenda e jashtë vendit me qindra-mijëra euro dhe unë konsideroj se ky është lëshim i vetë ne deputetëve.

Këto gjëra duhet t'i ndalim, ne kemi bërë privilegje të përjetshme për presidentë, për kryetarë të Kuvendit, për kryeministrin, ndërsa për ne ende s'i kemi kushtet elementare, s'kemi zyra, ne zhvillojmë punën nëpër korridore të Kuvendit që 20 vjet.

Po vazhdoj, se po më humb koha.

Dua të ndalem pak a shumë te buxheti për bujqësi dhe zhvillim rural.

Që nga ky projektligj shohim se në vitin 2019 pritet të jetë rreth 61,4 milionë euro. Nëse e krahasojmë trendin e ndarjes së buxhetit për këtë ministri në vitet e kaluara, pra, vërejmë se dallimet janë të vogla, mirëpo buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si përqindje e buxhetit vjetor të Kosovës ka shënuar rënie, kuptohet, po të lehtë. Përderisa buxheti i kësaj ministrie në vitin 2015 përbënte rreth 3,6% të buxhetit vjetor të Kosovës, këtë vit ose vitin që po e lëmë mbas, pra viti 2018, ka pasur vetëm 2,6% të buxhetit vjetor. Pra, buxheti i këtij dikasteri nuk është rritur në vijë me rritjen buxhetore vjetore. Dhe, ta keni parasysh që ky sektor është i veçantë për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës dhe fatkeqësisht kjo Qeveri në krye të këtij dikasteri ka një ministër, i cili quhet Rikalo, e që nuk e ka bërë as një ditë punë normale në këtë ministri dhe gjendja si në çdo fushë në këtë ministri e dimë të gjithë se si e kemi, por edhe me këtë buxhet.

Rreth shpërndarjes së buxhetit të kësaj ministrie sipas kategorive ekonomike vërejmë se rreth 80%, apo 48,9 milionë euro janë ndarë për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Kurse nga pjesa e mbetur 6,4 milionë janë ndarë për shpenzimet kapitale dhe për mallra dhe shërbime janë diku 2,6 milionë euro, për shpenzime komunale janë 136 mijë euro.

Kolegë të nderuar deputetë,

Rritja e buxhetit në këtë ministri në vitin 2019 dominohet nga rritja e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve prej 1,2 milion eurosh.

Sa u përket shpenzimeve kapitale, projekti i rehabilitimit dhe modernizimi i sistemit të ujitjes në kompaninë rajonale të ujitjes "Radoniq dhe Dukagjin", i financuar me mjetet e ndara përmes klauzolës së investimeve, përbën investimin më të lartë për këtë vit me vlerë prej 1,9 milion euro.

Këto mjete janë të destinuara për këtë projekt dhe janë bartje buxhetore nga viti 2018, pra nuk ka mjete të reja prej këtij viti.

Dhe, kolegë të nderuar deputetë,

Të gjitha projektet kapitale në këtë dikaster janë të bartura, pra të gjitha janë të bartura nga viti 2018, tërësisht 15 projekte të njëjta me vitin 2018 dhe mjetet buxhetore të njëjta të bartura, kjo jep të kuptohet se në vitin 2018 nuk është zhvilluar asnjë projekt.

Kurse rënie më të theksuar në buxhetin 2019 për dallim të vitit 2018 do të ketë Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve, të cilat do të reduktohen në kategoritë e subvencioneve dhe transfereve me afër 2 milionë euro.

Dua të theksoj edhe këtë. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2018 vë në pah edhe mungesën e stafit, monitorimin, vlerësimin, llogaridhënien dhe auditimin e brendshëm të agjencive për zhvillimin e bujqësisë. Kjo sipas raportit të Komisionit Evropian, ndikon negativisht në procesin e aplikacioneve dhe ekzekutimin e pagesave. Në vitin 2019 kjo agjenci parashihet të ketë rritje të buxhetit prej 41 mijë eurosh, ku e gjithë shuma do të drejtohet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Numri i të punësuarve në departamentet dhe agjencitë përbërëse të kësaj ministrie ka mbetur i pandryshuar me buxhetin 2018.

Mua, siç po e shoh, po më shkon koha se s'po mund të arrij, por po i drejtohem s'po di kujt, se ministrat e linjës nuk qenkan këtu, por po drejtohem me disa pyetje sa i përket bujqësisë.

A është planifikuar një monitorim i hollësishëm i procesit të kontroleve, gjë të cilat procese kontrollohen projekte që kanë përfituar nga subvencionet, sepse ne e dimë të gjithë se vërtet në këtë aspekt ka dyshime për keqpërdorim, po kërkojmë auditim.

A është ndërmarrë ndonjë veprim që kriteret e vendosura në programin për zhvillimin e bujqësisë dhe atë për pagesa direkte të jenë në vijë me udhëzimet administrative që e rregullojnë këtë program.

A parashihet rritja e stafit për monitorimin dhe ekzekutimin e subvencioneve dhe auditimin e brendshëm në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë gjatë vitit 2019, sepse për këtë vit po e shohim se çfarë ka ndodhur.

Dhe pa e prekur fare, sepse mua më paskan mbetur vetëm edhe një minutë e tridhjetë sekonda, pjesën e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, edhe në këtë drejtim gjatë gjithë vitit ne kemi punuar për ndotjen që i bëhet Republikës së Kosovës, kemi probleme me pyjet, kemi probleme me lumenj, kemi probleme me gurthyesit, kemi probleme të cilat vërtet janë të pamënaxhuara fare dhe unë nuk po di ku të filloj, po ndalem te kjo pyetje.

A janë të mjaftueshme 100 mijë euro buxhet? Sepse i keni 50 projekte të reja mbi 50 projekte të reja, të gjitha janë nga 100 mijë euro e 10 mijë euro dhe e dimë se sa të rëndësishme, sa kosto buxhetore kanë projektet e ambientit. Për ndërtimin e deponimeve në Prishtinë dhe në Pejë janë të ndara nga 100 mijë euro, apo 50 mijë euro, edhe të gjitha këto projekte i kanë kështu këto



shuma, domethënë janë projekte elektorale, nuk janë që zgjidhin farë problem, sepse ne e dimë qysh është dashur me 3-4 projekte të kryhen, e pastaj të fillojnë projekte të tjera.

Po mbetet shumë pa thënë, por natyrisht që do t'i diskutojmë dhe do të mundohemi që nëpërmjet ndonjë amendamenti të bëjmë ndonjë përmirësim, sepse vërtet ka nevojë për përmirësime ky projektbuxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të përgëzoj Qeverinë për punën e tyre dhe njëkohësisht ministrinë për punën që kanë bërë në përgatitjen e këtij projektligji, me shpresën që realizimi i projekteve të parapara do të kenë efektin e duhur dhe do të shkojnë në dobi të zhvillimit dhe ngritjes së mirëqenies së përgjithshme të vendit.

Më gëzon fakti që ky buxhet ka adresuar përmirësime konkrete në disa sektorë shumë të rëndësishëm për jetën e secilit qytetar në vend, sikurse janë shëndetësia, arsimi dhe drejtësia.

Shëndetësia dhe arsimi në Kosovë në vazhdimësi janë konsideruar si dy sektorët më të pazhvilluar dhe me buxhet të vogël përgjatë këtyre viteve.

Kemi kërkuar në vazhdimësi që rritja e buxhetit për sektorin e shëndetësisë është jetike për qytetarët e vendit tonë dhe për shkak të mungesës së qeverisjes së mirë në këtë dikaster në mandatet e kaluara çdo projekt i realizuar ka efekt real në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve në përgjithësi.

Puna e nisur në vitin e kaluar duhet të vazhdojë edhe më tutje me prioritet, sidomos në pjesën e mjeteve të ndara për barnat esenciale, në ndërtimin e objekteve spitalore, blerjen e pajisjeve moderne mjekësore si dhe në ofrimin e mbështetjes buxhetore për punësimin e mjekëve specialistë dhe infermierëve të rinj.

Prandaj, në mënyrë që t'i përmbushim këto qëllime, do të duhet të rritet ende buxheti për këtë sektor, sepse është ende e dukshëm më i ulët krahasuar me disa vende në rajon.

Përmirësimi në sektorin e drejtësisë që është kyç për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit duhet të vazhdojë të jetë prioritet edhe më tutje, sidomos në rritjen e numrit të gjyqtarëve,

prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në këtë sektor, në mënyrë që të përmirësohet efikasiteti operacional.

Forcimi i sundimit të ligjit është njëkohësisht i rëndësishëm edhe për përmirësimin e klimës e të bërit biznes.

Krahas këtyre sektorëve, Qeveria duhet të orientohet edhe në realizimin e projekteve që gjenerojnë të ardhura dhe kanë efekte ekonomike në një periudhë afatgjatë.

Është për t'u vlerësuar rritja e financimit dhe promovimit të punësimit, shërbimet e punësimit dhe masat aktive të tregut të punës. Mirëpo, mbetet ende sfidë orientimi i politikave të duhura zhvillimore në pjesën e trajnimit dhe aftësisimit profesional.

Njëkohësisht inkurajoj qeverinë që të vazhdojë me subvencionimin e projekteve dhe vënien e granteve të vogla, sidomos në sektorin e prodhimit, teknologjisë informative, atë të turizmit dhe bujqësisë, si parakusht për rritjen e punësimit të rinjve dhe promovimin e ndërmarrësisë, duke mundësuar kështu edhe zvogëlimin e papunësisë.

Ky projektbuxhet gjithashtu do të japë një kontribut më të madh në mbështetjen e implementimit të rezolutave të miratuara në këtë Kuvend, sikurse janë tash me rezoluta për mbështetjen e rinisë, implementimit të Ligjit të punës, me theks të veçantë në sektorin privat, ku dimë se kemi shumë ngecje në këtë drejtim dhe ajo e kontrollit të mallrave ushqyese, që qytetarët tanë të ushqehen shëndetshëm në këtë vend.

Megjithatë, rritjen e buxhetit në sektorin e arsimit duhet të fokusohemi edhe më shumë në pajisjet laboratorike në arsimin parauniversitar dhe ndarjen e mjeteve për trajnimin e mësimdhënësve dhe zhvillimin e kurrikulave.

Ndërsa në koordinim edhe me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, kuadri i investimeve publike kërkon forcim të mëtejshëm nëpërmjet analizave më të mira të kos-përfitimit dhe monitorimit të vazhdueshëm për arritjen e objektivave të parapara në mënyrë që të maksimizohet ndikimi real i projekteve që do të realizohen.

Në këtë drejtim gjithashtu është e rëndësishme të orientohemi në projekte që përveç përmirësimit të infrastrukturës rrugore, të kenë një efekt të rëndësishëm të promovimit të zhvillimit ekonomik.

Përfundimisht ky projektligj nuk sjell suksese vetvetiu dhe pa angazhimin konkret mund të bëhet vetëm një plan i mirë në letër, gjë për të cilën jemi dëshmitarë të disa projekteve që nuk kanë filluar, edhe pse ishin planifikuar.

Prandaj, jam i vendosur që në asnjë rrethanë të mos ndodhë, në asnjë rrethanë të mos cenohet e drejta e qytetarëve për mirëqenien më të mirë për shkak të një neglizhence të institucioneve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën të sqarojë zonjën Musliu, më duket.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

Mos u tut, se s'kam gaz me vete, e kemi kryer atë.

Më lejoni vetëm t'i përgjigjem deputetes së nderuar, Ganimete Musliu, që e përmendi me të drejtë Mitrovicën Veriore, edhe unë mendoj që është e udhës që ne të bëjmë amendament mes dy leximeve dhe unë pajtohem si ministër i Infrastrukturës që kjo të marrë një mbështetje financiare dhe me të vërtetë që të kryhen të gjitha ato rrugë lokale.

Po ashtu ne kemi punuar mjaft në atë drejtim, edhe këtë vit kemi investuar, kemi investuar çdo kund në Kosovë, por me të vërtetë e thoni që ne të mos i anashkalojmë rrugët lokale, sepse nuk është ndonjë projekt i madh që nuk mund të bëhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu, urdhëro!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit, ministër Lekaj,

Patjetër që unë do të bëj edhe amendament mes dy leximeve dhe sinqerisht nuk e di sa e njihni atë terren, po ajo gjatësi e rrugës dhe gjithë ato fshatra që përfshihen në veri të Mitrovicës, e parapëlqej të mos e quaj Mitrovica Veriore, mendoj që nuk ka mundësi me buxhet komunal të arrihet ai projekt.

Prandaj, në mes dy leximeve unë do të bëj edhe amendament dhe shpresoj shumë që do ta kem përkrahjen edhe të gjithë deputetëve, por e tuajën, sepse e thashë edhe më herët, ne si shtet duhet ta trajtojmë në mënyrë të veçantë atë pjesë dhe thjesht unë mendoj që investimi në atë pjesë duhet të jetë i rëndësisë nacionale, jo komunale.

Nuk guxojmë ne si shtet të lejojmë që për mosinvestim të braktisen ato fshatra, sepse e thashë, pa dashur ta zbërthej domethënien, kemi arsye shumëdimensionale për të investuar në atë pjesë të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Kolegë deputetë që jeni të pranishëm,

Dikush është më herët këtu deputet, dikush më vonë. Ndoshta nuk është e tepërt ta përsëris, është hera e parë në përvojën time që ka kaq shumë joseriozitet nga Qeveria në trajtimin e linjave buxhetore dhe pasqyrimin buxhetor të projektligjit më të rëndësishëm kalendarik, siç është projektbuxheti i Kosovës. Sigurisht, ajo dihet që puna e tyre është kryer, është bërë propozimi, por është mirë që të jenë të pranishëm dhe t'i dëgjojnë deputetët. Çdo diskutim këtu ka qenë i analizuar dhe ka ndarë prioritetet ashtu siç mendojnë dhe u takojnë edhe në punën tonë ligjore dhe kushtetuese dhe që do të reflektonte mbi politikën zhvillimore, ekonomike të Republikës së Kosovës.

Ajo çka shihet këtu është e mangët, kjo pjesa që lidhet me zhvillimin ekonomik, sidomos te ndarja e prioriteteve që do të duhej pikë së pari të luftohet inflacioni ekonomik, të ulen shpenzimet e luksit qeveritar, jo të rriten, të luftohet shpëlarja e parave dhe parandalimi i tyre, por prapëseprapë buxheti i vitit 2019 po përkufizohet si buxhet shpenzues, më shumë konsumues, duke përfshirë edhe pjesën e luksit qeveritar dhe nuk siguron perspektivë dhe një shpresë më të mirë për jetë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Këtë edhe po e bazoj edhe në diskutimin e shumë kolegëve, pa dallim pozitë-opozitë dhe të kërkesave të tyre që të përmirësohet Ligji i buxhetit. Ne vazhdimisht kemi kritikuar edhe në të kaluarën qasjet e qeverive, sidomos të fokusi i investimeve kapitale, siç është infrastruktura rrugore, e kemi kritikuar tenderromaninë, i kemi kritikuar shpronësimet klienteliste, disa edhe ato lokaliste dhe kemi kritikuar edhe disbalancet e mëdha për grantet në komuna. Unë do të theksoja një nevojë, zoti ministër, nëse ka mundësi, sepse të mos kemi detyrim vetëm të krijojmë amendamente, të cilat mendojmë që ne e përmirësojmë Ligjin e buxhetit, por të japim edhe propozime edhe ide, ato çka i marrim gjithmonë drejtpërdrejt nga qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kjo formula e ndarjes së granteve për komuna, mendoj që është dashur të ndryshohet në bazë të specifikave që kanë komunat në Republikën e Kosovës, pjesë e arsimit, shëndetësisë, infrastruktura, e tjera. Po e marr shembull Fushë-Kosovën, një prej komunave të mbipopulluara me qytetarë dhe po të shikoni aty në klasat ku zhvillohet mësimi ka 35 deri në 46 nxënës. Edhe në Mjekësinë Familjare, edhe në pjesët që lidhen me shërbimet komunale dhe kjo mendoj që është detyrim yni dhe juaji që ta ndryshoni. Kjo ndërlidhet edhe me Prishtinën, sepse Prishtina është një kryeqytet, i cili nuk banohet nga vetëm banorët rezidentë, po edhe ata që janë jorezidentë, edhe fëmijët e tyre, e shërbimet bëhen pa dallim dhe kjo duhet të ndryshojë. Kjo krijon atë disbalancën që ne, dikush po e kritikon dhe mendon që është fokus i veçantë vetëm në një pjesë e territorit të Republikës së Kosovës, por kjo duhet të ndryshohet, të krijojmë besim që të kemi besim në rritjen e institucioneve dhe çdo dikaster qeveritar ta bëjë punën e vetë me seriozitet. Ajo çka kemi parë deri më tani në shpenzimet buxhetore, pasqyra më e mirë është raporti i Auditorit të Përgjithshëm dhe ne nëse nuk kemi ruajtje të buxhetit dhe nuk kemi një shpenzim të planit koherent buxhetor, qoftë në institucionet e arsimit, shkencës edhe të trashëgimisë kulturore, po e shfrytëzoj rastin, ministrat që janë këtu, e kemi parë para dy ditësh një ngjarje e cila nuk na ka bërë të ndihemi mirë kur trashëgimia jonë kulturore, siç është lahuta,

bëhet pjesë e trashëgimisë kulturore të shtetit të Serbisë dhe mendoj që investimet këtu duhet të jenë me prioritet, duhet të jenë pa ndonjë arsyeshmëri, vetëm në kërkesat që ne i fokusojmë në një pjesë, sepse pjesët që ndërlidhen me zhvillimin në Republikën e Kosovës, një ndër pjesët kryesore është edhe trashëgimia që mendoj edhe krijon të hyra, por edhe krijon vende të punës.

Duke mos anashkaluar çdoherë edhe investimet që ne po i quajmë “regjionale”, unë dëgjova 2-3 herë që u apostrofua Deçani, por kolegë deputetë dhe qeveri e nderuar, është e vërtetë që ndoshta duket në shikim që ka ndonjëherë orientim të investimeve në infrastrukturë, por ajo çka është evidente Deçani është në pjesën më vitale që e ka Republika e Kosovës, në brezin e Bjeshkëve të Nemura. Dhe, Deçani nuk ka ujë të mjaftueshëm të pijes. Banorët në shumë fshatra përballen me këtë problem dhe investimet do të duhej të ishin edhe aty të prioritetizuara dhe të mos kritikojnë këtë formë. Infrastruktura energjetike është katastrofale, me ditë të tëra qytetarët e Deçanit ballafaqohen me mungesë të energjisë elektrike. Mbrojtja e ambientit nuk ka fonde të mjaftueshme dhe ambienti është i atakuar, pyjet janë të atakuara çdo ditë, domethënë në komunën e Deçanit, qoftë me prerjen, qoftë edhe me degradimin të çfarëdollojshëm. Subvencionet në bujqësi janë të mangëta edhe me këtë buxhet, edhe me këtë projektbuxhet, andaj nuk duhet të bëjmë dallime, duhet të ndajmë prioritetet dhe duhet të kemi fokus të qartë zhvillimor, qoftë edhe në komuna, qoftë në regjione.

Pjesa tjetër ndërlidhet edhe me atë që ne po e kërkojmë gjithmonë që të kemi një gjyqësi të fortë, një gjyqësi efikase, të pavarur dhe prapë mendoj dhe insistoj që është shtyllë e ndërtimit të demokracisë së mirëfilltë dhe pa këtë forcë pozitive nuk ka as zhvillim ekonomik, as social, pa rritjen e besimit të investitorëve të huaj që nuk mund të atakohen nga askush, as nga politika, as nga parapolitika, as nga krimi i organizuar. Andaj, këto janë disa pjesë, nuk po i quaj “kritike”, po më shumë po i quaj pjesë të detyrimit tonë që t’i ndajmë këto mendime, mbi të gjitha të japim propozime dhe jeta e qytetarëve të vendit pak a shumë të përmirësohet me këtë projektbuxhet. Unë po insistoj që prioriteti duhet të jetë edhe në shëndetësi, edhe në arsim, edhe në të gjitha dikasteret e qeverisë. Ne po flasim për përmirësimin në pjesën e investimeve që janë bërë në listën esenciale të barnave, por çdo ditë marrim ankesa nga kategoritë e ndryshme që nuk ka barna të mjaftueshme, po e zëmë për shembull barnat për luftimin e kancerit, ju e dini familjet kosovare me çka ballafaqohen, me çfarë kosto ballafaqohen për ndihmën që duhet t’u japin më të dashurve të tyre.

E kam ngritur edhe këtu ndihmën për familjet, për fëmijë me një sëmundje të rrallë, fibrozë cistike, të cilët po ashtu e kanë një kosto shumë të shtrenjtë dhe është e papërbalueshme për xhepin e tyre. Andaj, ju kisha lutur që të jeni racionalë në shpenzimin e parasë publike, nëse keni seriozitet ta kaloni këtë buxhet, por siç duket kjo po reflekton në gjendjen aktuale politike të shkuarjes në zgjedhje dhe pikërisht për herë të parë ne po i përfundojmë diskutimet ku nuk do të ketë votim në fund të ditës dhe kjo është një pasqyrë e keqe jo vetëm për juve si Qeveri, për Kuvendin e Republikës së Kosovës, por edhe për pritjet që i kanë qytetarët e vendit. Dhe, për

fund më lejoni ta përmbyll me një pjesë që e la kolegja ime, Besa Gaxherri. Ne kemi marrë një listë kërkesash nga ish-deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të të gjitha legjislativave. Çdo ditë ish-deputetët, të cilët në kohët më të vështira kanë kryer punën dhe mandatin e tyre ligjor e kushtetues, vetëm në javët e fundit kanë vdekur dy deputetë të Legjislativës të viteve të '90-ta, ata që e kanë shpallur Deklaratën kushtetuese të 2 Korrikut dhe deputetët e '92 dhe '98, plus deputetët që kanë qenë në kohën e UNMIK-ut, por edhe pas pavarësisë.

Përkujdesja institucionale ndaj tyre është e mangët, pothuajse fare nuk ekziston, dhe nuk ka ndonjë trajtim ligjor, as ndonjë beneficion të caktuar, të cilët ata e gëzojnë, ndonjë mbështetje nga dora e shtetit, të cilit i kanë shërbyer me dinjitet, mund dhe sakrificë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rekaliu e ka kërkuar fjalën. Edhe pse ke diskutuar dje një herë, po...

FIDAN REKALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Po, është e vërtetë që kam diskutuar në emër të kryesuesit të Deputetëve të Rinj dje, faleminderit!

Unë dua të ngre dy çështje: e para ka të bëjë me një marrëveshje, e cila është nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale që ka të bëjë me ndërtimin e 46 shtëpive në fshatin Balloc të komunës së Podujevës. Kërkesa ime është që ministria përkatëse që ta respektojë këtë marrëveshje që është nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Unë për këtë çështje do ta bëj edhe një amendament, po ashtu kërkesa tjetër dhe desha pasi që edhe ministri i Infrastrukturës është këtu. I nderuar ministër, pse janë hequr mjetet për ndërtimin e rrugës Podujevë - Prishtinë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet,

Projekti Podujevë -Prishtinë vazhdon, ju e dini që këtë vit ka pasur ndërhyrje bukur të madhe në atë segment rrugor dhe shpresoj që do të përfundojë në fund të vitit 2019, i tërë projekti. Nuk ka lëvizur buxheti, vijat buxhetore dhe unë nuk e di kah i keni këto informacione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka zoti Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë do të përpiqem të bëj disa komente dhe të jap disa ide lidhur me projektligjin për buxhetin, po e them me një emërtim të shkurtuar pak më popullor.

Ky është dokumenti më i rëndësishëm i një qeverie, i një viti dhe, pavarësisht se shprehet në shifra absolute, ky është dokument pastërtisht politik. Në këtë rast, ne do të duhej të kishim në seancë dhe kryeministrin, meqë dokumentet e kësaj natyre i kthejnë politikat në shifra, domethënë që të projektojnë implementimin e tyre. Unë besoj që shpjegimet e ministrit të Financave janë të domosdoshme dhe janë të dobishme, por përfaqësimi politik nënkupton diçka më shumë. Tani për nga struktura, edhe sivjet ky buxhet është si i viteve të tjera dhe ne kemi një fat të veçantë, një rrethënë lehtësuese që struktura e buxhetit tonë e këtij ligji kaq të rëndësishëm është e thjeshtë dhe kjo na jep mundësi që të mund ta kuptojmë, ta komentojmë dhe ta plotësojmë. Po ashtu, kjo strukturë jep mundësi që të vërejmë dhe mungesat, por unë besoj që në një rrafsh pak më të gjerë dokumentet e kësaj natyre duhet të lexohen krahas programit të Qeverisë, i cili nuk është vetëm për një vit, sidomos kur kemi parasysh atë që thashë në fillim që dokumentet e kësaj natyre, politikat themelore i kthejnë në shifra.

Tani Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas programit të saj qeverisës ka projektuar një rritje ekonomike në rreth 8%. Ndërkaq, ky projektligj dhe çfarë vërejmë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve në tre vjetët e ardhshme rritja ekonomike do të jetë mesatarisht 4.5%. Çka kuptojmë nga kjo? Që Qeveria e Kosovës s'po arrin t'i japë ligj të buxhetit, para, fonde të mjaftueshme për programin e saj, që domethënë janë në shpërputhje shumë të madhe ose, e dyta, që programi i Qeverisë së Kosovës ka qenë i menduar mirë. Është pak e rëndësishme nëse vlen arsyeja e parë apo e dyta, sepse rezultati në fund është ai për të cilin unë po flas. Ky buxhet është më i lartë kur e shprehim në shifra se sa buxheti i vitit të kaluar. Por, si në vitin e kaluar dhe viteve paraprake, ka një shpërputhje ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve. Tani kjo nëse ne e bëjmë pak më të thjeshtë, i bie që edhe gjatë vitit 2019 ne do të shpenzojmë më shumë se sa kemi dhe kjo do të thotë që ne do të vazhdojmë të krijojmë borxhe ose, edhe më shqip, që ne do të punojmë dhe me ato që s'i kemi.

Ministri e përsëriti disa herë që s'janë të rëndësishme burimet e financimit në kuptimin e tipologjisë, por e rëndësishme është që burimet janë të garantuara. Unë besoj që në kuptimin e implementimit ministri ka të drejtë, por në kuptimin e politikave dhe të parametrave makrofisiale, edhe ministri e di që nuk ka të drejtë. Pse? Sepse, burimet shprehin gjendjen ekonomike dhe financiare të vendit. Nuk është sikur rritjen ta kemi nga të hyrat, të cilat janë të rregullta, apo kur rritjen ose burimet t'i kemi nëpërmjet kredive apo projekteve nëpërmjet likuidimeve të AKP-së, që janë fonde të mundshme, domethënë që mund t'i kemi apo edhe s'mund t'i kemi. Nëse s'i marrim, kjo i rrezikon projektet, të cilat janë konkrete. Nëse i marrim, përmbushen, por si politikë kjo e thotë një gjë, e cila unë besoj që është shumë e rëndësishme që ne s'kemi përmirësime që mbulojnë politikat tona nga të hyrat e rregullta.

Tani unë do të përqendrohem te një fushë, të cilën unë e njoh më mirë, por paraprakisht do të evidentoj edhe problemin e skemave sociale, sepse është pjesë shumë e rëndësishme edhe strukturore, edhe për nga ngarkesa financiare e këtij dokumenti.

Nga analizat që i kam parë unë, janë 2-3 analiza, sepse unë s'jam ekspert i kësaj fushe, vërehet që shifrat janë shumë të larta, por ka shpërputhje me synimin themelor të skemave sociale. Cili është ai synim? Që të zvogëlojë varfërinë dhe që të ndihmojë. Tani pse po rriten shifrat dhe s'po zvogëlohet varfëria? Sepse, ne vazhdojmë të financojmë skema të paqarta, apo të qarta, por korruptive. E problemi bëhet edhe më i madh, sepse ne këto i kemi në dokumentin themelor të Qeverisë për vitin 2019 dhe Kuvendi do t'i legalizojë me votë. Projektohen dhe skemat e tjera, të cilat kanë në vete po këto paqartësi dhe kanë rrezikun prapë të kthehen në skema korruptive. Kjo do të jetë një nga problemet që do të përcjellë Kosovën, pavarësisht cila do të jetë Qeveria në vitet, të cilat do të vijnë.

Tani, normalisht që ka edhe një shpërputhje ndërmjet kategorisë së investimeve kapitale, transfereve, subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve. Do të duhej të rriteshin investimet kapitale, sepse unë besoj që kërkesat nuk janë zvogëluar aq shumë sa të zvogëlohet kjo kategori ose që të rriten kategoritë të dy llojeve të tjera dhe kjo kategori të mos rritet në masën në të cilën është e nevojshme. E kjo i bie që ndodh që në raste të caktuara të hiqen programe të rëndësishme, të ndërpriten programe të rëndësishme të financimit dhe nëse ndërpriten, edhe duhet të arsyetohen.

Te buxheti i Ministrisë së Kulturës ka një rritje, normalisht që rritja s'është e vërtetë në shifrat çfarë jepet, sepse ministria ka detyrime për shkak të projekteve të rëndësishme të këtij viti. Por, që në këtë fushë, e cila tepër gjatë s'ka qenë prioritare, ndiqet një rend i rritjes së buxhetit, unë besoj që është shpresëdhënëse dhe kjo është një e dhënë, të cilën unë e përshëndes. Sepse nga përvoja që e kam pasur, aty kam gjetur një buxhet rreth 19 milionë euro, e kam lënë me 33 milionë euro, brenda dy vjetëve është 40 milionë euro, s'është e mjaftueshme, por është rritje e mirë dhe çfarë është më e rëndësishme, tregon një interesim. Por, unë do të sugjeroja ministrin e Kulturës që të ketë kujdes, që të përqendrojë dhe të rrisë investimet në fushën e trashëgimisë kulturore, për shumë arsye dhe aty ka një rritje, e cila është e rëndësishme. Por, në këtë fushë ne kemi një dokument shumë të mirë, dokument politik, strategjinë, e cila është 10-vjeçare dhe nëse e vëreni me kujdes dhe lexoni bashkë me politikat dhe projeksionet financiare, do të kuptoni që ajo të përmbushet dhe është e domosdoshme, sepse kërkon kushte minimale, të cilat ne s'i kemi, duhen rreth 17 milionë euro. Domethënë, me këtë ritëm ajo nuk do të mund të plotësohet.

Por, projekte të veçanta, për regjione apo komuna të veçanta, unë nuk do të flas, kam disa evidenca për Pejën dhe ka mungesa, unë s'do të bëj këtë identifikim s'do ta çoj më tutje, por besoj që anëtarët e Qeverisë do të kenë parasysh që të plotësojnë dhe kërkesat e kësaj komune,



sepse janë kërkesa të një drejtuesi tepër racional dhe tepër punëtor, ose më shqip, i cili nuk kërkon ato që s'i duhen. Domethënë, janë të domosdoshme. Unë ju falënderoj për vëmendjen.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Dhe, për fund, ministri Hamza e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Zoti Shala, zëvendëskryeministër, deputetë, faleminderit për diskutimet, shumë shkurt se do të kaloj në pjesën tjetër, por te burimet e financimit nuk ka ekonomist që ka marrë pjesë të paktën në një proces buxhetor dhe që nuk e di çka janë të rëndësishme burimet e financimit, e lëre më dikush tjetër që ka marrë pjesë më shumë herë. Shumë është me rëndësi, e mira së mirës do të ishte të kemi një buxhet të ekuilibruar mes të hyrave të rregullta buxhetore edhe shpenzimeve buxhetore, mirëpo asnjë vend nuk ka që realisht nuk ka huazuar dhe nuk ka marrë borxhe në publik. Nëse e marrim Kosovën, borxhi aktual i Kosovës në raport me bruto produktin vendor është diku 16% dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm me borxhin publik, mirëpo është shumë mirë që është vendosur rregulla, klauzola e investimeve që të paktën rritja mbi 2% e atij deficiti primar duhet të jetë e lidhur me projekte kapitale. Po, do të jemi të kujdesshëm, besoj që edhe në të ardhmen sa i përket nivelit të borxhit publik dhe ka dallim mënyra e financimit, po i kam përmendur që sa herë burimet e financimit që janë edhe mjetet e AKP-së, edhe financimet përmes klauzolës së investimeve.

Në fund, deputetë të nderuar, dëshiroj t'ju falënderoj shumë për diskutimet tuaja shumë konstruktive, shumë korrekte, edhe me kritika qëllimmira, edhe propozimet tuaja dhe ju siguroj që gjatë gjithë kohës që buxheti do të trajtohet nga komisionet funksionale të Kuvendit do të jem i pranishëm dhe do të bëj përpjekje maksimale që ato propozime në formë të amendamenteve, të cilat kanë arsyeshmëri dhe kanë mundësi të akomodohen në buxhetin e Kosovës, unë do t'i përkrah. Unë të gjithë juve ju jam mirënjohës, ju falënderoj dhe me respektin maksimal i kam pranuar të gjitha diskutimet tuaja. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër, edhe prej jush për qëndresën dhe përballjen me raportet dhe me kërkesat e deputetëve. Kemi pasur një debat dyditor që unë mendoj ka qenë i mirë dhe i domosdoshëm, pa i përmendur vërejtjet e mia që i kam.

Atëherë, po vazhdojmë besoj që ky votimi duhet të bëhet pas vendimit të ri të Kryesisë për datën kur votojmë dhe deputetët do të njoftohen, por do të vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës për ta përfunduar seancën.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social**

Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. E ftoj Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Skënder Reçica, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Reçica, e keni fjalën!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Qeveria e Kosovës konform Programit qeveritar 2017-2021, Planit vjetor të Qeverisë 2018 dhe dokumenteve të tjera strategjike ka hartuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomik Social nr. 04/L-008. Ky projektligj është një akt i rëndësisë së veçantë, sepse për objektiv ka rregullimin më të mirë të funksionimit të dialogut social trepalësh në Republikën e Kosovës.

Dialogu social është një proces demokratik i informimit, i konsultimeve dhe i negociemeve të përfaqësuesve të Qeverisë, përfaqësuesve të punëdhënësve dhe përfaqësuesve të punëmarrësve mbi çështjet me interes të përbashkët të politikës së punësimit, politikës ekonomike dhe sociale të një vendi. Objektivi kryesor i këtij projektligji është qasja gjithëpërfshirëse e partnerëve socialë në Këshillin Ekonomik Social, duke i përshtatur kriteret për përzgjedhje sipas nevojave dhe kërkesave të punëdhënësve dhe punëmarrësve. E gjithë kjo me faktin se përmes dialogut sociale, liria e asociimit dhe të drejtat bazike të punëtorëve dhe punëdhënësve janë një bazë e nevojshme për zhvillimin dhe funksionimin adekuat të këtyre politikave.

Dialogimi për çështjet e politikave të punësimit, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike nga partnerët socialë është me interes të veçantë për secilin vend i cili angazhohet për një demokraci të zhvilluar dhe për avancimin e raporteve të përgjithshme në mes të Qeverisë, organizatave të punëmarrësve dhe organizatave të punëdhënësve.

Dispozitat e projektligjit në tërësi ofrojnë qasje të përshtatshme për dialogimin social përmes partnerëve në Këshillin Ekonomiko-Social. Ato kanë shtjelluar çështjet më kryesore të cilat janë të nevojshme për funksionimin e drejtë dhe efikas të KES-it. Duke pasur parasysh qëllimin, objektivat dhe rëndësinë e këtij Projektligji, i cili gjithashtu është një obligim në kuadër të MSA-së, kërkojmë që me votën tuaj të përkrahni këtë Projektligj. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër, tani ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale, zonjën Besa Baftiu, s'është. Flora Brovina në emër të Komisionit.

FLORA BROVINA: Po, faleminderit!

Në emër të Komisionit, në mungesë të kryetares së Komisionit, shpreh rekomandimin e Komisionit.

Në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor të këtij viti ne shqyrtuam si Komision Projektligjin për ndryshimin-plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social dhe vendosëm që të paraqesim rekomandimin.

Ne pajtohemi se Komisioni FunkSIONAL në mbledhje u pajtua në parim që të raportojë se ky i plotëson të gjitha kushtet që më tutje të shqyrtohet dhe në bazë të diskutimeve të shumta në Komision, ne kishim vërejtjet tona, të cilat do t'i paraqesim si amendamente në shqyrtimet e mëtutjeshme. Faleminderit!

Pra, rekomandojmë që ky projektligj të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, askush s'e ka kërkuar fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Bekim Haxhiu. Urdhëro, Bekim!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar plotësim-ndryshimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social dhe jep mbështetjen për votimin e këtij projektligji në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje s'e ka kërkuar fjalën. PSD po ashtu. Teuta Haxhiu në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e përkrahim në parim.

KRYESUESI: Deputeti Bilall Sherifi i Grupit Parlamentar Nisma për Kosovën.

BILALL SHERIFI: Kemi bërë disa ndajshitesa nënkryetar, Nisma Socialdemokrate e kemi tash. Po edhe në emër të Nismës Socialdemokrate i jap mbështetje në parim projektligjit në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur në emër të grupeve deputetë, individualisht nuk ka. Tani ne s'kemi kuorum që të mund të procedojmë më tutje me këtë pikë të rendit të ditës.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet biocide**

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Fatmir Matoshi që të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ky projektligj është dokument që çon në interes që qëndrueshmërisë së menaxhimit të produkteve biocide për të përmirësuar dhe plotësuar dispozitat ligjore të fushës së kimikateve me qëllim të krijimit të mundësisë për të monitoruar prodhimin, importin, ruajtjen dhe përdorimin e sigurt të produkteve biocide, si dhe rregullimin e tregut të tyre në Republikën e Kosovës, çdoherë duke pasur parasysh harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin dhe rregullat e BE-së, por edhe me përvojat me shtetet e tjera.

Ky projektligj është harmonizuar pjesërisht me Rregulloren e produkteve biocide nr. 528/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian. Qëllimi kryesor i këtij Projektligji është që të caktojë rregullimin dhe funksionimin e tregut të brendshëm nëpërmjet harmonizimit të rregullave për vënien në dispozicion dhe treg dhe përdorimin e produkteve biocide, duke siguruar nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve të kafshëve si dhe të mjedisit. Andaj ju ftoj që ta mbështetni këtë Projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mungesë të kryetarit fjalën e ka deputeti Andin Hoti, apo jo? Kush po e kërkon? Salih Salihu, por është me kartelë të Besa Baftiut.

Urdhëro Salih!

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Atëherë pra Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 20. 11. 2018, shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-130 për produkte biocide dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim, që të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-130 për produkte biocidde. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së s'është paraqitur askush. Grupi Parlamentar i PDK-së, Andin Hoti. Urdhëro, Andin!

ANDIN HOTI: Faleminderit!

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim Projektligjin për produkte biocide dhe kontributin tonë e japim në mes dy leximeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë unë po i jap fjalën vetëm përfaqësuesve të grupeve të cilët janë paraqitur. Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Ahmeti Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Në parim edhe ne e përkrahim, e kemi shqyrtuar dhe do ta japim kontributin në fazën e amendamentimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate, deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe në emër të Nismës i jap përkrahje Projektligjit në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetë të tjerë s'ka të paraqitur.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit**

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë. Ftoj edhe një herë ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Matoshi që të paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin. Urdhëroni, ministër!

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të përgjegjësive të veta planifikon që përmes fuqizimit të Projektligjit për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit, të rregullojë licencimin e arkitektëve dhe inxhinierëve.

Me anë të këtij Projektligji përcaktohet selia, statusi i tyre, roli dhe fushëveprimi i odave. Profesionet, licencat, përgjegjësinë disiplinore dhe edukimin e vazhdueshëm të arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Qëllimi i këtij projektligji është themelimi i një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm të licencimit i cili përmban mekanizma të fortë të mbikëqyrjes dhe edukimit të vazhdueshëm të arkitektëve dhe inxhinierëve. Për më tepër, përfitues janë ushtruesit e këtij profesioni dhe po ashtu edhe qytetarët e Kosovës. Kjo iniciativë bazohet në praktikat e vendeve rajonale dhe të Bashkimit Evropian.

Duke pasur parasysh se ndërtimi është një ekonomi në rritje të vazhdueshme atëherë ndihet nevoja që përmes krijimit të odave të arkitektëve dhe odës së inxhinierëve të caktohen përgjegjësitë gjatë kryerjes së punëve ndërtimore dhe projektuese. Prandaj, duke konstatuar se miratimi i këtij ligji është shumë i nevojshëm, ju ftoj që të bëni shqyrtimin dhe miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të Komisionit, fjalën e ka deputeti Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.11.2018 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-132 për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim: pra të miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-132 për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Edhe në emër të Grupit, e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit zoti nënkryetar, zoti Shala!

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës në parim e mbështet shqyrtimin e parë e Projektligjin për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit. Konsideroj se Lidhja Demokratike e Kosovës përmes ekspertëve të saj do të sjellë amendamente të caktuara për këtë ligj. Faleminderit për mbështetje!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, në emër të PDK-së.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari ministër,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës e përshëndet ardhjen në shqyrtim të parë të Projektligjit për Odën e Arkitekteve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Ne e kemi shqyrtuar dhe gjithsesi kontributin tonë do ta japim nëpërmjet anëtarëve të Komisionit në mes të dy leximeve gjatë amendamentimit të këtij ligji. Konsiderojmë që ky ligj i plotëson kushtet për të kaluar në lexim të parë, andaj i ftoj kolegët deputetë që ta përkrahin.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Urdhëro Sali!

SALI ZYBA: Përshëndetje, kryesues!

Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka shqyrtuar këtë ligj dhe do t'i japë mbështetje në këtë nivel, në këtë diskutim. Kontributin do ta japim edhe përmes Komisionit, si dhe mendimin e ekspertëve të përfshirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, Salih Salihu.

SALIH SALIHU: Edhe ne e përkrahim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Ahmet Isufi, Grupi Parlamentar i AAK-së.

AHMET ISUFI: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar dhe do ta përkrah me amendamentimin deri në leximin e dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi, Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Në parim gjithsesi e përkrahim, por unë ndërkohë mora le të themi kështu një informatë se ku thuhet që çështjen e licencimit të inxhinierëve e rregullon Ligji për profesionet e rregulluara, i aprovuar në vitin 2016 dhe e pash të arsyeshme tash këtu ta ngre. Sigurisht që ndërmjet dy leximeve do ta shqyrtojmë, mirëpo ndoshta ministri mund të ketë njohuri më të mëdha rreth kësaj, po gjithsesi që mes dy leximeve do të shohim se ku kolidon apo ku tentohet të bëhet një rregullim i dytë i një çështjeje që siç po më thuhet është i rregulluar me një ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kolegë të tjerë të paraqitur.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara.

Tani ftoj nënkryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore dhe të tjerë, zotin Hajdar Beqa për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 20. 11. 2018, e shqyrtoi Projektligjin nr. 6/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim: të miratohet Projektligji nr. 6/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, d.m.th. pa amendamente.

Vetëm për informatën e juaj për të mos ju ngarkuar tash në këto orët e vona, ky ligj është nismë e Komisionit për Legjislacion, i ka kaluar të gjitha procedurat, i kemi rekomandimet e të gjitha komisioneve, nuk ka as implikime buxhetore, edhe pse në raport është bërë një gabim teknik, por e kemi raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Edhe Komisioni për të Drejta dhe Komunitete dhe Kthim do të thotë e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Edhe Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2018 ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familje, dhe ka vlerësuar se Projektligji nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më datën 20. 11. 2018 shqyrtoi raportin final dhe vendosi t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit, do të thotë pa amendamente. Projektligji nuk ka amendamente, pos si i tillë.

Nëse më lejohet edhe në emër të Grupit të Partisë Demokratike e mbështesim këtë Projektligj dhe do ta votojmë. Në të njëjtën kohë kërkoj nga kolegët deputetë që ta përkrahin me votë në momentin kur ka kuorum. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit z. Beqa! Fjalën e ka kërkuar deputeti Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar.

**BILALL SHERIFI:** Po kryesues, në emër të Grupit. Do të doja të deklarohem se gjithashtu e mbështesim Projektligjin në fjalë në emër të Grupit Parlamentar të Nismës.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë edhe një herë theksoj se për këtë Projektligj nuk është propozuar asnjë amendament, por meqë s'ka kuorum nuk mund të procedojmë më tutje.



## **8. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e rekomandimeve të propozuara në këtë raport.

Kështu që unë ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotin Driton Selmanaj që të arsyetojë raportin dhe rekomandimet që ka propozuar Komisioni. Urdhëro Driton.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit nënkryetar Shala!

Në fakt ne si Komision kemi rekomanduar që të sillet ky raport por për shkak që opinionimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit është krejtësisht i kundërt, dhe prandaj kemi vendosur që ta trajtojmë këtu.

Opinionimi i kundërt me theksim të çështjes, pasqyrat financiare vjetore për vitin 2017 nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për shkak se janë kryer pagesa në mungesë të raporteve, pagesa pa bazë ligjore si dhe mjete të bartura në saldo të llogarive të paautorizuara në institucioneve vartëse.

Baza për opinion të kundërt, çështjet të cilat kanë ndikuar në bazën e opinionit të kundërt janë si në vijim: llogaritë bankare të institucioneve vartëse janë në bankat komerciale, menaxhohen nga drejtorët dhe nuk janë të autorizuar nga ana e Thesarit. Ministria kohë pas kohe derdh mjete nga kategoria e subvencioneve dhe investimeve kapitale në këtë llogari me qëllim të financimit të aktiviteteve të ndryshme të këtyre institucioneve. Si rezultat i kësaj, në fund të vitit në llogaritë e institucioneve kishin mbetur 2 milion e 430 mijë e 707 euro mjete të pashpenzuara.

Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe MKRS kanë kompensuar punëtorët profesionalë dhe punëtorët ndihmës në terren, të angazhuar në realizimin e projekteve të trashëgimisë kulturore në vlerë 526 730 euro. Sipas Rregullores 01/2009 për pagesën e punëtorëve në terren, e cila rregullore ishte shfuqizuar me vendim të Qeverisë. Për këtë çështje ishte modifikuar opinionimi.

Projekte të paarsyetuara me dokumente mbështetëse nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në vlerë 1 milion e 843 mijë e 534 euro.

Të gjeturat e tjera nga raporti: për vitin 2017, me buxhet fillestar ishin paraparë gjithsej 89 projekte kapitale, mirëpo si rezultat i mosrealizimit të projekteve, me rishikim të buxhetit ishin larguar 17 projekte. Më tej nga 72 projekte të parapara me buxhetin final, për gjashtë projekte nuk ishin shpenzuar fare në vitin 2017. Sekretari i përgjithshëm kishte lidhur memorandume të

bashkëpunimit me 27 federata sportive dhe me Komitetin Olimpik të Kosovës në vlerë 2 milionë e 743 mijë euro. Kjo vlerë është për 637 mijë euro më shumë sesa buxheti i cili ishte paraparë për këtë qëllim.

Kompensimet e parregullta. Drejtori i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës në Gjakovë vazhdon të punojë dhe të paguhet nga MKRS edhe pse kontrata e këtij personi ka skaduar në dhjetor të vitit 2013. Në katër raste punëtorët paguheshin sipas Rregullores 05/2011 edhe pse pozitat e tyre nuk figuronin fare në rregullore. Në kuadër të pozitave, krijues dhe performues të arteve ishin futur edhe njerëz të cilët punojnë sigurim, apo edhe pastruese. Nga shqyrtimi i listës së punonjësve të MKRS-së, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vërejtur se në shumë rast ishin aplikuar kompensime me koeficiente të ndryshme për pozita të njëjta.

Pagesa të parregullta. Me vendim të sekretarit ishte paguar Komisioni për çështje banesore i përbërë prej pesë anëtarësh, zyrtarë të Ministrisë, për mbajtjen e gjashtë seancave në vlerë totale 3125 euro. Vendimi dhe pagesat ishin në kundërshtim të plotës me nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Parregullsi në procedura të prokurimit si dhe mangësi në komisionet e pranimit të mallit. Ministria kishte aplikuar kontrata në vlera minimale, duke furnizuar disa herë gjatë vitit për të njëjtit artikuj si njëmbëdhjetë herë për pajisje të teknologjisë informative, katër herë me inventar dhe tri herë për servisim të automjeteve. Për më tepër, kërkesat për mallra dhe shërbime të bëra nga njësia kërkuuese nuk përputhej me sasinë e furnizimit. Komisionet për pranimin e mallit nuk ishin të autorizuara siç kërkon Rregullorja 01/2013 për kompensimin e parasë publike.

Po ashtu, këto komisione që pranuan mallrat kishin raporte të mangëta të cilat nuk dëshmojnë se janë pranuar mallrat e paguara, pasi që nuk specifikojnë llojin, sasinë e mallrave të pranuar si dhe kontrata për të cilët janë paguar.

Subvencionimi i parregullt. Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit kishte mbuluar shpenzimet për fanellat e tifozëve “Dardanët” me rastin e garave kualifikuese Botërori Rusi 2018, në total prej 23 570 euro. Për këtë nuk është marrë miratimi i ministrit ashtu siç kërkohej me ligj dhe se për këtë, për të njëjtin aktivitet, ishin bërë tri pagesa për subvencionim, derisa kontrata me përfituesin e subvencionimit ishte nënshkruar pas pranimit të faturës për pagesë. Arsyetimi i dobët i shpenzimeve nga Federata, subvencionet e dhëna për dhjetë federata sportive në vlerë 331 mijë euro nuk ishin menaxhuar mirë, kjo ngase në 13 raste mjetet e këstit përkatës ishin derdhur pa u arsyetuar paraprakisht kësti paraprak siç kërkohet me nenin 20 të Rregullores së brendshme për subvencione. Në dy raste të tjera të financimit të federatave sportive dhe Komitetit Olimpik ishin bërë pagesa edhe të njëjtat nuk kishin dorëzuar projekt financiar siç kërkohet me nenin 17 të Rregullores. Për mbështetjen e tri federatave sportive në vlerë 78 mijë euro, vendimi për subvencionim ishte bërë pas përfundimit të projektit.

Shpenzimet e mjeteve nga institucionet vartëse të Ministrisë. Te subvencionimi i Baletit, nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit në vlerë 39 560 euro, ka vërejtur se Baleti i Kosovës ka paguar ndërkaq për koreografët e jashtëm të angazhuar në projekte diku me para në dorë. Po ashtu mëditjet për udhëtime zyrtare paguhen në tarifa fikse prej 40 euro, duke mos respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 2004/07 për udhëtime zyrtare. Te subvencionimi i shfaqjes Zoti i Masakrës në vlerë 10 mijë euro, Teatri i Kosovës nuk kishte mbajtur në burim kontributet për të angazhuarit e brendshëm, ndërkaq për aktorët jovendas nuk ishte ndalur tatimi.

Me rastin e subvencionimit të Filarmonisë së Kosovës kemi vërejtur se mungon raporti narrativ dhe dokumentet financiare mbështetëse dhe nuk janë në pajtim me Rregulloren 01/2013 për shpenzimet publike. Kjo pasi që shtatë dirigjentë të huaj të angazhuar në projekte ishin paguar me para në dorë, në vlerë 30 mijë euro. Po ashtu ishin paguar edhe 58 instrumentistë të huaj në vlerë 15 mijë euro, si dhe tetë solistë të huaj në vlerë 3750 euro, të gjithë këto me para në dorë. Vlera e përgjithshme kap shumën e 48 537 euro, pra të gjitha këto pagesa janë bërë me para në dorë. Po flasim për vitin 2017.

Subvencionimi, ngjarje me karakter biznesi. Ministria e Kulturës kishte mbështetur projektin Koleksioni Dardani në vlerë 6000 euro. Në mungesë të planit dhe arsyeshmërisë së projektit, mjetet për këtë projekt ishin derdhur në llogari private dhe nuk dihej qëllimi i subvencionimit, pasi që aktiviteti i realizuar kishte karakter biznesi.

Financimi i OJQ-ve. Në një rast subvencionimi në vlerë 2 000 euro, pagesa është bërë në llogari private të personit dhe jo të OJQ-së. Te e njëjta nuk kishte kontratë të shkruar me përfituesin dhe kërkesa për financim në pjesëmarrje në turnirin ndërkombëtar të veteranëve, e bërë në emër të OJQ-së “Veteranët e futbollit të Prizrenit”, ishte e panënshkruar nga OJQ-ja.

Shpenzime të parregullta dhe mos ndjekja e procedurave të prokurimit. MKRS nuk kishte ndjekur procedura të prokurimit në kontraktimin e projekt-menaxherit mbikëqyrës në kryerjen e shërbimeve profesionale të renovimit të stadiumit të qytetit të Prishtinës. Më tutje për të njëjtin nuk i ishin mbajtur në burimet kontributet dhe tatimi në pagë, ashtu siç kërkohet me Ligjin e të ardhurave personale.

Gjatë viti 2017 pagesa totale për shërbimet dhe mbikëqyrësit të këtij menaxheri kapin shifrën 49 mijë e 500 euro.

Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të papërgjegjshëm. Në katër raste MKRS kishte shpërblyer me kontratë operatorët ekonomik të cilët nuk kishin plotësuar të gjitha kriteret sipas dosjes së tenderit. Operatorët ekonomikë vetëm pjesërisht kishin dëshmuar pronësinë e makinerisë së listuar dhe mjetet e punës të nevojshme për realizimin e punimeve.

Çështja e radhës lidhja e aneks-kontratës në mënyrë të parregullt. Në kuadër të kontratës bazë në vlerë 3 843 715 euro, renovimi i stadiumit të qytetit të Prishtinës, MKRS kishte lidhur një aneks-kontratë për punë shtesë në vlerë 381 mijë euro.

MKRS ka lidhur kontratë me procedura të negociuara pa publikim të kontratës në vlerë 4 471 928 euro.

Duke iu referuar Ligjit për Prokurim publik, autoriteti kontraktues mund t'i përdorë procedurat e negociuara pa publikim e njoftimit të kontratës kur punët apo shërbimet e tilla edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale janë të domosdoshme për t'i kompletuar.

Në këtë kuadër, në kuadër të kontratës prej 3 milionë e 843 mijë euro, MKRS kishte lidhur një aneks-kontratë për punë shtesë në vlerë 381 mijë euro. Kjo ishte bërë me qëllim që stadiumi t'i arrijë standardet e kërkuara nga UEFA, në kategorinë e katërt të stadiumeve.

Ky aneks ishte lidhur edhe pse dihej që më parë që me punët shtesë të parapara në këtë aneks, nuk do të arriheshin ato standarde për çka edhe ishte nënshkruar kontrata e re.

Për më tepër, për të kompletuar të gjitha punimet e kërkuara nga UEFA, për këtë kategori MKRS ka lidhur një kontratë të proceduar, të negociuar pa publikim të kontratës në vlerë 4 milionë e 471 mijë euro.

Mosdeklarimi i blerjeve mbi 500 euro në ATK, MKRS gjatë vitit 2017 nuk kishte deklaruar për blerjet mbi 5 mijë euro në ATK edhe pse kjo është kërkesë e Ligjit për Administratën Tatimore dhe proceduarat. Përveç që është kërkesë ligjore, MKRS ka të domosdoshme këtë deklaram, marrë parasysh faktin se institucionet vartëse të MKRS-së për disa nga blerjet aplikojnë formën e pagesave me para në dorë.

Në fund, zbatimin e rekomandimeve. Nga 22 rekomandimet e një viti paraprak, vetëm 6 nga to janë adresuar, 1 është në proces, kurse 15 nga to nuk janë adresuar fare.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave publike ka rekomanduar gjithsej 12 rekomandime...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare, LDK është paraqitur, PDK jo. Lëvizja Vetëvendosje, deputeti Ali Lajçi. Ali, e keni fjalën. Ali Lajçi, edhe një herë.

**ALI LAJÇI:** Ashtu siç u shpreh kryetari i komisionit. Pika tona të thirrjes së bordeve dhe ministrive për të raportuar në kuadër të këtij komisioni për çështje publike të financave kanë vajtur mirë dhe po shkojnë gjithnjë në trend të mirë.

Ne kemi parë praktika të mëhershme të këtyre raporteve, sidomos te auditimet të cilat janë përcjellë dhe e kanë pasur një përkushtim të mirë të punës e sidomos me auditimin e raporteve me karakter të rregullsisë më shumë. Ndërsa sa i përket çështjes së performancave të menaxhimeve kanë ngecur, por megjithatë është një këshillë që të mund të orientohemi drejt një auditimi me karakter të trajtimit të performancave që do të ishte një trajtim më i gjithanshëm me një ekspertizë të thirrur dhe të domosdoshme.

Në këtë mes ne e kemi parë edhe një raport të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të cilin edhe auditimi e ka kualifikuar dhe ne sigurisht në përcjellje të saj si njërin prej raporteve mund të themi me mangësi më të mëdha në kuptim të auditimit të cilin faktikisht në mënyrë kronologjike, saktë mund të themi se është parë edhe modeli i menaxhimit të asaj ministrie, respektivisht nga raporti i vitit 2017.

Siç e tha me të drejtë edhe kryetari i komisionit, janë adresuar çështje të cilat faktikisht kanë dhënë një raport mjaft të dobët të menaxhimit të ministrisë. Prandaj, edhe te pasqyrat financiare edhe te mbivlerësimet edhe te personeli, organizimi i tij, edhe te përgjegjësitë të rregullsisë e paraqitjeve të tenderëve, buxheti kapital etj., ka kaluar mund të themi me shumë defekte çfarë u përmenden në mënyrë kronologjike me shumë të drejtë.

Në këtë mes edhe rekomandimet të cilat do të mund ta luanin një rol të rëndësishëm në përmirësimin e menaxhimeve, jo vetëm këtu, por edhe në shumë ministri edhe në shumë borde, sigurisht se po ngecin dhe nuk janë në trajtim të duhur të tyre, gjë që shpesh mund të ndodh që 80% të raporteve që i dedikohen me rekomandime nuk zbatohen, madje shumë pak iu qasen atyre përmirësimeve dhe kështu mbetin me trajtime negative të tyre.

Edhe kjo ministri nuk i ka trajtuar në nivel të duhur rekomandimet, por është vërejtur në raport që ishte edhe ministri, se ky ministri i ri ka tentuar pak ta ndryshojë gjendjen, megjithëse të metat e mëdha që kanë mbetur si trashëgimi.

Përgjithësisht ne ende nuk kemi parë nga këto ministri ndonjë raport me kaq defekte, sa i përket dhënies së auditimit në kuptim të një qasje çfarë iu është bërë.

Ne mbesim me shpresë që ministri i ri dhe synimet që kishte në këtë plan të mund të ishin më pozitive në rezultat dhe të trajtohen këto, sidomos përcjellja dhe trajtimi i rekomandimeve. Faleminderit!

**KRESUESI:** Faleminderit! Mërgim e keni kërkuar më vonesë fjalën për atë edhe e kalove radhën.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit! Ke të drejtë, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që e kam lexuar këtë raport me një shqetësim të madh, dhe duke qenë se jam edhe pjesë e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e kemi bashkëbiseduar me kolegë dhe me përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe kemi parë që ky rekomandim, këto të gjetura të auditorit me të vërtetë janë shumë shqetësuese.

Ne e dimë se pas pavarësisë së vendit dhe shtetformimit, sigurisht që nuk mund të vihen të gjitha çështjen në binarë dhe të rregullohen ashtu siç duhet, por krahasuar me ministrinë e tjera të cilat kishin hyrë në binarë të ligjeve dhe kishin të gjetura më të vogla krahasuar me këtë ministri, e kemi shprehur që këto të gjetura dhe këto rekomandime të vijnë në seancë për diskutim.

Për mua ka qenë gjithashtu shumë shqetësuese çështje e kodeve buxhetore ose disa agjenci që Ministria e Kulturës i ka nën ombrellën e saj, kanë pasur kode në banka private, por këtu vlen të theksohet dhe e falënderoj ministrin e ri të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili ishte me neve në takim dhe bashkëbiseduam sesi t'i rregullojmë që në të ardhmen mos t'i kemi këto të gjetura.

Më erdhi mirë që shumicën e rekomandimeve vetëm se i kishte plotësuar dhe i kishte vendosur në binarin e ministrisë dhe nën ombrellën e legjislacionit të kësaj ministrie.

Këtu vlen të theksohet që realisht të gjitha këto të gjetura janë përgjegjësi e menaxhmentit të lartë të ministrive të kaluara. Siç e thashë edhe më herët janë të gjetura shumë serioze dhe në këtë drejtim ne si grup parlamentar i kemi shqyrtuar bashkërisht dhe do ta mbështesim miratimin e këtyre rekomandimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ia jep fjalën Driton Selmanjat, meqë nuk ka arritur t'i lexojë rekomandimet në tërësi. Driton, urdhëro!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt unë do të doja ta merrja fjalën pas ministrit, por për shkak të transkriptit më mirë po i lexoj rekomandimet.

Rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike:

A. MKRS duhet ta hartojë planin e veprimit dhe t'i caktojë personat përgjegjës si dhe afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MKRS-së për vitin 2017. Ky plan i veprimit dorëzohet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike brenda një muaji, në veçanti: Ministri duhet të sigurojë që përgatitja ose kërkesa buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë, po ashtu është e nevojshme

që të bëhen përpjekje për ndarjen në kodeve buxhetore të veçanta për secilin institucion vartës të kulturës, në mënyrë që institucionet të planifikojnë buxhetin e tyre.

B. Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuar të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin do të bëhet konform kontratave valide dhe rregulloreve në fuqi, si dhe ministri duhet të sigurojë se kategorizimi i pozitave të drejtorëve në institucionet vartëse të bëhet në përputhje me mandatin e tyre dhe ligjet përkatëse të institucioneve vartëse.

C. Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore. Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë kompensime shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të postit që mbajnë punonjësit e ministrisë. Gjithashtu, duhet të sigurojë se të gjitha pagesat kryhen sipas ligjeve përkatëse.

D. Ministri duhet të sigurojë që plani i prokurimit të përfshijë në një kontratë, mallrat, shërbimet si dhe furnizimet e njëjta. Për çdo furnizim komisionet autorizohen dhe raportet e pranimit të përmbajnë informata të nevojshme që dëshmojnë se mallrat e paguara janë pranuar në përputhje me sasinë dhe cilësinë e kontratës përkatëse.

E. Ministri duhet të sigurojë që secili vendim për subvencionim do të përmbajë shumën totale të financuar për aktivitete të caktuara dhe do të jetë konform rregullores së brendshme.

F. Ministri duhet të sigurojë që të respektohen të gjitha kriteret e rregullores së brendshme me rastin e financimit të federatave dhe të mos financohet kësti tjetër pa u arsyetuar tërësisht këstet paraprake. Gjithashtu të sigurojë se vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve dhe të mos jepen subvencione për projekte që tashmë janë realizuar.

G. Ministri duhet që të hartojë rregulloren gjithëpërfshirëse për kompensimin e të angazhuarve në projekte të baletit, dhe kompensimi për të angazhuarit e jashtëm të bëhet vetëm nëpërmjet llogarive bankare. Po ashtu tatimet dhe kontributet e të angazhuarve duhet të mbahen në burim sipas kërkesave ligjore, si dhe furnizimet nga institucionet vartëse duhet t'i nënshtrohen procedurave formale të prokurimit.

H. Ministri duhet të sigurojë që në të ardhmen mjetet për financimin e projekteve të OJQ-ve të derdhen në llogaritë bankare të OJQ-ve, personave juridik që subvencionohen. Të sigurohet gjithashtu se OJQ-të financohen vetëm në rast të kërkesave valide dhe të kenë kontratë të nënshkruar me përfituesin e subvencionimit.

I. Ministri duhet të sigurojë që për secilin aktivitet të përkufizuar në Ligjin e prokurimit publik do të aplikohen procedura të prokurimit. Po ashtu të sigurojë që kontrollet lidhur me shpenzimin

e parasë publike janë duke funksionuar ashtu që pagesat të realizohen në përputhje të plotë me ligjin në fuqi. Po ashtu, ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontratat do të lidhen me operatorët ekonomik të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit.

J. Ministri duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit, bashkëpunimit të nënshkruhen nga ai dhe jo nga Sekretari i Përgjithshëm.

K. Ministri dhe drejtori i thesarit, duhet të sigurohen që të mos paguajnë faturat e papranuara e ta protokolluara nga MKRS dhe pa u konfirmuar marrja e mallrave apo e shërbimeve.

L. Ministri duhet të sigurojë aktivitete të mjaftueshme të njësisë së auditimit të brendshëm mbi institucionet vartëse të MKRS-së, dhe përfundimin e planit vjetor të auditimit. Linjat llogaridhënëse brenda ministrisë duhet të rishikohen në mënyrë që njësia e auditimit të brendshëm të raportojë te ministri. Po ashtu duhet ndërmarrë veprime proaktive në adresimin e rekomandimeve të njësisë së auditit të brendshëm duke përgatitur një plan të veprimit për implementimin e tyre.

Në fakt ishin shumë rekomandime, po kjo vjen si rezultat i shumë të gjeturave të cilat i listova më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë nuk ka të tjerë të paraqitur, fjalën e ka ministri Gashi.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht ju falënderoj për të gjitha rekomandimet të cilat u dhanë për Ministrinë e Kulturës, pavarësisht faktit në periudhën për të cilën është bërë auditimi në Ministrinë e Kulturës, unë nuk kam qenë në krye të kësaj ministrie. Megjithatë, në lartësinë 100% i kemi adresuar të gjitha të gjeturat, dhe është një fat i mirë se prej shumicës së atyre që i theksove zoti Selmanaj, tashmë veç kanë përfunduar dhe janë bërë pjesë edhe të adresimit, por në të njëjtën kohë edhe të gjitha të gjetura edhe defektet janë eliminuar.

Unë jam përpjekur që një pjesë të atyre që ju thatë t'i shkruaj dhe do të mundohem që shkurtimisht të përgjigjem secilën.

Sa i përket çështjes së llogarive bankare të cilat kanë qenë në banka komerciale e të cilat kanë qenë të gjitha të institucioneve vartëse, edhe të kulturës edhe të trashëgimisë kulturore, menjëherë i kemi mbyllur dhe në të njëjtën kohë të gjitha mjetet financiare të cilat kanë qenë, këto xhirollogari janë kthyer në buxhet të Republikës së Kosovës.



Tashmë edhe projektet të cilat kanë qenë duke u realizuar, por edhe ato që kanë qenë të planifikuara janë duke u administruar nga Ministria e Kulturës, pra nuk ka më menaxhim nga drejtorët e institucioneve dhe në të njëjtën kohë nga institucionet, qofshin ato qendra rajonale të trashëgimisë kulturore po edhe institucionet tjera. Pra, gjithçka është duke ndodhur brenda Ministrisë së Kulturës në bashkëpunimin edhe me Ministrinë e Financave.

Sa i përket çështje së pagesave në terren, po është fakt kanë ndodhur, janë paguar në terren dhe nga ia moment ne kemi ndërprerë pagesat në terren dhe kemi filluar menjëherë hartimin e një rregulloreje përkatëse, me të cilën do të gjejmë natyrisht edhe bazën ligjore e cila do të na mundësojë që atyre që punojnë në terren, qoftë jashtë orarit, qoftë gjatë vikendeve t'i paguajmë, por për momentin kjo çështje është ndërprerë edhe nuk bëhet asnjë pagesë.

Sa i përket çështjes së federatave është fakt që më shumë janë lidhur memorandume dhe marrëveshje me federatat se sa kanë qenë të planifikuara, megjithatë ne kemi arritur që në fund të vitit 2017 me ridestinim të mjeteve t'i mbulojmë të gjitha obligimet që ka pasur ministria ndaj këtyre federatave dhe kemi hyrë në vitin 2018 pa obligime shtesë.

Është fakt që për ata që e njohin pjesën ose fushën e Ministrisë së Kulturës në disa prej federatave nuk kemi paguar TM Cashin, për shkak se nuk raportuar me kohë dhe kemi hyrë në vitin 2018, por kemi hyrë pa obligime.

Të çështja e rregullores për krijues dhe përformues ku në kuadër të kësaj rregulloreje kanë qenë edhe disa punëtorë teknik, ne gjatë këtij viti më 12 shtator ose 13 shtator të këtij viti e kemi miratuar rregulloren e re për krijues dhe performues, dhe kemi arritur që t'i eliminojmë të gjitha këto defekte që nuk kanë qenë shumë, kanë qenë 3 ose katër punëtorë tek ne të cilët kanë qenë pjesë e rregullores, dhe tashmë ata nuk janë pjesë e kësaj rregulloreje dhe po paguhen natyrisht teknik, si shërbyes civil të ministrisë.

Federatat financohen me rregullore të re tashmë, dhe asnjë prej federatave të sporteve nuk e merr këstin e ardhshëm nëse nuk ka raportuar paraprakisht për këstin paraprak. Pra, për të gjitha federatat gjatë vitit 2018 të cilat janë financuar nga Ministria e Kulturës, të gjitha është dashur ta mbyllin TM1 për ta marrë TM2, e kanë mbyllur TM2 dhe pastaj kanë arritur që ta përfitojnë TM3.

Është fat i mirë që një e pjesë e madhe e këtyre federatave tashmë kanë filluar të bëhen pagesat edhe për TM4. Pra, ka një disiplinë jashtëzakonisht të mirë në këtë drejtim dhe kemi arritur që edhe federatat edhe zyrtarët financiar brenda federatave tua mbajmë një trajtim dhe t'ju japim njohuritë e reja sesi duhet raportuar dhe për mbyllje të federatave. Pra, është një ndryshim jashtëzakonisht i madh dhe të gjitha federatat janë duke raportuar sipas sistemit të ri të cilin e ka krijuar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Te baleti dhe pagesat që kanë ndodhur, qoftë për koreograf ose të angazhuar nga jashtë, është e vërtetë që pagesat janë bërë me para kesh. Gjatë vitit 2018 nuk kemi asnjë rast i cili ka ndodhur dhe janë paguar këta jo nëpërmjet xhirollogarive, por me mjete kesh, dhe e kemi ndërprerë këtë dukuri që mendoj edhe unë ka qenë një prej dukurive shumë të shëmtuara që kanë ndodhur brenda kësaj ministrie, sepse ndoshta kanë qenë vlera të mëdha të cilat janë paguar me mjetet kesh, por të gjitha këto kanë ndodhur nga institucionet e kulturës.

Pra, tashmë edhe të angazhuarit nga jashtë të cilët angazhohen në institucione, të gjithë paguhen nëpërmjet xhirollogarive pasi paraprakisht bëjnë kontrata me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Sa i përket marrëveshjeve mbi shërbime të veçanta, unë ju siguroj që gjatë vitit 2018 asnjë marrëveshje ose asnjë i angazhuar me shërbime të veçanta nuk punon në Ministri të Kulturës pa konkurs paraprak. Të gjithë të angazhuarit që nuk është numër shumë i madh, gjatë vitit 2018 kanë ardhur në Ministri të Kulturës me konkurs. Pra, e kemi një ndryshim.

Është e vërtetë që në të kaluarën ka ndodhur që ka pasur të angazhuar edhe pa konkurs.

Te pagesa e komisioneve, ata të cilët janë pjesë e Ministrisë së Kulturës dhe janë pjesë e bordeve ose këshillave të institucioneve të kulturës, tashmë nuk paguhen, e kemi ndërprerë. Nuk marrin pagesa ose mëditje për angazhim në këto këshilla, me përjashtim të atyre që janë të angazhuar prej jashtë, që nuk janë pjesë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Te memorandumet që kanë ndodhur në të kaluarën kur sekretari i ka nënshkruar është e vërtetë, një pjesë dërmuese të memorandumëve janë nënshkruar nga sekretari, në vitin 2018 i kemi vetëm dy memorandume nga sekretari për shkak të një udhëtimit që kanë pasur jashtë, por e kam autorizuar sekretarin që ta nënshkruajë. Përndryshe, 98% ose 99% të memorandumëve janë të nënshkruara nga unë dhe të gjitha janë duke u implementuar sipas marrëveshjes që kemi pasur.

Te plani vjetor i auditimit, ne sot e kemi proceduar, domethënë e kemi përmbyllur. Kam pasur takim me auditorin e brendshëm, dhe po besoj që të gjitha këto çështje e të gjetura i kemi adresuar në mënyrën më të mirë të mundshme, edhe pse nuk mund të garantoj që gjatë viti 2019 nuk mund të ketë ndonjë të gjetur të vitit 2018. Por, ajo që është e sigurt dhe e garantoj nuk do të ketë përsëritje. Ato që janë gjetur gjatë vitit 2017, nuk do të gjenden edhe gjatë vitit 2018, sepse në masë të madhe të gjitha i kemi adresuar.

Edhe një informatë. Në kohën kur ka filluar ta drejtoj ministrinë kemi pasur realizim të buxhetit vetëm 40% në tërësi dhe kemi arritur që pas ridestinimit të buxhetit, realizimin në total ta mbërrijmë në 96%, sepse një pjesë e madhe kanë qenë borxhe, qofshin federatave apo qofshin edhe institucioneve tjera, edhe organizatave të cilat kanë përfituar nga konkurset e ndryshme,

qoftë në Departament të Rinisë apo Kulturës, dhe kemi arritur ta realizojmë buxhetin për rreth 96% pas ridestimit të mjeteve.

Besoj që jam përpjekur që në pika të shkurtra t'i jap të gjitha përgjigjet. Është shumë e rëndësishme që ky raport ka ardhur sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe të gjitha rekomandimet që u dhanë nga komisioni do të gjejnë adresim të duhur edhe nga unë, por edhe nga stafi im në Ministri të Kulturës.

Unë ju falënderoj që keni qenë jashtëzakonisht të angazhuar edhe në takimin që kemi pasur me komisionin, por edhe sot këtu për t'i eliminuar ato të gjetura që kanë ndodhur në 2017 në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani pas përfaqësuesit të Qeverisë, fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

E mbështes çdo raport i cili i vë në pah mangësitë, të cilat kanë ndodhur gjatë shfrytëzimit të buxhetit.

Disiplinimi i federatave sportive dhe organizatave tjera buxhetore është më se i domosdoshëm. Por, raporti i auditimit shpeshherë nuk paraqet edhe disa gjendje faktike të cilat janë në terren.

Raporti i auditimit nuk na paraqet, se ne për këto 20 vjet nuk kemi qenë të gatshëm që ta kemi një stadium të futbollit ku mund të zhvillojmë ndeshje ndërkombëtare.

Raporti i auditimit nuk e paraqet që ne një cikël kualifikues e luajtëm në Shkodër. Raporti i auditimit nuk paraqet edhe disa anë të tjera të cilat kanë qenë shumë të domosdoshme për zhvillimin e sportit. As ato të lobimit e të angazhimit të punës së mirëfilltë për të ardhur deri në këtë gjendje që sporti të zhvillohet në nivelin e kënaqshëm që ne vërtetë të jemi krenar me rezultatet e sportistëve tanë.

U potencuar financimi i “Dardanëve”, 23 mijë euro. Shumë i vogël si financim. Ministria duhet të shkojë kah disiplinimi i procedurave, por tifozeria jonë duhet të mbështet jo vetëm për përkrahjen që u bën sportistëve tanë, por edhe në vetëdijesimin dhe ngritjen e vetëdijes edhe të të gjithë shikuesve, e në veçanti në eliminimin e dukurive negative.

Kur jemi këtu, kërkoj që edhe për fund të këtij viti, por edhe për vitin e ardhshëm, ministria vërtet të planifikojë. Kur një ish-ministër është duke e udhëhequr seancën, e tjetri duke raportuar, sigurisht që kritikën kryesore të atij auditimi 2017 i shkojnë udhëheqësit të seancës, por nuk duhet lënë edhe pa meritat e sukseseve, sepse unë dua të jem real edhe kur kritikojmë, por edhe kur japim merita për punë.

Ju e dini që unë udhëheqjen e seancës kur ka qenë ministër e kam kritikuar shumë kur luajtëm në Shkodër, por ka filluar puna për stadiumin në Prishtinë dhe dobësitë që ai stadium të mos lëshohet me kohë dhe të mos funksionalizohet me kohë kanë qenë mu në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, edhe ato tejkallimet buxhetore, të cilat kanë ndodhur për shkak që stadiumit që t'i plotësojë kriteret sipas FIFA-s dhe UEFA-s ka qenë prapë te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për çka dua ta falënderoj pasuesin e udhëheqjes së seancës, këtë rast ministrin Kujtimin Gashi që arrit ta përmbyllë me sukses këtë projekt dhe vazhdoi edhe me projekte të tjera nacionale, edhe tani me projektin e Stadiumit Olimpik 'Adem Jashari' në Mitrovicë, po edhe me atë nacional.

Po çka ka sigurisht nevojë dhe që nuk është në raport, raporti nuk e paraqet nevojën që të ketë një ligj të veçantë për menaxhimin e objekteve sportive, më se e domosdoshme, sepse të gjitha investimet që janë bërë në objekte të tjera sportive, në palestra, por edhe këto stadiumet e futbollit, edhe 'Adem Jashari', edhe stadiumi i Prishtinës është e parregulluar me ligj, apo them më mirë, nuk është rregulluar me ligj menaxhimi i tyre, edhe aspektet e sigurisë. Përveç aspekteve të sigurisë që parashohin federatat ndërkombëtare, këto edhe për shkak të rrethanave në të cilat po jetojmë sigurisht që duhet të ketë edhe një ligj të veçantë, e në veçanti për menaxhimin, sepse këto investime kaq të mëdha që po bëhen në sport, edhe duhet të ruhen me anë të ligjit dhe me persona përgjegjës për ta ditur se kush e ka përgjegjësinë për këto objekte sportive. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Driton Selmanaj, ka të drejtë si deputet apo jo?

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, nënkryetar Shala!

Në fakt tash po tentoj të flas si deputet.

Kjo periudhë e raportimit në fakt ju përfshin dy ministrat, njëri gjysmën, tjetri gjysmën, sepse afërsisht ashtu e kap periudha.

Megjithatë për mua pak ka rëndësi ajo se kush ka qenë ministër, të rëndësishme janë të gjeturat shqetësuese, të cilat ne si komision kur kemi filluar t'i trajtojmë, i kemi parë aty.

Tash unë s'kam mundur të mendoj se në vitin 2017 akoma institucionet paguajnë para kesh në dorë, t'i kesh 4-5 kontrata në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik në Kosovë, ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Tash unë mund të pajtohem, mund të pajtohem me gjithë ato çka zoti Gashi tha, nëse janë të vërteta, normalisht i përshëndet, por këto ne i konstatojmë në raportin tjetër kur të vijmë në komisionin tonë dhe ne i trajtojmë. Nëse janë mirë, do t'i përshëndesim, sigurisht, nëse janë keq, i diskutojmë prapë.

Atë çka unë e kam shqetësim është që shumica e institucioneve kur të vijmë tek ne thonë zotohemi që do të përmirësojmë dhe, në fakt, disa edhe ndodh që i përmirësojnë, problemi është çka me ata që kanë bërë shkelje.

Ne po flasim për shumë veprime, të cilat kanë ndodhur që mund të mos jenë fare me përfaqësimin politik dhe me postin politik, mund të jenë krejt të karakterit administrativ, të punëtorëve aty, prej sekretarit të përhershëm e teposhtë dhe të njëjtit vazhdojnë të ushtrojnë funksionin, këtu e kanë problemin, sepse përkushtimi mund të jetë i ministrit maksimal, por nëse këto të gjetura, të cilat ne i përmendëm këtu e disa nuk arritëm t'i përmendim, vazhdojnë të figurojnë ato, ose edhe përmirësohen, po persona të njëjti vazhdojnë të ushtrojnë funksionin.

Tash, ne përpos që mund të kemi edhe përgjegjësi të tjera përtej përgjegjësive jopolitike, po në kuadër të punës që e bëjnë, mund të ketë edhe elemente të përgjegjësisë penale, por kjo është çështje e dikujt tjetër, të cilën mund ta vënë në funksion institucionet e tjera.

Por unë kam dallimet e mia me shumë institucione të cilët na sjellin edhe përkushtimin e tyre, duhet përshëndetur përkushtimi, por dikush duhet të përgjigjet për ato që ka ndodhur, sepse po flasim për një varg të madh shkeljesh.

Unë po ju lus jo vetëm si kryetar i komisionit, po edhe si Driton, si deputet, në këtë rast, që t'i miratojmë këto rekomandime kurdo që na vinë në agjendë, sepse unë mendoj që janë në të mirë të shpenzimit të parasë publike në të gjitha institucionet në Kosovë.

Mund të jem i kritikuar nga dikush, sepse më thoshte se ja, shihe ministri juaj, por nuk është ideja këtu të mbrojmë askënd, por secili përgjegjës, i cili është përfshirë në këto procese, të ketë adresë llogaridhënëse, për cilin unë jam i sigurt që më tepër janë të karakterit tjetër se sa të karakterit politik. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur.

Nuk kemi kuorum. Edhe unë kam disa komente, po meqë sipas Rregullores duhet të dal në foltore dhe duhet të më zëvendësojë dikush, e s'ka kush të më zëvendësojë, kërkoj lejen tuaj që të flas nga këtu, nëse jo, nuk do të flas. Domethënë, mundem.

Faleminderit! Sepse nuk dëshiroj të keqkuptohet.

Tani do t'i bëj 2-3 sqarime: E para, raporti i komisionit është me copa të raportit të auditorit, domethënë me copa të një dokumenti, i cili ka më shumë se një vit që është publik dhe është diskutuar dhe rekomandimet janë pjesë të rekomandimeve të auditorit, domethënë siç çështje është e njohur.

Komisioni ka zgjedhur çështjet, të cilat për ta janë specifike. Unë besoj që normalisht nuk mohoj rëndësinë e problemeve për të cilat folët, po probleme të tjera ka shumë më të rëndësishme se sa këto.

Përcaktimi themelor i këtij raporti dhe kualifikimi që i bën auditori u referohet pasqyrave të pasurisë së ministrisë dhe, që ta bëjmë më të qartë, këto po i them, me që unë i di, sepse në vitin 2017 në një pjesë të vitit kam qenë ministër.

Ju referohet pasqyrave, më shqip, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk i ka kthyer të dhënat për pasurinë e saj në një tabelë të re, kaq ka, domethënë ky është problemi. Po problemi themelor i këtij raporti janë pasqyrat financiare të pasakta dhe këtë do të duhej të trajtonte Komisionit.

Çka do të thotë kjo, pasqyra financiare të pasakta e bëjnë gati të pamundur që të kesh pamjen e plotë dhe të saktë për gjendje e administrimit.

Tani çka janë raportet e auditimit? Janë kualifikime ose vlerësime për procesin e administrimit dhe të menaxhimit që s'kanë të bëjnë me drejtuesit politikë, që s'kanë të bëjnë me ministrin dhe me kabinetin e tij, por i drejtohen ministrit që të marrë masa.

Pse, sepse pa raportet e kësaj natyre, një pjesë të mirë të problemeve, të cilat i evidenton auditori, ministri s'do të mund t'i dinte asnjëherë. Si, për shembull, çështjet e institucioneve të kulturës ose të federatave. Pse, sepse institucionet e kulturës janë të pavarura, ndërkaq federatat janë organizata joqeveritare.

Tash unë do të flas për 2-3 çështje, shpresoj që të jem i qartë.

Rezultati ose përmbushja e kërkesave të auditorit do të vërehet, pajtohem, në raportin e ri të Zyrës së Auditorit Kombëtar.

Në vitin 2016 ka pasur një raport më të mirë se sa ky dhe përkeqësimi ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit politik, e ky është detyrim i përfaqësuesve politikë dhe përgjegjësi e përfaqësuesve politikë.

Unë besoj që ka interpretime ligjore dhe të auditorit, të cilat nuk janë të sakta. Pse? Sepse ka interpretime të cilat ju drejtohen rregulloreve e ligjet e rregullojnë ndryshe, ndërkaq ligjet kanë përparësi në raport me rregulloret dhe ne këto i dimë sepse i miratojmë vetë.

Tani, pati edhe vlerësime të punës. Unë vërtet për punën kam folur shumë pak, do të flas për rastet specifike.

Stadiumi i qytetit të Prishtinës ka qenë një projekt i përbashkët i Qeverisë dhe i Komunës së Prishtinës.

Tani, unë s'mund të them që është projekt imi dhe ka dy kontrata dhe auditori gabon kur evidenton nënshkrimin e një kontrate shtesë nga ana e sekretarit të përgjithshëm. Pse? Sepse kontrata e parë nënkuptonte që ai stadium të bëhej i kategorisë së dytë, ndërkaq FIFA e kërkoi të kategorisë së katërt, për atë u bë kontrata e dytë, kur unë më s'isha ministër.

Për vonesat s'ka qenë përgjegjëse Qeveria, por Komuna e Prishtinës, sepse nuk ka kërkuar kushtet e ndërtimit nga Ministria e Ambientit, ministria priste, komuna s'i kërkonte, madje i kishte dërguar shkresë Ministrisë së Ambientit që të mos lejojë operatorin të punojë, sepse s'kishte leje, s'kishte kushte.

Pastaj, ia dha mundësinë, e autorizoi Qeverinë ose Ministrinë e Kulturës që të kërkojë këtë leje dhe punimet filluan me shumë vonesë.

Por, po të vazhdonte punën Qeveria e atëherëshme, ai stadium i cili u krye një vit më vonë do të përfundonte më 28 gusht të vitit 2017, sepse ky ka qenë orientimi dhe kjo ka qenë marrëveshja.

Sa për financimin e federatave, për të cilin foli edhe ministri, kjo është praktika e njohur, kjo kështu ka qenë. Nëse një federatë merr një pjesë të buxhetit dhe arsyeton dhe zyrtarët e ministrisë japin pjesën tjetër, i bie që shkelet Rregullorja për subvencionim.

Në të gjitha rastet, nëse e bën këtë, e shkel rregulloren dhe kjo bëhet me një firmë dhe ajo firmë domethënë e tregon edhe përgjegjësin.

Tani, unë do të flas edhe për një çështje, kjo është themelorja, besoj, e që është problem ligjor dhe kjo na intereson më së shumti ne këtu, sepse ne miratojmë ligje.

Për çështje, të cilat janë plotësisht në dorën e shërbimit civil, të shërbyesve civil, në pikën e fundit është përgjegjës ministri dhe unë po e bëj të qartë. Për shembull, për procedurat e prokurimit ministri s'ka të drejtë të ndërhyjë, s'ka të drejtë të interesohet në kuptimin e pjesëmarrjes, por nëse kontrata ka një shumë të lartë, ai duhet ta nënshkruajë në fund dhe s'mund

ta refuzojë, nëse e refuzon, bën shkelje, nëse nuk është i bindur dhe nënshkruan dhe ka pasur probleme, bëhet përgjegjësi kryesor edhe ai, dhe në këto duhet t'i kemi parasysh.

Tjetra, dokumentet tona lejojnë ose mundësojnë që ministri të autorizojë shërbyesit civilë që ta përfaqësojnë, si në rastin për të cilin foli ministri Gashi, vërtet tha dy raste, me të cilat në bazë të Rregullores e ka autorizuar sekretarin e përgjithshëm, po sekretari i përgjithshëm nuk është funksion politik, është shef i shërbimit civil dhe në pikën e fundit dhe e administratës. Ministri mund të autorizojë vetëm zëvendësministrin, e mbi çfarë baze e ka autorizuar ministri Gashi, mbi bazën e Rregullores 02/2011 për mandatet dhe përgjegjësitë e Qeverisë. Domethënë shihni çfarë problemesh kemi në këtu.

Rastet veç e veç unë do t'i diskutoj, por unë meqë e njoh raportin dhe e di, në të gjitha çështjet të cilat evidenton raporti, asnjë nga tre ministrat e vitit 2017 aty nuk ka firmë, po dikush e ka.

Nëse janë raste që duhet të diskutohen përtej këtu besoj që duhet të merren parasysh dhe ka kush t'i trajtojë.

Unë ju falënderoj për diskutimin dhe për debatin, s'do ta zgjas, nëse ka kolegë të tjerë që dëshirojnë fjalën? Jo.

Atëherë në nuk kemi kuorum, zoti ministër, faleminderit!

Në s'kemi kuorum që t'i miratojmë rekomandimet, por këto rekomandime unë e njoh edhe planin e veprimit të ministrisë, ministria i ka pasur parasysh dhe tashmë po merret me to, se është në fund dhe do të shohim rezultatin e tyre.

Atëherë rekomandimet do t'i miratojmë kurdo që të kemi kuorum.

Edhe një herë ju kërkoi falje që fola nga këtu.

## **9. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka dorëzuar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, besoj ministri Matoshi, në cilësinë e propozuesit që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: I nderuar nënkryetar,  
Të nderuar deputetë,



I nderuar ministër,

Qëllimi kryesor i këtij raporti është informimi i institucioneve qendrore dhe publikut të gjerë për gjendjen e mjedisit në Kosovë. Mirëpo të dhënat e tij janë edhe një bazë e mirë që mund të shërbejnë edhe për hartimin e politikave mjedisore dhe orientimeve e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët, të cilët kanë ndikim në mjedis, siç janë: industria, energjetika, transporti, bujqësia, e të tjerë. Shkurtimeisht, po i lexoj disa nga të gjeturat kryesore të këtij raporti në fushën e ajrit, përkundër progresit të arritur në ngritjen e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit, ende ka nevojë që të investohet në modernizimin, plotësimin dhe mirëmbajtjen e këtij rrjeti dhe në veçanti për funksionalizimin e softuerit qendror për përpunimin e të dhënave dhe raportin e tyre në kohë reale.

Vlerësimet tregojnë se burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë sektori i energjisë, transportit dhe ai i amvisërisë. Tek uji, cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve në bujqësi, si dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve dhe ndërtimet ilegale. Treguesit e prezantuar në këtë raport tregojnë për prani të ndotësve organikë, bakteriologjikë në ujërat e lumenjve, megjithëse mund të konstatohet që ujërat sipërfaqësore nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi.

Tek mbeturinat Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave, aktualisht në nivel nacional grumbullohen rreth 60% e mbeturinave të gjeneruara, pjesa më e madhe e tyre deponohet në deponi sanitare, ndërsa që ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes në burim dhe të riciklimit të mbeturinave. Është evidentuar po ashtu edhe numër i madh i deponive ilegale në tërë territorin e Kosovës, domethënë rreth 1 mijë e 500 sosh, të cilat përkundër angazhimit të komunave dhe donatorëve, vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori.

Raporti përmban të gjetura edhe për sektorët e tjerë mjedisorë, si toka, shëndeti publik dhe aspekte të përgjithshme të menaxhimit të mjedisit dhe po ashtu ofron edhe rekomandime për përmirësimin e gjendjes për secilin nga sektorët mjedisorë, të cilat rekomandime mund t'i gjeni të përmbledhura në një kapitull të veçantë të këtij dokumenti.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e prezantuara, në të gjeturat kyçe të raportit dhe në rekomandimet që jep dokumenti, ju ftoj që ta mbështesin aprovimin e tij dhe procedimin e mëtejshëm me qëllim të përmirësimit dhe menaxhimit të mjedisit dhe gjendjes mjedisore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër!

Tani në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, kryetari s'është, zoti Nitaj, kush do të flasë? Deputeti Salih Salihu!

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhje të mbajtur më datë 13 dhe 20. 11. 2018 shqyrtoi raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim: që të miratojë raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po më duhet ta ndërroj vendin, se teknika në Kuvend nuk punon dhe kjo lidhet edhe me pikën tjetër që diskutuam për buxhet, sa në rregull është Kuvendi i Republikës së Kosovës me teknikë dhe me të gjitha.

Ne sot po e shqyrtojmë raportin e mjedisit për vitin 2017, i cili vërtet të mundëson të kuptosh se kjo Qeveri sa është në rregull ose ky legjislacion, për arsye se ne po hyjmë në vitin 2019 dhe çfarë relevance ka që ta shqyrtojmë sot këtë raport të vitit 2017.

Megjithatë, fatkeqësisht gjendja e mjedisit që nga ai vit e deri tash është ende shumë alarmante. Ndotje të ajrit, të ujit, mbeturinat në çdo cep të vendit, deponitë e mbeturinave ilegale, ndërsa ato legale në gjendje të mjerueshme, shkatërrim i pyjeve, shkatërrim i lumenjve, mosrehabilitimi i tyre, shkatërrim i hapësirave nga gurthyesit, gjendja e memorialëve në gjendje të mjerueshme, ndotja dhe nga zhurmat. Inspektorati për të gjitha këto na ankohet sa herë i thërrasim për të na u përgjigjur për jofunksionimin e tyre, se vërtet u mungon stafi, ndërsa në buxhetin e këtij viti nuk parashihet rrit të stafit për Inspektorat për asnjë fushë, të cilat i ceka. Për të qenë më konkrete, pasi rastësisht ministri qenka sot këtu, unë po ju drejtohem, zoti ministër, me disa pyetje konkrete. Në bazë të raportit dhe në bazë të gjendjes aktuale, ju pyes a ka përgatitur Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ndonjë strategji ose plan për zëvendësimin e qymyrit, për djegien në shtëpi dhe biznese në Prishtinë si masë ndaj ndotjes së madhe të ajrit në fundvit? Nëse po, cili është plani i veprimit dhe masat kryesore, po të pyes për vitin 2019? Kur do të publikohet studimi i ministrisë tuaj për ndotësit kryesorë të ajrit në Prishtinë dhe Kosovë, i paralajmëruar për vitin 2018?

Çfarë do të ndodhë në vitin 2019 me numrin e stafit dhe buxhetin e drejtorive, pjesë e AMMK-së, të cilët merren me mbrojtjen e pyjeve nacionale, pasi gjatë vitit 2018 është raportuar për shkatërrimin e pyjeve në masë të madhe dhe në vijimësi? Cili është plani për mbylljen e deponive ilegale dhe integrimin e strategjisë dhe masterplanit për menaxhimin e mbeturinave nëpër komuna? A do të rritet shtrirja e ofrimit të shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave gjatë vitit 2019, ky si hap me ndikim në uljen e numrit të deponimeve ilegale? E, që në bazë të buxhetit, prapë po e theksoj që e shqyrtuam pikërisht sot, a janë të mjaftueshëm, zoti ministër,

për shembull, 100 mijë euro buxhet të ndara për vitin 2019 për ndërtimin e dy deponive në Prishtinë e në Pejë, nga gjithsej 66 milionë euro buxhet për shpenzime kapitale me të cilat menaxhon ministria juaj.

Unë e thashë më herët në diskutimin tim, po e përsëris, të gjitha projektet që i keni planifikuar, mbi 50, janë elektorale për të menaxhuar deponi dhe gjendjen alarmante të ambientit e që unë dhe ti dhe të gjithë e dimë që ambienti ka kosto të lartë rehabilitimi, janë qesharake të ndahen nga 100 mijë euro për projekte të tilla. Çka është ndërmarrë për të audituar tenderët dhe projektet për memorialët në Republikën e Kosovës? Zoti ministër, veç një shembull po ta jap për memorialin Adem Jashari, që fatkeqësisht atje janë investuar mbi 10 milionë euro dhe ne ende i kemi kullat të pakonservuara, pra pjesën më kruciale, më të rëndësishme të pakonservuar dhe ta keni parasysh, unë e kam vizituar, atje sidomos për këso listash, e sheh secili, edhe njeriu i thjeshtë, që mbi 3 milionë nuk janë investuar dhe të gjitha të tjerat janë vjedhur. Pra, mbi 10 milionë janë investuar dhe a keni planifikuar të bëni auditim në këtë drejtim?

Pastaj, kemi memorialin në Meje e të gjitha memorialët në gjendje të mjerueshme. Pyetje tjetër, a ka ndonjë plan konkret nga ministria juaj për rastin e deponive të Mirashit dhe Obiliqit, të cilat sipas raportit të Komisionit Evropian 2018 janë rrezik për mjedisin, veçanërisht për kontaminimin e ujit. A planifikohet rritja e stafit të Inspektoratit Mjedisor për vitin 2019, sepse nuk e keni në buxhet, stafin e rritni në ministrinë tuaja, ndërsa atje ku kërkohet çdo ditë vërtet inspektim në të gjitha fushat dhe jo vetëm në këtë aspekt, nuk ka planifikim buxhetor për punëtorët e tillë. Faleminderit për vëmendje!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pas deklarimit të grupeve parlamentare. Andin Hoti, në emër të PDK-së, Andin apo individualisht?

**ANDIN HOTI:** Jo në emër të PDK-së dhe mandej individualisht, nëse më lejon.

**KRYESUESI:** Mirë!

**ANDIN HOTI:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë të pranishëm,

Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë me të drejtë paraqet gjendjen jo të mirë të mjedisit. Prandaj ne si Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë raport dhe i ftoj edhe kolegët deputetë ta përkrahin.

Ndërsa, në emër timin, i nderuar kryesues, nëse më lejohet, ne jemi të shqetësuar shumë për shëndetin e qytetarëve të Kosovës si pasojë e shumë faktorë të mjedisit, mirëpo në theks të veçantë për ajrin e ndotur, i cili çdo ditë e më shumë po bëhet i rrezikshëm për jetën tonë.

Çdo ditë hasim në media paralajmërimë për të mos dalë jashtë shtëpive, sepse rrezikojmë shëndetin tonë, mirëpo në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe parandalimit të përkeqësimit të shëndetit të qytetarëve po bëhet shumë pak.

Të nderuar institucione përgjegjëse për mjedis,

Qytetarët e Kosovës janë gjallë, ata jetojnë, punojnë, dalin. Prandaj ne nuk mund as nuk guxojmë t'i sugjerojmë që ata të izolohen në shtëpi. Juaja dhe jona është të merren të gjitha masat e nevojshme dhe të mbrojmë ajrin nga ndotja dhe në të njëjtën kohë, u bëj thirrje të gjitha ndërmarrjeve publike, të gjitha ndërmarrjeve të cilat ndikojnë në cilësinë e ajrit, në ambient, siç është KEK-u, Qendra e Regjistrimit të Automjeteve, Termokosi dhe të tjera, të kenë kujdes të shtuar dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Gjithashtu u lutem qytetarëve që të evitojnë përdorimin e produkteve të rrezikshme për ambient. Qeveria e Kosovës e ka gati të pamundur ose shumë të vështirë të ndikojë në familjet e Kosovës dhe të konfiskojë këto materie ose këto produkte, siç është thëngjilli, e të tjera. Mirëpo Qeveria e Kosovës mundet dhe mendoj se duhet patjetër të bëjë fushata informuese për ndikimin e këtyre produkteve në shëndetin e popullit të Kosovës, e në veçanti në shëndetin e atyre familjeve që përdorin thëngjill dhe produkte të tjera helmuese.

I bëj thirrje Ministrisë së Mjedisit që të zbatohet në plotëni strategjia dhe plani i veprimit për ajrin që e ka. Në të njëjtën kohë u bëj thirrje edhe të gjitha komunave të Kosovës, por në veçanti kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, në të cilin është bërë gati e pamundur të jetohej sot, që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, të investojnë në ambient, të investojnë në gjelbërim dhe të na e lehtësojnë jetën të gjithë qytetarëve të Kosovës kudo që jetojnë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, deputeti Sali Zyba.

**SALI ZYBA:** Faleminderit kryesues! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar me vëmendjen më të përkushtuar dhe me konsultat edhe me profesionistë. Vlen të theksohet paraprakisht se ne si anëtarë në komisionin përkatës e kemi kundërshtuar, ndërsa është dominuar me votën dhe ka ardhur si raport. Arsyet tona kanë qenë të bazuara për raportin. Do të shkëpus këtu, të cek shumë mirë, mjaftueshëm, se ne kemi pasur kritika edhe vetëm për raportin, duke mos e përfshirë gjendjen e ambientit, se gjendja edhe ashtu është e rëndë dhe e keqe.

Pra po shkëpus disa pjesë të raportit. Siç e meriton edhe raporti, po filloj me fletën e fundit, d.m.th. po e përshkruaj gjendjen, sepse raporti vjen prej agjencisë. Ndërsa thuhet këtu në Prishtinë, në qershor 2018, ndërsa ne po flasim në fund të vitit. Edhe raporti paraprak është në këtë vit, për vitin 2016, ka ardhur në Kuvend. Këto vonesa në të njëjtën ditë të na vijjnë raporti për vitin 2017 dhe të njëjtën ditë të vijë buxheti, ndërsa të mungojë ministri kur është shqyrtuar

buxheti, është shumë e rëndë. Është e keqe edhe për faktin se gjendja është shumë e rëndë në Kosovë.

Po u referohem disa prej shkeljeve, disa prej pikave, ose parregullsish që përmban raporti, por edhe disa konkluzione që i ka nxjerrë vetë raporti. Në faqen 73, ministër, thuhet: “Ndonëse është rritur buxheti për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për projekte kapitale mjedisore dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, çështja e mjedisit në Kosovë ende trajtohet me prioritet të ulët të Qeverisë”.

Andaj këtu e parashtoj një pyetje, a është shkëputur prej kësaj gjendjeje dhe a është avancuar pak, të paktën si prioritet, duke pasur parasysh siç e ceka edhe më lart përkushtimin ose evidentimin në buxhet, për të cilin nuk e kemi konsideruar që është mjaftueshëm në ndryshim.

Ndërsa në faqen 72 thotë raporti kështu: “Aktualisht në nivel nacional grumbullohen rreth 60 për qind të mbeturinave të gjeneruara”. 40% të mbeturinave ku shkojnë? Duhet pasur këtu një përshkrim. Është një dobësi ose një mënyrë e dobët e raportimit. Sa u përket formave tabelare, ta kemi parasysh, raporti është vetëm një kopje e raporteve paraprake, në rastin më të mirë të mundshëm e ka ndërruar formën e ilustrimit. Në përshkrimet tabelare, ku kemi disa prej investimeve, po i veçoj disa. Po i përmend, në fakt, disa prej tyre, është hapja dhe pastrimi i shtratit në lumin Sitnica.

Ne e dimë shtratin dhe gjatësinë e lumit Sitnica, duhet pasur përshkrim në cilën komunë, në cilën pjesë të shtratit dhe cila ka qenë domosdoshmëria. D.m.th. janë investimet, nuk po i përmend shifrat. Ose për më tutje thotë: “Rregullimi i kanalizimit në Kamenicë, rregullimi i kanalizimit në Mitrovicë”. Ndoshta e kanë të rregulluar Kamenica, Mitrovica, Skenderaj, qysh janë të përshkuara, ndërsa nuk ka përshkrim si duhet, kjo është mënyrë e dobët e raportimi. Pra, po e cek për gjendjen në terren do të flasim në mënyra të tjera, por jemi duke folur vetëm për raportin. Ndërsa sa u përket të tjera investimeve, për shembull, në faqen 68 e kemi që thuhet se disa prej projekteve janë projekte mjedisore të implementuar nga buxheti i ministrisë për vitin 2017.

Një pikë tjetër është ndërtimi i deponisë së materialeve të ngurta në Prishtinë. Kur dhe ku është realizuar ky projekt? Flasim për 2017-ën thotë; janë projekte të realizuara. Nëse nuk është realizuar, do të duhej të thuhej të planifikuara.

E di, jam ballafaquar me këtë problem, me këtë dukuri, ku qytetarët nuk e kanë hapësirën ku duhet t'i orientojnë ose t'i destinojnë mbeturinat inerte, në këtë rast, ose kategori të ndryshme që u përafrohen këtyre...

Po kaloj te format tabelare, për masat që janë marrë. Sa i përket formës së raportimit, është shumë e dobët. Përveç raportimit që është i pakët, i mangët në raport me masat, me nevojat që

duhet të merren si masa, ne e kemi një përshkrim tabelar për qendrat prej nga vijnë, për masat që merren. Por, kemi raporte shumë të dobëta, ku thuhet, kur janë iniciuar procedurat, dy raste në komunë përkatëse ose për kah natyre, për kah natyra, për kah fusha kah vjen.

Qoftë te mjedisi kur kemi dënime nuk janë të evidentuara, qoftë te inspektimet, procedurat, ku janë shifra shumë të ulëta.

E marr një shembull tjetër, te lloji i aktivitetit ku i drejtohet parkut kombëtar “Sharri”, dhe po shkoj te ilustrimi në njërin prej komunave ku i përket, shtrirjen gjeografike që e ka parku nacional “Sharri” e përfshin ndër komunat më së shumti edhe Prizrenin.

Është kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prizren, është vetëm një rast. A është e mundshme të jetë vetëm një rast në parkun nacional “Sharri”, duke e pasur parasysh dëmet dhe gjendjen që e ka parku, shqetësimet që janë të qytetarëve dhe të zyrtarëve për atë gjendje atje.

Meqenëse vërejte kemi shumë, por do të jem dhe i shkurtër. Po i referohem vetëm gjendje ku thotë, faqe 17, kalova shumë shpejt nëpër këtë, vërehet se prej vitit 2013 deri në vitin 2017, në stacionet e vendosura në Prishtinë, Drenas, Obiliq, Gjilan, Han i Elezit janë vlera mesatare më të larta. Do të thotë për këtë periudhë kemi ngritje të shqetësimit, kemi konstatime që është gjendja me e rëndë.

Po flas vetëm për raportin edhe njëherë. Ky raport me të drejtë është cilësuar se nuk i plotëson kushtet. Sa i përket gjendjes së masave të ndërmarra në terren, prapë është i dobët.

Unë e kam një pyetje konkrete, ministër, meqenëse obligimi për raportim vjen për ministrinë, ndërsa ky përshkrim, ky raportim ka ardhur prej agjencisë përkatëse. Në rast se nuk kalon në Kuvend, në rast se nuk e merr votën e deputetëve, përfaqësuesve të qytetarëve, cili do të jetë hapi juaj konkret në stafin menaxherial të këtij raporti? Përveçse gjendja në terren, e në veçanti nëpërmjet vijave buxhetore nuk lë për të shpresuar, të paktën deklarimi juaj se çfarë masash do të merren ndaj zyrtarëve që nuk i kanë kryer obligimet.

Për mua është shqetësuese mënyra e raportimit, por edhe më shqetësuese është gjendja e qytetarëve dhe e hapësirës së mjedisit ku jetojmë dhe veprojmë në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i PSD-së, Salih Salihu.

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryesues!

Faleminderit, ministër!

Në qoftë se e merrni dhe e shikoni raportin, e shihni se si është gjendja e ambientit apo e mjedisit, më së miri tregojnë, thjesht, të gjeturat që i paraqet ky raport.

Që të mos i lexoj edhe një herë, mbase ministri i lexoi, e që ndoshta ministri do të duhej t'i lexonte më shumë rekomandimet që i janë drejtuar ministrisë së tij, sesa të gjeturat, mbase të gjeturat i ka bërë Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit.

Ajo që është pak a shumë paradoksale që Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërkaq të gjeturat i pasqyron mirë, ku thuhet se gjendja e mjedisit është shumë e rëndë në të gjitha fushat që i kanë përshkruar, i kanë paraqitur në raport.

Por, te rekomandimet i adresohet ministrisë dhe nëse i shikon rekomandimet, se çka duhet të ndërmarrë ministria që ta përmirësojë gjendjen e mjedisit në Kosovë, faktikisht e sheh qartë se janë përsëritur gjërat nga viti në vit, e sheh qartë se asgjë nuk është ndërmarrë në përmirësimin e mjedisit apo ambientit në përgjithësi në Kosovë.

Fatkeqësisht është një ministri, e cila me të vërtetë ka pësuar ndryshime, një ministër shkon e një vjen, dhe tani në komision ministri aktual tha që prej momentin që unë kam ardhur.

Përndryshe do të jem shumë më aktiv. Uroj të jetë ashtu, mirëpo deri më tash gjendja e mjedisit në Kosovë është katastrofale. Janë pyjet, janë ajri, janë tokat bujqësore, degradimi i saj dhe janë lumenjtë. Të gjitha këto janë në një gjendje shumë të rëndë dhe për t'i parandaluar këto natyrisht duhet një bashkëpunim ndërinstytucional, ndërministror, sepse nuk mund të bëhet vetëm vetë si ministri.

Unë e shoh që sivjet buxheti për ministrinë tuaj është rritur diku për 16 milionë euro, pra i keni gjithsej 70 milionë euro duke përfshirë një varg të projekteve kapitale që i keni në plan, por që t'i merrni seriozisht këto rekomandime që ju ka bërë Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit juve dhe këtë gjendje ta përmirësoni që në vitin tjetër të mos ndodhë të përsëritet i njëjti raport me të njëjtat të gjetura dhe përsëri t'ju adresohet të njëjtit ministër apo të njëjtës ministri.

Unë po e lexoj vetëm një rekomandim të përgjithshëm, s'po i shkoj pika-pika, se ka shumë pika, shumë rekomandime, por te rekomandimi i përgjithshëm, ku thotë që: të riprocedohet për miratim në Qeverinë e Kosovës dhe në Kuvendin e Kosovës strategjia shtetërore dhe plani i veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtje të mjedisit. Pra ende nuk ka ardhur për riprocedim në Kuvend dhe në Qeveri. Këtë mendoj se duhet lëvizje që duhet ta bëni shumë shpejt, sepse në Plan të veprimit janë të përshkruara domethënë të gjitha masat që duhet të ndërmerrni për të parandaluar këto probleme që lidhen me ambientin.

E fundit, zoti ministër, keni një dikaster, një ministri e cila e prek një fushë shumë të ndjeshme dhe e cila nuk bën dallime. Ne këtu flasim me të vërtetë, a e din pa ndonjë tendencë politike, por situata është e rëndë dhe ambienti është i gjithë shqiptarëve, i gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë, i gjithë fëmijëve tanë dhe ne kemi përgjegjësi secili nga ne. Për ndotjen e ambientit ne nuk mund sot të akuzojmë 20 vjet pas luftës dikë tjetër nga jashtë përveçse vetveten, përveçse dikasterin adekuat që ju udhëhiqni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve individualisht. Armend Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër i pranishëm,

Pajtohem plotësisht me parafolësin e fundit të kolegut që potencoi që mjedisi është hapësirë e përbashkët të cilën e shfrytëzojmë, por edhe ku jetojmë të gjithë ne pa dallim, qoftë në moshë, gjini, apo në fe e kulturë e në të gjitha. Mendoj se është preokupim i përbashkët që të kujdesemi për mjedisin dhe natyrën në Republikën e Kosovës. Kjo ministri siç duket në vazhden edhe të asaj që kritikave në të kaluarën, pasi edhe po flasim për një raport të viteve paraprake, por e mora fjalën ta shfrytëzoj praninë e ministrit për korrektësi, i cili është këtu i pranishëm në shqyrtimin e raportit dhe ta bëjmë një analogji edhe me të kaluarën.

Raporti në fjalë është raport formal dhe shihet që nuk i plotëson as kriteret procedurale të gjendjes aktuale çfarë rezulton në Republikën e Kosovës. Neve që jetojmë këtu mbi të gjitha edhe që udhëtojmë nëpër hapësira të ndryshme në Republikën e Kosovës e shohim gjendjen realisht. Problemet kryesore janë deponitë e mbeturinave, prerja ilegale e pyjeve, dëmtimi i tyre, gurthyesit para syve tanë dhe shikojeni gjendjen po flas në rrugën nacionale Prishtinë-Pejë se cila është gjendja nga gurthyesit dhe në brendësi të fshatrave të ndryshme në Republikën e Kosovës. Shpeshherë këto tema janë ngritur zoti ministër në Kosovë, disa janë edhe pjesë e këtij raporti, por masa nuk ka. Nuk po dëgjojmë madje as sot.

Unë dëshiroj që ta shfrytëzoj praninë tuaj, t'i ngre këto çështje, se në të ardhmen më duhet të kërkoj përgjegjësi. Ne kemi shpeshherë kur kemi potencuar elementet e degradimit të natyrës në rajone të ndryshme të Kosovës, kemi marrë përgjigje që Ministria do të intervenojë. Përpos vizitave formale, aktiviteti i degradimit ka vazhduar. Shembull konkret është gryka e Deçanit, është Lumëbardhi i Deçanit, pjesa më e bukur e atij vendi sot është në gjendje e cila nuk ka mbetur as për t'u vizituar dhe besoj që ju jeni të njoftuar për këtë. Ministrja paraprake ishte e njoftuar, e kishte një vizitë, nga ajo vizitë e tutje nuk ka ndonjë rezultat konkret. Andaj unë sot këtu do t'ju bëj një pyetje me kërkesë se cilat masat ju do t'i merrni dhe në të ardhmen do të shohim cili është angazhimi juaj personal edhe politik në këtë pjesë.



Pjesa tjetër ndërlidhet me deponitë e mbeturinave. Anembanë Kosovës ne kemi deponi ilegale. Jo edhe sot debatuar për dy çështje të rëndësishme. E para është jeta e rrezikuar e njerëzve, rritja e numrit me kancer dhe sëmundje të tjera në Republikën e Kosovës. Kjo dihet për shkakun dhe arsytet se cilat janë. Ne ndajmë miliona që t'iu ndihmojmë, qytetarët tanë shpenzojnë miliona, Ministria ju thatë që po kërkon edhe për një investim kapital "Ta pastrojmë Kosovën" me miliona, por rezultati është minimal. Kjo është shqetësim jo vetëm për neve si deputetë, por është shqetësim edhe për qytetarët e ndershëm, disa që paguajnë në mënyrë të rregullt për hedhjen e mbeturinave, sepse ka edhe asi që nuk paguajnë asnjëherë dhe kërkojnë që të kenë ambient të pastër. Kjo nuk do të mund të ndodhë pa një vetëdijesim edhe të përgjithshëm të qytetarëve të cilët jetojnë në këtë pjesë të Evropës e ne duhet të jemi shembull, sepse edhe në masat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ju e dini që një numër i madh i masave lidhen edhe me ambientin që janë pjesë e punës edhe përmbushjes së obligimeve edhe në ministrinë tuaj.

Prandaj, zoti ministër, ne nuk kemi dëgjuar deri më sot që në Ministrinë e Planifikimit dhe Ambientit apo edhe ajo pjesa tjetër që lidhet edhe me hapësirën, dikush është shkarkuar për mospërgjegjësi për të mbrojtur natyrën, edhe këto aferat korruptive që i kemi dëgjuar në Republikën e Kosovës. Cili është efekti i këtij raporti? Ne mund ta miratojmë sot, është procedurë, por mbetet te ju cilat masat ju do t'i ndërmerri. Asnjë zyrtar i një ndonjë agjencie, unë nuk jam këtu sot për të kërkuar heqje kokash dhe s'është interesim as i imi, edhe nuk e njoh asnjë njeri aty personalisht, por mendoj që përgjegjësia ka qenë zero. Madje më e ulët se zero, kur shohim që edhe disa fjali përmes këtij raporti në përmbushjen e saj janë në masë minimale, apo përafërsisht mbi atë pjesën 50 përqindësh, ndërsa pjesa tjetër ku ka mbetur.

Këta taksapagues të Republikës së Kosovës kërkojnë mbrojtje me ligj, jo në mënyrë fizike, as në mënyrë klanore dhe të grupeve të cilat jemi mësuar t'i shohim në Republikën e Kosovës, sidomos te pjesa që ndërlidhet me gurthyesit. Edhe këtu në Kuvend të Kosovës nuk po dua të parafrtoj as fjalime as diskutime, por njerëzit e lidhur me politikën qëndrojnë prapa gurthyesve të cilët e ndotin ambientin, me emra dhe mbiemra, edhe në Dukagjin, edhe në Drenicë, edhe në Anamoravë, edhe në pjesën qendrore të Kosovës, edhe në pjesën veriore dhe me krenari flasin shpeshherë edhe para qytetarëve të vendit. Andaj unë ju bëj thirrje juve sot këtu, në këto ora të vona edhe në këtë joseriozitet edhe të Qeverisë edhe të Kuvendit realisht kur shqyrtohen këto raporte dhe besoj që do t'i keni parasysh sepse si mandatar të këtij Kuvendi, si deputet shpeshherë do të kërkojmë edhe përgjigje nga ju se çka po ndërmerri në mandatin tuaj, aq sa ju lejon ligji dhe kushtetuta. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radhën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të përpiqem të flas shkurt, sepse ky raport i ambientit është shqetësues për faktin se gjendja e ambientit në Kosovë nuk është e mirë. Duke lexuar raportin, atëherë edhe mund të vijmë në një konstatim për arsyen e rritjes së shkallës së sëmundshmërisë në Kosovë, në veçanti ato të grupit të frymëmarrjes. Prandaj e përkrahi edhe propozimin e deputetit Andin Hoti që të investohet më shumë në gjelbërim, sepse ne që një kohë të gjatë jetojmë në Prishtinë, Prishtina dikur i kishte disa hapësira gjelbëruese por tani është shndërruar në qytet të betonit.

I nderuar ministër, edhe në raportin paraprak kur kemi shqyrtuar unë kam vërejtur disa shqetësime dhe kam dhënë disa propozime sa i përket disa çështjeve që duhet të përmirësohen ose që kanë për të pasur efekt. Njëra prej tyre ka qenë investimi në deponinë e Mirashit. Edhe atëherë e kam thënë dhe po e përsëris, por e kanë thënë edhe të tjerët përmes raporteve, përmes edhe emisioneve për këtë çështje, deponia e Mirashit është një bombë ekologjike. Pasojat e saj mund t'i vuajë edhe kryeqyteti, jo vetëm qyteti i Obiliqit, por edhe fshatrat përreth Obiliqit, por edhe deri në kryeqytet pasojat ekologjike të saj.

Për investime në këtë deponi është kërkuar nga viti 2019. Janë dhënë rekomandime Qeverisë që të investohet në sanimin e gjendjes së deponisë së Mirashit dhe menaxhmenti i kompanisë për menaxhimin e deponive dhe mbeturinave nga viti 2012 i drejton kërkesa të vazhdueshme Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për të investuar në këtë deponi, por ama bash një investim nuk është bërë. krejt ajo çka është riparuar, është sanuar, është falë punës së menaxhmentit të KMDK-së, i cili është menaxhment që ka marrë vlerësimin e Bankës Botërore si i vetmi menaxhment ndër më të mirët të vlerësuar në menaxhimin e financave publike dhe sanimin e gjendjes në deponi, sepse deri në vitin 2011 gjendja ishte katastrofale e disa prej këtyre deponive edhe digjeshin dhe krijonin edhe probleme të tjera ambientale.

Prandaj, i nderuar ministër, ju sugjeroj që të bashkëpunoni ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe të ndani mjete për të investuar në deponinë e Mirashit. Të sanohet gjendja atje, sepse edhe GIZ-i dhe Banka Botërore kanë qenë të gatshëm që të mbështesin financimin në këtë projekt, nëse edhe Qeveria ka gatishmërinë e saj.

Një tjetër problem që është, sepse ne flasim shumë për mbeturinën, por kurrë nuk kthehemi se cila është tarifa e trajtimit të një toni mbeturinë. Në Kosovë tarifa për trajtimin e mbeturinë është 5 euro e 33 centë. Ndërsa mesa di unë a qysh na vjen faktura ne si ekonomi familjare, e paguajmë 4 euro e 80 centë mujoren. Por ta trajtosh një ton mbeturinë, tarifa është 5,33. Është më e ulëta edhe në rajon, edhe në Evropë. Po jua krahasoj i nderuar ministër që ta keni parasysh këtë çështje dhe ta bisedoni me ministrin e Zhvillimit Ekonomik çështjen e ngritjes së tarifës për trajtimin e mbeturinës, sepse kjo nuk do të prodhojë efekt shpenzues për kompanitë, as për qytetarët, por do të jetë një mundësi më e mirë për ta sanuar gjendjen nëpër deponitë e mbeturinave.

Shqipëria e ka 15 euro për ton tarifën e trajtimit të mbeturinave, Maqedonia e ka 11 euro, Mali i Zi e ka 18 euro, Kroacia e ka 33 euro trajtimin e një ton mbeturinave, Rumania 15, ndërsa Suedia e ka 130 euro trajtimin e tonit të mbeturinës. Kjo është rëndësia që i kushtojnë vendet e tjera dhe ajo që ne i kushtojmë. Prej vitit 2012 përgjegjësi për ngritjen e tarifës është ministri i Zhvillimit Ekonomik, prandaj i nderuar ministër kërkoj që të bashkëpunoni ngushtë me ministrin e Zhvillimit Ekonomik për ngritjen e tarifës, sepse Banka Botërore ka propozuar dhe ka rekomanduar, edhe ka sugjeruar që e nevojshme është që të jetë 31 euro sipas kushteve tona çmimi për një ton të trajtimit të mbeturinës.

Por, unë po e them që edhe nëse arrijmë t'i afrohem 25 euroshit do të ishte e mirëseardhur dhe do të ndikonte drejtpërdrejt që të kemi një ambient më të mirë dhe më të pasur. unë mendoj që vërtet pas këtij raporti, ne duhet të ulemi bashkërisht, në veçanti Komisioni përgjegjës përkatës parlamentar dhe ju i nderuar ministër, edhe të ndërmerren hapat edhe në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe me organizatat financuese të cilat ndihmojnë në këto projekte të ambientit që vërtet të shkojmë duke e përmirësuar ambientin, sepse gjendja e ambientit në Kosovë nuk është e mirë dhe po e shihni që pothuajse çdo ditë të sezonit dimëror, Kosova renditet ndër vendet, ndër qytetet më të ndotura në Evropë dhe nganjëherë i afrohet edhe qyteteve për nga ndotja edhe atyre vendeve të tjera të botës sa i përket ndotjes së ambientit dhe në disa raste edhe ka prirë si qyteti më i ndotur në botë dhe kjo është shqetësuese, sepse kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e sëmundshmërisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radhën e ka deputeti Sali Zyba dhe s'ka deputet të tjerë të paraqitur.

**SALI ZYBA:** Faleminderit kryesues!

Ministër, po i kthehem pak diskutimit tash edhe si deputet, por meqenëse kur thash për mungesën e projekteve në ministrinë përkatëse, tash në këtë rast është një projekt Ta Pastrojmë Kosovën. Iniciativa që ta pastrojmë Kosovën, pa e bërë zgjidhjen e deponive që e përmendi edhe kolegu paraparak është një dëm për mënyrën e menaxhimit edhe trajtimit ligjor të mbeturinave dhe të ambientit, sepse në të kaluarën për vite me radhë kemi pasur iniciativa sidomos në kohë fushatash kur është ndërmarrë, janë caktuar parqe të biznesit, janë caktuar zona industriale. Me funksionim të atyre nuk janë plotësuar infrastruktura adekuate. Kemi që funksionojnë zona industriale, nuk e kanë rregullimin e impianteve. Nga një zonë industriale ne i dimë pasojat e rreziqet që vijnë për ndotjen e ambientit. Prandaj është kërkesë dhe tash do të duhej të sqaronit pak iniciativat për gjendjen ekzistuese të zonave industriale. Po i përmendi zonat industriale sepse trajtohen veçantë prej mënyrës, organizimit dhe menaxhimit të mbeturinave të veçanta, prandaj është shqetësim edhe i banorëve, edhe i zonave, prej nga vetë ato e shkaktojnë.

Ndërsa te raporti, e kemi në raport te të gjeturat kryesore të raportit e keni vlerësuar, thotë se: vlerësimet tregojnë që burimet kryesore të ndotjes janë sektori i energjisë, transporti dhe ai i

amvisërisë. Në vizitat që i kemi bërë ne në emër të Komisionit tash po flas, si anëtar i atij Komisioni, kemi bërë të termoelektranat, por edhe njëherësh edhe të qendra e homologimit dhe të disa mënyra të tjera që kemi vizituar. Këtu thuhet se ata nuk e pranojnë që janë shkaktarë. Nuk është përkufizimi i duhur, nuk është analiza dhe nuk është i mjaftueshëm konstatimi i ekspertëve se këto janë box për nga renditja, sepse në Komision ju e keni renditur, është numri një në dosje janë termocentralet, numri dy janë automjetet dhe numri tre janë amvisëritë. Ka qenë renditja edhe verbalisht e juaja në Komision. Prandaj edhe këtu duhet të kemi një konstatim të ekspertëve të fushave prej nga vijnë.

Ndërsa, për shqetësim të mënyra e raportimit e kam edhe formën ku kërkohen masat për mbrojtjen e mjedisit. Mënyra e raportimit, paraqitja e një varg ligjesh dhe normash ndërkombëtare, por edhe vendore, është shqetësuese, sepse ky raport përmban vetëm kësi gjërash. Për ta ilustruar më mirë këtë po i kthehem faqes 74, të rekomandimet. Ne e dimë që rekomandimet duhet të përmbahen diku, por jo të përmbahet ky komplet teksti ku thuhet, p.sh. të ajri, vetëm ajrin po e cek: të implementohet kërkesa e rezolutës së Kuvendit numër kaq. Të rekomandimet, çka është punua që duhet të bëhet, se rekomandimet, edhe urdhëresat, edhe ligjet i nxjerrë Kuvendi. Prandaj mos t'ia kthejmë një raport Kuvendit ku thuhet të rekomandimet është ky rekomandim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Meqë s'ka deputet të tjerë të paraqitur, fjalën e ka ministri për fjalën përfundimtare.

**MINISTRI FATMIR MATOSHI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Se sa është fokusimi i shoqërisë, ose sa ka qenë fokusimi i shoqërisë sonë në çështjet e ambientit, besoj e tregon edhe kjo situatë. Megjithatë, unë ju falënderoj juve të nderuar deputetë, sepse edhe ju keni mundur sikur më shumë se 100 të tjerë që nuk janë këtu, që mos të jenë në sallë, dhe të vijnë e të diskutojnë për çështje të ambientit dhe çështjet e mjedisit në të cilin po jetojmë.

Jam mundur t'i shënoj disa nga pikat të cilat ose shqetësimet që u ngritën. Po e them personalisht se nuk jam fare i shqetësuar nëse ky raport nuk aprovohet. Nuk është derti im aprovimi ose mosaprovimi i këtij raporti. I përshkruhet një periudhë për të cilën nuk jam përgjegjës dhe në të cilën nuk kam qenë në ministri.

Njëkohësisht, ju them sot se edhe raporti i periudhës për të cilën unë jam në krye të kësaj ministri nuk do jetë aq i mirë për shkak të problemeve të trashëguara vit pas viti, tash e 20 vjet të pasluftës, ku asnjë qeveri nuk është marrë seriozisht me çështje të ambientit. Kjo pjesë shumë e rëndësishme ka mbetur shpeshherë edhe si kusur për pazare politike ndërmjet subjekteve politike.

Dua t'ju them se kemi një fokusim më të madh të kësaj Qeveri. E kemi një përkushtim më të madh në fushën e ambientit dhe kemi hapa konkretë të ndërmarrë.

Më duhet t'ju them se pikërisht kjo ndërtesë është raportuar jo më shumë se dy vite më parë se është ngrohur me thëngjill, dhe shumë ndërtesa dhe objekte të tjera, institucione të tjera publike në Republikën e Kosovës.

Kemi kërkuar që të ndërpritet kjo praktikë, Qeveria ka marrë vendimin dhe përdorimi i thëngjillit si lëndë djegëse në institucionet publike është i ndërprerë.

A ka strategji për zëvendësim? Pyeti deputetja. Unë po ju them se zgjerimi i rrjetit të koogjenerimit është e vetmja strategji për momentin, sepse ne nuk kemi një strategji tjetër. Duhet të punohet në këtë drejtim më shumë. Edhe Termokosi e di që ka fonde. Ka fonde edhe Komisioni Evropian për këtë çështje, vetëm se duhet që këto projekte të mos mbeten shumë nëpër zyre, por më shpejt të fillojnë implementimin e të mos vonohemi.

Një çështje tjetër ishte raporti profesional i ekspertëve për ndotësit. Po ne jemi duke punuar me Qeverinë japoneze në përpilim e një raporti. Na është thënë se do të jetë në muajin nëntor. I kam takuar ekspertët japonezë, kanë kërkuar edhe pak kohë shtesë dhe maksimumi i kësaj kohe shtesë do të jetë muaji prill i vitit të ardhshëm, kur ne do të pranojmë një raport nga Xhajka japoneze për ndotësit kryesor të ajrit e sidomos të mjedisit në Kosovë.

Folët për deponitë ilegale. Këtu janë ato 40% të mbeturinave që nuk mblidhen. Se thatë 60% dhe 40% të tjera kur shkojnë. Shkojnë nëpër deponi ilegale.

Në aksionin “Ta pastrojmë Kosovën”, kemi arritur që t'i eliminojmë 707 deponi ilegale. Nuk e kemi bërë vetëm ne si ministri. E kanë bërë organizata joqeveritare, shoqëria civile, komunat, kryetarët e komunave. I falënderoj një për një të gjithë, edhe ata që subjektet e tyre politike i kanë këtu në opozitë edhe ata që i kanë në pozitë. Është mirë të bisedoni me ta dhe të shihni sepse kemi bërë një punë jashtëzakonisht të madhe. Kemi bërë në Gjilan, kemi bërë Vushtrri, kemi bërë në Prizren, kemi bërë në shumë komuna të Republikës së Kosovës, dhe i kemi eliminuar brenda një periudhe për më pak se tre muaj 707 deponi ilegale të mbeturinave.

Nuk është gjendja ajo që e dëshirojë, por sido që të jetë është shumë herë më e mirë.

Kemi filluar ta zbatojmë udhëzimin administrativ për gjoba për ata që hedhin mbeturina në vende të palejuara. Nuk jam shumë i lumtur dhe i kënaqur me atë se çka ka ndodhur brenda një muaji që ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi, por jemi në koordinim të përditshëm edhe policinë e Kosovës, edhe me kryetarët e komunave, edhe me inspektorët e ministrisë sonë, dhe

do ta arrijmë që ta zbatojmë këtë udhëzim administrativ plotësisht ose në masën më të madhe të mundshme.

Njëkohësisht nuk do të ndalemi duke plotësuar infrastrukturë tjetër për deponim të mbeturinave nëpër qytete dhe nëpër vende tona.

Folët për memorialët. Edhe kjo për mua personalisht është një sfidë. Unë nuk kam qenë më herët në qeverise qendrore. Nuk kam qenë as në Kuvend as në Qeveri, kam qenë në komunë. Por, mos harroni Agjencia për Menaxhimin e Memorialëve nuk është brenda Ministrisë së Mjedisit zonja deputete. Është një agjencion i pavarur.

Është një kompani për menaxhimin e deponive, është e pavarur prej Ministrisë së Mjedisit. Është një Komision për Miniera dhe Minerale që jep licenca për gurthyesit, është jashtë ministrisë. Këtë gjendje e kemi gjetur. Kjo është gjendja në të cilën jemi.

Të gjithë këta aktor dhe kjo shtrirje e kompetencave e shtrinë edhe përgjegjësinë dhe nuk mundemi sot ta drejtojmë gishtin për gurthyesit te një institucion i vetëm. Nuk mundemi për memorialët te një institucion i vetëm, sepse së voni është një agjenci atje për menaxhim të memorialëve dhe nuk ka të bëjë asgjë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Po ashtu për deponitë. Meqenëse e kemi një kompani për menaxhimin e deponive, ne si ministri mbështesim në rehabilitimin e deponive, në ndërtimin e deponive. Ne kemi dhënë Prizren 50 mijë euro sivjet. Nuk e di a do të arrijnë që t'i shpenzojnë. Kemi mbështetur Komunën e Prishtinës me 50 mijë euro sivjet. Kemi edhe nga 100 mijë vitin e ardhshëm. Pejën po ashtu. Dhe do vazhdojmë vit për vit të mbështesim në rehabilitim, në sanim, në rregullim të infrastrukturës së deponive të Kosovës.

Ne vetëm mund t'i mbështetim ata, sepse përgjegjësinë për menaxhimin e tyre nuk e kemi ne si ministri.

U tha për vonesë në dërgimin e raportit. Plotësisht pajtohem. I nderuar deputet ka ardhur pak tepër vonë, sado që më dërguan mesazh që ka ardhur shumë më herët dhe vonesat janë në Parlament, por që sot e shqyrtojmë raportin e vitit 2017 kjo pa dyshim që nuk është në rregull.

Folët për investime me emra të përveçëm edhe të lumenjve edhe të lumit Sitnica, por lumi Sitnica trajtohet në secilën komunë varësisht prej projekteve që i marrim. Është duke u trajtuar nëpër secilën që kalon. Ka mjetet buxhetore të ndara ose ka pasur në vitin 2018. Ka në vitin 2019. Për secilën pjesë të komunave që i prek ky lum.

Mund të ketë edhe projekte të atilla sikur që janë të padefinuara ashtu siç duhet, siç është rregullimi i kanalizimeve dhe përmendet vetëm emërtimi i komunës. Këto janë projekte me të cilat i mbështesim komunat dhe bashkojmë mjetet bashkë me to për t'i realizuar projektet e përbashkëta në interes të qytetarëve.

U fol për drejtoritë e parqeve kombëtare. Po është kriter që të kemi zona të mbrojtura, që të kemi parqe kombëtare. Këto parqe kombëtare nuk i ka shpallur ministria, i ka shpallur Parlamenti. Dhe në vazhdimësi, edhe ministria, edhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit parashtron kërkesa për rritjen e numrit të rojeve nëpër këto parqe. Deri më tash nuk kemi pasur sukses që të na aprovohen kërkesat e tilla. Do të ishte mirë që të aprovohen sepse janë njerëzit ata që do t'i ruajnë këto parqe.

Me sa arrita të shënoj, nuk e di nëse të kam mbetur diku borxh, sigurisht se po, por jam i gatshëm që të përgjigjem sërish dhe të diskutojmë më tutje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit zoti ministër! Tani tre kolegë deputetë janë paraqitur për replikë. Do t'i kenë nga dy minuta. Së pari, Besa Gaxherri.

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit, kryesues!

Dy minuta nuk besoj se do të më dalin, megjithatë...Po zoti ministër është e vërtetë që janë diku pesë agjenci; Agjencia Pyjore e Kosovës, Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit.

Agjencia për Menaxhim e Komplekseve Memorialë deri në këtë vit është menaxhuar ose buxheti është ndarë në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Unë kërkoja më parë dhe thashë, a keni menduar ndonjëherë që ta bëni ndonjë auditim që aty ka keqpërdorime të skajshme. Edhe konkretisht ju zoti ministër. Ju po thoni që e vetmja strategji për ndotjen e ambientit është koogjenerimi. Prej 66 milionëve investime kapitale, projektet të reja 37,9 milionë euro, çka ndarë ju për këtë aspekt. Në buxhetin për vitin 2019 asnjë cent nuk është ndarë në këtë drejtim në mënyrë që të zbutet çështja e ndotjes së ambientit, ose t'ju ndihmohet qytetarëve.

Qytetarët nuk mund t'i gjykojmë, dhe t'u themi që të mos ngrohen me thëngjill, dhe kështu t'i orientojmë kah drunjtë dhe të shkatërrohen pyjet. Ose të ngrohen me rrymë kur dihet se çfarë çmimi e kemi ne e aq më tepër kur dihet se në çfarë shkalle është varfëria e qytetarëve tanë. Ndërsa, ministria juaj apo Qeveria nuk punon në këtë drejtim fare. Nuk merret hiç me këtë çështje, veç ne mbajmë këso takimeve dhe diskutojmë, e konstatojmë se gjendja është alarmante, ndërsa nuk kemi asnjë lloj strategjie që vërtetë të dalim nga kjo situatë.

Nuk mund të fshihemi pas asaj se çfarë ka ndodhur dje, se ju do të shkoni dhe të vijë tjetri, por ai tjetri nuk mund të arsyetohet se ju nuk i keni përfunduar punët, por duhet ta marrë përgjegjësinë dhe të raportojë së paku, dhe ta bëjë ndarjen.

Ju duhet ta keni guximin që së paku që ta bësh ndarjen, se nëse dikush vërtetë se ka kryer punën. Të raportoni pse nuk është kryer puna.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministër, nëse dëshironi? Një minutë e keni.

**MINISTRI FATMIR MATOSHI:** Faleminderit!

Unë e nderuar deputete nuk jam auditor, që të bëj auditime. Nëse ju keni të dhëna që ka pasur keqpërdorime është mirë t'i dërgoni atje ku është vendi, ku është dikush tjetër që i heton.

Fokusimi im për kohën sa do ta drejtojë këtë ministri nuk është që të merrem me çështjet që kanë ndodhur në të kaluarën kur unë s'kam qenë aty. Janë çështje që i përkasin komplet dikujt tjetër.

E thatë, nuk keni investuar asnjë ose nuk keni paraparë asnjë cent në mbrojtjen e ambientit. Kjo nuk qëndron, nuk është e vërtetë. Nëse i lexoni me kujdes projektet e shihni që janë rreth 15 milionë euro që u dedikohen lumenjve, që ne konsiderojmë që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përmirësimin e ambientit në vend, sepse kemi një degradim të madh të tij.

Kemi 2,5 milionë euro në fushën e mjedisit në investime të drejtpërdrejta. Kemi në kuadër të buxhetit tonë edhe pjesë...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, replikë dy minuta. Besa, nuk ke të drejtë më.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit!

Unë i nderuar ministër përkrahi çdo aksion për pastrimin e ambientit, por aksioni i fundit i ka mangësitë e veta.

Eliminimi i deponive ilegale është urdhëruar që ato mbetura që janë grumbulluar të dërgohen në deponitë legale. Kompanitë për menaxhimin e deponive janë urdhëruar që të pranojnë këto mbeturina pa pagesë, përkundër kostos së lartë buxhetore, dhe ju vet e thatë që janë 700 deponi ilegale të cilat janë larguar, dhe për këtë ju u keni krijuar shpenzime kompanive për menaxhimin e deponive dhe s'i keni mbështetur me asnjë cent në asnjë komunë të Kosovës.

Nëse keni mbështetur ndonjë kompani, ndërmarrje komunale është diçka tjetër, por kompanitë për menaxhimin e deponive jo. Nuk ka mbështetje se sapo më shkruan me vet menaxherët e këtyre deponive.



Nuk ka ndonjë mbështetje për asnjë vit buxhetor nga Ministria e Ambientit për këto kompani, as për Mitrovicën, as për komunat tjera e as për këto të cilat janë në Komunën e Prishtinës.

E keni mbështetur “Pastrimin” është diçka tjetër, sepse jeni në bashkëqeverisje, ju kuptoj për atë. Faleminderit i nderuar ministër!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri ka prapë një minutë për kundër-replikë.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Jo kundër-replikë, vetëm sqarim.

Po i nderuar deputet, ministri i Zhvillimit Ekonomik ka marrë në vendim me të cilin ka kërkuar nga kompanitë për menaxhimin e deponive të mbeturinave që t’i pranojnë mbeturinat që grumbullohen nga vullnetarët, nga kompanitë, nga qytetarët përgjatë aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, t’i pranojnë pa pagesë.

Kjo është e vërtetë. Ekziston ky vendim. Ministri Lluka është zotuar se Ministria e Zhvillimit Ekonomik do t’i kompensojë dhe do t’i mbështesë këto deponi për këtë shpenzim, për këtë pjesë të fushatës sa jemi në tre muajt e aksionit dhe unë shpresoj që do t’i mbështesë, patjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba replikë dy minuta.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër përveç që isha i shkurtër në fjalën time, isha edhe shumë konkret. Në rast se nuk kalon ky raport i shkruar, masat e juaja ndaj zyrtarit, sepse po e citoj se me vete kam marrë edhe mënyrën e emërimit edhe të shkarkimit të zyrtarit, në këtë rast drejtorit.

Thotë: “Për shkak të dështimit të përmbushjes së mandatit të dhënë me këtë ligj”, në këtë rast me cilindo ligj. Pyetja ishte konkrete, çfarë masash merr ndaj atij zyrtari i cili nuk e ka përmbush, qoftë edhe si raportim? U përpjeka që gjendjen ta shkëpus gjithnjë, gjendja është shumë e rëndë. Por, raportimi zyrtar duhet të jetë në nivel siç e kërkojnë normat dhe standardet tona.

Prandaj, me deklarimin tënd, nuk jam fare i shqetësuar se a provohet raporti. Tash sapa na shqetësove të gjithëve. Ky deklaram publik të lutem, përgjegjësi duhet pasur edhe për mënyrën e komunikimit. E këtë lë për të dyshuar që edhe masat do duhej të ishin në nivel edhe ndaj menaxherit, por edhe e secilit rast veç e veç.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replika e fundit. Një minutë!

MINISTRI FATMIR MATOSHI: I nderuar deputet, mos u shqetëso fare për këtë punë. Edhe vetë e thatë, në rast se nuk kalon raporti dihen edhe masat.

KRYESUESI: Regjia, ju lutem ta mbyllni mikrofonin. Zoti ministër duhet të respektoni mënyrën e komunikimit në Kuvend dhe t'i respektoni deputetët si përfaqësues të popullit të Kosovës. Mund të vazhdoni.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Gjithsesi i nderuar nënkryetar!

Kam respekt për deputetin Zyba patjetër, po nuk ka nevojë që të shqetësohet deri në atë masë për shkak se mosaprovimi i raportit nënkupton pasojën që ka për hartuesin ose bartësin e atij institucioni që e ka hartuar këtë raport.

Kështu që parashihet ligji. Është vlerësim i punës së tij. Po gjithsesi, po nuk është në rregull që të shqetësoheni shumë kur dihet se çka ndodhë nëse nuk aprovohet raporti.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, jemi në fund të debatit të kësaj pike të rendit të ditës. S'kemi kuorum që të votojmë. Dy pika tjera të rendit të ditës së kësaj seance, për këto dy pika po ashtu duhet kuorum dhe ne s'kemi.

Kështu që mendoj se duhet ta ndërpresim seancën këtu, ndërkaq për kohën e vazhdimit të saj do të njoftoheni nga Administrata. Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*